

UDHËZIM Nr. 649, datë 20.3.2006

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.69, DATË 11.2.1999 "PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË"

UDHËZIM Nr. 646/1, datë 15.5.2006

MBI DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 646, DATË 20.03.2006 "MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.74, DATË 11.02.1999 "PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT NËPËRMJET MBËSHTETJES SË FORMIMIT INSTITUCIONAL""

UDHËZIM Nr. 647/1, datë 15.5.2006

MBI DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.647, DATË 20.03.2006 "MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 632, DATË 11.02.1999 "PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË PUNËKËRKUESEVE TË PAPUNA FEMRA""

UDHËZIM Nr. 648/1, datë 15.5.2006

MBI DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 648, DATË 20.03.2006 "MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 73, DATË 11.02.1999 "PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT, NËPËRMJET FORMIMIT NË PUNË""

UDHËZIM Nr. 646, datë 20.3.2006

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.74, DATË 11.2.1999 "PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT NËPËRMJET MBËSHTETJES SË FORMIMIT INSTITUCIONAL"

UDHËZIM

Nr. 647, datë 20.3.2006

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.632, DATË 18.09.2003 "PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË PUNËKËRKUESEVE TË PAPUNA FEMRA"

UDHËZIM Nr. 648, datë 20.3.2006

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.73, DATË 11.2.1999 "PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT, NËPËRMJET FORMIMIT NË PUNË"

VENDIM Nr.7, date 7.1.2005

PER MIRATIMIN E STRATEGJISE PER NXITJEN E PUNESIMIT NE ADMINISTRATEN PUBLIKE TE STUDENTEVE TE DIPLOMUAR JASHTE VENDIT

UDHËZIM Nr. 649/1, datë 15.5.2006

MBI DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 649, DATË 20.03.2006 "MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 69, DATË 11.02.1999 "PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË""

VENDIM Nr.816, datë 3.12.2004

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SUEDISË, PËR MBËSHTETJEN E PROJEKTIT TË SHËRBIMEVE EFIÇENTE TË PUNËSIMIT NË SHQIPËRI

LIGJ Nr.9320, datë 25.11.2004

PËR RATIFIKIMIN E "KONVENTËS NR.97 TË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS "PËR MIGRACIONIN PËR PUNËSIM", E RISHIKUAR"

VENDIM Nr.315, date 21.5.2004

PER NJE NDRYSHIM NE VENDIMIN NR.511, DATE 24.10.2002 TE KESHILLIT TE MINISTRAVE "PER KOHEZGJATJEN E PUNES DHE TE PUSHIMIT NE INSTITUCIONET SHTETERORE", TE NDRYSHUAR

**UDHEZIM Nr.73, date 14.1.2004
PER ZBATIMIN E VENDIMIT TE KESHILLIT TE MINISTRAVE NR.73, DATE 11.2.1999 "PER PROGRAMIN E NXITJES SE PUNESIMIT NEPERMJET FORMIMIT NE PUNE"**

**UDHEZIM Nr.74, date 14.1.2004
PER DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NE UDHEZIMIN NR.895, DATE 12.4.2000 "PER ZBATIMIN E VENDIMIT TE KESHILLIT TE MINISTRAVE NR.74, DATE 11.2.1999 "PER PROGRAMIN E NXITJES SE PUNESIMIT NEPERMJET MBESHTETJES SE FORMIMIT INSTITUCIONAL" "**

**UDHEZIM Nr. 75 date 14.1.2004
PER ZBATIMIN E VENDIMIT TE KESHILLIT TE MINISTRAVE NR.69, DATE 11.2.1999 "PER PROGRAMIN E NXITJES SE PUNESIMIT TE PUNEKERKUESVE TE PAPUNE"**

**UDHEZIM Nr.76, date 14.1.2004
PER ZBATIMIN E VENDIMIT TE KESHILLIT TE MINISTRAVE NR.632, DATE 18.9.2003 "PER PROGRAMIN E NXITJES SE PUNESIMIT TE PUNEKERKUESEVE TE PAPUNA FEMRA"**

**VENDIM Nr.730, date 6.11.2003
PER FUNKSIONIMIN E KESHILLIT KOMBETAR TE PUNES DHE PER CAKTIMIN E PERFAQESUESVE TE KESHILLIT TE MINISTRAVE NE KETE KESHILL**

**VENDIM Nr.726, date 30.10.2003
PER NJE NDRYSHIM NE VENDIMIN NR.511, DATE 24.10.2002 TE KESHILLIT TE MINISTRAVE "PER KOHEZGJATJEN E PUNES DHE TE PUSHIMIT NE INSTITUCIONET SHTETERORE"**

**VENDIM Nr.708. date 16.10.2003
PER MENYREN E LICENCIMIT DHE TE FUNKSIONIMIT TE AGJENCIVE PRIVATE TE PUNESIMIT**

**VENDIM Nr.632, date 18.9.2003
PER PROGRAMIN E NXITJES SE PUNESIMIT TE PUNEKERKUESVE TE PAPUNE, FEMRA**

**VENDIM Nr .309, date 15.5.2003
PER TRAJTIMIN E PUNONJESVE TE ADMINISTRATES SE ALBKROMIT SHA, QE SHKURTOHEN NGA PRIVATIZIMI DHE DHENIA ME KONCESION E INDUSTRISE SE KROMIT**

**LIGJ Nr.9034, date 20.3.2003
PER EMIGRIMIN E SHTETASVE SHQIPTARE PER MOTIVE PUNESIMI**

**VENDIM Nr .96, date 13.2.2003
PER PERCAKTIMIN PER VITIN 2003 TE NUMRIT TE PUNONJESVE TE INSTITUCIONEVE BUXHETORE**

VENDIM Nr. 61, date 23.1.2003

PER CAKTIMIN E NUMRIT TE PERFAQESUESVE TE ORGANIZATAVE TE PUNEMARRESVE DHE TE PUNEDHENESVE NE KESHILLIN KOMBETAR TE PUNES

V E N D I M Nr. 17, date 10.1.2003

PER DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NE STATUTIN E SHERBIMIT KOMBETAR TE PUNESIMIT, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 42, DATE 17.1.1998 TE KESHILLIT TE MINISTRAVE "PER MIRATIMIN E STATUTIT TE SHERBIMIT KOMBETAR TE PUNESIMIT", I NDRYSHUAR

VENDIM Nr. 67, date 10.1.2003

PER MIRATIMIN E STRATEGJISE SE PUNESIMIT DHE TE FORMIMIT PROFESIONAL

VENDIM Nr. 511, date 24.10.2002

PER KOHEZGJATJEN E PUNES DHE TE PUSHIMIT NE INSTITUCIONET SHTETERORE

L I G J Nr.8862, datë 7.3.2002

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7995, DATË 20.9.1995 "PËR NXITJEN E PUNËSIMIT", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8444, DATË 21.1.1999

L I G J Nr. 8857, datë 07.02.2002

PË DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7986, DATË 13.09.1995 "PËR INSPEKTIMIN SHTETËROR TË PUNËS", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR. 8394, DATË 02.09.1998

VENDIM Nr .262, date 25.5.2000

PER DHENIEN E LEJES PER PUNE SHTETASVE TE HUAJ

VENDIM Nr .263, date 25.5.2000

PER MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NE STATUTIN E SHERBIMIT KOMBETAR TE PUNESIMIT, E MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 42, DATE 17.1.1998, TE KESHILLIT TE MINISTRAVE, "PER MIRATIMIN E ST ATUTIT TE SHERBIMIT KOMBETAR TE PUNESIMIT"

VENDIM Nr. 307, date 1.7.1999

PER NJE NDRYSHIM NE VENDIMIN E KESHILLIT TE MINISTRAVE NR. 768, DATE 8.12.1998 "PER CAKTIMIN E PERFAQESUESVE TE ORGANIZATAVE TE PUNEMARRESVE DHE PUNEDHENESVE NE KESHILLIN KOMBETAR TE PUNES"

V E N D I M Nr.69, date 11.2.1999

PER PROGRAMIN E NXITJES SE PUNESIMIT TE PUNEKERKUESVE TE PAPUNE

V E N D I M Nr.70, date 11.2.1999

PER EVIDENTIMIN E PUNEKERKUESVE TE PAPUNE

V E N D I M Nr.71, DATE 11.2.1999

PER MENYREN E LICENCIMIT DHE TE FUNKSIONIMIT TE AGJENCIVE PRIVATE TE PUNESIMIT

V E N D I M Nr.73, date 11.2.1999

PER PROGRAMIN E NXITJES SE PUNESIMIT NEPERMJET FORMIMIT NE PUNE

V E N D I M Nr.74, date 11.2.1999

PER PROGRAMIN E NXITJES SE PUNESIMIT, NEPERMJET MBESHTETJES SE FORMIMIT INSTITUCIONAL

L I G J Nr.8444, DATE 21.1.1999
PER DISA SHTESA E NDRYSHIME NE LIGJIN NR.7995, DATE 20.9.1995 "PER NXITJEN E PUNESIMIT"

L I G J Nr.8394, DATE 2.9.1998
PER DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NE LIGJIN NR.7986, DATE 13.9.1995 "PER INSPEKTORATIN SHTETEROR TE PUNES"

V E N D I M Nr.357, datë 25.3.1996
PER RREGULLIMIN E KOHES SE PUNES DHE TE PUSHIMIT NE INSTITUCIONET E SPEKTAKLIT

V E N D I M Nr.358, datë 25.3.1996
PER RREGULLIMIN E KOHES SE PUNES DHE TE PUSHIMIT PER SHTYPIN E SHKRUAR DHE TE FOLUR

V E N D I M Nr.359, datë 25.3.1996
PER RREGULLIMIN E KOHES SE PUNES DHE PUSHIMIT TE ROJAVE DHE PUNONJESVE TE TJERE TE CILET PERMBUSHIN FUNKSIONE TE NGJASHME ME TA

V E N D I M Nr.360, datë 25.3.1996
PER RREGULLIMIN E KOHES SE PUNES DHE TE PUSHIMIT NE NDERMARRJET E TRANSPORTIT AUTOMOBILISTIK, HEKURUDHOR, DENTAR DHE AJROR DHE NDERMARRJET QE MIREMBAJNE DHE RIPAROJNE MJETET E TRANSPORTIT

V E N D I M Nr.429, datë 25.3.1996
PER KOHEN E PUNES DHE TE PUSHIMIT NE SISTEMIN E SHENDETESISE

V E N D I M Nr.430, datë 25.3.1996
PER RREGULLIMIN E KOHES SE PUNES E TE PUSHIMIT NE NDERMARRJET QE SIGUROJNE FURNIZIMIN ME BUKE DHE TE MIRA MATERIALE QE DEMTOHEN SHPEJT

V E N D I M Nr.431, datë 25.3.1996
PER RREGULLIMIN E KOHES SE PUNES E TE PUSHIMIT NE NDERMARRJET E KONSERVAVE, KOPSHTARISE, PYJEVE DHE KULLOTAVE

L I G J Nr.7995, datë 20.9.1995
PER NXITJEN E PUNESIMIT

L I G J Nr.7986, datë 13.9.1995
PER INSPEKTORATIN SHTETEROR TE PUNES

VENDIM Nr.470, datë 12.9.1994
PER RREGULLIMIN E KOHES SE PUNES DHE PUSHIMIT NE INSTITUCIONET BUXHETORE TE SISTEMIT TE MINISTRISE SE KULTURES, RINISE DHE SPORTEVE

VENDIM Nr. 400, date 22.8.1994
PER NJE SHTESE NE VENDIMIN E KESHILLIT TE MINISTRAVE NR. 314, DATE 30.6.1993 "PER RREGULLIMIN E KOHES SE PUNES DHE TE PUSHIMIT NE MINISTRI, INSTITUCIONE TE TJERA QENDRORE DHE ORGANET E PUSHTETIT LOKAL"

V E N D I M Nr.297, datë 30.6.1994
PER RREGULLIMIN E KOHES SE PUNES DHE PUSHIMIT NE INSTITUCIONET SHENDETESORE

V E N D I M Nr.314, datë 30.6.1993
PER RREGULLIMIN E KOHES SE PUNES DHE TE PUSHIMIT NE MINISTRITE, DHE INSTITUCIONET E TJERA QENDRORE DHE ORGANET E PUSHTETIT LOKAL

L I G J
PER MARREDHEINIET E PUNES

L I G J
PER PUNESIMIN E SHTETASVE SHQIPTARE JASHTE TERRITORIT RE REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D I M Nr. 140, datë 03.04.1991
**PËR DETYRAT E TË DREJTAT E KOMITETIT TË PUNËS DHE TË EMIGRIMIT EKONOMIK
D E K R E T PËR LEJIMIN E PUNËSIMIT JASHTË SHTETIT DHE KRIJIMIN E KOMITETIT
TË PUNËS DHE TË EMIGRIMIT EKONOMIK**

UDHËZIM

Nr. 649, datë 20.3.2006

MBI ZBATIMIN E **VENDIMIT** TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.69, DATË 11.2.1999 "PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në zbatim të pikës 8 të **VENDIMIT** të Këshillit të Ministrave nr.69, datë 11.2.1999 "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë" dhe të nenit 18/1 të Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, miratuar me **VENDIMIN** e Këshillit të Ministrave nr.42, datë 17.1.1998 "Për miratimin e Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit" i ndryshuar, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

UDHËZON:

1. Ka të drejtë të aplikojë në programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë çdo punëdhënës, i cili është person juridik apo fizik.
 2. Punëdhënësit që aplikojnë duhet të plotësojnë këto kushte:
 - i) nuk duhet të kenë bërë pushime nga puna (pa shkaqe të arsyeshme) në një periudhë njëvjeçare përpara aplikimit për programin e nxitjes së punësimit;
 - ii) të kenë derdhur rregullisht sigurimet e detyrueshme për një periudhë të paktën njëvjeçare;
 - iii) të mos kenë pasur shkelje të legjislacionit të punës të verifikuara nga Inspektorati i punës për një periudhë njëvjeçare.
 3. Për të përfutur nga ky program, punëdhënësi duhet të paraqesë pranë zyrës kompetente të punësimit të rrethit ku ai zhvillon aktivitetin, dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) **VENDIMIN** e gjykatës së rrethit për regjistrimin si person juridik/fizik (në **VENDIMIN** e gjykatës duhet të jetë përfshirë aktiviteti për të cilin kërkon të punësojë punëkërkuesit e papunë).
 - b) Certifikatën e regjistrimit në organin tatimor.
 - c) Informacion mbi:
 - i) përshkrimin e detajuar të aktivitetit që kryen,
 - ii) numrin e fuqisë punëtore,
 - iii) listën e punëtorëve të punësuar dhe të siguruar para aplikimit për përfitim për programe nxitje punësimi,
 - iv) nivelin e pagës që ai ka dhënë për çdo person.
 - ç) Vërtetim për kontributet e paguara për sigurimet shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesin, që lëshohen nga organi tatimor përkatës.
 - d) Vërtetim për periudhën pararendëse (për të paktën 1 vit) për pagesën e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe numrin e personave të siguruar, të lëshuar nga organet e sigurimeve shoqërore;
 - dh) Numrin e llogarisë bankare.
 - e) Një informacion mbi:
 - i) numrin e punëmarrësve që kërkohen të punësohen,
 - ii) profesionin për të cilin do të punësohen,
 - iii) përshkrimin e aktivitetit që do të kryejnë këta punëtorë,
 - iv) kohëzgjatjen e punësimit,
 - v) llojin e kontratës që kërkon të zbatojë,
 - vi) nivelin e pagës.
 - ë) Një plan biznesi ku të jetë e justifikuar rritja e menjëhershme e fuqisë punëtore dhe kushtet e punës, pajisjeve dhe ambienteve.
 - f. Vërtetim nga dega e tatim-taksave e rrethit ku ushtron veprimtarinë personi juridik/fizik, për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe numrin e personave të siguruar për tre muajt e fundit.
- Me të dhënat e dokumentacionit të mësipërm, punëdhënësi, në bashkëpunim me zyrën

kompetente të punësimit, plotëson formularin përkatës.

4. Inspektori i Inspektoratit Rajonal dhe Vendor të Punës, bën verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti sipas germave c dhe e dhe shprehet brenda 7 ditëve mbi vërtetësinë e këtij dokumentacioni, si dhe korrektesinë e subjektit ndaj legjislacionit të punës. Marrëdhëniet midis tyre rregullohen me urdhrin nr.418, datë 25.2.2004 të Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale.

5. Zyra kompetente e punësimit shpall në media, çdo fillim viti, numrin e projekteve që do të financojë sipas prioriteteve të vendosura nga Ministri. Vetëm në rastet kur për një projekt ka të paktën tre aplikues, zyra e punësimit ia paraqet ato Këshillit Lokal Trepalësh, i cili shqyrton dhe vendos mbi dobishmërinë social-ekonomike të projekteve që do të kërkohen të financohen.

6. Pas miratimit në parim të projekteve në Këshillin Lokal Trepalësh, zyra kompetente e punësimit i rendit aplikimet sipas prioriteteve të vendosura nga Ministri dhe i dërgon për miratim si më poshtë:

- Zyra vendore e punësimit, dërgon për miratim të gjitha projektet, sipas rastit, në zyrën rajonale të punësimit ose në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

- Zyra rajonale e punësimit miraton projektet, kur aplikues janë ndërmarrjet e vogla në kuptim të **LIGJit** nr.8957, datë 17.10.2002 "Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme" dhe dërgon për miratim në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit projektet ku aplikues janë ndërmarrjet që kanë mbi 21 të punësuar.

Sipas **LIGJit** të sipërpërmendur:

I. Ndërmarrjet e vogla janë ndërmarrjet të cilat:

a) punësojnë 6-20 punonjës;

b) xhiroja ekonomike vjetore e tyre nuk e kalon shumën 40 milionë lekë;

c) 100 për qind e kapitalit të këtyre ndërmarrjeve zotërohet nga subjekte, të cilat, në kuptim të **LIGJit** të sipërpërmendur, klasifikohen si ndërmarrje të vogla.

II. Ndërmarrjet e mesme janë ndërmarrjet të cilat:

a) punësojnë 21-80 punonjës;

b) xhiroja ekonomike vjetore e tyre nuk e kalon shumën 80 milionë lekë;

c) më pak se 25 për qind e kapitalit të këtyre ndërmarrjeve zotërohet nga subjekte, të cilat, në kuptim të **LIGJit** të sipërpërmendur, nuk klasifikohen si ndërmarrje të vogla dhe të mesme.

7. Në rastet kur aplikues janë ndërmarrje të vogla në kuptimin e numrit të punonjësve, por me përfitimin e financimit sipas këtij programi hyjnë te ndërmarrjet e mesme, aplikimi dërgohet për miratim në komisionin e ngritur në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

8. Mënyra e vlerësimit të projekteve nga komisionet përcaktohet në një rregullore të miratuar nga Këshilli Administrativ Trepalësh i SHKP-së.

9. Për zbatimin e pikës 6 të këtij **UDHËZIMI** ngrihen komisionet përkatëse për miratimin e projekteve dhe konkretisht:

a) në çdo zyrë rajonale punësimi ngrihet komisioni i miratimit të projekteve.

b) në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit ngrihet komisioni i miratimit të projekteve.

Mënyra e funksionimit të metodikës së punës dhe përbërjes së komisioneve përcaktohet me rregullore të veçantë të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

10. Komisioni i zyrës rajonale të punësimit vendos për miratimin ose jo të një projekti brenda 20 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për aplikim nga punëdhënësit. Komisioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit vendos për miratimin ose jo të një projekti brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes për aplikim nga punëdhënësit.

11. Për projektet e miratuara zyra kompetente e punësimit, në bashkëpunim me punëdhënësin, plotësojnë listën e punëkërkuesve të papunë që do të përfshihen në program. Punëkërkuesit e papunë që përfshihen në program duhet të jenë të regjistruar në zyrat e punësimit për një periudhë të paktën tremujore.

Ndërmjet zyrave kompetente të punësimit dhe punëdhënësit nënshkruhet një kontratë ku përfshihen të drejtat dhe detyrat që përcakton programi për secilën palë. Kontratat e lidhura

ndërmjet punëdhënësit dhe zyrave kompetente të punësimit janë të vlefshme vetëm për vitin kalendarik.

Në rastet kur financimi vazhdon për vitin pasardhës, shtesa përkatëse në kontratë bëhet pasi kryhet një vlerësim për zbatimin e projektit me kontratën e parë.

12. Në zbatim të pikës 1 të **VENDIMIT** për çdo të punësuar punëdhënësi përfiton:

- a) Kompensim mujor për pagë në masën 70% të pagës minimale në shkallë vendi;
- b) Kompensim mujor për sigurimet e detyrueshme shoqërore e shëndetësore në masën 100% duke iu referuar **VENDIMIT** të Këshillit të Ministrave nr.402, datë 11.6.2001 "Për disa çështje në zbatim të **LIGJIT** nr.7703 datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

13. Financimi ndaj subjektit bëhet duke iu referuar nivelit të pagës minimale në shkallë vendi, për efekt të zbatimit të këtij **VENDIMI**.

14. Në zbatim të pikës 2, zyra kompetente e punësimit në bashkëpunim me punëdhënësin plotëson listën e punëkërkuësve të papunë që do të përfshihen në këtë program.

Për efekt zbatimi të pikës 2 të **VENDIMIT**:

a) Paragrafi 1. Punëdhënësi përfiton financim mujor të barabartë me shumën e 5 pagave minimale në shkallë vendi dhe shpenzimet për sigurime të detyrueshme për çdo të punësuar. 4 paga dhe sigurimet e detyrueshme për katër muaj financohen në katër muajt e parë të zbatimit të kontratës dhe 1 pagë dhe sigurimet e detyrueshme për një muaj në muajin e fundit të zbatimit të kontratës.

b) Paragrafi 2. Në rastin kur punëdhënësi ka përfituar më parë sipas pikës 1 të **VENDIMIT**, atëherë financimi mujor që ai përfiton është i barabartë me shumën e 3 pagave minimale në shkallë vendi dhe shpenzimet për sigurimet e detyrueshme. 2 paga dhe sigurimet e detyrueshme jepen në dy muajt e parë të zbatimit të kontratës dhe 1 pagë dhe sigurimet e detyrueshme jepen në muajin e fundit të zbatimit të kontratës.

15. Në zbatim të pikës 3 të **VENDIMIT** të Këshillit të Ministrave nr.69, datë 11.2.1999

a) Në rast se personat e punësuar nuk kanë formimin e duhur profesional, për proceset e punës për të cilat do të punësohen (e evidentuar me formularin tip) punëdhënësi fiton 20% shtesë të kompensimit për punësimin sipas pikës 1 të **VENDIMIT** dhe për pikën 2 të **VENDIMIT** rritje të subvencionit në masën 10%.

b) Kur për ngritjen profesionale të personave të punësuar kërkohen masa të veçanta dhe shpenzime shtesë që detyrohet t'i kryejë punëdhënësi, ai në aplikimin e tij duhet të paraqesë edhe shpenzimet që do të kryhen për përgatitjen profesionale në formën e buxhetit të trajnimit.

c) Komisioni përkatës vendos për financimin e tyre në rastet kur ai e shikon të nevojshme dhe të argumentuar.

16. Në zbatim të pikës 4 të **VENDIMIT** të Këshillit të Ministrave nr.69, datë 11.2.1999, punëdhënësi përfiton shtesë të kompensimit për personat e punësuar, të cilët janë përfitues të programit të pagesës së papunësisë në masë proporcionale me numrin e muajve të pagesës së papunësisë që shkurtohen.

Kontratës së nënshkruar ndërmjet zyrës kompetente të punësimit dhe punëdhënësit i bashkëngjitet lista e personave të punësuar që janë përfitues të pagesës së papunësisë dhe kompensimi mujor për pagë

- rritet 3% për çdo muaj pagese papunësie që shkurtohet në rastin e punësimit sipas pikës 1 të **VENDIMIT**;

- shtohet subvencionit në masë 25% të shumës së mbetur për t'u paguar si pagesë papunësie për rastin e punësimit sipas paragrafit të parë të pikës 2 të **VENDIMIT**.

Për efekt zbatimi të kësaj pike, i referohemi nivelit bazë të pagesës së papunësisë.

17. Në zbatim të pikës 5 të **VENDIMIT** të Këshillit të Ministrave nr.69, datë 11.2.1999, punëdhënësi përfiton shtesë të kompensimit për personat që janë punësuar, të cilët janë pjesëtarë të familjeve të trajtuara nga programi i ndihmës ekonomike në masë proporcionale me ndihmën ekonomike që familja ka përfituar në vitin e fundit kalendarik.

Kontratës së nënshkruar ndërmjet zyrës kompetente të punësimit dhe punëdhënësit, i bashkëngjitet lista e personave të punësuar që janë pjesëtarë të familjeve përfituese të ndihmës

ekonomike.

Për punësimin, sipas pikës 1 të **VENDIMIT**, kompensimi mujor për pagë rritet 2% për çdo muaj ndihmë ekonomike të plotë dhe 1% për çdo muaj ndihmë ekonomike të pjesshme (në varësi të llojit të ndihmës që përfiton familja në të cilën bën pjesë i punësuar). Për personat e punësuar sipas paragrafit të parë të pikës 2 të **VENDIMIT**, punëdhënësi fiton shtesë subvencioni në masën 10% të shumës së paguar për ndihmë ekonomike në vitin e fundit kalendarik.

18. Në zbatim të pikës 6 të **VENDIMIT** të Këshillit të Ministrave nr.69, datë 11.2.1999, zyra kompetente e punësimit, llogarit, nëpërmjet formularit të personave të punësuar që janë përfitues të pagesës së papunësisë, fondet e kursyera nga ai program, të cilat i kalojnë në masën 100% buxhetit të këtij programi.

19. Në zbatim të pikës 7 të **VENDIMIT** të Këshillit të Ministrave nr.69, datë 11.2.1999, zyra kompetente e punësimit llogarit, nëpërmjet formularit të personave të papunë të punësuar pjesëtarë të familjeve përfitues të ndihmës ekonomike, fondet që përfiton buxheti i programit. Për personin që punësohet sipas pikës 1 të **VENDIMIT** sasia e fondeve që transferohen është 30% e ndihmës ekonomike të plotë për një familje me 4 persona për një periudhë të barabartë me kohën e punësimit. Për punësimin sipas paragrafit të parë të pikës 2 të **VENDIMIT** për çdo person që punësohet nga programi i ndihmës ekonomike transferohet një fond i barabartë me 30% të shpenzimeve që programi i ndihmës ekonomike ka bërë për familjen e personit, gjatë vitit të fundit kalendarik.

20. Marrëdhëniet midis zyrave kompetente të punësimit, punëdhënësit dhe punëkërkesve të papunë të punësuar sipas këtij programi, vendosen në marrëveshje të përbashkëta midis tyre. Punëdhënësi dhe punëmarrësi nënshkruajnë një kontratë për kushtet e punësimit të personave që punësohen. Kontrata përmban në çdo rast emrat e të gjithë personave që do të angazhohen në program.

21. Në rastet ku punëmarrësit e punësuar sipas këtij programi largohen përpara afatit të përcaktuar në kontratë, punëdhënësi duhet të bëjë njoftim në zyrën e punësimit. Punëmarrësit e larguar nuk zëvendësohen.

22. Zyra kompetente e punësimit përpilon dhe dërgon çdo muaj në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit informacione në lidhje me projektet, zbatimin e tyre, personat e punësuar, përfituesit e programeve të mbështetjes me të ardhura, punëkërkesit e papunë etj.

23. Procedurat e mëtejshme për përdorimin e fondeve të nxitjes së punësimit, përcaktohen në **UDHËZIMIN** e përbashkët të Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Ministrit të Financave nr.1, datë 5.2.2001 "Për kriteret dhe procedurat e subvencionimit për të nxitur punësimin".

24. Procedurat për zbatimin e këtij programi, formularët tip, kontratat tip, marrëveshjet tip, përcaktohen me rregulloren metodike të zbatimit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

Kontratat dhe marrëveshjet tip të miratuara, të shërbejnë vetëm si udhëzues për punonjësit e zyrave të punësimit, ndërkohë që ato duhet të rishkruhen për çdo rast lidhje kontrate me subjekte të ndryshme.

25. Për përparësitë dhe fushat prioritare ku do të zbatohet programi, të zbatohet urdhri i nxjerrë çdo fillim viti nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

26. **UDHËZIMI** nr.75, datë 14.1.2004 "Mbi zbatimin e **VENDIMIT** të Këshillit të Ministrave nr.69, datë 11.2.1999 "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkesve të papunë", i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky **UDHËZIM** hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KOÇO BARKA
MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA

UDHËZIM

Nr. 646/1, datë 15.5.2006

MBI DISA NDRYSHIME NË **UDHËZIMIN** NR. 646, DATË 20.03.2006 "MBI ZBATIMIN E **VENDIMIT** TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.74, DATË 11.02.1999 "PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT NËPËRMJET MBËSHTETJES SË FORMIMIT INSTITUCIONAL"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në zbatim të pikës 8 të **VENDIMIT** të Këshillit të Ministrave nr.74, datë 11.02.1999 "Për programin e nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit institucional" dhe të nenit 18/1 të Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, miratuar me **VENDIM**in e Këshillit të Ministrave nr.42, datë 17.01.1998 "Për miratimin e Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit", i ndryshuar", Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

UDHËZON:

Në **UDHËZIM**in nr.646, datë 20.03.2006 "Mbi zbatimin e **VENDIMIT** të Këshillit të Ministrave nr.74, datë 11.02.1999 "Për programin e nxitjes së punësimit nëpërmjet mbështetjes së formimit institucional", bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2 riformulohet si vijon:

"Punëdhënësit që aplikojnë duhet të plotësojnë këto kushte:

- i) nuk duhet të kenë bërë pushime nga puna (pa shkaqe të arsyeshme) për aq kohë sa kryen aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare;
- ii) të kenë derdhur rregullisht sigurimet e detyrueshme për aq kohë sa kryejnë aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare;
- iii) të mos kenë pasur shkelje të legjislacionit të punës të verifikuara nga Inspektorati i Punës për aq kohë sa kryejnë aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare.

2. Paragrafi "ç" i pikës 3 riformulohet si vijon:

"ç) Vërtetim nga dega e tatim-taksave ku ushtron veprimtarinë personi juridik/fizik, për shlyerjen e detyrimeve tatimore, për aq kohë sa kryen aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare."

3. Në fjalinë e dytë të pikës 4 shprehja ".. 418 datë 25.02.2004 të ..", zëvendësohet me lidhëzën "e".

4. Pika 6 riformulohet si vijon:

"Zyra kompetente e punësimit ia paraqet projektet Këshillit Lokal Trepalësh, i cili i shqyrton dhe vendos mbi dobishmërinë social-ekonomike të projekteve që do të kërkohen të financohen."

5. Pika 8 riformulohet si vijon:

"Mënyra e vlerësimit të projekteve përcaktohet në rregulloret e komisioneve.

6. Në paragrafin e parë të pikës 24 shprehja "... të Këshillit Administrativ Trepalësh .." hiqet.

Ky **UDHËZIM** hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇESHTJEVE SOCIALE

DHE SHANSEVE TË BARABARTA

Koço Barka

UDHËZIM

Nr. 647/1, datë 15.5.2006

MBI DISA NDRYSHIME NË **UDHËZIMIN** NR.647, DATË 20.03.2006 "MBI ZBATIMIN E **VENDIMIT** TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 632, DATË 11.02.1999 "PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË PUNËKËRKUESEVE TË PAPUNA FEMRA"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në zbatim të pikës 8 të **VENDIMIT** të Këshillit të Ministrave nr.632, datë 11.02.1999 "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papuna femra" dhe të nenit 18/1 të Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, miratuar me **VENDIMIN** e Këshillit të Ministrave nr.42, datë 17.01.1998 "Për miratimin e Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit", i ndryshuar", Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

UDHËZON:

Në **UDHËZIMIN** nr.647, datë 20.03.2006 "Mbi zbatimin e **VENDIMIT** të Këshillit të Ministrave nr.632, datë 11.02.1999 "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papuna femra", bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2 riformulohet si vijon:

"Punëdhënësit që aplikojnë duhet të plotësojnë këto kushte:

- i) nuk duhet të kenë bërë pushime nga puna (pa shkaqe të arsyeshme) për aq kohë sa kryen aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare;
- ii) të kenë derdhur rregullisht sigurimet e detyrueshme për aq kohë sa kryejnë aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare;
- iii) të mos kenë pasur shkelje të legjislacionit të punës të verifikuara nga Inspektorati i Punës për aq kohë sa kryejnë aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare.

2. Në pikën 3 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Në paragrafin "e" shprehja në kllapa "(për të paktën 1 vit)" zëvendësohet me shprehjen "(për aq kohë sa kryen aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare)"

Pika "i" riformulohet si vijon:

"i) Vërtetim nga dega e tatim-taksave ku ushtron veprimtarinë personi juridik/fizik, për shlyerjen e detyrimeve tatimore, për aq kohë sa kryen aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare."

3. Në fjalinë e dytë të pikës 4 shprehja "... 418 datë 25.02.2004 të ...", zëvendësohet me lidhëzën "e".

4. Në pikën 5 fjalia e dytë riformulohet si vijon:

"Zyra kompetente e punësimit ia paraqet projektet Këshillit Lokal Trepalësh, i cili i shqyrton dhe vendos mbi dobishmërinë social-ekonomike të projekteve që do të kërkohen të financohen."

5. Pika 8 riformulohet si vijon:

"Mënyra e vlerësimit të projekteve përcaktohet në rregulloret e komisioneve.

6. Në pikën 22 fjalia e fundit ndryshohet si vijon:

"Zyra e punësimit merr masa për zëvendësimin e punëmarrësve të larguar."

Ky **UDHËZIM** hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Koço Barka

UDHËZIM

Nr. 648/1, datë 15.5.2006

MBI DISA NDRYSHIME NË **UDHËZIMIN** NR. 648, DATË 20.03.2006 "MBI ZBATIMIN E **VENDIMIT** TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 73, DATË 11.02.1999 "PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT, NËPËRMJET FORMIMIT NË PUNË"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në zbatim të pikës 6 të **VENDIMIT** të Këshillit të Ministrave nr.73, datë 11.02.1999 "Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë" dhe të nenit 18/1 të Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, miratuar me **VENDIM**in e Këshillit të Ministrave nr.42, datë 17.01.1998 "Për miratimin e Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit" i ndryshuar", Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

UDHËZON:

Në **UDHËZIM**in nr.648, datë 20.03.2006 "Mbi zbatimin e **VENDIMIT** të Këshillit të Ministrave nr.73, datë 11.02.1999 "Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë", bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

1. Pika 2 riformulohet si vijon:

"Punëdhënësit që aplikojnë duhet të plotësojnë këto kushte:

- i) nuk duhet të kenë bërë pushime nga puna (pa shkaqe të arsyeshme) për aq kohë sa kryen aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare;
- ii) të kenë derdhur rregullisht sigurimet e detyrueshme për aq kohë sa kryejnë aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare;
- iii) të mos kenë pasur shkelje të legjislacionit të punës të verifikuara nga Inspektorati i Punës për aq kohë sa kryejnë aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare.

2. Në pikën 3 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Në paragrafin "d." shprehja në kllapa "(për të paktën 1 vit)" zëvendësohet me shprehjen "(për aq kohë sa kryen aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare)"

Pika "f" riformulohet si vijon:

"f) Vërtetim nga dega e tatim-taksave ku ushtron veprimtarinë personi juridik/fizik, për shlyerjen e detyrimeve tatimore, për aq kohë sa kryen aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare."

3. Në fjalinë e dytë të pikës 4 shprehja "... 418 datë 25.02.2004 të ...", zëvendësohet me lidhëzën "e".

4. Në pikën 5 fjalia e dytë riformulohet si vijon:

"Zyra kompetente e punësimit ia paraqet projektet Këshillit Lokal Trepalësh, i cili i shqyrton dhe vendos mbi dobishmërinë social-ekonomike të projekteve që do të kërkohen të financohen."

5. Pika 8 riformulohet si vijon:

"Mënyra e vlerësimit të projekteve përcaktohet në rregulloret e komisioneve.

6. Në pikën 16 fjalia e fundit ndryshohet si vijon:

"Zyra e punësimit merr masa për zëvendësimin e punëmarrësve të larguar."

7. Në paragrafin e parë të pikës 24, shprehja "... të Këshillit Administrativ Trepalësh ..." hiqet. Ky **UDHËZIM** hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Koço Barka

UDHËZIM

Nr. 646, datë 20.3.2006

MBI ZBATIMIN E **VENDIMIT** TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.74, DATË 11.2.1999 "PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT NËPËRMJET MBËSHTETJES SË FORMIMIT INSTITUCIONAL"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në zbatim të pikës 8 të **VENDIMIT** të Këshillit të Ministrave nr.74, datë 11.2.1999 "Për programin e nxitjes së punësimit nëpërmjet mbështetjes së formimit institucional" dhe të nenit 18/1 të Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit miratuar me **VENDIM**in e Këshillit të Ministrave nr.42, datë 17.1.1998 "Për miratimin e Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit", i ndryshuar, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

UDHËZON:

1. Ka të drejtë të aplikojë në programin e nxitjes së punësimit nëpërmjet mbështetjes së formimit institucional, çdo subjekt i cili është person juridik/fizik me veprimtari të licencuar nga Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale.
 2. Subjektet që aplikojnë duhet të plotësojnë këto kushte:
 - i) nuk duhet të kenë bërë pushime nga puna (pa shkaqe të arsyeshme) në një periudhë njëvjeçare përpara aplikimit për programin e nxitjes së punësimit;
 - ii) të kenë derdhur rregullisht sigurimet e detyrueshme për një periudhë të paktën njëvjeçare;
 - iii) të mos kenë pasur shkelje të legjislacionit të punës të verifikuara nga inspektorati i punës për një periudhë njëvjeçare.
 3. Për të përfituar nga ky program, punëdhënësi duhet të paraqesë pranë zyrës përkatëse të punësimit të rrethit ku ai zhvillon aktivitetin, dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Një informacion mbi:
 - i) përshkrimin e detajuar të aktivitetit që kryen,
 - ii) kapacitetin e qendrës,
 - iii) studim mbi dobinë social-ekonomike që sjell zhvillimi i kursit.
 - b) Numrin e llogarisë bankare;
 - c) Një informacion mbi:
 - i) numrin e punëkërkesve që kërkohen të trajnohen,
 - ii) profesionin për të cilin do të trajnohen,
 - iii) kohëzgjatjen e trajnimit,
 - iv) llojin e kontratës që kërkon të zbatohet,
 - v) nivelin e pagesës që ai ka dhënë për çdo person,
 - vi) fushën e trajnimit.
 - ç) Vërtetim nga dega e tatim-taksave e rrethit ku ushtron veprimtarinë personi juridik/fizik, për shlyerjen e detyrimeve tatimore, për periudhën njëvjeçare pararendëse dhe periudhën në vazhdim deri në momentin që aplikon për program nxitje punësimi;
 - d) Vërtetim nga dega e tatim-taksave e rrethit ku ushtron veprimtarinë personi juridik/fizik, për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, dhe numrin e personave të siguruar për tre muajt e fundit.
 - e) Lista e punëkërkesve të punësuar dhe të siguruar para aplikimit për përfitim për programe nxitje punësimi.
- Me të dhënat e dokumentacionit të mësipërm, subjekti në bashkëpunim me zyrën përkatëse të punësimit, plotëson formularin përkatës.
4. Inspektori i Inspektoratit Rajonal dhe Vendor të Punës, bën verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti sipas germave a, c dhe e dhe shprehet brenda 7 ditëve mbi vërtetësinë e këtij dokumentacioni, si dhe korrektësinë e subjektit ndaj legjislacionit të punës. Marrëdhëniet midis tyre rregullohen me urdhrin nr.418, datë 25.2.2004 të Ministrisë të Punës dhe Çështjeve

Sociale.

5. Zyra kompetente e punësimit shpall në media çdo fillim viti numrin e projekteve që do të financojë sipas prioriteteve të vendosura nga Ministri.

6. Në rastet kur për një projekt ka të paktën tre aplikues zyra kompetente e punësimit ia paraqet ato Këshillit Lokal Trepalësh, i cili shqyrton dhe vendos mbi dobishmërinë social-ekonomike të projekteve që do të kërkohen të financohen.

7. Pas miratimit në parim të projekteve në Këshillin Lokal Trepalësh, zyra kompetente e punësimit i rendit aplikimet sipas prioriteteve të vendosura nga Ministri dhe i dërgon për miratim në komisionin e miratimit të projekteve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

8. Mënyra e vlerësimit të projekteve nga komisionet përcaktohet në një rregullore të miratuar nga Këshilli Administrativ Trepalësh i SHKP-së.

9. Në Drejtorinë e Përgjithshme të SHKP-së, ngrihet komisioni i mirat

UDHËZIM

Nr. 647, datë 20.3.2006

MBI ZBATIMIN E **VENDIMIT** TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.632, DATË 18.09.2003 "PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË PUNËKËRKUESEVE TË PAPUNA FEMRA"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, **VENDIM**it të Këshillit të Ministrave nr.632, datë 18.9.2003 "Programin e nxitjes së punësimit të punëkërkueseve të papuna femra" dhe nenit 18/1 të Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit miratuar me **VENDIM**in e Këshillit të Ministrave nr.42, datë 17.1.1998 "Për miratimin e Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit" i ndryshuar, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

UDHËZON:

1. Ka të drejtë të aplikojë në programin e nxitjes së punësimit të punëkërkueseve të papuna femra çdo punëdhënës, i cili është person juridik/fizik.
 2. Punëdhënësit që aplikojnë duhet të plotësojnë këto kushte:
 - i) nuk duhet të kenë bërë pushime nga puna (pa shkaqe të arsyeshme) në një periudhë njëvjeçare përpara aplikimit për programin e nxitjes së punësimit;
 - ii) të kenë derdhur rregullisht sigurimet e detyrueshme për një periudhë të paktën njëvjeçare;
 - iii) të mos kenë pasur shkelje të legjislacionit të punës të verifikuara nga inspektorati i punës për një periudhë njëvjeçare.
 3. Për të përfutur nga ky program, punëdhënësi duhet të paraqesë pranë zyrës kompetente të punësimit të rrethit ku ai zhvillon aktivitetin, dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) **VENDIM**in e gjykatës së rrethit për regjistrimin si person juridik apo fizik (në **VENDIM**in e gjykatës duhet të jetë përfshirë aktiviteti për të cilin kërkon të punësojë punëkërkuesit e papunë).
 - b) Certifikatën e regjistrimit në organin tatimor.
 - c) Informacion mbi:
 - i) përshkrimin e detajuar të aktivitetit që kryen,
 - ii) numrin e fuqisë punëtore,
 - iii) listën e punëtorëve të punësuar dhe të siguruar para aplikimit për përfitim për programe nxitje punësimi
 - iv) nivelin e pagës që ai ka dhënë për çdo person.
 - d) Vërtetim për kontributet e paguara për sigurimet shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesin, që lëshohen nga organi tatimor përkatës.
 - e) Vërtetim për periudhën pararendëse (për të paktën 1 vit) për pagesën e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe numrin e personave të siguruar, të lëshuar nga organet e sigurimeve shoqërore.
 - f) Numrin e llogarisë bankare.
 - g) Një informacion mbi:
 - i) numrin e punëtorëve që kërkohen të punësohen,
 - ii) profesionin për të cilin do të punësohen,
 - iii) përshkrimin e aktivitetit që do të kryejnë këta punëtorë,
 - iv) kohëzgjatjen e punësimit,
 - v) llojin e kontratës që kërkon të zbatojë,
 - vi) nivelin e pagës.
 - h) Një plan biznesi ku të jetë e justifikuar rritja e menjëhershme e fuqisë punëtore dhe kushtet e punës, pajisjeve dhe ambienteve.
 - i) Vërtetim nga dega e tatim-taksave e rrethit ku ushtron veprimtarinë personi juridik/fizik, për shlyerjen e detyrimeve tatimore, për periudhën njëvjeçare pararendëse dhe periudhën në vazhdim deri në momentin që aplikon për program nxitje punësimi.
- Me të dhënat e dokumentacionit të mësipërm, punëdhënësi në bashkëpunim me zyrën

kompetente të punësimit, plotëson formularin përkatës.

4. Inspektori i Inspektoratit Rajonal dhe Vendor të Punës, bën verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti sipas germave c dhe g dhe shprehet brenda 7 ditëve mbi vërtetësinë e këtij dokumentacioni, si dhe korrektësinë e subjektit ndaj legjislacionit të punës. Marrëdhëniet midis tyre rregullohen me urdhrin nr.418, datë 25.2.2004 të Ministrisë të Punës dhe Çështjeve Sociale.

5. Zyra kompetente e punësimit shpall në media, çdo fillim viti, numrin e projekteve që do të financojë sipas prioriteteve të vendosura nga Ministri. Vetëm në rastet kur për një projekt ka të paktën tre aplikues zyra e punësimit ia paraqet ato Këshillit Lokal Trepalësh, i cili shqyrton dhe vendos mbi dobishmërinë social-ekonomike të projekteve që do të kërkohen të financohen.

6. Pas miratimit në parim të projekteve në Këshillin Lokal Trepalësh zyra kompetente e punësimit i rendit aplikimet sipas prioriteteve të vendosura nga Ministri dhe i dërgon për miratim si më poshtë:

a) Zyra vendore e punësimit dërgon për miratim të gjitha projektet, sipas rastit në zyrën rajonale të punësimit ose në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

b) Zyra rajonale e punësimit miraton projektet, kur aplikues janë ndërmarrjet e vogla në kuptim të **LIGJ**it nr.8957, datë 17.10.2002 "Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme" dhe dërgon për miratim në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit projektet ku aplikues janë ndërmarrjet që kanë mbi 21 të punësuar.

Sipas **LIGJ**it të sipërpërmendur:

I. Ndërmarrjet e vogla janë ndërmarrjet të cilat:

a) punësojnë 6-20 punonjës;

b) xhiroja ekonomike vjetore e tyre nuk e kalon shumën 40 milionë lekë;

c) 100 për qind e kapitalit të këtyre ndërmarrjeve zotërohet nga subjekte, të cilat, në kuptim të **LIGJ**it të sipërpërmendur, klasifikohen si ndërmarrje të vogla.

II. Ndërmarrjet e mesme janë ndërmarrjet të cilat:

a) punësojnë 21-80 punonjës;

b) xhiroja ekonomike vjetore e tyre nuk e kalon shumën 80 milionë lekë;

c) më pak se 25 për qind e kapitalit të këtyre ndërmarrjeve zotërohet nga subjekte, të cilat, në kuptim të **LIGJ**it të sipërpërmendur, nuk klasifikohen si ndërmarrje të vogla dhe të mesme.

7. Në rastet kur aplikues janë ndërmarrje të vogla në kuptimin e numrit të punonjësve, por me përfitimin e financimit sipas këtij programi hyjnë te ndërmarrjet e mesme, aplikimi dërgohet për miratim në komisionin e ngritur në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

8. Mënyra e vlerësimit të projekteve nga komisionet përcaktohet në një rregullore të miratuar nga Këshilli Administrativ Trepalësh i SHKP-së.

9. Për zbatimin e pikës 6 ngrihen komisionet përkatës për miratimin e projekteve dhe konkretisht:

a) në çdo zyrë rajonale punësimi ngrihet komisioni i miratimit të projekteve;

b) në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit ngrihet komisioni i miratimit të projekteve.

Mënyra e funksionimit e metodikës së punës dhe përbërjes së komisioneve përcaktohet me rregullore të veçantë të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

10. Komisioni i zyrës rajonale të punësimit vendos për miratimin ose jo të një projekti nga tre të tillë brenda 20 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për aplikim nga punëdhënësit.

Komisioni i miratimit të projekteve në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, vendos për miratimin ose jo të një projekti brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes për aplikim nga punëdhënësit.

11. Për projektet e miratuara zyra kompetente e punësimit në bashkëpunim me punëdhënësin plotësojnë listën e punëkërkuesve të papunë që do të përfshihen në program. Punëkërkuesit e papunë që përfshihen në program duhet të jenë të regjistruar në zyrat e punësimit për një periudhë të paktën tre mujore para aplikimit në projekt.

Ndërmjet zyrave kompetente të punësimit dhe punëdhënësit nënshkruhet një kontratë ku

përfshihen të drejtat dhe detyrat që përcakton programi për secilën palë. Kontratat e lidhura ndërmjet punëdhënësit dhe zyrave kompetente të punësimit janë të vlefshme vetëm për vitin kalendarik.

Në rastet kur financimi vazhdon për vitin pasardhës, shtesa përkatëse në kontratë bëhet pasi kryhet një vlerësim për zbatimin e projektit me kontratën e parë.

12. Për efekt zbatimi të këtij **VENDIMI**, financimi për sigurimet e detyrueshme bëhet proporcionalisht duke iu referuar nivelit të shpenzimeve të kontributit të punëdhënësit.

13. Për çdo të punësuar, sipas pikës 1 të **VENDIMIT** të Këshillit të Ministrave nr.632, datë 18.9.2003 "Programin e nxitjes së punësimit të punëkërkueseve të papuna femra", punëdhënësi përfiton financimin mujor të barabartë me 70% të shumës së shpenzimeve të sigurimeve të detyrueshme (kontributi i punëdhënësit) për gjithë vitin e zbatimit të kontratës.

70% të sigurimeve të detyrueshme

14. Për efekt të zbatimit të pikës 2 të **VENDIMIT** të Këshillit të Ministrave nr.632, datë 18.9.2003 "Programin e nxitjes së punësimit të punëkërkueseve të papuna femra", punëdhënësi përfiton financim mujor:

a) 70% të shumës së shpenzimeve për sigurime të detyrueshme (kontributi i punëdhënësit) për vitin e parë të zbatimit të kontratës;

b) 85% të shumës së shpenzimeve për sigurimet e detyrueshme (kontributi i punëdhënësit) për çdo të punësuar, për të gjithë vitin e zbatimit të kontratës. Financimi fillon në vitin e dytë të zbatimit të kontratës.

70% sigurime të detyrueshme viti i parë

85% sigurime të detyrueshme viti i dytë

15. Për efekt të zbatimit të pikës 3 të **VENDIMIT** të Këshillit të Ministrave nr.632, datë 18.9.2003 "Programin e nxitjes së punësimit të punëkërkueseve të papuna femra", punëdhënësi përfiton financim mujor:

a) 70% të shumës së shpenzimeve për sigurime të detyrueshme (kontributi i punëdhënësit) për vitin e parë të zbatimit të kontratës;

b) 85% të shumës së shpenzimeve për sigurimet e detyrueshme (kontributi i punëdhënësit) për vitin e dytë të zbatimit të kontratës, për çdo të punësuar;

c) të barabartë me 100% të shumës së shpenzimeve të detyrueshme (kontributi i punëdhënësit) për çdo të punësuar, për vitin e tretë të zbatimit të kontratës. Financimi fillon vitin e tretë të zbatimit të kontratës.

70% sigurime të detyrueshme viti i parë

85% sigurime të detyrueshme viti i dytë

100% sigurime të detyrueshme viti i tretë

16. Në zbatim të pikës 4 të **VENDIMIT** të Këshillit të Ministrave nr.632, datë 18.9.2003 "Programin e nxitjes së punësimit të punëkërkueseve të papuna femra", punëdhënësit të cilët punësojnë punëkërkuese femra mbi 35 vjeç, femra rome, femra me aftësi të kufizuara, vajzat nëna, femra të divorcuara me probleme sociale:

a) (paragrafi a) Kur punësimi bëhet sipas pikës 1 të **VENDIMIT** të sipërpërmendur, përveç financimit sipas pikës 13 të këtij **UDHËZIMI**, përfitojnë financim 4 paga minimale në shkallë vendi gjatë vitit të parë të zbatimit të kontratës. 3 paga jepen në fillim të vitit të punës (për çdo muaj) dhe 1 pagë jepet në muajin e fundit të kontratës së punës.

70% sigurime të detyrueshme

4 paga minimale

b) (Paragrafi b) Kur punësimi bëhet sipas pikës 2 të **VENDIMIT** të sipërpërmendur, përveç financimit sipas pikës 13 dhe 14 të këtij **UDHËZIMI** dhe paragrafit 1 të kësaj pike, përfitojnë financim 6 paga minimale në shkallë vendi. 5 paga minimale në shkallë vendi jepen në fillim të vitit të dytë të kontratës (për çdo muaj) dhe 1 pagë jepet në fund të vitit.

70% sigurime të detyrueshme për vitin e parë

85% sigurime të detyrueshme për vitin e dytë

4 paga minimale për vitin e parë

6 paga minimale për vitin e dytë

c. (paragrafi c) Kur punësimi bëhet sipas pikës 3 të **VENDIMIT** të sipërpërmendur, përveç financimit sipas pikës 15 të këtij **UDHËZIMI** dhe paragrafi 1 dhe 2 i kësaj pike, përfitojnë 8 paga minimale në shkallë vendi. 7 paga jepen në 7 muajt e parë të zbatimit të kontratës dhe 1 pagë jepet në muajin e fundit të zbatimit të kontratës.

70% sigurime të detyrueshme për vitin e parë

85% sigurime të detyrueshme për vitin e dytë

100% sigurime të detyrueshme për vitin e tretë

4 paga minimale për vitin e parë

6 paga minimale për vitin e dytë

8 paga minimale për vitin e tretë

17. Identifikimi i personave sipas pikës 4 bëhet si më poshtë:

1. Për femrat e trafikuarat listat e tyre kërkohen çdo fillim viti nga Shërbimi Social Shtetëror për ato që trajtohen në institucionet shtetërore të përkujdesit, si dhe nga OJF-të të cilat kanë marrëveshje me Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale;

2. Për femra mbi 35 vjeç, identifikimi bëhet nga regjistrimi në zyrën kompetente të punësimit (duke e vërtetuar me një kopje të dokumentit të identifikimit të noterizuar);

3. Për femrat rome të regjistruara, zyrat e punësimit duhet të bashkëpunojnë me shoqatat rome të regjistruara në gjykatë;

4. Për femrat me aftësi të kufizuara, identifikimi bëhet me vërtetim të komisioneve KMCAP dhe KMPV;

5. Për vajzat-nëna, të paraqitet certifikata nga zyra e gjendjes civile;

6. Për femra të divorcuara me probleme sociale, të kërkohet **VENDIMI** i gjykatës për zgjidhje martesë dhe një vërtetim nga njësi administrative përkatëse për gjendjen ekonomike të tyre.

18. Në zbatim të pikës 5 të **VENDIMIT** të Këshillit të Ministrave nr.632, datë 18.9.2003

"Programin e nxitjes së punësimit të punëkërkueseve të papuna femra", kontrolli bëhet nga inspektorët e Inspektoratit Rajonal dhe Vendor për pikat a, b dhe c dhe punëdhënësi përfiton nga ky program, kur nga kontrollet e bëra rezulton se nuk janë shkelur këto pika.

19. Me kërkesë të Inspektoratit Shtetëror të Punës apo të strukturave të kontrollit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit punëdhënësit i ndërpritet financimi kur bën pushime, pa shkaqe të arsyeshme të punëmarrësve të tjerë jashtë këtij programi.

20. Në zbatim të pikës 7 të **VENDIMIT** të Këshillit të Ministrave nr.632, datë 18.9.2003

"Programin e nxitjes së punësimit të punëkërkueseve të papuna femra", zyra kompetente e punësimit llogarit nëpërmjet formularit të personave të punësuar që janë përfitues të pagesës së papunësisë fondet e kursyera nga ai program të cilat i kalojnë në masën 100% buxhetit të këtij programi. Procedurat e kalimit të fondeve përcaktohen në **UDHËZIMIN** e përbashkët të Ministrisë të Financave nr.1, datë 5.2.2001 "Për kriteret dhe procedurat e subvencionimit për të nxitur punësimin".

21. Marrëdhëniet midis zyrave kompetente të punësimit, punëdhënësit dhe punëkërkuesve të papunë të punësuar sipas këtij programi, vendosen në marrëveshje të përbashkëta midis tyre. Punëdhënësi dhe punëmarrësi nënshkruajnë një kontratë për kushtet e punësimit të personave që punësohen. Kontrata përmban në çdo rast emrat e të gjithë personave që do të angazhohen në program.

22. Në rastet kur punëmarrësit e punësuar sipas këtij programi largohen përpara afatit të përcaktuar në kontratë, punëdhënësi duhet të bëjë njoftim në zyrën e punësimit. Punëmarrësit e larguar nuk zëvendësohen.

23. Zyra kompetente e punësimit përpilon dhe dërgon çdo muaj në drejtorinë e përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit informacion në lidhje me projektet, zbatimin e tyre, personat e punësuar, përfituesit e programeve të mbështetjes me të ardhura etj. Detaje të mëtejshme përcaktohen në rregulloren e Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

24. Në zbatim të pikës 8, **VENDIMIT** të Këshillit të Ministrave nr.632, datë 18.9.2003 "Programin e nxitjes së punësimit të punëkërkueseve të papuna femra", kostoja e programit mbulohet nga fondet vjetore të Buxhetit të Shtetit për nxitjen e punësimit.

25. Procedurat për përdorimin e fondeve të nxitjes së punësimit dhe hollësi të tjera përcaktohen

në **UDHËZIM**in e përbashkët të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrit të Financave nr.1, datë 5.2.2001 "Për kriteret dhe procedurat e subvencionimit për të nxitur punësimin".

26. Procedurat për zbatimin e këtij programi, formularët tip, kontratat tip, marrëveshjet tip, rregullohen me rregulloren metodike të zbatimit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

Kontratat dhe marrëveshjet tip të miratuara, të shërbejnë vetëm si udhëzues për punonjësit e zyrave të punësimit, ndërkohë që ato duhet të rishkruhen për çdo rast lidhje kontrate me subjekte të ndryshme.

27. Për përparësitë dhe fushat prioritare ku do të zbatohet programi, të zbatohet urdhri i nxjerrë çdo fillim viti nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

28. **UDHËZIMI** nr.76, datë 14.1.2004 "Mbi zbatimin e **VENDIMIT** të Këshillit të Ministrave nr.632, datë 18.9.2003 "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkueseve të papuna femra, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky **UDHËZIM** hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KOÇO BARKA
MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA

UDHËZIM

Nr. 648, datë 20.3.2006

MBI ZBATIMIN E **VENDIMIT** TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.73, DATË 11.2.1999 "PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT, NËPËRMJET FORMIMIT NË PUNË"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në zbatim të pikës 6 të **VENDIMIT** të Këshillit të Ministrave nr.73, datë 11.2.1999 "Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë" dhe të nenit 18/1 të Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, miratuar me **VENDIM**in e Këshillit të Ministrave nr.42, datë 17.1.1998 "Për miratimin e Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit" i ndryshuar, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

UDHËZON:

1. Ka të drejtë të aplikojë në programin e nxitjes së punësimit të punëkërkesve të papunë çdo punëdhënës, i cili është person juridik apo fizik.
 2. Punëdhënësit që aplikojnë duhet të plotësojnë këto kushte:
 - i) nuk duhet të kenë bërë pushime nga puna (pa shkaqe të arsyeshme) në një periudhë njëvjeçare përpara aplikimit për programin e nxitjes së punësimit;
 - ii) të kenë derdhur rregullisht sigurimet e detyrueshme për një periudhë të paktën njëvjeçare;
 - iii) të mos kenë pasur shkelje të legjislacionit të punës të verifikuara nga Inspektorati i Punës për një periudhë njëvjeçare.
 3. Për të përfituar nga ky program, punëdhënësi duhet të paraqesë pranë zyrës kompetente të punësimit të rrethit ku ai zhvillon aktivitetin, dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) **VENDIM**in e gjykatës së rrethit për regjistrimin si person juridik apo fizik (në **VENDIM**in e gjykatës duhet të jetë përfshirë aktiviteti për të cilin kërkon të punësojë punëkërkesit e papunë).
 - b) Certifikatën e regjistrimit në organin tatimor.
 - c) Informacion mbi:
 - i) përshkrimin e detajuar të aktivitetit që kryen;
 - ii) numrin e fuqisë punëtore;
 - iii) Listën e punëtorëve të punësuar dhe të siguruar para aplikimit për përfitim për programe nxitje punësimi;
 - iv) nivelin e pagës që ai ka dhënë për çdo person.
 - ç) Vërtetim për kontributet e paguara për sigurimet shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesin, që lëshohen nga organi tatimor përkatës.
 - d) Vërtetim për periudhën pararendëse (për të paktën 1 vit) për pagesën e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe numrin e personave të siguruar, të lëshuar nga organet e sigurimeve shoqërore.
 - dh) Numrin e llogarisë bankare.
 - e) Një informacion mbi:
 - i) numrin e punëtorëve që kërkohen të punësohen,
 - ii) profesionin për të cilin do të punësohen,
 - iii) përshkrimin e aktivitetit që do të kryejnë këta punëtorë,
 - iv) kohëzgjatjen e punësimit,
 - v) llojin e kontratës që kërkon të zbatojë,
 - vi) nivelin e pagës.
 - ë) Një plan biznesi ku të jetë e justifikuar rritja e menjëhershme e fuqisë punëtore dhe kushtet e punës, pajisjeve dhe ambienteve.
 - f) Vërtetim nga dega e tatim-taksave e rrethit ku ushtron veprimtarinë personi juridik/fizik, për shlyerjen e detyrimeve tatimore, për periudhën njëvjeçare pararendëse, si dhe periudhën e vitit në vazhdim deri në momentin që aplikon për program nxitje punësimi.
- Me të dhënat e dokumentacionit të mësipërm, punëdhënësi në bashkëpunim me zyrën

kompetente të punësimit, plotëson formularin përkatës.

4. Inspektori i Inspektoratit Rajonal dhe Vendor të Punës bën verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti sipas germave "c" dhe "e" dhe shprehet brenda 7 ditëve mbi vërtetësinë e këtij dokumentacioni, si dhe korrektësinë e subjektit ndaj legjislacionit të punës. Marrëdhëniet midis tyre rregullohen me urdhrin nr.418, datë 25.2.2004 të Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale.

5. Zyra kompetente e punësimit shpall në media çdo fillim viti numrin e projekteve që do të financojë sipas prioriteteve të vendosura nga Ministri. Vetëm në rastet kur për një projekt ka të paktën tre aplikues zyra e punësimit ia paraqet ato Këshillit Lokal Trepalësh, i cili shqyrton dhe vendos mbi dobishmërinë social-ekonomike të projekteve që do të kërkohen të financohen.

6. Pas miratimit në parim të projekteve në Këshillin Lokal Trepalësh zyra kompetente e punësimit i rendit aplikimet sipas prioriteteve të vendosura nga Ministri dhe i dërgon për miratim si më poshtë:

a) Zyra vendore e punësimit dërgon për miratim të gjitha projektet, sipas rastit në zyrën rajonale të punësimit ose në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

b) Zyra rajonale e punësimit miraton projektet, kur aplikues janë ndërmarrjet e vogla në kuptim të **LIGJit** nr.8957, datë 17.10.2002 "Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme" dhe dërgon për miratim në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit projektet ku aplikues janë ndërmarrjet që kanë mbi 21 të punësuar.

Sipas **LIGJit** të sipërpërmendur:

I. Ndërmarrjet e vogla janë ndërmarrjet të cilat:

a) punësojnë 6-20 punonjës;

b) xhiroja ekonomike vjetore e tyre nuk e kalon shumën 40 milionë lekë;

c) 100 për qind e kapitalit të këtyre ndërmarrjeve zotërohet nga subjekte, të cilat, në kuptim të **LIGJit** të sipërpërmendur, klasifikohen si ndërmarrje të vogla.

II. Ndërmarrjet e mesme janë ndërmarrjet të cilat:

a) punësojnë 21-80 punonjës;

b) xhiroja ekonomike vjetore e tyre nuk e kalon shumën 80 milionë lekë;

c) më pak se 25 për qind e kapitalit të këtyre ndërmarrjeve zotërohet nga subjekte, të cilat, në kuptim të **LIGJit** të sipërpërmendur, nuk klasifikohen si ndërmarrje të vogla dhe të mesme.

7. Në rastet kur aplikues janë ndërmarrje të vogla në kuptimin e numrit të punonjësve, por me përfitimin e financimit sipas këtij programi hyjnë te ndërmarrjet e mesme, aplikimi dërgohet për miratim në komisionin e ngritur në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

8. Mënyra e vlerësimit të projekteve nga komisionet përcaktohet në një rregullore të miratuar nga Këshilli Administrativ Trepalësh i SHKP-së.

9. Për zbatimin e pikës 6 të këtij **UDHËZIMI** ngrihen komisionet përkatëse për miratimin e projekteve dhe konkretisht:

a) Në çdo zyrë rajonale punësimi ngrihet komisioni i miratimit të projekteve.

b) Në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit ngrihet komisioni i miratimit të projekteve.

Mënyra e funksionimit e metodikës së punës dhe përbërjes së komisioneve përcaktohet me rregullore të veçantë të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

10. Komisioni i zyrës rajonale të punësimit vendos për miratimin ose jo të projektit brenda 20 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për aplikim nga punëdhënësi. Komisioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit vendos për miratimin ose jo të projektit brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes për aplikim nga punëdhënësi.

11. Për projektet e miratuara zyra kompetente e punësimit, në bashkëpunim me punëdhënësin, plotësojnë listën e punëkërkuesve të papunë që do të përfshihen në program. Punëkërkuesit e papunë që përfshihen në program duhet të jenë të regjistruar në zyrat e punësimit për një periudhë të paktën tre mujore.

Ndërmjet zyrave kompetente të punësimit dhe punëdhënësit nënshkruhet një kontratë ku përfshihen të drejtat dhe detyrat që përcakton programi për secilën palë. Kontratat e lidhura

ndërmjet punëdhënësit dhe zyrave kompetente të punësimit janë të vlefshme vetëm për vitin kalendarik.

Në rastet kur financimi vazhdon për vitin pasardhës, shtesa përkatëse në kontratë bëhet pasi kryhet një vlerësim për zbatimin e projektit me kontratën e parë.

12. Në zbatim të pikës 1 të **VENDIMIT** për çdo punëkërkuar të përfshirë në program punëdhënësi përfiton:

a) Kompensim mujor për pagë në masën 100% të pagës minimale për një periudhë deri në 6 muaj me përjashtim të programeve që zbatohen në fushën e industrisë minerale, nxjerrëse dhe përpunuese ku kohëzgjatja mund të jetë deri në 9 muaj.

b) Kompensim mujor për sigurimet shoqërore e shëndetësore në masën 100% për një periudhë 6-mujore, me përjashtim të programeve që zbatohen në fushën e industrisë minerale, nxjerrëse dhe përpunuese ku kohëzgjatja mund të jetë deri në 9 muaj, duke iu referuar **VENDIMIT** të Këshillit të Ministrave nr.402, datë 11.6.2001 "Për disa çështje në zbatim të **LIGJIT** nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

13. Në zbatim të pikës 2 të **VENDIMIT**, pas përfundimit të periudhës së formimit për çdo të punësuar mbi numrin e fiksuar në kontratë, punëdhënësi merr një shpërblim të menjëhershëm të barabartë me 100% të shumës së pagës minimale në shkallë vendi dhe 100% të shpenzimeve për sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore për punëmarrësit për një periudhë 3-mujore.

14. Financimi ndaj subjektit bëhet duke iu referuar nivelit të pagës minimale në shkallë vendi, për efekt të zbatimit të këtij **VENDIMI**.

15. Marrëdhëniet midis zyrave kompetente të punësimit, punëdhënësit dhe punëkërkuarëve të papunë të punësuar sipas këtij programi, vendosen në marrëveshje të përbashkëta midis tyre. Punëdhënësi dhe punëmarrësi nënshkruajnë një kontratë për kushtet e punësimit të personave që punësohen. Kontrata përmban në çdo rast emrat e të gjithë personave që do të angazhohen në program.

16. Në rastet ku punëmarrësit e punësuar sipas këtij programi largohen përpara afatit të kontratës, punëdhënësi duhet të bëjë njoftim në zyrën e punësimit. Punëmarrësit e larguar nuk zëvendësohen.

17. Me kërkesë të Inspektoratit Shtetëror të Punës apo të strukturave të kontrollit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit punëdhënësit i ndërpriten financimi kur bën pushime, pa shkaqe të arsyeshme të punëmarrësve të tjerë jashtë këtij programi.

18. Në zbatim të pikës 3 të **VENDIMIT** zyra kompetente e punësimit është e detyruar të çregjistrojë nga lista e punëkërkuarëve të papunë personat që pa arsye të pranueshme refuzojnë të marrin pjesë në program. Procedurat përcaktohen në rregulloren përkatëse të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

19. Në zbatim të pikës 4 të **VENDIMIT**, zyra kompetente e punësimit plotëson listën e personave të përfshirë në program të cilët janë përfitues të pagesës së papunësisë. Zyra kompetente e punësimit llogarit nëpërmjet kësaj liste fondet e kursyera nga ai program të cilat i kalojnë masën 100% buxhetit të këtij programi.

20. Në zbatim të pikës 5 të **VENDIMIT**, zyra kompetente e punësimit plotëson listën e personave të punësuar që janë pjesëtarë të familjeve përfituese të programit të ndihmës ekonomike. Zyra kompetente e punësimit llogarit nëpërmjet këtij formulari sasinë e fondeve që përfiton ky program nga punësimi i tyre. Kjo sasi është 40% e ndihmës ekonomike të plotë për një familje me 4 persona për çdo muaj trajnim.

21. Zyra kompetente e punësimit përpilon dhe dërgon çdo muaj në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, informacion në lidhje me zbatimin e projekteve, personat e punësuar, përfituesit e programeve të mbështetjes me të ardhura, punëkërkuarët e papunë etj.

22. Për përparësitë dhe fushat prioritare ku do të zbatohet programi, të zbatohet urdhri i nxjerrë çdo fillim viti nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

23. Procedurat e mëtejshme për përdorimin e fondeve të nxitjes së punësimit përcaktohen në **UDHËZIMIN** e përbashkët të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrit të Financave nr.1, datë 5.2.2001 "Për kriteret dhe procedurat e subvencionimit për

të nxitur punësimin".

24. Procedurat për zbatimin e këtij programi, formularët tip, kontratat tip, marrëveshjet tip përcaktohen me rregulloren metodike të zbatimit të Këshillit Administrativ Trepalësh të Shërbimit Kombëtar të Punësimin.

Kontratat dhe marrëveshjet tip të shërbejnë vetëm si udhëzues për punonjësit e zyrave të punësimin, ndërkohë që ato duhet të rishkruhen për çdo rast lidhje kontrate me subjekte të ndryshme.

25. **UDHËZIMI** nr.73, datë 14.1.2004 "Mbi zbatimin e **VENDIMIT** të Këshillit të Ministrave nr.73, datë 11.2.1999 "Për programin e nxitjes së punësimin nëpërmjet formimit në punë", i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky **UDHËZIMI** hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KOÇO BARKA
MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA

VENDIM

Nr.7, date 7.1.2005

PER MIRATIMIN E STRATEGJISE PER NXITJEN E PUNESIMIT NE ADMINISTRATEN PUBLIKE TE STUDENTEVE TE DIPLOMUAR JASHTE VENDIT

Ne mbështetje te nenit 100 te Kushtetutës, me propozimin e Ministrit te Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e strategjisë për nxitjen e punësimit ne administratën publike te studenteve te diplomuar jashtë vendit.

Ky **VENDIM** hyn ne fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

UDHËZIM

Nr. 649/1, datë 15.5.2006

MBI DISA NDRYSHIME NË **UDHËZIMIN** NR. 649, DATË 20.03.2006 "MBI ZBATIMIN E **VENDIMIT** TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 69, DATË 11.02.1999 "PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në zbatim të pikës 8 të **VENDIMIT** të Këshillit të Ministrave nr.69, datë 11.02.1999 "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuarve të papunë" dhe të nenit 18/1 të Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, miratuar me **VENDIMIN** e Këshillit të Ministrave nr.42, datë 17.01.1998 "Për miratimin e Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit", i ndryshuar", Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

UDHËZON:

Në **UDHËZIMIN** nr.649, datë 20.03.2006 "Mbi zbatimin e **VENDIMIT** të Këshillit të Ministrave nr.69, datë 11.02.1999 "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuarve të papunë", bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2 riformulohet si vijon:

"Punëdhënësit që aplikojnë duhet të plotësojnë këto kushte:

- i) nuk duhet të kenë bërë pushime nga puna (pa shkaqe të arsyeshme) për aq kohë sa kryen aktivitetin, por jo më gjatë së një periudhë njëvjeçare;
- ii) të kenë derdhur rregullisht sigurimet e detyrueshme për aq kohë sa kryejnë aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare;
- iii) të mos kenë pasur shkelje të legjislacionit të punës të verifikuara nga Inspektorati i Punës për aq kohë sa kryejnë aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare.

2. Në pikën 3 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Në paragrafin "d." shprehja në kllapa "(për të paktën 1 vit)" zëvendësohet me shprehjen "(për aq kohë sa kryen aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare)"

Pika "f" riformulohet si vijon:

"Vërtetim nga dega e tatim-taksave ku ushtron veprimtarinë personi juridik/fizik, për shlyerjen e detyrimeve tatimore, për aq kohë sa kryen aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare."

3. Në fjalinë e dytë të pikës 4 shprehja ".. 418 datë 25.02.2004 të ..", zëvendësohet me lidhëzën "e".

4. Në pikën 5 fjalia e dytë riformulohet si vijon:

"Zyra kompetente e punësimit ia paraqet projektet Këshillit Lokal Trepalësh, i cili i shqyrton dhe vendos mbi dobishmërinë social-ekonomike të projekteve që do të kërkohen të financohen."

5. Pika 8 riformulohet si vijon:

"Mënyra e vlerësimit të projekteve përcaktohet në rregulloret e komisioneve.

6. Në pikën 21 fjalia e fundit ndryshohet si vijon:

"Zyra e punësimit merr masa për zëvendësimin e punëmarrësve të larguar."

Ky **UDHËZIM** hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE

DHE SHANSEVE TË BARABARTA

Koço Barka

VENDIM

Nr.816, datë 3.12.2004

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SUEDISË, PËR MBËSHTETJEN E PROJEKTIT TË SHËRBIMEVE EFIÇENTE TË PUNËSIMIT NË SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të **LIGJ**it nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Suedisë, për mbështetjen e projektit të shërbimeve efiçente të punësimit në Shqipëri, nënshkruar në Tiranë, më 27.10.2004.

Ky **VENDIM** hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

MARRËVESHJE

SPECIFIKE NDËRMJET QEVERISË SË SUEDISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR MBËSHTETJEN E PROJEKTIT TË SHËRBIMEVE EFIÇENTE TË PUNËSIMIT NË SHQIPËRI

Qeveria e Suedisë (më poshtë referuar si Suedia) dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (më poshtë referuar si Shqipëria) kanë rënë dakord për sa më poshtë: Agjencia Suedeze për Zhvillim e Bashkëpunim Ndërkombëtar, SIDA dhe autoriteti kompetent i Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale të Shqipërisë do të kenë autoritetin për të përfaqësuar qeveritë e tyre në çështjet përkatëse lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 1

Fusha dhe objektivat e kësaj Marrëveshjeje

Shqipëria ka vendosur të realizojë një projekt të quajtur Shërbime Efiçente të Punësimit në Shqipëri.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është që të nxisë një funksionim më të mirë të tregut të punës në Shqipëri dhe rritjen e punësimit në vend, nëpërmjet ndihmës më efiçente dhe më efektive të Shërbimit Kombëtar të Punësimit (SHKP).

Qëllimet, objektivat e projektit janë: të përmirësojë cilësinë dhe efektivitetin e shërbimeve publike të punësimit për punëdhënësit dhe punëkërkuarit në Shqipëri; të zhvillojë një sistem të ri të informacionit për menaxhimin e tregut të punës në SHKP si një bazë për nxitjen e menaxhimit sipas objektivave dhe rezultateve; nxitjen e një modeli të ri të trajnimit për stafin e SHKP-së, në mënyrë që të rriten kapacitetet e tij, si dhe të përmirësojë komunikimin dhe koordinimin si brenda, ashtu dhe jashtë institucionit të SHKP-së me partnerët e tij.

Rezultatet që priten të realizohen janë:

. Shërbime publike të reja dhe efiçente të punësimit, (SHPP-Shërbimet Publike të Punësimit) në dy rajone pilot të Shqipërisë me shërbime të përmirësuara dhe cilësore, që do t'i përshtaten kërkesës së tregut të punës. Rezultate të tjera janë koordinimi në rritje ndërmjet punëdhënësve, të cilët përdorin SHPP-në dhe që ndjehen të kënaqur me shërbimet e SHPP-së, me zhvillimin e një plani për zbatimin e sistemeve të testuara pilot në të gjithë Organizatën e Shërbimit Kombëtar të Punësimit;

. Një sistem i ri dhe eficient për menaxhimin e informacionit të tregut të punës dhe menaxhim sipas objektivave dhe rezultateve të ngritura (të formuara) në SHKP-në dhe në dy rajonet (zonat) pilot të përzgjedhura. Rezultate të tjera janë zhvillimi i një plani për zbatimin e të dy sistemeve në të gjithë Organizatën e Shërbimit Kombëtar të Punësimit (SHKP);

. Ngritja e një modeli të ri për trajnimin e stafit, veçanërisht duke u fokusuar në dy rajonet pilot të përzgjedhura. Rezultate të tjera janë menaxhimi i përmirësuar dhe aftësimi i stafit në zyrat qendrore të Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe në qendrat rajonale të punësimit në dy zonat e përzgjedhura;

. Zhvillimi i një modeli të ri për komunikimin brenda dhe jashtë institucionit, si dhe një plan zhvillimi për përmbushjen e politikave të reja në të gjithë sistemin organizativ të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

Projekti do të realizohet në përputhje me projektdokumentin e titulluar "Shërbimet efçente të punësimit në Shqipëri", që mban datën 4 qershor 2004, si dhe ndryshimeve të mëvonshme. Do të ketë edhe aktivitete të veçanta, si dhe termat e referencës për monitorimin e projektit nëpërmjet shërbimeve të një grupi të kualifikuar, që do të prokurohet (përzgjidhet) nga Suedia.

Neni 2

Kontributi suedez

Suedia do të mbështesë zbatimin dhe monitorimin e projektit dhe të një grupi të kualifikuar siç specifikohet në këtë Marrëveshje me një shumë prej katërmëdhjetë milionë korona suedeze (14 000 000 sek).

Neni 3

Detyrimet e Palës shqiptare

Shqipëria merr përsipër:

Të përmbushë projektin dhe të mundësojë burimet siç është përcaktuar në këtë

Marrëveshje, veçanërisht të mundësojë burimet dhe mbulimin e kostos përkatëse si vijon:

- Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale (Ministria) duhet të caktojë një anëtar të një niveli të lartë për të marrë pjesë rregullisht në mbledhjet e Komitetit Drejtues të Projektit, i cili do të ngrihet për përmbushjen e këtij projekti;

- Ministria dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP) do të mundësojnë alokimin e një buxheti të nevojshëm për Taksën mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) lidhur me investimet e këtij projekti në një vlerë maksimale prej 160000 euro (njëqind e gjashtëdhjetë mijë euro);

- Një koordinator lokal projekti, shumë i kualifikuar, do të caktohet (për të punuar me 80% kohë pune për këtë projekt) nga SHKP-ja, për të filluar nga puna nga fundi i tetorit 2004; Ky person do të jetë përgjegjës për planet ditore, koordinimin dhe monitorimin e aktiviteteve dhe grupit shqiptar të punës në këtë projekt dhe për koordinimin me dhe mbështetjen e drejtuesit suedez të projektit, si dhe të ekspertëve që do të punojnë me këtë projekt;

- Ministria dhe SHKP-ja duhet të garantojnë përgjithësisht një staf të mirë për projektin, si dhe pjesëmarrje të aktorëve në aktivitetet trajnuese. Për secilin nga komponentët kryesorë të projektit (katër komponentë), një drejtues për komponent do të zgjidhet nga stafi i SHKP-së.

Këta drejtues pritet që t'i kushtojnë një kohë të mjaftueshme aktiviteteve të këtij projekti;

- SHKP-ja duhet të mundësojë shërbime të nevojshme dhe mbështetje për të mundësuar mbarëvajtjen e projektit dhe stafi shqiptar duhet të marrë pjesë në aktivitetet e projektit, të tilla si:

i) Hapësira për t'u përdorur për zyra për projektin dhe pajisje për zyra në selinë qendrore të SHKP-së, përfshirë edhe koston telefonike;

ii) Sekretari, shërbime të përkthimit me shkrim e me gojë për të gjitha dokumentet e prodhuara brenda, si dhe përkthimi gjatë mbledhjeve të brendshme do të sigurohet nga SHKP-ja. Suedia do të mbulojë vetëm koston e dokumenteve të prodhuara jashtë dhe koston e përkthimit në konferenca;

iii) Transporti lokal, akomodimi dhe ushqimi në rastet e konferencave etj. për stafin shqiptar, kur marrin pjesë në aktivitetet e projektit dhe në trajnime siç edhe kërkohet nga SHKP-ja; do të mbulohen nga vetë ai, d.m.th. SHKP-ja. Suedia do të financojë koston e transportit dhe të akomodimit për stafin ndërkombëtar të projektit.

Neni 4

Kushtet për kontributin suedez

1. Vetëm kostoja për aktivitetet që do të realizohen gjatë periudhës nga fillimi deri në 30 nëntor të 2006 mund të financohet nga kontributi suedez. Projekti do të mund të fillojë vetëm pasi të firmoset kjo Marrëveshje nga ana e Palës suedeze dhe Palës shqiptare pas plotësimit të procedurave të nevojshme nëpërmjet kanaleve diplomatike në lidhje me datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes. Nëse Marrëveshja nuk do të firmoset deri më 31 tetor të vitit 2004 atëherë projekti nuk do të fillojë.

2. Pas një periudhe prej 6 muajsh nga data e përmendur, kontributi në këtë Marrëveshje nuk do të jetë i mundshëm për t'u disbursuar. Nëse aktivitetet pas datës së 30 nëntorit të 2006 nuk janë financuar sipas një marrëveshjeje të re, personeli mund të financohet nga kjo Marrëveshje, për periudhën e shënuar në kontratat individuale të punës, për një periudhë maksimale prej gjashtë muajsh, me kusht që autoritetet përgjegjëse të kenë rënë dakord për periudhën e punësimit ose të zgjatjes së kontratës për periudhën e punësimit përtej datës së fundit të përmendur më sipër.

3. Suedia mundet që në çdo kohë, të ndërpresë projektin ose punën e konsulentëve nëse ndodhin shmangie nga plani ose nga buxheti për të cilin është rënë dakord më parë; nëse vihet re keqpërdorimi i fondeve ose burimeve të tjera: nëse burimet që do të alokohen nga përfituesi nuk janë dhënë sipas planifikimit; nëse objektivat e projektit janë të rrezikuara; nëse raportet nuk dorëzohen siç është rënë dakord; nëse menaxhimi financiar i projektit nuk është i kënaqshëm: ose nëse projekti nuk zhvillohet në mënyrë të favorshme për sa i përket objektivave dhe çdo aspekti tjetër të rëndësishëm të tij.

4. Kushte të rëndësishme specifike të projektit. Projekti do të mund të fillojë vetëm me firmosjen e kësaj Marrëveshjeje. Nëse Marrëveshja nuk do të jetë firmosur deri më 31 tetor 2004 dhe nuk do të jetë caktuar një koordinator lokal projekti nga SHKP-ja deri në këtë datë, atëherë projekti nuk do të fillojë. Për më tepër, në qoftë se detyrimet e Shqipërisë, të përmendura në nenin 3, nuk janë realizuar në afatet e duhura kohore, Suedia mund të ndërpresë projektin dhe punën e konsulentëve. Nëse do të ndodhë kështu, Suedia sipas opsioneve të lindura (sipas dëshirës), mund të zgjidhë këtë Marrëveshje, duke dhënë një njoftim me shkrim një muaj përpara, ose në një datë të tillë që Suedia bie dakord, (duke iu referuar gjithashtu nenit 11).

Neni 5

Prokurimi

Asnjë ofertë, dhuratë ose pagesë, konsideratë ose përfitim i çdo lloji, që mund të vihet re si një praktikë abuzive/korruptive ose e paligjshme, nuk duhet të pranohet as drejtpërdrejt ose tërthorazi, si një shpërblim ose si stimul për zbatimin e kontratave të financuara brenda projektit. Suedia mund të prokurojë ose detyrojë të prokurohen të gjitha mallrat, punët dhe shërbimet brenda këtij projekti.

Mallrat e prokuruar nga Suedia sipas kësaj Marrëveshjeje për t'u përdorur nga konsulentët, mbeten pasuri e Suedisë pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, nëse nuk është rënë dakord për një formë tjetër.

Neni 6

Raportimi dhe procedurat e tjera të zbatimit të projektit

Palët do të mbajnë mbledhje të rregullta pune për të shqyrtuar, planifikuar dhe ndjekur ecurinë e projektit çdo gjashtëmuajor. Një nga këto mbledhje do të përbëjë edhe mbledhjen e rregullt

vjetore. Raportet e mbledhjes do të firmohen për çdo mbledhje.

Një draft i raportit vjetor progresit do t'i paraqitet Suedisë nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit para mbajtjes së mbledhjes së rregullt vjetore dhe jo më vonë se data 1 maj e viteve 2005 dhe 2006. Mbledhja e rregullt vjetore mund të vendosë se ky raport duhet të ndryshohet dhe në këtë rast duhet të caktohet një datë për raportin përfundimtar në protokollin e mbledhjes.

Pavarësisht nga rënia dakord për kohën e raportimit, palët duhet të informojnë në mënyrë të shpejtë njëra-tjetrën nëse ndodh një situatë që e bën projektin të mos realizohet siç edhe është rënë dakord.

Neni 7

Disbursimi

Suedia do të bëjë pagesa të drejtpërdrejta konsulentëve për shërbimet dhe prokurimet. Përfituesi do të kontrollojë dhe miratojë të gjitha faturat për shërbimet dhe prokurimet.

Neni 8

Delegimi i pushtetit

Suedia, nëpërmjet Agjencisë së saj për Zhvillim e Bashkëpunim Ndërkombëtar, SIDA dhe Shqipëria, nëpërmjet Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale të Republikës së Shqipërisë, do të kenë autoritetin për të përfaqësuar qeveritë e tyre në çështjet që kanë të bëjnë me përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 9

Lidhja me marrëveshjet e tjera

Bashkëpunimi midis palëve sipas kësaj Marrëveshjeje rregullohet gjithashtu nga:

- "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Suedisë dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë mbi termat dhe kushtet e përgjithshme për zhvillim dhe bashkëpunim" për periudhën 5 prill 2001-31 dhjetor 2005; dhe
- çdo marrëveshje që mund të amendojë ose zëvendësojë marrëveshjet në fjalë.

Neni 10

Shpërndarja e kësaj Marrëveshjeje

Palët marrin përsipër të shpërndajnë kopje të kësaj Marrëveshjeje për të gjitha ministritë e tyre, autoritetet dhe institucionet e tjera të përfshira në projektin e bashkëpunimit ose që kanë nevojë për informacion mbi përmbajtjen e saj.

Neni 11

Përfundimi

Kjo Marrëveshje do të jetë e vlefshme deri më 30 qershor 2006 nëse nuk përfundon më parë përmes një njoftimi me shkrim të bërë tre muaj para kësaj kohe.

Në rast shkeljeje të neneve 3 dhe/ose 4, Suedia mund ta përfundojë Marrëveshjen duke bërë një njoftim një muaj para.

Në rast shkeljeje serioze të Marrëveshjes, Suedia mund ta përfundojë/tërhiqet nga Marrëveshja në mënyrë të menjëhershme.

Në rast të përfundimit të Marrëveshjes nga Shqipëria, asnjë fond nuk do të jepet për aktivitet pas skadimit të Marrëveshjes.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Pala suedeze dhe njoftimit nga Pala shqiptare, nëpërmjet kanaleve diplomatike, të datës së hyrjes në fuqi të saj pas plotësimit të procedurave të brendshme.
Dy origjinale të tekstit të kësaj Marrëveshjeje, secili në gjuhët angleze dhe shqipe, janë firmosur. Për çdo mospërputhje midis teksteve në anglisht dhe shqip, teksti në anglisht ka përparësi.

Tiranë, 27.10.2004

LIGJ

Nr.9320, datë 25.11.2004

PËR RATIFIKIMIN E "KONVENTËS NR.97 TË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS "PËR MIGRACIONIN PËR PUNËSIM", E RISHIKUAR"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Konventa nr.97 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës "Për migracionin për punësim", e rishikuar".

Neni 2

Ky **LIGJ** hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4422, datë 14.12.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

KONVENTA NR.97 E ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS MBI MIGRACIONIN PËR PUNËSIM (E RISHIKUAR)

Rishikuar në 1949, hyrë në fuqi më 22 janar 1952

Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës,
e mbledhur në Gjenevë nga trupi drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës, në sesionin e saj të tridhjetë e dytë më 8 qershor 1949,
duke vendosur për miratimin e disa propozimeve lidhur me rishikimin e Konventës së migracionit për punësim, 1939, miratuar nga Konferenca në sesionin e saj të njëzet e pestë, që përfshihet në pikën njëmbëdhjetë të kalendarit të këtij sesioni;
duke pasur parasysh që këto propozime duhet të marrin formën e një Konvente ndërkombëtare, miraton në ditën e 1 korrik 1949 Konventën e mëposhtme me emrin Konventa për migracionin për punësim (e rishikuar):

Neni 1

Çdo Shtet Palë i Organizatës Ndërkombëtare të Punës për të cilin është në fuqi kjo Konventë merr përsipër të vërë në dispozicion të Zyrës Ndërkombëtare të Punës dhe pjesëtarëve të tjerë sipas kërkesës çdo

- a) informacion për politikën kombëtare, **LIGJ**et dhe rregulloret që lidhen me emigracionin imigracionin;
- b) informacion për masat specifike lidhur me migracionin për punësim dhe kushtet e punës dhe jetesës së migrantëve për punësim;
- c) informacion për marrëveshjet e përgjithshme dhe masat e veçanta për këto çështje të lidhura nga Shtetet Palë.

Neni 2

Çdo Shtet Palë për të cilin kjo Konventë është në fuqi merr përsipër të mbajë ose të përmbushë mbajtjen e një shërbimi të përshtatshëm dhe falas për të ndihmuar migrantët për punësim, dhe në mënyrë të veçantë t'u japë atyre informacion të saktë.

Neni 3

1. Çdo Shtet Palë për të cilin kjo Konventë është në fuqi merr përsipër që, aq sa e lejojnë **LIGJ**et dhe rregullat vendase, të ndërmarrin të gjitha hapat e duhura kundër propagandës së rreme lidhur me emigracionin dhe imigracionin.
2. Për këtë qëllim ata do të bashkëpunojnë, kur del nevoja, me Shtetet e tjera Palë të interesuara.

Neni 4

Nga secili Shtet Palë do të merren masat e duhura, brenda juridiksionit të tij, për të lehtësuar nisjen, udhëtimin dhe pritjen e migrantëve për punësim.

Neni 5

Çdo Shtet Palë për të cilin kjo Konventë është në fuqi merr përsipër të organizojë, brenda juridiksionit të tij, shërbimet e duhura mjekësore përgjegjëse për:

- a) të siguroar, kur është e nevojshme, si në kohën e nisjes edhe në atë të mbërritjes, që migrantët për punësim dhe pjesëtarët e familjeve të tyre të autorizuar për t'i shoqëruar ose për t'u bashkuar me ta gëzojnë shëndet të mirë;
- b) të siguroar që migrantët për punësim dhe pjesëtarët e familjeve të tyre të gëzojnë kujdesin e duhur mjekësor dhe kushtet e mira higjienike në kohën e nisjes, gjatë udhëtimit dhe në mbërritje në territorin e destinacionit.

Neni 6

1. Çdo Shtet Palë për të cilin kjo Konventë është në fuqi merr përsipër të zbatojë, pa diskriminim lidhur me kombësinë, racën, fenë ose seksin, për imigrantët që qëndrojnë **LIGJ**ërisht në territorin e tij, trajtim jo më pak të favorshëm sesa ai që zbatohet për shtetasit e vet lidhur me çështjet e mëposhtme:

- a) Për çështjet që rregullohen nga **LIGJ**i ose rregullat, ose që i nënshtrohen kontrollit të autoriteteve administrative:
 - i) shpërblimi, përfshi të ardhurat familjare kur këto përbëjnë pjesë të shpërblimit, orët e punës, puna jashtë orarit, pushimet e paguara, kufizimet për punën në shtëpi, mosha minimale për punësim, trajnimi dhe kualifikimi, puna e grave dhe puna e personave në moshë të re;
 - ii) anëtarësimi në sindikata dhe përfitimet e marrëveshjeve kolektive;
 - iii) strehimi.
- b) Sigurimet shoqërore (domethënë masat **LIGJ**ore lidhur me dëmtimin në punë, shtatzaninë, sëmundjen, invaliditetin, pleqërinë, vdekjen, papunësinë dhe përgjegjësitë familjare, dhe çdo ngjarje tjetër të paparashikuar që, sipas **LIGJ**eve dhe rregullave vendase, mbulohet nga një skemë e sigurimeve shoqërore), që i nënshtrohen kufizimeve të mëposhtme:
 - i) mund të ketë masa të veçanta për ruajtjen e të drejtave të fituara ose të të drejtave në proces fitimi;
 - ii) **LIGJ**et ose rregullat vendase të vendeve të imigracionit mund të përcaktojnë masa të veçanta lidhur me përfitimet ose pjesët e përfitimeve që janë të pagueshme plotësisht nga fondet publike, dhe lidhur me pagesat për personat që nuk përmbushin kushtet e kontributit të parashikuara për të marrë pension normal.

c) Taksat e punësimit, detyrimet ose kontributet që paguhen lidhur me personin e punësuar. d) Procedurat **LIGJ**ore lidhur me çështjet të cilave u referohet kjo Konventë.

2. Në rastin e një shteti federal masat e këtij neni zbatohen deri në nivelin ku çështjet e trajtuara rregullohen nga **LIGJ**i ose rregullat federale ose i nënshtrohen kontrollit të autoriteteve administrative federale. Shtrirja dhe mënyra sesi zbatohen këto masa lidhur me çështjet që rregullohen nga **LIGJ**i ose rregullat e shteteve përbërëse, provincave apo kantoneve, ose që i nënshtrohen kontrollit të autoriteteve administrative, përcaktohen nga çdo Shtet Palë. Shteti Palë tregon në raportin e përvitshëm mbi zbatimin e Konventës shtrirjen në të cilën rregullohen çështjet e trajtuara në këtë nen nga **LIGJ**i ose rregullat federale ose i nënshtrohen kontrollit të autoriteteve administrative federale. Lidhur me çështjet që rregullohen nga **LIGJ**i ose rregullat e shteteve përbërëse, provincave apo kantoneve, ose i nënshtrohen kontrollit të autoriteteve administrative, Shteti Palë ndërmerr hapat e përcaktuara në paragrafin 7 (b) të nenit 19 të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

Neni 7

1. Çdo Shtet Palë për të cilin është në fuqi kjo Konventë merr përsipër që shërbimi i tij i punësimit dhe shërbimet e tjera që lidhen me migracionin të bashkëpunojnë në rastet e duhura me shërbimet përkatëse të Shteteve të tjera Palë.
2. Çdo Shtet Palë për të cilin kjo Konventë është në fuqi, merr përsipër të sigurojë që shërbimet e bëra nga shërbimi i tij publik i punësimit për migrantët të jenë falas.

Neni 8

1. Një migrant për punësim që është pranuar për qëndrim të përhershëm dhe pjestarët e familjes së tij që janë autorizuar ta shoqërojnë ose të bashkohen me të nuk do të kthehen në territorin e tyre të origjinës ose në territorin nga ku kanë emigruar, për arsyen se migranti nuk është në gjendje të vazhdojë punësimin e tij për shkak të sëmundjes ose dëmtimit pas hyrjes, përveç rastit kur personi në fjalë e dëshiron këtë ose kur kjo përcaktohet nga një marrëveshje ndërkombëtare në të cilën Shteti Palë ka pranuar.
2. Kur migrantët për punësim pranohen për qëndrim të përhershëm pas mbërritjes në vendin e imigracionit autoriteti kompetent i atij vendi mund të përcaktojë që masat e paragrafit I të këtij neni të hyjnë në fuqi vetëm pas një periudhe të arsyeshme që në asnjë rast nuk do t'i kalojë 5 vjetët që nga data e pranimit të këtyre migrantëve.

Neni 9

Çdo Shtet Palë për të cilin kjo Konventë është në fuqi merr përsipër të lejojë, duke marrë parasysh kufizimet e lejuara nga **LIGJ**et dhe rregullat vendase lidhur me eksportin dhe importin e valutës, transferimin e pjesës së fitimeve dhe kursimeve të migrantit për punësim sipas dëshirës së migrantit.

Neni 10

Në rastet kur numri i migrantëve që shkojnë nga territori i një Shteti Palë tek ai i një Shteti tjetër Palë është mjaft i madh, autoritetet kompetente të territoreve në fjalë, kur është e nevojshme ose e dëshirueshme, bëjnë marrëveshje për qëllimin e rregullimit të çështjeve që përbëjnë shqetësim të përbashkët që lindin lidhur me zbatimin e masave të kësaj Konvente.

Neni 11

1. Për qëllimin e kësaj Konvente termi migrant për punësim do të thotë një person që migron

nga një vend në një tjetër me synimin për t'u punësuar jo për llogari të tij dhe përfshin çdo person të pranuar rregullisht si migrant për punësim.

2. Kjo konventë nuk zbatohet për:

- a) punëtorët kufitarë;
- b) hyrjen afatshkurtër të profesionistëve të lirë dhe artistëve;
- c) detarët.

Neni 12

Ratifikimet zyrtare të kësaj Konvente i komunikohen Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës për regjistrim.

Neni 13

1. Kjo Konventë është detyruese vetëm për ata Shtete Palë të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, ratifikimi i të cilëve është regjistruar pranë Drejtorit të Përgjithshëm.
2. Ajo hyn në fuqi 12 muaj pas datës në të cilën ratifikimet e dy Shteteve Palë të jenë regjistruar pranë Drejtorit të Përgjithshëm.
3. Pas kësaj, kjo Konventë hyn në fuqi për çdo Shtet Palë 12 muaj pas datës së regjistrimit të ratifikimit.

Neni 14

1. Çdo Shtet Palë që ratifikon këtë Konventë, me anën e një deklaratë të bashkëngjitur me ratifikimin, mund të përjashtojë nga ratifikimi ndonjë ose të gjitha anekset e Konventës.
2. Duke iu nënshtruar kushteve të kësaj deklaratë, masat e anekseve kanë të njëjtin efekt me masat e Konventës.
3. Çdo Shtet Palë që bën një deklaratë të tillë ka mundësinë që më vonë, me anën e një deklaratë tjetër, të njoftojë Drejtorin e Përgjithshëm që pranon ndonjë ose të gjitha anekset e përmendura në deklaratë; që nga data e regjistrimit të këtij njoftimi nga Drejtori i Përgjithshëm masat e këtyre anekseve bëhen të zbatueshme për Shtetin Palë në fjalë.
4. Ndërkohë që një deklaratë e bërë sipas paragrafit 1 të këtij neni mbetet në fuqi për ndonjë aneks, Shteti Palë mund të deklarojë vullnetin e tij për ta pranuar atë aneks si rekomandim.

Neni 15

1. Deklaratat e komunikuar te Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës në përputhje me nenin 35 të Kushtetutës së Zyrës Ndërkombëtare të Punës do të tregojnë:
 - a) territoret për të cilat Shteti Palë në fjalë merr përsipër që masat e Konventës do të zbatohen pa ndryshime;
 - b) territoret për të cilat ai merr përsipër që masat e Konventës do të zbatohen me ndryshime, së bashku me hollësitë e ndryshimeve të përmendura;
 - c) territoret për të cilat Konventa është e pazbatueshme dhe në këto raste bazat për këtë pazbatueshmëri;
 - d) territoret për të cilat ai rezervon pezullimin e **VENDIMIT** deri në rishikim të pozicionit.
2. Masat e ndërmarra sipas pikave (a) dhe (b) të paragrafit 1 të këtij neni konsiderohen pjesë përbërëse të ratifikimit dhe kanë të njëjtën fuqi me ratifikimin.
3. Çdo Shtet Palë ka mundësinë që në çdo kohë me anën e një deklaratë të mëvonshme të anulojë plotësisht ose pjesërisht çdo rezervim të bërë në deklaratën fillestare lidhur me pikat (b), (c) ose (d) të paragrafit 1 të këtij neni.
4. Çdo Shtet Palë ka mundësinë që, në çdo kohë që Konventa i nënshtrohet denoncimit në përputhje me masat e nenit 17, t'i komunikojë Drejtorit të Përgjithshëm një deklaratë që ndryshon çdo aspekt kushtet e çdo deklaratë zyrtare të mëparshme dhe që përcakton

pozicionin aktual lidhur me këto territore siç mund të specifikohet në të.

Neni 16

1. Deklaratat e komunikuara te Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës, në përputhje me paragrafin 4 ose 5 të nenit 35 të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës, do të tregojnë nëse masat e Konventës do të zbatohen në territorin në fjalë pa ndryshime ose do t'u nënshtrohen ndryshimeve; kur deklarata tregojnë që masat e Konventës do të zbatohen me ndryshime, do të jepen hollësi për këto ndryshime.
2. Shteti Palë, anëtarët ose autoriteti ndërkombëtar i interesuar mund që në çdo kohë me anën e një deklaratë të mëvonshme të heqë dorë plotësisht ose pjesërisht nga e drejta për të kërkuar ndryshime në deklaratat e mëparshme.
3. Shteti Palë ose autoriteti ndërkombëtar i interesuar mund që, në çdo kohë që Konventa i nënshtrohet denoncimit në përputhje me masat e nenit 17, t' i komunikojë Drejtorit të Përgjithshëm një deklaratë për ndryshimin në çdo aspekt të deklaratave të mëparshme dhe që përcakton pozicionin aktual lidhur me zbatimin e Konventës.

Neni 17

1. Një Shtet Palë që e ka ratifikuar këtë Konventë mund ta denoncojë arë pasi të kenë kaluar 10 vjet nga data e hyrjes në fuqi e Konventës për herë të parë, me anën e një akti që i komunikohet Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës për regjistrim. Ky denoncim nuk duhet të hyjë në fuqi deri një vit pas datës kur është regjistruar.
2. Çdo Shtet Palë që ka ratifikuar këtë Konventë dhe që, brenda një viti në vijim të mbarimit të periudhës prej 10 vjetësh, përmendur në paragrafin pararendës, nuk ushtron të drejtën e denoncimit të përcaktuar në këtë nen, do t'i shtohen detyrimet edhe për 10 vjet të tjera dhe, pas kësaj, ai mund ta denoncojë këtë Konventë në mbarim të çdo periudhe prej 10 vjetësh sipas kushteve të përcaktuara në këtë nen.
3. Në çdo kohë që kjo Konventë i nënshtrohet denoncimit në përputhje me masat e paragrafëve pararendës, çdo Shtet Palë që nuk e bën këtë denoncim, mund t'i komunikojë Drejtorit të Përgjithshëm një deklaratë ku të denoncojë veçan çdo aneks të Konventës që është në fuqi për atë Shtet Palë.
4. Denoncimi i kësaj Konvente ose i ndonjërit apo i të gjitha anekseve nuk do të ndikojë mbi të drejtat e garantuara në këtë Konventë për një migrantë ose për pjesëtarët e familjes së tij, nëse ai ka imigruar në kohën që Konventa ose anekset përkatëse ishin në fuqi, lidhur me territorin ku ngrihet çështja e vazhdimit të vlefshmërisë së këtyre të drejtave.

Neni 18

1. Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës njofton të gjitha Shtetet Palë të Organizatës Ndërkombëtare të Punës për regjistrimin e të gjitha ratifikimeve dhe denoncimeve që i janë komunikuar atij nga Shtetet Palë të Organizatës.
2. Kur Drejtori i Përgjithshëm njofton Shtetet Palë të Organizatës për regjistrimin e ratifikimit të dytë që i është komunikuar atij, ai tërheq vëmendjen e Shteteve Palë të Organizatës për datën kur Konventa do të hyjë në fuqi.

Neni 19

Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës i komunikon Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara regjistrimin në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara me të gjitha hollësitë e të gjitha ratifikimeve dhe aktet e denoncimit të regjistruara prej tij në përputhje me masat e neneve paraardhëse.

Neni 20

Në përfundim të çdo periudhe prej 10 vjetësh pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Njësia Drejtuese e Zyrës Ndërkombëtare të Punës i paraqet Konferencës së Përgjithshme një raport për funksionimin e kësaj Konvente dhe shqyrton mundësinë për të futur në kalendarin e Konferencës çështjen e rishikimit të saj të plotë ose të pjesshëm.

Neni 21

1. Nëse Konferenca miraton një Konventë të re duke rishikuar këtë Konventë plotësisht ose pjesërisht, atëherë, vetëm nëse Konventa e re përcakton ndryshe:

a) ratifikimi nga një Shtet Palë i Konventës së re të rishikuar do të përmbajë në vetvete edhe denoncimin e menjëhershëm të kësaj Konvente, pavarësisht nga masat e nenit 17 më lart, kur Konventa e re e rishikuar të ketë hyrë në fuqi;

b) që nga data kur Konventa e re e rishikuar hyn në fuqi kjo Konventë nuk është më e hapur për ratifikim nga ana e Shteteve Palë.

2. Kjo Konventë gjithsesi mbetet në fuqi në formën dhe përmbajtjen e saj aktuale për ata Shtete Palë që e kanë ratifikuar atë, por nuk kanë ratifikuar Konventën e rishikuar.

Neni 22

1. Konferenca Ndërkombëtare e Punës mundet që, në çdo sesion kur kjo çështje është e përfshirë në kalendarin e saj, të miratojë me shumicë prej dy të tretash një tekst të rishikuar të një ose më shumë aneksesh të kësaj Konvente.

2. Çdo Shtet Palë për të cilin kjo Konventë është në fuqi, brenda periudhës prej një viti ose, në rrethana të jashtëzakonshme, prej 18 muajsh, që nga mbyllja e sesionit të Konferencës, paraqet këtë tekst të rishikuar tek autoriteti ose autoritetet brenda kompetencave të të cilit është kjo çështje, për hartimin e legjislacionit ose për veprime të tjera.

3. Çdo tekst i rishikuar hyn në fuqi për çdo Shtet Palë për të cilin kjo Konventë është në fuqi me komunikimin nga ana e atij Shteti Palë te Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës të një deklaratë ku njofton pranimin nga ana e tij të tekstit të rishikuar.

4. Që nga data e miratimit të tekstit të rishikuar të aneksit nga Konferenca, vetëm teksti i rishikuar është i hapur për pranim nga Shtetet Palë.

Neni 23

Variantet anglisht dhe frëngjisht të tekstit të kësaj Konvente janë të njëvlershme.

ANEKSI I

REKRUTIMI, VENDOSJA NË PUNË DHE KUSHTET E PUNËS TË MIGRANTËVE PËR PUNËSIM TË REKRUTUAR JASHTË MARRËVESHJEVE TË MBËSHTETURA NGA QEVERIA PËR TRANSFERIMET NË GRUP

Neni 1

Ky aneks zbatohet për migrantët për punësim që rekrutohen jashtë marrëveshjeve të mbështetura nga qeveria për transferimet në grup.

Neni 2

Për qëllimet e këtij aneksi:

a) Termi rekrutim do të thotë:

- i) angazhimi i një personi në një territor për llogari të një punëdhënësi në një territor tjetër;
 - ii) dhënia e një përgjegjësie një personi në një territor për t'u punësuar në një territor tjetër, së bashku me marrjen e masave lidhur me veprimet e përmendura në pikën (i) dhe (ii), përfshi edhe kërkimin për një përzgjedhje të emigrantëve dhe përgatitjet për nisjen e emigrantëve.
- b) Termi paraqitje do të thotë çdo veprim për të siguruar ose lehtësuar mbërritjen ose pranimin në një territor të personave që janë rekrutuar brenda kuadrit të paragrafit (a) të këtij neni.
- c) Termi vendosje do të thotë çdo veprim për qëllimin e sigurimit ose lehtësimit të punësimit të personave që janë paraqitur në përputhje me paragrafin (b) të këtij neni.

Neni 3

1. Çdo Shtet Palë për të cilin ky aneks është në fuqi, **LIGJET** dhe rregullat e të cilit lejojnë veprimet e rekrutimit, paraqitjes dhe vendosjes sipas përcaktimit në nenin 2, i rregullojnë veprimet e lartpërmendura siç përcaktohet nga **LIGJET** dhe rregullat e tij në përputhje me masat e këtij neni.
2. Duke iu nënshtruar masave të paragrafit të mëposhtëm, e drejta për t'u angazhuar në veprimet e rekrutimit, paraqitjes dhe vendosjes kufizohet në:
 - a) zyrat publike të punësimit ose organet publike të tjera në territorin ku kryhet ky veprim;
 - b) organet publike të një territori të ndryshëm nga ai ku bëhen veprimet që janë të autorizuar të veprojnë në atë territor me marrëveshje ndërmjet qeverive në fjalë;
 - c) çdo organ të krijuar në përputhje me kushtet e një instrumenti ndërkombëtar.
3. Në përputhje me sa lejojnë **LIGJET** dhe rregullat vendase ose një marrëveshje dypalëshe, veprimet e rekrutimit, paraqitjes dhe vendosjes mund të ndërmerren nga:
 - a) punëdhënësi i' ardhshëm ose një person në shërbim të tij, që vepron për llogari të tij, që i nënshtrohet, nëse është e nevojshme për interesin e migrantit, miratimit dhe mbikëqyrjes nga autoriteti kompetent;
 - b) një agjenci private, nëse i është dhënë autorizim paraprak për ta bërë këtë nga autoriteti kompetent i territorit ku do të kryhen veprimet e lartpërmendura, në ato raste dhe me ato kushte që përcaktohen nga:
 - i) **LIGJET** dhe rregullat e atij territori ose
 - ii) marrëveshja ndërmjet autoritetit kompetent të territorit të emigracionit ose ndonjë organi të krijuar në përputhje me kushtet e një instrumenti ndërkombëtar dhe autoritetit kompetent të territorit të imigracionit.
4. Autoriteti kompetent i territorit ku kryhen veprimet mbikëqyr veprimtaritë e organeve dhe personave të cilëve u është dhënë autorizim në përputhje me paragrafin 3 (b), përveç organeve të krijuara në përputhje me kushtet e një instrumenti ndërkombëtar, pozicioni i të cilit do të vazhdojë të rregullohet sipas kushteve të instrumentit të lartpërmendur ose nga ndonjë marrëveshje e bërë ndërmjet këtij organi dhe autoritetit kompetent në fjalë.
5. Asgjë në këtë nen nuk do të konsiderohet se lejon pranimin e një migranti për punësim për t'u pranuar në territorin e një Shteti Palë nga ndonjë person ose organ i ndryshëm nga autoriteti kompetent i territorit të imigracionit.

Neni 4

Çdo Shtet Palë për të cilin ky aneks është në fuqi, merr përsipër të sigurojë që shërbimet e bëra nga shërbimi i tij publik i punësimit, lidhur me rekrutimin, paraqitjen ose vendosjen e migrantëve për punësim, të bëhen falas.

Neni 5

1. Çdo Shtet Palë, për të cilin ky aneks është në fuqi, i cili ka një sistem të mbikëqyrjes së kontratave të punësimit ndërmjet një punëdhënësi ose një personi që vepron për llogari të tij

dhe një migranti për punësim merr përsipër të kërkojë:

- a) që një kopje e kontratës së punësimit t'i jepet migrantit përpara nisjes ose, nëse qeveritë në fjalë bien dakord, në një qendër pritjeje pas mbërritjes në territorin e imigracionit;
- b) që kontrata të përmbajë masa që tregojnë kushtet e punës dhe në mënyrë të veçantë shpërblimin e ofruar për migrantin;
- c) që migranti të marrë me shkrim përpara nisjes, me anën e një dokumenti që ka lidhje me të individualisht ose me një grup migrantësh ku ai bën pjesë, informacion lidhur me kushtet e përgjithshme të jetesës dhe të punës që zbatohen për të në territorin e imigracionit.

2. Nëse një kopje e kontratës do t'i jepet migrantit pas mbërritjes në territorin e imigracionit, ai do të informohet me shkrim përpara nisjes, me anën e një dokumenti që lidhet me atë individualisht ose me një grup migrantësh ku ai bën pjesë, për kategorinë e punës për të cilën ai është marrë dhe për kushtet e tjera të punës, në mënyrë të veçantë për pagesën minimale që i garantohet atij.

3. Autoriteti kompetent siguron që masat e paragrafëve paraardhës të zbatohen dhe që të zbatohen ndëshkimet e duhura për shkeljet.

Neni 6

Masat e marra sipas nenit 4 të Konventës përfshijnë:

- a) thjeshtimin e formaliteteve administrative;
- b) masën për shërbimet e interpretimit;
- c) çdo asistencë të nevojshme gjatë një periudhe fillestare për vendosjen e migrantëve dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre të autorizuar për ta shoqëruar ose për t'u bashkuar me ta;
- d) ruajtjen e mirëqenies, gjatë udhëtimit dhe në mënyrë të veçantë gjatë transportimit të migrantëve dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre të autorizuar për ta shoqëruar ose për t'u bashkuar me ta.

Neni 7

1. Në rastet kur numri i migrantëve për punësim që shkojnë nga territori i një Shteti Palë në territorin e një Shtetit tjetër Palë është mjaft i madh, autoritetet kompetente të territoreve në fjalë, kur është e nevojshme ose kur dëshirojnë, hyjnë në marrëveshje për qëllimin e rregullimit të çështjeve të shqetësimit të përbashkët që dalin lidhur me zbatimin e masave të këtij aneksi.

2. Kur Shtetet Palë kanë një sistem mbikëqyrjeje të kontratave të punësimit, këto marrëveshje tregojnë mënyrat me të cilat do të zbatohen detyrimet kontraktore të punëdhënësve.

Neni 8

Çdo person që nxit imigracionin klandestin ose të pa**LIGJ**shëm u nënshtrohet ndëshkimeve përkatëse.

ANEKSI II

REKRUTIMI, VENDOSJA DHE KUSHTET E PUNËS TË MIGRANTËVE PËR PUNËSIM TË REKRUTUAR SIPAS MASAVE TË MBËSHTETURA NGA QEVERIA PËR TRANSFERIMET NË GRUP

Neni 1

Ky aneks zbatohet për migrantët për punësim të cilët rekrutohen sipas masave të mbështetura nga qeveria për transferimet në grup.

Neni 2

Për qëllimet e këtij aneksi:

a) Termi rekrutim do të thotë:

i) angazhimi i një personi në një territor për llogari të një punëdhënësi në një territor tjetër sipas masave të mbështetura nga qeveria për transferimet në grup;

ii) dhënia e një përgjegjësie një personi në një territor për t'u punësuar në një territor tjetër sipas masave të mbështetura nga qeveria për transferimin në grup, së bashku me marrjen e masave, lidhur me veprimet e përmendura në pikën (i) dhe (ii) përfshi edhe kërkimin për një përzgjedhje të emigrantëve dhe përgatitjet për nisjen e emigrantëve.

b) Termi paraqitje do të thotë çdo veprim për të siguruar ose lehtësuar mbërritjen ose pranimin në një territor të personave që janë rekrutuar sipas masave të mbështetura nga qeveria për transferimin në grup brenda kuadrit të nënparagrafit (a) të këtij paragrafi.

c) Termi vendosje do të thotë çdo veprim për qëllimin e sigurimit ose lehtësimit të punësimit të personave që janë paraqitur sipas masave të mbështetura nga qeveria për transferimin në grup në përputhje me nënparagrafin (b) të këtij paragrafi.

Neni 3

1. Çdo Shtet Palë për të cilin ky aneks është në fuqi, **LIGJET** dhe rregullat e të cilit lejojnë veprimet e rekrutimit, paraqitjes dhe vendosjes siç përcaktohet në nenin 2, rregullon veprimet e lartpërmendura siç lejohet nga **LIGJET** dhe rregullat e tij në përputhje me masat e këtij neni.

2. Sipas masave të paragrafit të mëposhtëm, e drejta për t'u angazhuar në veprimet e rekrutimit, paraqitjes dhe vendosjes do të kufizohen në:

a) zyrat publike të punësimit ose organet e tjera publike të territorit ku kryhen veprimet;

b) organet publike të një territori të ndryshëm nga ai ku kryhen veprimet të cilat janë të autorizuar për të vepruar në atë territor me marrëveshje ndërmjet qeverive në fjalë;

c) çdo organ të krijuar në përputhje me kushtet e një instrumenti ndërkombëtar.

3. Aq sa e lejojnë **LIGJET** dhe rregullat vendase ose marrëveshjet dypalëshe, dhe duke iu nënshtruar, nëse është e nevojshme për interes të migrantit, miratimit dhe mbikëqyrjes së autoritetit kompetent, veprimet e rekrutimit, paraqitjes dhe vendosjes mund të ndërmerren nga:

a) punëdhënësi i ardhshëm ose një person në shërbim të tij, duke vepruar për llogari të tij;

b) agjencitë private.

4. E drejta për t'u angazhuar në veprimet e rekrutimit, paraqitjes dhe vendosjes i nënshtrohet autorizimit paraprak të autoritetit kompetent të territorit ku do të kryhen veprimet e lartpërmendura në ato raste dhe me ato kushte që mund të parashikohen nga:

a) **LIGJET** dhe rregullat e atij territori ose

b) marrëveshja ndërmjet autoritetit kompetent të territorit të emigracionit ose çdo organi të krijuar në përputhje me kushtet e një instrumenti ndërkombëtar dhe autoritetit kompetent të territorit të imigracionit.

5. Autoriteti kompetent i territorit ku kryhen veprimet, në përputhje me marrëveshjet e bëra ndërmjet autoriteteve kompetente në fjalë, mbikëqyr veprimtarinë e organeve dhe personave të cilëve u janë dhënë autorizimet në përputhje me paragrafin pararendës, përveç organeve të krijuara në përputhje me kushtet e një instrumenti ndërkombëtar, pozicioni i të cilit vazhdon të drejtohet nga kushtet e instrumentit të lartpërmendur ose nga marrëveshjet e bëra ndërmjet organit dhe autoritetit kompetent në fjalë.

6. Përpara se të autorizojë paraqitjen e migrantëve për punësim autoriteti kompetent i territorit të imigracionit sigurohet që nuk ka numër të mjaftueshëm personash që të jenë në gjendje të bëjnë punën në fjalë.

7. Asgjë në këtë nen nuk do të konsiderohet sikur lejon pranimin e një migranti për punësim në territorin e një Shteti Palë nga ndonjë person apo organizëm i ndryshëm nga autoriteti kompetent i territorit të imigracionit.

Neni 4

1. Çdo Shtet Palë, për të cilin është në fuqi ky aneks, merr përsipër të sigurojë që shërbimet e ofruara nga shërbimi i tij i punësimit lidhur me rekrutimin, paraqitjen ose vendosjen e migrantëve për punësim, të jenë falas.
2. Shpenzimet administrative të rekrutimit, paraqitjes dhe vendosjes nuk mbulohen nga migrantët.

Neni 5

Në rastin e transportit kolektiv të migrantëve nga një vend në një tjetër që kanë nevojë për kalim transit nëpër një shtet të tretë, autoriteti kompetent i territorit të transitit merr masat për të përshpejtuar kalimin, për të shmangur vonesat dhe vështirësitë administrative.

Neni 6

1. Çdo Shtet Palë, për të cilin ky aneks është në fuqi, që ka një sistem mbikëqyrjeje të kontratave të punës ndërmjet një punëdhënësi ose një personi që vepron për llogari të tij, dhe një migranti për punësim merr përsipër të kërkojë:
 - a) që një kopje e kontratës së punësimit t'i jepet migrantit përpara nisjes ose, nëse qeveritë në fjalë bien dakord, në një qendër pritjeje pas mbërritjes në territorin e imigracionit;
 - b) që kontrata të përmbajë masa që tregojnë kushtet e punës dhe në mënyrë të veçantë shpërblimin e ofruar për migrantin;
 - c) që migranti të marrë me shkrim përpara nisjes, me anën e një dokumenti që ka lidhje me të individualisht ose me një grup migrantëshku ai bën pjesë, informacion lidhur me kushtet e përgjithshme të jetesës dhe të punës që zbatohen për të në territorin e imigracionit.
2. Nëse një kopje e kontratës do t'i jepet migrantit pas mbërritjes në territorin e imigracionit, ai do të informohet me shkrim përpara nisjes, me anën e një dokumenti që lidhet me atë individualisht ose me një grup migrantësh ku ai bën pjesë, për kategorinë e punës për të cilën ai është marrë dhe për kushtet e tjera të punës, në mënyrë të veçantë për pagesën minimale që i garantohet atij.
3. Autoriteti kompetent siguron që masat e paragrafëve paraardhës të zbatohen dhe që të zbatohen ndëshkimet e duhura për shkeljet.

Neni 7

1. Masat e marra sipas nenit 4 të kësaj Konvente përfshijnë:
 - a) thjeshtimin e formaliteteve administrative;
 - b) masën për shërbimet e interpretimit;
 - c) çdo asistencë të nevojshme gjatë një periudhe fillestare për vendosjen e migrantëve dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre të autorizuar për ta shoqëruar ose për t'u bashkuar me ta;
 - d) ruajtjen e mirëqenies, gjatë udhëtimit dhe në mënyrë të veçantë gjatë transportimit të migrantëve dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre të autorizuar për ta shoqëruar ose për t'u bashkuar me ta;
 - e) lejen për likuidimin dhe transferimin e pasurive të migrantëve për punësim të pranuar në mënyrë të përhershme.

Neni 8

Autoriteti kompetent merr masat e duhura për të ndihmuar migrantët për punësim, gjatë periudhës fillestare, lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me kushtet e tyre të punësimit; aty ku është e drejtë, këto masa mund të merren në bashkëpunim me organizatat e miratuara vullnetare.

Neni 9

Nëse një migrant për punësim i paraqitur në territorin e një Shteti Palë, në përputhje me masat e nenit 3 të këtij aneksi, nuk arrin, për një arsye për të cilën ai nuk është përgjegjës, të sigurojë punësimin për të cilin ai është rekrutuar ose një punësim tjetër të përshtatshëm, kostoja e kthimit të tij dhe të pjesëtarëve të familjes së tij, të cilët janë autorizuar ta shoqërojnë ose të bashkohen me të, përfshi edhe tarifën administrative, shpenzimet e transportit dhe jetesën deri në destinacionin përfundimtar, dhe pagesat për transportin e sendeve shtëpiake, nuk do të rëndojnë mbi migrantin.

Neni 10

Nëse autoriteti kompetent i territorit të imigracionit e vlerëson që punësimi për të cilin është rekrutuar migranti për punësim, në përputhje me nenin 3 të këtij aneksi, është vlerësuar si i papërshtatshëm, ai merr masat e duhura për ta ndihmuar atë që të gjejë një punësim të përshtatshëm që nuk paragjykon punëtorët vendas dhe ndërmerr hapa për të siguruar jetesën e tij deri në gjetjen e punësimit ose kthimin e tij në zonën e rekrutimit, nëse migranti dëshiron ose ka pranuar kthimin në kohën e rekrutimit të tij, ose vendosjen e tij diku tjetër.

Neni 11

Nëse një migrant për punësim, i cili është refugjat ose person i shpërngulur dhe që ka hyrë në territorin e imigracionit në përputhje me nenin 3 të këtij aneksi, bëhet i panevojshëm për punësim në atë territor, autoriteti kompetent i atij territori bën përpjekjet e tij më të mëdha për ta mundësuar atë që të ndërmarrë një punësim të përshtatshëm që nuk i paragjykon punëtorët vendas, dhe ndërmerr hapa për të siguruar jetesën e tij deri në vendosjen në një punësim të përshtatshëm ose vendosjen e tij në një vend tjetër.

Neni 12

1. Autoritetet kompetente të territoreve në fjalë hyjnë në marrëveshje për qëllimin e rregullimit të çështjeve që përbëjnë shqetësim të përbashkët që dalin lidhur me zbatimin e masave të këtij aneksi.
2. Kur Shtetet Palë kanë një sistem mbikëqyrjeje të kontratave të punësimit, këto marrëveshje tregojnë mënyrat me të cilat do të zbatohen detyrimet kontraktore të punëdhënësve.
3. Këto marrëveshje përcaktojnë, kur duhet, për bashkëpunim ndërmjet autoritetit kompetent të territorit të emigracionit ose të një organi të krijuar në përputhje me kushtet e një instrumenti ndërkombëtar dhe autoritetit kompetent të territorit të imigracionit, lidhur me ndihmën që duhet t'u jepet migrantëve lidhur me kushtet e punësimit në përputhje me masat e nenit 8.

Neni 13

Çdo person që nxit imigracionin klandestin ose të pa**LIGJ**shëm, u nënshtrohet ndëshkimeve përkatëse.

ANEKSI III

IMPORTIMI I SENDEVE PERSONALE, MJETEVE DHE PAJISJEVE TË MIGRANTËVE PËR PUNËSIM

Neni 1

1. Sendet personale që u përkasin migrantëve të rekrutuar për punësim dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre që janë autorizuar t'i shoqërojnë ose të bashkohen me ta përjashtohen nga detyrimet doganore kur mbërrijnë në territorin e imigracionit.
2. Veglat e punës të transportueshme dorazi dhe pajisjet e transportueshme dorazi të çdo lloji,

që zakonisht kanë punëtorët për kryerjen e detyrave të tyre që u përkasin migrantëve të rekrutuar për punësim dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre, të cilët janë autorizuar t'i shoqërojnë ose të bashkohen me ta, përjashtohen nga detyrimet doganore kur mbërrijnë në territorin e imigracionit, nëse këto vegla dhe pajisje mund të tregohet, në kohën e transportimit, se zotërohen aktualisht prej tyre, ose janë zotëruar dhe përdorur prej tyre për një kohë të konsiderueshme, dhe se ata synojnë t'i përdorin ato gjatë punësimit të tyre.

Neni 2

1. Sendet personale që u përkasin migrantëve për punësim dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre, të cilët janë autorizuar për ta shoqëruar ose për t'u bashkuar me të, përjashtohen nga detyrimet doganore, kur personat në fjalë kthehen në vendin e tyre të origjinës, nëse këta persona e kanë ruajtur shtetësinë e vendit në kohën e kthimit atje.

2. Veglat e punës dhe pajisjet që mund të transportohen dorazi si ato që zotërojnë zakonisht punëtorët për kryerjen e detyrave të tyre të veçanta që u përkasin migrantëve për punësim dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre, të cilët janë autorizuar ta shoqërojnë ose të bashkohen me të, përjashtohen nga detyrimet doganore, kur këta persona kthehen në vendin e tyre të origjinës, nëse këta persona e kanë ruajtur shtetësinë e atij vendi në kohën e kthimit të tyre atje dhe nëse mund të tregojnë, në kohën e importimit të tyre, që këto vegla pune dhe pajisje zotërohen aktualisht prej tyre, kanë qenë në zotërim dhe përdorim të tyre për një kohë të konsiderueshme dhe do të përdoren prej tyre gjatë punësimit.

VENDIM

Nr.315, date 21.5.2004

PER NJE NDRYSHIM NE **VENDIMIN** NR.511, DATE 24.10.2002 TE KESHILLIT TE MINISTRAVE "PER KOHEZGJATJEN E PUNES DHE TE PUSHIMIT NE INSTITUCIONET SHTETERORE", TE NDRYSHUAR

Ne mbeshtetje te nenit 100 le Kushtetutes, te neneve 19 shkronja "c", 20 shkronja "e" dhe "g", e 29 te **LIGJit** nr.8549, date 11.11.1999 "Statusi i nepunesit civil" dhe te neneve 76-108 te **LIGJit** nr.7961, date 12.7.1995 "Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise", i ndryshuar, me propozimin e Zevendes kryeministrit, Keshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 2 e kreut I te **VENDIMit** nr. 511, date 24.10.2002 te Keshillit te Ministrave, te ndryshuar, te behet si me poshte vijon:

"2. Orari ditor i punes fillon cdo dite ne oren 8.00 dhe perfundon ne oren 16.30, ndersa ditën e premte fillon ne oren 8.00 dhe perfundon ne oren 14.00."

Ky **VENDIM** hyn ne fuqi menjehere dhe botohet ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

UDHEZIM

Nr.73, date 14.1.2004

PER ZBATIMIN E **VENDIMIT** TE KESHILLIT TE MINISTRAVE NR.73, DATE 11.2.1999 "PER PROGRAMIN E NXITJES SE PUNESIMIT NEPERMJET FORMIMIT NE PUNE"

Ne mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në zbatim të **VENDIMIT** të Keshillit të Ministrave nr. 73, date 11.2.1999 "Per programin e nxitjes se punesimit nepermjet formimit ne pune" dhe te nenit 18/1 te Statutit te Sherbimit Kombetar te Punesimit, miratuar me **VENDIM**in e Keshillit te Ministrave date 17.1.1998 "Per miratimin e Statutit te Sherbimit Kombetar te Punesimit", i ndryshuar,

UDHEZOJ:

1. Ka të drejtë të aplikojë në programin e nxitjes së punesimit të punëkerkuesve të papunë çdo punedhënës, i cili është person juridik ose fizik dhe ushtron aktivitet ekonomik prej të paktën një viti nga data e aplikimit në këtë program.
2. Për të përfituar nga ky program, punedhënesi duhet të paraqesë pranë zyres kompetente të punesimit të rrethit ku ai zhvillon aktivitetin dokumentacionin e mëposhtem:
 - a) **VENDIM**in e gjykates së rrethit për regjistrimin si person juridik apo fizik (në **VENDIM**in e gjykates duhet të jete përfshire aktiviteti për të cilin kërkon të punesoje punëkerkuesit e papunë).
 - b) Certifikatën e regjistrimit në organin tatimor.
 - c) Një informacion mbi:
 - i) përshkrimin e detajuar të aktivitetit që kryen;
 - ii) numrin e fuqisë punëtore;
 - iii) nivelin e pages që ai ka dhënë për çdo person.
 - d) Marrëveshjen me sigurimet shoqërore për numrin e punëtoreve të siguruar.
 - e) Numrin e llogarise bankare.
 - f) Një informacion mbi:
 - i) numrin e punëtoreve që kërkohen të punesohen;
 - ii) profesionin për të cilin do të punesohen;
 - iii) përshkrimin e aktivitetit që do të kryejnë këta punëtore;
 - iv) kohezgjatjen e punesimit;
 - v) llojin e kontratës që kërkon të zbatohet;
 - vi) nivelin e pages.
 - g) Bilancin ekonomik-financiar të vitit të mëparshëm për personat juridike. (Që të konsiderohet kërkesa e punedhënesit, bilanci duhet të jete pozitiv, vertetuar kjo nga dega e tatimtaksave e rrethit ku ushtron aktivitetin.) Për personat fizike duhet të paraqitet një vertetim nga dega e tatim-taksave në lidhje me korrektesinë e derdhjes së detyrimeve tatimore.

Me të dhënat e dokumentacionit të mësipërm, punedhënesi, në bashkëpunim me zyren kompetente të punesimit, plotëson formularin përkatës.
3. Vertetësia e dokumentacionit të paraqitur nga punedhënesi verifikohet në bashkëpunim me inspektore të inspektoratit vendor dhe rajonal të punës, i cili shprehet brenda 7 ditëve mbi vertetësinë e dokumentacionit dhe korrektesinë e subjektit ndaj legjislacionit të punës. Marrëdhëniet midis tyre rregullohen me urdher të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale.
4. Përparësitë dhe fushat prioritare ku do të zbatohet programi vendosen me urdher të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale çdo fillim viti.
5. Zyra kompetente e punesimit mbledh, shqyrton dhe vlerëson projektet e paraqitura nga punedhënesit. Ajo thërret mbledhjen e keshillit lokal tripartesh, i cili shqyrton dhe vendos mbi dobishmerinë social-ekonomike të projekteve që do të kërkohen të financohen. Zyra kompetente e punesimit i rendit aplikimet sipas prioriteteve të vendosura nga ministri dhe i dergon për miratim si më poshtë:
 - a) Zyra vendore e punesimit dergon për miratim të gjitha projektet, sipas rastit, në zyren

rajonale te punesimit ose ne Drejtorine e Pergjithshme te Sherbimit Kombetar te Punesimit.

b) Zyra rajonale e punesimit miraton projektet, kur aplikues jane ndermarrjet e vogla ne kuptim te **LIGJit** nr. 8957, date 17.10.2002 "Per ndermarrjet e vogla dhe te mesme" dhe dergon per miratim ne Drejtorine e Pergjithshme te Sherbimit Kombetar te Punesimit projektet ku aplikues jane ndermarrjet qe kane mbi 21 te punesuar.

Sipas **LIGJit** te siperpermendur, ndermarrjet e vogla jane ndermarrjet te cilat:

a) punesojne 6-20 punonjes;

b) xhiroja ekonomike vjetore e tyre nuk e kalon shumen 40 milione leke;

c) 100 per qind e kapitalit te ketyre ndermarrjeve zoterohet nga subjekte te cilat, ne kuptim te **LIGJit** te siperpermendur, klasifikohen si ndermarrje te vogla.

6. Ne rastet kur aplikues jane ndermarrje te vogla ne kuptimin e numrit te punonjesve, por me perfitimin e financimit sipas ketij programi hyjne te ndermarrjet e mesme, aplikimi dergohet per miratim ne komisionin e ngritur ne Drejtorine e Pergjithshme te Sherbimit Kombetar te Punesimit.

7. Per zbatimin e pikes 6 te ketij **UDHEZIMI** ngrihen komisionet perkatese per miratimin e projekteve dhe konkretisht:

a) Ne cdo zyre rajonale punesimi ngrihet komisioni i miratimit te projekteve.

b) Ne Drejtorine e Pergjithshme te Sherbimit Kombetar te Punesimit ngrihet komisioni i miratimit te projekteve.

Menyra e funksionimit dhe e perberjes se komisioneve percaktohet me rregullore te Sherbimit Kombetar te Punesimit.

8. Komisioni i zyres rajonale te punesimit vendos per miratimin ose jo te projektit brenda 20 diteve nga data e paraqitjes se kerkeses per aplikim nga punedhenesi. Komisioni i Drejtorise se Pergjithshme te Sherbimit Kombetar te Punesimit vendos per miratimin ose jo te projektit brenda 30 diteve nga data e paraqitjes per aplikim nga punedhenesi.

9. Per projektet e miratuara, zyra kompetente e punesimit ne bashkepunim me punedhenesin plotesojne listen e punekerkuesve te papune qe do te perfshihen ne program. Ndermjet zyrave kompetente te punesimit dhe punedhenesit nenshkruhet nje kontrate, ku perfshihen te drejtat dhe detyrat qe percakton programi per secilen pale.

10. Per efekt zbatimi te ketij **VENDIMI**, financimi behet duke iu referuar nivelit te pages minimale ne shkalle vendi.

11. Ne zbatim te pikes 1 te **VENDIMI**it, per cdo te punesuar punedhenesi perfiton:

a) kompensim mujor per page ne masen 100 per qind te pages minimale;

b) kompensim mujor per sigurimet shoqerore e shendetesore ne masen 100 per qind, duke iu referuar **VENDIMI**it te Keshillit te Ministrave nr.402, date 11.6.2001 "Per disa ceshtje ne zbatim te **LIGJit** nr. 7703, date 11.5.1993 "Per sigurimet shoqerore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar.

12. Ne zbatim te pikes 2 te **VENDIMI**it, pas perfundimit te periudhes se formimit per cdo te punesuar mbi numrin e fiksuar ne kontrate, punedhenesi merr nje shperblim te menjehershem te barabarte me 100 per qind te shumes se pages minimale ne shkalle vendi dhe 100 % te shpenzimeve per sigurimet e detyrueshme shoqerore dhe shendetesore per punemarresit per nje periudhe 3-mujore.

13. Marredheniet midis Sherbimit Kombetar te Punesimit, punedhenesit dhe punekerkuesve te papune te punesuar sipas ketij programi vendosen ne marreveshje te perbashketa midis tyre. Punedhenesi dhe punemarresi nenshkruajne nje marreveshje per kushtet e punesimit te personave qe punesohen. Marreveshja permban ne cdo rast emrat e te gjitha personave qe do te angazhohen ne program.

14. Ne zbatim te pikes 3 te **VENDIMI**it, zyra kompetente e punesimit eshte e detyruar te cregjistroje nga lista e punekerkuesve te papune personat qe pa arsye te pranueshme refuzojne te marrin pjese ne program. Procedurat percaktohen ne rregulloren e Sherbimit Kombetar te Punesimit.

15. Ne zbatim te pikes 4 te **VENDIMI**it, zyra kompetente e punesimit ploteson listen e personave te perfshire ne program, te cilet jane perfitues te pageses se papunesise. Zyra kompetente e

punesimit llogarit nepermjet kesaj liste fondet e kursyera nga ai program, te cilat e kalojne masen 100 per qind te buxhetit te ketij programi. Procedurat e kalimit te fondeve percaktohen ne **UDHEZIM**in e perbashket me Ministrin e Financave.

16. Ne zbatim te pikes 5 te **VENDIM**it, zyra kompetente e punesimit ploteson listen e personave te punesuar qe jane pjesetare te familjeve perfituese te programit te ndihmes ekonomike. Zyra kompetente e punesimit llogarit nepermjet ketij formulari sasine e fondeve qe perfiton ky program nga punesimi i tyre. Kjo sasi eshte 40 per qind e ndihmes ekonomike te plote per nje familje me 4 persona per cdo muaj trajnim. Procedurat e kalimit te fondeve percaktohen ne **UDHEZIM**in e perbashket me Ministrin e Financave.

17. Zyra kompetente e punesimit perpilon dhe dergon cdo muaj informacion ne lidhje me zbatimin e projekteve, personat e punesuar, perfituesit e programeve te mbeshtetjes me te ardhura, punekerkuesit e papune etj.

18. Procedurat per perdorimin e fondeve te nxitjes se punesimit dhe hollesi te tjera percaktohen ne **UDHEZIM**in e perbashket me Ministrin e Financave.

19. Procedurat per zbatimin e ketij programi, formularet tip, kontratat tip, marreveshjet tip percaktohen me rregulloren metodike te zbatimit te Sherbimit Kombetar te Punesimit.

20. **UDHEZIMI** nr.368/2, date 10.5.1999 "Per zbatimin e **VENDIM**it te Keshillit te Ministrave nr.73, date 11.2.1999 "Per programin e nxitjes se punesimit nepermjet formimit ne pune", shfuqizohet.

Ky **UDHEZIM** hyn ne fuqi menjehere.

MINISTRI I PUNES DHE I ÇESHTJEVE SOCIALE

Engjell Bejtaj

UDHEZIM

Nr.74, date 14.1.2004

PER DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NE **UDHEZIMIN** NR.895, DATE 12.4.2000 "PER ZBATIMIN E **VENDIMIT** TE KESHILLIT TE MINISTRAVE NR.74, DATE 11.2.1999 "PER PROGRAMIN E NXITJES SE PUNESIMIT NEPERMJET MBESHTETJES SE FORMIMIT INSTITUCIONAL " "

Ne mbeshtetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutes se Republikes te Shqiperise, ne zbatim te **VENDIMIT** te Keshillit te Ministrave nr.74, date 11.2.1999 "Per programin e nxitjes se punesimit nepermjet mbeshtetjes se formimit institucional",

UDHEZOJ:

1. Pika 1 e **UDHEZIMIT** riformulohet me kete permbajtje:

"Ne zbatim te pikes 1 te **VENDIMIT** te Keshillit te Ministrave nr. 74, date 11.2.1999, Sherbimi Kombetar i Punesimit ploteson me punekerkues te papune te regjistruar ne zyrat e punesimit per shfrytezimin e kapacitetit te kurseve te ofruara nga punedhenesit, veprimtaria e te cileve eshte licencuar nga Ministri i Punes dhe i Çeshtjeve Sociale dhe kane te pakten 6 muaj eksperience ne fushen e formimit profesional, kur ata garantojne punesimin me kontrate te rregullt njevjeçare te 20% te pjesemarresve ne kurs."

2. Fjalía e dyte e pikes 8 dhe nenpikat e saj riformulohen me kete permbajtje:

"Fushat prioritare ku zbatohet programi vendosen me urdher te Ministrit te Punes dhe te Çeshtjeve Sociale çdo fillim viti. " .

Ky **UDHEZIM** hyn ne fuqi menjehere.

MINISTRI I PUNES DHE I ÇESHTJEVE SOCIALE

Engjell Bejtaj

UDHEZIM

Nr. 75 date 14.1.2004

PER ZBATIMIN E **VENDIMIT** TE KESHILLIT TE MINISTRAVE NR.69, DATE 11.2.1999 "PER PROGRAMIN E NXITJES SE PUNESIMIT TE PUNEKERKUESVE TE PAPUNE"

Ne mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në zbatim të **VENDIMIT** të Keshillit të Ministrave nr.69, date 11.2.1999 "Per programin e nxitjes se punesimit te puneckerkuesve te papune" dhe të nenit 18/1 të Statutit të Sherbimit Kombëtar të Punesimit, miratuar me **VENDIMIN** të Keshillit të Ministrave nr.42 date 17.1.1998 "Per miratimin e Statutit të Sherbimit Kombëtar të Punesimit", i ndryshuar,

UDHEZOJ:

1. Ka të drejtë të aplikojë në programin e nxitjes së punesimit të puneckerkuesve të papune çdo punedhënes i cili është person juridik ose fizik dhe ushtron aktivitet ekonomik prej të paktën një viti nga data e aplikimit në këtë program.
2. Për të përfituar nga ky program, punedhënesi duhet të paraqesë pranë zyres kompetente të punesimit të rrethit ku ai zhvillon aktivitetin dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) **VENDIMIN** të gjykates së rrethit për regjistrimin si person juridik/fizik (në **VENDIMIN** të gjykates duhet të jete përfshirë aktiviteti për të cilin kërkohet të punesoje puneckerkuesit e papune).
 - b) Certifikatën e regjistrimit në organin tatimor.
 - c) Një informacion mbi:
 - i) përshkrimin e detajuar të aktivitetit që kryen;
 - ii) numrin e fuqisë punëtore;
 - iii) nivelin e pages që ai ka dhënë për çdo person.
 - d) Marrëveshjen me sigurimet shoqërore për numrin e punëtoreve të siguruar.
 - e) Numrin e llogarise bankare.
 - f) Një informacion mbi:
 - i) numrin e punëtoreve që kërkohen të punesohen;
 - ii) profesionin për të cilin do të punesohen;
 - iii) përshkrimin e aktivitetit që do të kryejnë këta punëtore;
 - iv) kohezgjatjen e punesimit;
 - v) llojin e kontratës që kërkohet të zbatohet;
 - vi) nivelin e pages.
 - g) Bilancin ekonomik-financiar të vitit të mëparshëm për personat juridike. (Që të konsiderohet kërkesa e punedhënesit, bilanci duhet të jete pozitiv vertetuar kjo nga dega e tatimtaksave e rrethit ku ushtron aktivitetin.) Për personat fizike duhet të paraqitet një vertetim nga dega e tatim-taksave në lidhje me korrektesinë e derdhjes së detyrimeve tatimore.

Me të dhënat e dokumentacionit të mësipërm, punedhënesi, në bashkëpunim me zyren kompetente të punesimit, plotëson formularin përkatës.
3. Vertetësia e dokumentacionit të paraqitur nga punedhënesi verifikohet në bashkëpunim me inspektore të inspektoratit vendor dhe rajonal të punës, i cili shprehet brenda 7 ditëve mbi vertetësinë e dokumentacionit dhe korrektesinë e subjektit ndaj legjislacionit të punës. Marrëdhëniet midis tyre rregullohen me urdher të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale.
4. Përparësitë dhe fushat prioritare ku do të zbatohet programi vendosen me urdher të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale çdo fillim viti.
5. Zyra kompetente e punesimit mbledh, shqyrton dhe vlerëson projektet e paraqitura nga punedhënesit. Ajo thërret mbledhjen e keshillit lokal tripartesh, i cili shqyrton dhe vendos mbi dobishmerinë social-ekonomike të projekteve që do të kërkohen të financohen. Zyra kompetente e punesimit i rendit aplikimet sipas prioriteteve të vendosura nga Ministri dhe i dergon për miratim si më poshtë:
 - a) Zyra vendore e punesimit dergon për miratim të gjitha projektet, sipas rastit, në zyren

rajonale te punesimit ose ne Drejtorine e Pergjithshme te Sherbimit Kombetar te Punesimit.

b) Zyra rajonale e punesimit miraton projektet, kur aplikues jane ndermarrjet e vogla ne kuptim te **LIGJ**it nr.8957, date 17.10.2002 "Per ndermarrjet e vogla dhe te mesme" dhe dergon per miratim ne Drejtorine e Pergjithshme re Sherbimit Kombetar te Punesimit projektet ku aplikues jane ndermarrjet qe kane mbi 21 te punesuar.

Sipas **LIGJ**it te siperpermendur, ndermarrjet e vogla jane ndermarrjet te cilat:

a) punesojne 6-20 punonjes;

b) xhiroja ekonomike vjetore e tyre nuk e kalon shumen 40 milione leke;

c) 100 per qind e kapitalit te ketyre ndermarrjeve zoterohet nga subjekte te cilat, ne kuptim te **LIGJ**it te siperpermendur, klasifikohen si ndermarrje te vogla.

6. Ne rastet kur aplikues jane ndermarrje te vogla ne kuptimin e numrit te punonjesve, por me perfitimin e financimit sipas ketij programi hyjne te ndermarrjet e mesme, aplikimi dergohet per miratim ne komisionin e ngritur ne Drejtorine e Pergjithshme te Sherbimit Kombetar te Punesimit.

7. Per zbatimin e pikes 6 te ketij **UDHEZIMI** ngrihen komisionet perkarese per miratimin e projekteve dhe konkretisht:

a) ne cdo zyre rajonale punesimi ngrihet komisioni i miratimit te projekteve.

b) ne Drejtorine e Pergjithshme te Sherbimit Kombetar te Punesimit ngrihet komisioni i miratimit te projekteve.

Menyra e funksionimit dhe e perberjes se komisioneve percaktohet me rregullore te Sherbimit Kombetar re Punesimit.

8. Komisioni i zyres rajonale te punesimit vendos per miratimin ose jo te projektit brenda 20 diteve nga data e paraqitjes se kerkeses per aplikim nga punedhenesi. Komisioni i Drejtorise se Pergjithshme te Sherbimit Kombetar te Punesimit vendos per miratimin ose jo te projektit brenda 30 diteve nga data e paraqitjes per aplikim nga punedhenesi.

9. Per projektet e miratuara, zyra kompetente e punesimit ne bashkepunim me punedhenesin plotesojne listen e punekerkesve te papune qe do te perfshihen ne program. Ndermjet zyrave kompetente te punesimit dhe punedhenesit nenshkruhet nje kontrate, ku perfshihen te drejtat dhe detyrat qe percakton programi per secilen pale.

10. Per efekt zbatimi te **VENDIMI**it, financimi behet duke iu referuar nivelit te pages minimale ne shkalle vendi.

11. Ne zbatim te pikes 1 te **VENDIMI**it, per cdo te punesuar punedhenesi perfiton:

a) kompensim mujor per page ne masen 70 per qind te pages minimale ne shkalle vendi;

b) kompensim mujor per sigurimet e detyrueshme shoqerore e shendetesore ne masen 100 per qind, duke iu referuar **VENDIMI**it te Keshillit te Ministrave nr.402, date 11.6.2001 "Per disa ceshtje ne zbatim te **LIGJ**it nr.7703, date 11.5.1993 "Per sigurimet shoqerore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar.

12. Ne zbatim te pikes 2, zyra kompetente e punesimit ne bashkepunim me punedhenesin ploteson listen e punekerkesve te papune qe do te perfshihen ne kete program. Per efekt zbatimi te pikes 2 te **VENDIMI**it:

Paragrafi 1. Punedhenesi perfiton financim mujor te barabarte me shumen e 5 pagave minimale ne shkalle vendi dhe shpenzimet per sigurime te detyrueshme per cdo te punesuar, 3 paga dhe sigurimet e detyrueshme per tre muaj financohen ne tre muajt e pare te zbatimit te kontrates dhe 2 paga dhe sigurimet e detyrueshme per dy muaj ne 2 muajt e fundit te zbatimit te kontrates.

Paragrafi 2. Ne castin kur punedhenesi ka perfituar me pare sipas pikes 1 te **VENDIMI**it, atehere financimi mujor qe ai perfiton eshte i barabarte me shumen e 3 pagave minimale ne shkalle vendi dhe shpenzimet per sigurimet e detyrueshme, 2 paga dhe sigurimet e detyrueshme jepen ne dy muajt e pare te zbatimit te kontrates dhe 1 paga dhe sigurimet e detyrueshme jepen ne muajin e fundit te zbatimit te kontrates.

13. Ne zbatim te pikes 3 te **VENDIMI**it te Keshillit te Ministrave nr.69, date 11.2.1999:

a) Ne rast se personat e punesuar, nuk kane formimin e duhur profesional, per proceset e punes per te cilat do te punesohen (e evidentuar me formularin tip), punedhenesi fiton 20 per

qind shtese te kompensimit per punesimin sipas pikes 1 te **VENDIM**it dhe per piken 2 te **VENDIM**it rritje te subvencionit ne masen 10 per qind.

b) Kur per ngritjen profesionale te personave te punesuar kerkohen masa te vecanta dhe shpenzime shtese qe detyrohet t'i kryje punedhenesi, ai ne aplikimin e tij duhet te paraqese edhe shpenzimet qe do te kryhen per pergatitjen profesionale ne formen e buxhetit te trajnimit.

c) Komisioni perkates vendos per financimin e tyre, ne rastet kur ai e shikon te nevojshme dhe te argumentuar.

14. Ne zbatim te pikes 4 te **VENDIM**it te Keshillit te Ministrave nr.69, date 11.2.1999 punedhenesi perfiton shtese te kompensimit per personat e punesuar, te cilet jane perfitues te programit te pageses se papunesise ne mase proporcionale me numrin e muajve te pageses se papunesise qe shkurtohen. Kontrates se nenshkruar ndermjet zyres kompetente te punesimit dhe punedhenesit i bashkengjitet lista e personave te punesuar qe jane perfitues te pageses se papunesise dhe kompensimi mujor per page:

- rritet 3 per qind per cdo muaj page se papunesie qe shkurtohet ne rastin e punesimit sipas pikes 1 te **VENDIM**it;

- shtohet subvencioni ne mase 25 per qind te shumes se mbetur per t'u paguar si page se papunesie per rastin e punesimit sipas paragrafit te pare te pikes 2 te **VENDIM**it.

Per efekt zbatimi te kesaj pike i referohemi nivelit baze te pageses se papunesise.

15. Ne zbatim te pikes 5 te **VENDIM**it te Keshillit te Ministrave nr.69, date 11.2.1999, punedhenesi perfiton shtese te kompensimit per personat qe jane punesuar, te cilet jane pjesetare te familjeve te trajtuara nga programi i ndihmes ekonomike ne mase proporcionale me ndihmen ekonomike qe familja ka perfituar ne vitin e fundit kalendarik. Kontrates se nenshkruar ndermjet zyres kompetente te punesimit dhe punedhenesit i bashkengjitet lista e personave te punesuar qe jane pjesetare te familjeve perfituese te ndihmes ekonomike.

Per punesimin sipas pikes 1 te **VENDIM**it, kompensimi mujor per page rritet 2 % per cdo muaj ndihme ekonomike te plote dhe 1 % per cdo muaj ndihme ekonomike te pjeseshme (ne varesi te llojit te ndihmes qe perfiton familja ne te cilen ben pjese i punesuari). Per pesonat e punesuar sipas paragrafit te pare te pikes 2 te **VENDIM**it, punedhenesi titan shtese subvencioni ne masen 10% te shumes se paguar per ndihme ekonomike ne vitin e fundit kalendarik.

16. Ne zbatim te pikes 6 te **VENDIM**it te Keshillit te Ministrave nr.69, date 11.2.1999, zyra kompetente e punesimit llogarit, nepermjet formularit te personave te punesuar qe jane perfitues te pageses se papunesise, fondet e kursyera nga ai program, te cilat i kalojne ne masen 100% buxhetit te ketij programi. (Procedurat e kalimit te fondeve percaktohen ne **UDHEZIM**in e perbashket me Ministrin e Financave.)

17. Ne zbatim te pikes 7 te **VENDIM**it te Keshillit te Ministrave nr.69, date 11.2.1999, zyra kompetente e punesimit llogarit nepermjet formularit te personave te papune te punesuar pjesetare te familjeve perfituese te ndihmes ekonomike fondet qe perfiton buxheti i programit. Per personin qe punesohet sipas pikes 1 te **VENDIM**it, sasia e fondeve qe transferohen eshte 30% e ndihmes ekonomike te plote per nje familje me 4 persona per nje periudhe te barabarte me kohen e punesimit. Per punesimin sipas paragrafit te pare te pikes 2 te **VENDIM**it, per cdo person qe punesohet nga programi i ndihmes ekonomike transferohet nje fond i barabarte me 30% te shpenzimeve qe programi i ndihmes ekonomike ka bere per familjen e personit gjate vitit te fundit kalendarik. (Procedurat e kalimit te fondeve percaktohen ne **UDHEZIM**in e perbashket me Ministrin e Financave.)

18. Marredheniet midis Sherbimit Kombetar te Punesimit, punedhenesit dhe punekerkuesve te papune te punesuar sipas programit vendosen ne marreveshje te perbashketa midis tyre. Punedhenesi dhe punemarresi nenshkruajne nje marreveshje per kushtet e punesimit te personave qe punesohen. Marreveshja permban ne cdo rast emrat e te gjitha personave qe do te angazhohen ne program.

19. Zyra kompetente e punesimit perpilon dhe dergon cdo muaj ne Drejtorine Qendrore te Sherbimit Kombetar te Punesimit informacione ne lidhje me projektet, personat e punesuar, perfituesit e programeve te mbeshtetjes me te ardhura, punekerkuesit e papune etj.

20. Procedurat per perdorimin e fondeve te nxitjes se punesimit dhe hollesi te tjera te

percaktohen ne **UDHEZIM**in e perbashket te Ministrit te Punes dhe te Çeshtjeve Sociale dhe Ministrit te Financave.

21. Procedurat per zbatimin e ketij programi, formularet tip, kontratat tip, marreveshjet tip, percaktohen ne rregulloren metodike te zbatimit te Sherbimit Kombetar te Punesimit.

22. **UDHEZIMI** nr.370/2, date 10.5.1999 "Per zbatimin e **VENDIM**it te Keshillit te Ministrave nr. 69, date 11.2.1999 "Per programin e nxitjes se punesimit te punekerkuesve te papune"", shfuqizohet.

Ky **UDHEZIM** hyn ne fuqi menjehere.

MINISTRI I PUNES DHE I ÇESHTJEVE SOCIALE

Engjell Bejtaj

UDHEZIM

Nr.76, date 14.1.2004

PER ZBATIMIN E **VENDIMIT** TE KESHILLIT TE MINISTRAVE NR.632, DATE 18.9.2003 "PER PROGRAMIN E NXITJES SE PUNESIMIT TE PUNEKERKUESEVE TE PAPUNA FEMRA"

Ne mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, **VENDIMIT** të Keshillit të Ministrave nr.632, date 18.9.2003 "Programin e nxitjes së punesimit të punekerkueseve të papuna femra" dhe nenit 18/1 të Statutit të Sherbimit Kombëtar të Punesimit, miratuar me **VENDIMIN** e Keshillit të Ministrave nr.42, date 17.1.1998 "Per miratimin e Statutit të Sherbimit Kombëtar të Punesimit", i ndryshuar,

UDHEZOJ:

Ka të drejtë të aplikojë në programin e nxitjes së punesimit të punekerkueseve të papuna femra çdo punedhënes i cili është person juridik/fizik dhe ushtron aktivitet ekonomik prej të paktën një viti nga data e aplikimit në këtë program.

Per të përfituar nga ky program, punedhënesi duhet të paraqesë pranë zyres kompetente të punesimit të rrethit ku ai zhvillon aktivitetin dokumentacionin e mëposhtem:

a) **VENDIMIN** e gjykares së rrethit për regjistrimin si person juridik ose fizik (në **VENDIMIN** e gjykares duhet të jetë përfshirë aktiviteti për të cilin kërkohet të punesoje punekerkuesit e papunë).

b) Certifikatën e regjistrimit në organin tatimor.

c) Një informacion mbi:

i) përshkrimin e detajuar të aktivitetit që kryen;

ii) numrin e fuqisë punëtore;

iii) nivelin e pages që ai ka dhënë për çdo person.

d) Marrëveshjen me sigurimet shoqërore për numrin e punëtorëve të siguruar.

e) Numrin e llogarise bankare.

f) Një informacion mbi:

i) numrin e punëtorëve që kërkohen të punesohen;

ii) profesionin për të cilin do të punesohen;

iii) përshkrimin e aktivitetit që do të kryejnë këto punëtore;

iv) kohezgjatjen e punesimit;

v) llojin e kontratës që kërkohet të zbatohet;

vi) nivelin e pages.

d) Bilancin ekonomik-financiar të vitit të mëparshëm për personat juridikë. (Që të konsiderohet kërkesa e punedhënesit, bilanci duhet të jetë pozitiv, vertetuar kjo nga dega e tatimtaksave e rrethit ku ushtron aktivitetin.) Për personat fizikë duhet të paraqitet një vertetim nga dega e tatim-taksave në lidhje me korrektesinë e derdhjes së detyrimeve tatimore.

Me të dhënat e dokumentacionit të mësipërm, punedhënesi, në bashkëpunim me zyren kompetente të punesimit, plotëson formularin përkares.

3. Vertetësia e dokumentacionit të paraqitur nga punedhënesi verifikohet në bashkëpunim me inspektore të inspektoratit vendor dhe rajonal të punës, i cili shprehet brenda 7 ditëve mbi vertetësinë e dokumentacionit dhe korrektesinë e subjektit ndaj legjislacionit të punës.

Marrëdhëniet midis tyre rregullohen me urdher të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale.

4. Përparësitë dhe fushat prioritare ku do të zbatohet programi vendosen me urdher të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale çdo fillim viti.

5. Zyra kompetente e punesimit mbledh, shqyrton dhe vlerëson projektet e paraqitura nga punedhënesit. Ajo thërret mbledhjen e keshillit lokal tripartesh, i cili shqyrton dhe vendos mbi dobishmerinë social-ekonomike të projekteve që do të kërkohen të financohen. Zyra kompetente e punesimit i rendit aplikimet sipas prioriteteve të vendosura nga Ministri dhe i dërgon për miratim si më poshtë:

a) Zyra vendore e punesimit dërgon për miratim të gjitha projektet, sipas rastit, në zyren

rajonale te punesimit ose ne Drejtorine e Pergjithshme te Sherbimit Kombetar te Punesimit.

b) Zyra rajonale e punesimit miraton projektet, kur aplikues jane ndermarrjet e vogla, ne kuptim te **LIGJit** nr.8957, date 17.10.2002 "Per ndermarrjet e vogla dhe te mesme" dhe dergon per miratim ne Drejtorine e Pergjithshme te Sherbimit Kombetar te Punesimit projektet, ku aplikues jane ndermarrjet qe kane mbi 21 te punesuar.

Sipas **LIGJit** te siperpermendur ndermarrjet e vogla jane ndermarrjet te cilat:

a) punesojne 6-20 punonjes;

b) xhiroja ekonomike vjetore e tyre nuk e kalon shumen 40 milione leke;

c) 100 per qind e kapitalit te ketyre ndermarrjeve zoterohet nga subjekte te cilat, ne kuptim te **LIGJit** te siperpermendur, klasifikohen si ndermarrje te vogla.

6. Ne rastet kur aplikues jane ndermarrje te vogla ne kuptimin e numrit te punonjesve, por me perfitimin e financimit sipas ketij programi hyjne tek ndermarrjet e mesme, aplikimi dergohet per miratim ne komisionin e ngritur ne Drejtorine e Pergjithshme te Sherbimit Kombetar te Punesimit.

7. Per zbatimin e pikes 4 ngrihen komisionet perkatese per miratimin e projekteve dhe konkretisht:

a) Ne cdo zyre rajonale punesimi ngrihet komisioni i miratimit te projekteve.

b) Ne Drejtorine e Pergjithshme te Sherbimit Kombetar te Punesimit ngrihet komisioni i miratimit te projekteve.

Menyra e funksionimit dhe e perberjes se komisioneve percaktohet me rregullore te Sherbimit Kombetar te Punesimit.

8. Komisioni i zyres rajonale te punesimit vendos per miratimin ose jo te projektit brenda 20 diteve nga data e paraqitjes se kerkeses per aplikim nga punedhenesi. Komisioni i Drejtorise se Pergjithshme te Sherbimit Kombetar te Punesimit vendos per miratimin ose jo te projektit brenda 30 diteve nga data e paraqitjes per aplikim nga punedhenesi.

9. Per projektet e miratuara, zyra kompetente e punesimit ne bashkepunim me punedhenesin ploteson listen e punekerkueseve femra te papuna. Ndermjet zyrave kompetente te punesimit dhe punedhenesit nenshkruhet nje kontrate ku perfshihen te drejtat dhe detyrat qe percakton programi per secilen pale.

10. Per efekt zbatimi te ketij **VENDIMI**, financimi per sigurimet e detyrueshme behet proporcionalisht duke iu referuar nivelit te shpenzimeve te kontributit te punedhenesit.

11. Per cdo te punesuar, sipas pikes 1 te **VENDIMI** te Keshillit te Ministrave, punedhenesi perfiton financimin mujor te barabarte me 70% te shumes se shpenzimeve te sigurimeve te detyrueshme (kontributi i punedhenesit) per gjithe vitin e zbatimit te kontrates.

70% te sigurimeve te detyrueshme

12. Per efekt te zbatimit te pikes 2 te **VENDIMI**, punedhenesi perfiton financimi mujor:

a) sipas pikes 10 te ketij **UDHEZIMI**, pra 70 per qind te shumes se shpenzimeve per sigurime te detyrueshme (kontributi i punedhenesit) per vitin e pare te zbatimit te kontrates;

b) 85 per qind te shumes se shpenzimeve per sigurimet e detyrueshme (kontributi i punedhenesit) per cdo te punesuar, per gjithe vitin e zbatimit te kontrates. Financimi fillon ne vitin e dyte te zbatimit te kontrates.

70% sigurime te detyrueshme viti i pare

85 % sigurime te detyrueshme viti i dyte

13. Per efekt te zbatimit te pikes 3 te **VENDIMI**, punedhenesi perfiton financim mujor:

a) sipas pikes 10 dhe 11 te ketij **UDHEZIMI**, pra 70 % te shumes se shpenzimeve per sigurime te detyrueshme (kontributi i punedhenesit) per vitin e pare te zbatimit te kontrates,

85 % te shumes se shpenzimeve per sigurimet e detyrueshme (kontributi i punedhenesit) per vitin e dyte te zbatimit te kontrates, per cdo te punesuar.

b) te barabarte me 100% te shumes se shpenzimeve te detyrueshme (kontributi i punedhenesit) per cdo te punesuar, per vitin e trete te zbatimit te kontrates. Financimi fillon vitin e trete te zbatimit te kontrates.

70 % sigurime te detyrueshme viti i pare

85 % sigurime te detyrueshme viti i dyte

100 % sigurime te detyrueshme viti i trete

14. Ne zbatim te pikes 4 te **VENDIM**it, punedhenesit te cilet punesojne punekerkuese femra mbi 35 vjec, femra rome, femra me aftesi te kufizuara, vajzat nena, femra te divorcuara me probleme sociale:

a) (paragrafi a) Kur punesimi behet sipas pikes 1 te **VENDIM**it, pervec financimit sipas pikes 10 te ketij **UDHEZIMI**, perfitojne financim 4 paga minimale ne shkalle vendi gjate vitit te pare te zbatimit te kontrates. 3 paga jepen ne fillim te vitit te punes (per cdo muaj) dhe 1 page jepet ne muajin e fundit te kontrates se punes.

70 % sigurime te detyrueshme 4 paga minimale

b) (paragrafi b) Kur punesimi behet sipas pikes 2 te **VENDIM**it, pervec financimit sipas pikes 10 dhe 11 te ketij **UDHEZIMI** dhe paragrafit 1 te kesaj pike, perfitojne financim 6 paga minimale ne shkalle vendi. 5 paga minimale ne shkalle vendi jepen ne fillim te vitit te dyte te kontrates (per cdo muaj) dhe 1 page jepet ne fund te vitit.

70 % sigurime te detyrueshme per vitin e pare 85 % sigurime te detyrueshme per vitin e dyte 4 paga minimale per vitin e pare

6 paga minimale per vitin e dyte

c) (paragrafi c) Kur punesimi behet sipas pikes 3 te **VENDIM**it, pervec financimit sipas pikes 12 te ketij **UDHEZIMI** dhe paragrafit 1 dhe 2 te kesaj pike, perfitojne 8 paga minimale ne shkalle vendi. 7 paga jepen ne 7 muajt e pare te zbatimit te kontrates dhe 1 page jepet ne muajin e fundit te zbatimit te kontrates.

70 % sigurime te detyrueshme per vitin e pare 85 % sigurime te detyrueshme per vitin e dyte

100 % sigurime te detyrueshme per vitin e trete

4 paga minimale per vitin e pare 6 paga minimale per vitin e dyte 8 paga minimale per vitin e trete

15. Identifikimi i personave sipas pikes 4 behet si me poshte:

- Per femrat e trafikuar, listat e tyre duhet te vijne nga Sherbimi Social Shteteror per ato qe trajtohen ne institucionet shteterore te perkujdesit, si dhe nga OJF-te, te cilat kane marreveshje me Ministrine e Punes dhe te Çeshtjeve Sociale;

- Per femra mbi 35 vjec identifikimi behet nga regjistrimi ne zyren kompetente te punesimit (duke e vertetuar me nje kopje te dokumentit te identifikimit te noterizuar);

- Per femrat rome te regjistruara, zyrat e punesimit duhet te bashkepunojne me shoqatat rome te regjistruara ne gjykate;

- Per femrat me aftesi te kufizuar, identifikimi behet me vertetim te komisioneve KMCAP dhe KMPV;

- Per vajzat nena te paraqitet certifikata nga zyra e gjendjes civile;

- Per femra, te divorcuara me probleme sociale duhet **VENDIMI** i gjykates per zgjidhje martese dhe nje vertetim nga njesia administrative perkatese per gjendjen ekonomike te tyre.

16. Ne zbatim te pikes 5 te **VENDIM**it, kontrolli behet nga inspektorët e inspektoratit rajonal dhe vendor per pikat (a), (b) dhe (c), punedhenesi perfiton nga ky program kur nga kontrollet e bera rezulton se nuk jane shkelur keto pika.

17. Me kerkese te Inspektoratit Shteteror te Punes apo te strukturave te kontrollit te Sherbimit Kombetar te Punesimit, punedhenesit i nderpritet financimi kur ben pushime, pa shkaqe te arsyeshme te punemarresve te tjere jashte ketij programi.

18. Ne zbatim te pikes 7 te **VENDIM**it, zyra kompetente e punesimit llogarit nepermjet formularit te personave te punesuar qe jane perfitues te pageses se papunesise fondet e kursyera nga ai program, te cilat i kalojne ne masen 100% buxhetit te ketij programi.

(Procedurat e kalimit te fondeve percaktohen ne **UDHEZIMI**n e perbashket me Ministrin e Financave.)

19. Zyra kompetente e punesimit perpilon dhe dergon cdo muaj ne Drejtorine e Pergjithshme te Sherbimit Kombetar te Punesimit informacion ne lidhje me projektet, ecurine e tyre, personat e punesuar, perfituesit e programeve te mbeshtetjes me te ardhura etj. Hollesite percaktohen ne rregulloren e Sherbimit Kombetar te Punesimit.

20. Ne zbatim te pikes 8, kostoja e programit mbulohet nga fondet vjetore te buxhetit te shtetit

per nxitjen e punesimit. Procedurat per perdorimin e fondeve te nxitjes se punesimit dhe hollesi te tjera percaktohen ne **UDHEZIM**in e perbashket te Ministrit te Punes dhe te Çeshtjeve Sociale dhe Ministrit te Financave.

21. Procedurat per zbatimin e ketij programi, formularet tip, kontratat tip, marreveshjet tip, rregullohen me rregulloren metodike te zbatimit te Sherbimit Kombetar te Punesimit.

Ky **UDHEZIM** hyn ne fuqi menjehere.

MINISTRI I PUNES DHE I ÇESHTJEVE SOCIALE

Engjell Bejtaj

VENDIM

Nr.730, date 6.11.2003

PER FUNKSIONIMIN E KESHILLIT KOMBETAR TE PUNES DHE PER CAKTIMIN E PERFAQESUESVE TE KESHILLIT TE MINISTRAVE NE KETE KESHILL

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te pikave 6, 9 e 10 te nenit 200 te **LIGJ**it nr.7961, date 12.7.1995 "Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise", i ndryshuar, me propozimin e Ministrit te Punes dhe te Çeshtjeve Sociale, Keshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Keshilli Kombetar i Punes, ne vijim KKP, funksionon prane Ministrit te Punes dhe te Çeshtjeve Sociale.
2. KKP-ja zhvillon keshillime, merr **VENDIM**e me konsensus dhe i ben rekomandimet perkatese Keshillit te Ministrave, nepermjet Ministrit te Punes dhe te Çeshtjeve Sociale.
3. KKP-se, nga organizatat e punedhenesve dhe te punemarresve, si dhe nga administrata publike, t'i vihen ne dispozicion te gjitha informacionet dhe te dhenat e nevojshme, qe kane lidhje me objektin e funksionimit te saj per zhvillimin e keshillimeve.
4. Perfaqesimi i organizatave te punemarresve dhe te punedhenesve ne KKP percaktohet ne mbeshtetje te vleresimit te treguesve te meposhtem:
Per organizatat e punemarresve:
 - a) numrit te anetareve, i vertetuar nga deklarimet personale, kuotizacionet ose vertetimet noteriale;
 - b) numrit te kontratave kolektive te punes te lidhura dhe numrit te punonjesve te mbuluar nga keto kontrata;
 - c) numrit te degeve/profesioneve dhe/ose organizatave territoriale;
 - ç) mundesise per t'u angazhuar ne bisedime per realizimin e marreveshjeve kolektive dhe zgjidhjes se konflikteve nepermjet ndermjetesimit;
 - d) anetaresimit ne organizatat nderkomretare.Per organizatat e punedhenesve:
 - a) numrit te ndermarrjeve te anetaresuara;
 - b) numrit te punonjesve te punesuar ne ndermarrjet e anetaresuara;
 - c) numrit te degeve/profesioneve dhe/ose organizatave territoriale;
 - ç) buxhetit te organizates per ceshtjet shoqerore;
 - d) mundesise se organizates per t'u angazhuar ne bisedime per realizimin e marreveshjeve kolektive dhe zgjidhjes se konflikteve nepermjet ndermjetesimit;
 - dh) anetaresimit ne organizatat nderkombetare.
5. Jane anetare te KKP-se keta perfaqesues te Keshillit te Ministrave:
 - Ministri i Punes dhe i Çeshtjeve Sociale,
 - Ministri i Financave,
 - Ministri i Shendetesise,
 - Ministri i Arsimit dhe i Shkences,
 - Ministri i Drejtesise,
 - Ministri i Ekonomise,
 - Ministri i Industrise dhe i Energjetikes.Kandidatet e KKP-se, perfaqesues te Keshillit te Ministrave, jane zevendesministrat perkates.
6. Perfaqesuesit e punedhenesve dhe te punemarresve, anetare te KKP-se, caktojne perkatesisht kryetaret e paleve, te cilet jane edhe nenkryetare te KKP-se.
7. Kryetari i KKP-se eshte Ministri i Punes dhe i Çeshtjeve Sociale.
Detyrat dhe pergjegjesite e kryetarit te KKP-se jane:
 - a) te drejtoje mbledhjet e KKP-se;
 - b) te miratoje rendin e dites, raportin perfundimtar te mbledhjeve, si dhe programin vjetor te

KKP-se, pas mirekuptimit me palet;

c) te informoje Keshillin e Ministrave per rekomandimet e KKP-se, si dhe per mendimet e organizatave te punedhenesve dhe te punemarresve.

8. KKP-ja mblidhet, ne perputhje me programin e miratuar prej tij ose me kerkesen me shkrim te çdo pale, drejtuar kryetarit te KKP-se, sipas percaktimit te bere ne rregulloren e brendshme te funksionimit.

9. Anetaret e KKP-se, per ceshtjet qe do te diskutohen, kane te drejten e keshillimit paraprak dhe e shprehin qendrimin e tyre, nepermjet kryetarit te pales.

Vetem ne rastet kur palet shprehen dakord, atehere mund t'i rekomandohet Keshillit te Ministrave nje projektakt **LIGJ**or ose nen**LIGJ**or.

10. Prane KKP-se krijohen dhe funksionojne komisionet e specializuara tripaleshe, te perhershme, si me poshte vijojne:

a) komisioni juridik,

b) komisioni i punesimit dhe i formimit profesional,

c) komisioni i pagave dhe i pensioneve,

ç) komisioni i kushteve te punes, shendetit dhe sigurimit ne pune,

d) komisioni i ekonomise dhe i finances.

11. Komisionet e specializuara, tripaleshe, te perhershme, kane per objekt te shqyrtojne ceshtje per fushat e tyre te kompetences dhe to i transmetojne mendimet dhe perfundimet e keshillimeve KKP-se, per:

a) orientimin dhe zbatimin e politikave shteterore ne fushat e veprimtarise se tyre;

b) projekt**LIGJ**et dhe projekt**VENDIM**et e Keshillit te Ministrave, qe kane lidhje me fushat e veprimtarise se tyre;

c) ceshtjet per te cilat KKP-ja iu eshte drejtuar atyre per konsultim dhe mendim.

Per arritjen e objektiveve, cdo komision mund te angazhoje specialiste te kualifikuar.

12. Komisionet e sr:ecializuara tripaleshe, te perhershme kryesohen nga kryetari dhe kane ne perberje me shume se 8 anetare. Perberja e tyre percaktohet nga KKP-ja.

13. Kryetaret e komisioneve te specializuara, tripaleshe, te perhershme caktohen nga Ministri i Punes dhe i Çeshtjeve Sociale, brenda administrates se kesaj ministrie, ne nivelin e drejtorit te drejtorise, sipas fushave qe ata mbulojne.

Anetaret e komisioneve, perfaqesues te institucioneve shteterore, caktohen nga titullaret e tyre.

14. Menyra e organizimit dhe pergatitja e dokumentacionit te mbledhjeve te Keshillit Kombetar te Punes percaktohen ne rregulloren e brendshme te miratuar prej tij.

15. Per funksionimin e KKP-se, ne Ministrine e Punes dhe te Çeshtjeve Sociale, ngrihet sekretariati, i perbere nga tre sekretare, te cilet jane nepunes te administrates te kesaj ministrie, respektivisht nga nje per cdo pale te perfaqesuar ne kete keshill. Per emerimin e sekretareve te KKP-se merret dhe mendimi i partnereve sociale.

16. Buxheti i pavarur i KKP-se perbehet nga:

a) fondi i dhene nga buxheti i shtetit per Keshillin Kombetar te Punes;

b) kontributet e organizatave te punedhenesve dhe te punemarresve;

c) donacione te ndryshme.

17. Fondi i dhene nga buxheti i shtetit per Keshillin Kombetar te Punes te perdoret, kryesisht, per perballimin e shpenzimeve te mbledhjeve te KKP-se, komisioneve te specializuara, te perhershme te tij, funksionimin e zyrave shteterore te pajtimit, si dhe per organizimin dhe pjesemarrjen ne konferenca tripaleshe.

18. Fondi i mbledhur nga kontributet e organizatave te punedhenesve dhe te punemarresve te perdoret per financimin ne masen 50 per qind te shpenzimeve, qe parashikohen per kryerjen e studimeve, seminareve per ceshtjet ne interes te ketyre organizatave, si dhe veprimtari te tjera brenda dhe jashte vendit, te ngjashme me to.

19. KKP-ja ben miratimin paraprak te projektbuxhetit vjetor dhe nepermjet Ministrit te Punes dhe te Çeshtjeve Sociale ia propozon ate per miratim Keshillit te Ministrave.

20. Shperblimi i anetareve te KKP-se, per cdo mbledhje, eshte ne masen 5 per qind te pages mujore te Ministrit.

Shperblimi i anetareve te komisioneve te specializuara, per cdo mbledhje, eshte ne masen 5 per qind te pages se drejtorit te drejtorise ne ministri.

21. Kandidatet e KKP-se, ne rastet kur zevendesojne anetaret, perfitojne shperblimin sipas pikes 20 te ketij **VENDIMI**.

22. **VENDIMI** nr.379, date 20.5.1996 i Keshillit te Ministrave "Per Keshillin Kombetar te Punes dhe te Çeshtjeve Sociale", shfuqizohet.

Ky **VENDIM** hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.726, date 30.10.2003

PER NJE NDRYSHIM NE **VENDIMIN** NR.511, DATE 24.10.2002 TE KESHILLIT TE MINISTRAVE "PER KOHEZGJATJEN E PUNES DHE TE PUSHIMIT NE INSTITUCIONET SHTETERORE"

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes, te nenit 19 shkronja "e", te nenit 20 shkronjat "e" dhe "g" dhe te nenit 29 te **LIGJ**it nr. 8549, date 11.11.1999 "Statusi i nepunesit civil" dhe te neneve 76-108 te **LIGJ**it nr.7961, date 12.7.1995 "Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise", i ndryshuar, me propozimin e Zevendes kryeministrit dhe Minister i Shtetit per Integrimin Europian, Keshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 2 e kreut I te **VENDIM**it nr. 511, date 24.10.2002 te Keshillit te Ministrave te ndryshohet si me poshte vijon:

"2. Orari ditor i punes te jete si me poshte vijon:

- Per periudhen 1 prill - 31 tetor fillon cdo dite nga ora 8.00 deri ne oren 13.00 dhe nga 14.30 deri ne oren 18.00, ndersa ditën e premte fillon ne oren 8.00 deri ne oren 14.00.

- Per periudhe 1 nentor - 31 mars fillon cdo dite ne oren 8.00 deri ne oren 16.00.

Ky **VENDIM** hyn ne fuqi me date 1.11.2003, dhe botohet ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.708. date 16.10.2003

PER MENYREN E LICENCIMIT DHE TE FUNKSIONIMIT TE AGJENCIVE PRIVATE TE PUNESIMIT

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te nenit 19 te **LIGJ**it nr.7961, date 12.7.1995 "Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise", i ndryshuar, me propozimin e Ministrit te Punes dhe te Çeshtjeve Sociale, Keshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Veprimtaria private e ndermjetesimit ne pune te ushtrohet vetem nga agjencite private te punesimit (ne vazhdim agjencia), te licencuara pas permbushjes se kerkesave te percaktuara ne kete **VENDIM**.
2. Agjencia private e punesimit regjistrohesh si person fizik/juridik, privat dhe e ushtron veprimtarine e ndermjetesimit ne pune nepermjet ketyre sherbimeve:
 - a) informimit, keshillimit, si dhe vleresimit te kerkesave dhe te aplikimeve per ndermjetesimin per pune;
 - b) kerkimit te vendeve te punes;
 - c) ndermjetesimit per percaktimin e kushteve dhe lidhjen e marredhenieve te punes, ndermjet punekerkuesit dhe punedhenesit.
3. Per punesimin e shtetasve shqiptare jashte shtetit, agjencia zbaton te gjitha marreveshjet dypaleshe te Qeverise shqiptare me vendet perkatese.
4. Sherbimet e agjencise per punekerkuesit jane falas. Agjencia nuk e ngarkon punekerkuesin me asnje detyrim financiar, te drejtperdrejte ose te terthorte, me perjashtim te pageses se shpenzimeve te nevojshme per plotesimin e dosjes administrative te cdo punekerkuesi.
5. Shpenzimet per sherbimin e ndermjetesimit, te kryera nga agjencia, te perballohen nga pala punedhenese.
6. Agjencia siguron trajtim te barabarte per te gjitha punekerkuesit. Asnje punekerkues nuk mund te diskriminohet per shkaqe te tilla, si: gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, shoqerore ose perkatesia prinderore.
7. Punekerkuesi i ndermjetesuar ne pune nga agjencia gezon te drejten per negocimin kolektiv, pagen minimale, kohen dhe kushtet e punes, perfitimet e sigurimeve shoqerore, mbrojtjen e sigurise dhe te shendetit ne pune.
8. Agjencia duhet te njoftoje punekerkuesin per kushtet e punes dhe te punesimit, perpara fillimit te marredhenieve te punes.
9. Agjencia nuk duhet te ndermjetesojte per punekerkuesin ne vende pune, qe paraqesin rrezik e pasiguri per jeten dhe shendetin e tij ose ku mund te jete subjekt abuzimi a trajtimi diskriminues. .
10. Personeli i agjencise, per sherbimet qe ofron, duhet te kete kualifikimin dhe trajnimin e nevojshem.
11. Agjencia bashkepunon me zyrtar shteterore te punesimit per:
 - a) mbledhjen, shkembimin e te dhenave dhe perdorimin e terminologjise se perbashket per permiresimin e transparences se funksionimit te tregut te punes;
 - b) shkembimin e njoftimeve per vendet e lira te punes;
 - c) lidhjen e marreveshjeve per zbatimin e veprimtarive te ndryshme;
 - ç) trajnimin e stafit.
12. Ministri i Punes dhe i Çeshtjeve Sociale eshte autoriteti pergjegjes, i cili leshon licencat per agjencite private te punesimit.
13. Prane Ministrit te Punes dhe te Çeshtjeve Sociale ngrihet dhe funksionon komisioni i shqyrtimit te kerkesave per licencimin e ketyre agjencive. Menyra e funksionimit dhe perberja e komisionit percaktohen me **UDHEZIM** te Ministrit te Punes dhe te Çeshtjeve Sociale.

14. Dokumentet e nevojshme qe duhet te paraqiten per licencim jane:

- a) kerkesa me shkrim per ushrimin e veprimtarise;
- b) **VENDIMI** i gjykates per regjistrimin si person fizik/juridik;
- c) vertetimi nga banka, deri ne marrjen e licences, per gjendje te ngurtesuar, ne llogari rrjedhese te shumes jo me pak se 100 000 (njqind mije) leke te subjektit kerkues;
- ç) vertetimi per shlyerjen e detyrimeve fiskale e te sigurimeve shoqerore per tre muajt e fundit;
- d) vertetimi nga gjykata dhe prokuroria, i cili verteton se kerkuesi i licences nuk eshte ne ndjekje penale;
- dh) vertetimi nga gjykata, i cili verteton se subjekti fizik/juridik nuk eshte ne proces falimentimi;
- e) vertetimi i gjendjes gjyqesore te kerkuesit, ortakut, aksionarit dhe anetareve te organeve drejtuese te subjektit qe ka kerkuar licencen;
- ë) pershkrimi i hollesishem i veprimtarise qe kerkon te kryeje;
- f) planimetria e mjediseve te agjencise dhe nje liste emerore e personelit, qe perfshihet ne procesin e ndermjetesimit, e shoqeruar me CV -te perkatese;
- g) fotokopja e noterizuar e dokumentit te identifikimit dhe 2 fotografi te kerkuesit/kerkuesve.

15. Licenca per ushrimin e veprimtarise private te ndermjetesimit ne pune nuk i jepet subjektit kerkues, ne rast se personi fizik/juridik (ortaku, aksionari ose anetari i organeve drejtuese te tij):

- a) ka qene i denuar per vepra penale te kryera me dashje;
- b) provohet se ka kerkuar tarifa nga punekerkuesi per sherbimet e ofruara;
- c) ka perpiluar ose me dijeni ka perdorur dokumente te rreme;
- ç) eshte punonjes i sistemit te Ministrise se Punes dhe te Çeshtjeve Sociale dhe ka nje funksion te tille qe paraqet konflikt interesi;
- d) i eshte anuluar licenca per mosrespektim te dispozitave te ketij **VENDIMI**.

16. Para leshimit te licences, Inspektorati Shteteror i Punes ben inspektimin e mjediseve, te pajisjeve dhe te dokumenteve qe zoteron personi fizik/juridik.

17. Komisioni i licencimit, pasi ben vleresimin e kerkeses dhe te dokumentacionit te paraqitur nga subjektet e interesuara dhe nga Inspektorati Shteteror i Punes, i propozon Ministrin te Punes dhe te Çeshtjeve Sociale miratimin ose refuzimin e dhenies se licences.

18. Afati i marrjes se **VENDIMI** per licencimin ose jo te subjektit te interesuar eshte 30 dite nga data e marrjes se kerkeses.

19. Licenca jepet per nje vit, me te drejte riprertitjeje. Kur licenca merret per here te pare paguhet nje tarife prej 100 000 (njqind mije) lekesh per personat fizike dhe 150 000 (njqind e pesedhete mije) lekesh per personat juridike. Riprertitja eshte falas.

20. Kerkesa per riprertitjen e licences duhet te behet 45 dite para afatit te skadimit te vlefshmerise se licences. Pervec kerkeseve te parashikuara ne piken 14 te ketij **VENDIMI** kerkohet edhe nje raport me shkrim per veprimtarine e agjencise.

21. Perpunimi i te dhenave te punekerkuesit nga agjencia behet duke respektuar konfidencialitetin dhe perdorimin e te dhenave, sipas natyres se punes.

22. Agjencia nuk duhet te regjistroje ne dosje ose regjistra, te dhena vetjake te punekerkuesit, qe nuk jane te nevojshme per te vleresuar prirjen e tij per vendin e punes.

23. Agjencia duhet t'i ruaje te dhenat vet jake te nje punekerkuesi, vetem per aq kohe sa justifikohet nga qellimet e vecanta, per te cilat jane mbledhur keto te dhena ose per aq kohe sa punekerkuesi deshiron te mbetet ne listen e kandidateve te mundshem per nje vend pune.

24. Agjencia, pervec rasteve kur lidhet drejtperdrejt me kerkesat per nje profesion te vecante ose me pelqimin e punekerkuesit te interesuar, nuk duhet te kerkoje, te ruaje ose te perdore te dhena per gjendjen mjekesore te nje punekerkuesi ose te perdore nje te dhene te tille per percaktimin e pershtatshmerise se tij per punesim.

25. Agjencia, dy here ne vit, njofton Ministrine e Punes dhe te Çeshtjeve Sociale per strukturen dhe veprimtarine e vet.

26. Inspektorati Shteteror i Punes kryen inspektime periodike per te percaktuar perputhshmerine e veprimtarise se agjencise me legjislacionin perkates dhe, kur veren shkelje,

njofton komisionin e licencimit.

27. Anulimi i licences behet nga Ministri i Punes dhe i Çeshtjeve Sociale ne rastet kur agjencia:

- a) ka shkelur parimin e barazise, duke diskriminuar punekerkuesit;
- b) pranon drejtperdrejt ose terthorazi pagesa, mallra ose sherbime nga punekerkuesi, pervec pageses se parashikuar ne piken 4 te ketij **VENDIMI**;
- c) reklamon njoftime te rreme ose mashtruese per ndermjetesimin;
- ç) ben deklarata, deshmi te rreme ose perdor dokumente te falsifikuara;
- d) nxit drejtperdrejt ose terthorazi punekerkuesin per t'u transferuar ne nje vend tjeter pune, pervec kur ky transferim eshte ne interes te punekerkuesit;
- dh) ndikon ose perpiqet te ndikojte cdo punedhenes ose ndermarrje per te mospunesuar disa persona;
- e) ofron sherbimet e veta per te miturit;
- ë) angazhohet te ndermjeresoje per punekerkuesin ne vende pune, qe cenojne dinjitetin e Republikes se Shqiperise;
- f) pengon ose perpiqet te pengoje inspektimin e organeve perkatese;
- g) nuk permbush detyrimet per sigurimet shoqerore ose kontratat e punes per punemarresin e vet.

28. Ankimi kunder **VENDIMI** per refuzimin e dhenies se licences dhe per anulimin e saj behet brenda 30 diteve nga data e njoftimit.

29. Ministri i Punes dhe i Çeshtjeve Sociale shqyrton ankimin dhe merr **VENDIM** brenda nje muaji nga data e depozitimit te ankimit. Ne rast se ankimi nuk zgjidhet brenda ketij afati, personi fizik/juridik mund te ankohet ne Gjykatën e Shkalles se Pare, Tirane brenda 30 diteve nga perfundimi i afatit te shqyrtimit te ankimit.

30. **VENDIM**et nr.71, date 11.2.1999 "Per menyren e licencimit dhe te funksionimit te agjencive private te punesimit" dhe nr.72, date 11.2.1999 "Per menyren e licencimit dhe funksionimin e zyrave private te emigracionit" te Keshillit te Ministrave, shfuqizohen.

31. Ngarkohen Ministria e Punes dhe e Çeshtjeve Sociale dhe Ministria e Financave per zbatimin e ketij **VENDIMI**.

Ky **VENDIM** hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.632, date 18.9.2003

PER PROGRAMIN E NXITJES SE PUNESIMIT TE PUNEKERKUESVE TE PAPUNE, FEMRA

Ne mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 8 të **LIGJIT** nr.7995, date 20.9.1995 "Për nxitjen e punesimit", me propozimin e Ministrisë të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Punedhënesi, që punëson me kontratë të rregullt, me kohezgjatje të pakten njëvjeçare, punëkerkues të papunë, femër, nga lista e zyrës së punesimit, përfiton një financim mujor të barabartë me 70 për qind të shpenzimeve për sigurimet e detyrueshme (kontributi i punedhënesit), për të gjithë vitin e zbatimit të kontratës.
2. Kur kontrata e punës është me një kohezgjatje të pakten dyvjeçare, punedhënesi përfiton financimin mujor sipas pikës 1 të këtij **VENDIMI** dhe një financim mujor të barabartë me 85 për qind të shumës së shpenzimeve për sigurimet e detyrueshme (kontributi i punedhënesit), financim i cili fillon në vitin e dytë të zbatimit të kontratës së punës dhe zgjat gjatë të gjithë vitit.
3. Kur kontrata e punës është me një kohezgjatje të pakten trevjeçare, punedhënesi përfiton financim mujor sipas pikave 1 e 2 të këtij **VENDIMI** dhe një financim të barabartë me 100 për qind të shumës së shpenzimeve për sigurime të detyrueshme (kontributi i punedhënesit), financim i cili fillon në vitin e tretë të zbatimit të kontratës së punës dhe zgjat gjatë të gjithë vitit.
4. Kur punësohen femra të trafikuar, femra mbi 35 vjeç, femra romë, femra me aftësi të kufizuara, vajza nëna, femra të divorcuara, me probleme sociale, financimi, sipas pikave 1,2 dhe 3, i shtohet, sipas rastit, financimi si më poshtë vijon:
 - a) Në rastin e punesimit sipas pikës 1 financimi mujor shtohet deri në nivelin e katër pagave minimale në shkallë vendi;
 - b) Në rastin e punesimit sipas pikës 2, përveç përfitimit sipas shkronjës "a" të kësaj pike, financimi mujor shtohet deri në nivelin e gjashtë pagave minimale në shkallë vendi, financim i cili fillon vitin e dytë të kontratës;
 - c) Në rastin e punesimit sipas pikës 3, përveç përfitimit sipas shkronjave "a" dhe "b" të kësaj pike, financimi mujor shtohet deri në nivelin e tetë pagave minimale në shkallë vendi, financim i cili fillon vitin e tretë të kontratës.
5. Financimi i parashikuar në pikat 1, 2 dhe 3 mund të jepet kur:
 - a) punedhënesi, në rastin e kërkesës, nuk ka bërë pushime pa shkaqe të arsyeshme të punëmarresve në 12 muajt paraardhës të kërkesës;
 - b) punedhënesi ka derdhur rregullisht kontributet për sigurimet e detyrueshme për punëmarresin e punësuar prej tij;
 - c) punedhënesi nuk ka pasur shkelje të legjislativës së punës të konstatuara nga Inspektorati Shtetëror i Punës;
 - ç) bilanci financiar i vitit të fundit është pozitiv.
6. Financimi i parashikuar në pikat 1, 2 dhe 3, nderpritet kur punedhënesi, pas përfitimit të financimit sipas këtij **VENDIMI**, bën pushime, pa shkaqe të arsyeshme të punëmarresve të tjerë.
7. Fondet e pagesës së papunësisë, të kursyera nga dalja prej skemës së punëkerkuesve të papunë femra, që punësohen sipas këtij programi, transferohen në masën 100 për qind në buxhetin e programit.
8. Kostoja e këtij programi të përballohet nga fondet vjetore të buxhetit të shtetit për Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale, zeri "Nxitja e punesimit".
9. Ngarkohet Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij **VENDIMI**. Ky **VENDIM** hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrihet efektet financiare nga data 1 janar 2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM

Nr .309, date 15.5.2003

PER TRAJTIMIN E PUNONJESVE TE ADMINISTRATES SE ALBKROMIT SHA, QE SHKURTOHEN NGA PRIVATIZIMI DHE DHENIA ME KONCESION E INDUSTRISE SE KROMIT

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes, te nenit 6 te **LIGJit** nr.8562, date 22.12.1999 "Per percaktimin e formes dhe struktures se formules se privatizimit te shoqerise anonime Albkrom" dhe te **LIGJit** nr.8334, date 23.4.1998 "Per privatizimin e shoqerive tregtare qe veprojne ne sektoret jostrategjike", me propozimin e Ministrit te Ekonomise dhe te Ministrit te Industrise dhe te Energjetikes, Keshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjesve te administrates se Albkromit sh.a., te cilet shkurtohen gjate vitit 2003, si rezultat i privatizimit dhe dhenies me koncesion te industrise se kromit, t'u jepet nje shperblim, per dy vjet, i barabarte me pagen baze mesatare mujore te vendit te punes qe kane marre gjate vitit 2002. Fondet e nevojshme te sigurohen nga te ardhurat qe dalin nga privatizimi i objekteve te Albkromit sh.a.
 2. Shperblimin, sipas pikes 1 te ketij **VENDIMI**, e perfitojne punonjesit e Albkromit sh.a., te cilet kane qene ne marredhenie pune me kete shoqeri per me shume se nje vit. Me fillimin e punes punonjesit i nderpritet shperblimi.
 3. Ky shperblim te behet me 8 keste, ku secili kest perfshin 3 muaj. Pagesa e shperblimit fillon nga data e nderprerjes se marredhenieve te punes me Albkrom sh.a.
 4. Ngarkohen Ministria e Ekonomise dhe Ministria e Industrise dhe Energjetikes per zbatimin e ketij **VENDIMI**.
- Ky **VENDIM** hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

LIGJ

Nr.9034, date 20.3.2003

PER EMIGRIMIN E SHTETASVE SHQIPTARE PER MOTIVE PUNESIMI

Ne mbeshtetje te neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 te Kushtetutes, me propozimin e Keshillit te Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

Neni 1
Objekti

V E N D O S I:

KREU I DISPOZITA TE PERGJITHSHME

1. Ky **LIGJ** rregullon marredheniet ne fushen e emigracionit te shtetasve shqiptare, qe largohen nga Republika e Shqiperise per motive punesimi.
2. Shteti garanton perkujdesjen dhe mbrojtjen e shtetasve te tij emigrante, si dhe ruajtjen dhe forcimin e lidhjeve te tyre me Republiken e Shqiperise.

Neni 2
Perkufizime

Per qellime te ketij **LIGJi**, termat e meposhtem kane kuptimin si vijon:

1. "Emigrant" konsiderohen shtetasit shqiptare qe largohen nga Republika e Shqiperise ne vende te tjera per qellime punesimi, ne pajtim me legjislacionin vendas dhe te shtetit prites.
2. "Shtet prites" konsiderohet vendi ku shtetasit shqiptare emigrojne per qellime punesimi.
3. "Emigrant afatgjate" konsiderohet emigranti, i cili qendron jashte shtetit per nje periudhe kohore me te gjate se nje vit.
4. "Emigrant afatshkurter" konsiderohet emigranti, i cili qendron jashte shtetit per nje periudhe kohore me te shkurter se nje vit.
5. "Punonjes/e emigrant/e" konsiderohen personat punedhenes, punemarres dhe te vetepunesuar, qe punesohen ne nje shtet tjetet, pa qene shtetas/e te tij.
6. "Pjesetar familjeje" konsiderohen paraardhesit ose pasardhesit e shkalles se pare, si dhe personat e tjere ne ngarkim, ne baze te legjislacionit shqiptar.
7. "Emigrante te parregullt" konsiderohen shtetasit shqiptare emigrante, te cilet nuk permbushin te gjitha kushtet dhe kerkesat e vendosura nga shteti prites, lidhur me hyrjen, qendrimin dhe ushtrimin e nje veprimtarie ne territorin e ketij shteti.
8. "Agjenci private punesimi" konsiderohen personal fizike ose juridike, te cilet ofrojne sherbime punesimi, brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

Neni 3
Subjektet

Subjekte te ketij **LIGJi** jane shtetasit shqiptare, te cilet emigrojne per qellime punesimi ne nje shtet tjetet, sipas dispozitave te ketij **LIGJi** dhe te standardeve nderkombetare te pranuar edhe nga shteti prites.

KREU II

TE DREJTAT E SHTETASVE SHQIPTARE PER EMIGRIM

Neni 4

E drejta per te emigruar

1. Cdo person ka te drejte te largohet nga territori i Republikes se Shqiperise.
2. E drejta per t'u larguar nga territori i Republikes se Shqiperise nuk kufizohet, me perjashtim kur behet per te mbrojtur sigurimin kombetar, rendin publik, shendetin publik, moralin, te drejtat dhe lirite e te tjereve, sipas kushteve te parashikuara ne **LIGJ** dhe ne perputhje me parimet e pergjithshme te akteve nderkombetare ku Republika e Shqiperise eshte pale.
3. E drejta per t'u larguar kufizohet me **VENDIM** gjykate.
4. Cdo shtetas shqiptar, i cili largohet nga territori i Republikes se Shqiperise, ka te drejte te rikthehet. Mundesia e pajisjes me leje kalimi i jepet cdo shtetasi shqiptar, qe eshte jashte territorit te Republikes se Shqiperise, nga perfaqesite diplomatike.

Neni 5

Lirite dhe te drejtat politike

1. Shtetasit shqiptare emigrante gezojne lirite dhe te drejtat politike, te parashikuara nga Kushtetuta dhe legjislacioni shqiptar ne fuqi, duke marre pjese aktive ne jeten politike te vendit.
2. Shteti krijon lehtesi per emigrantet qe kthehen ne atdhe per te ushtruar te drejten e votes ne zbatim te Kodit Zgjedhor.

Neni 6

Perfaqesimi i interesave

Shteti shqiptar siguron dhe mbeshtet kontaktin e emigranteve shqiptare, nepermjet perfaqesuesve te zgjedhur te organizatave te tyre, me organet e qeverisjes qendrore dhe vendore per te paraqitur dhe mbrojtur interesat e tyre.

Neni 7

E drejta per sherbime

Punonjesit emigrante kane te drejten e informimit dhe te keshillimit falas ne fushen e formimit profesional, te sherbimeve te ndermjetesimit per punesim, te mbrojtjes sociale, te organizimit ne sindikata, si dhe te njohjes se kushteve te jeteses dhe mundesive per strehim, arsimim dhe sigurime shoqerore.

KREU III

DETYRIMET E SHTETIT SHQIPTAR PER EMIGRANTET

Neni 8

Garantimi i levizjes se lire

1. Shteti shqiptar garanton levizjen e lire te shtetasve per qellime punesimi, lidh marreveshje punesimi me shtetet pritese, ndihmon dhe lehteson integrimin e emigranteve ne vendet pritese, ne zbatim te te drejtave dhe detyrimeve qe rrjedhin nga konventat nderkombetare ku Republika e Shqiperise eshte pale.
2. Shtetasit shqiptare qe deshirojne te emigrojne jashte Shqiperise per qellime punesimi, regjistrohen ne nje regjister te vecante "Per emigrantet", i cili mbahet nga Ministria e Punes dhe Çeshtjeve Sociale.

Neni 9

Informacioni i rreme

1. Shteti shqiptar ndalon cdo lloj informacioni te rreme te dhene nga persona fizike ose juridike dhe veprimtari te kunder **LIGJ**shme per qellime perfitimi ne fushen e emigrimit te shtetasve shqiptare per motive punesimi.
2. Ushtrimi i veprimtarive te mesiperme denohet sipas dispozitave te Kodit Penal.

Neni 10

Sherbimi konsullor

1. Shteti shqiptar, nepermjet sherbimit konsullor ne shtetet pritese, ndihmon dhe lehteson zgjidhjen e problemeve te shtetasve shqiptare emigrante.
2. Tarifat per sherbimet konsullore ndaj emigranteve percaktohen me **LIGJ** te vecante.
3. Ne shtetet pritese, ku nuk ka perfaqesi diplomatike te Republikes se Shqiperise, kete veprimtari e kryejne perfaqesite diplomatike te akredituara ne shtete te tjera, si dhe konsujt e nderit te emeruar ne baze te **LIGJ**it nr. 8372, date 9.7.1998 "Per ushtrimin e funksioneve konsullore nga perfaqesite diplomatike ose konsullore".
4. Ministria e Punes dhe Çeshtjeve Sociale ne bashkepunim me Ministrine e Puneve te Jashtme hartojne dhe zbatojne programe per kualifikimin e personelit te sherbimit konsullor ne fushen e emigrimit.

Neni 11

Ruajtja e lidhjeve nderkomunitare

1. Shteti mbeshtet dhe ndihmon ngritjen, forcimin dhe zhvillimin e komuniteteve shqiptare jashte vendit, bashkepunon me to, duke konsoliduar veprimtarite e ndermarra nga klube, bashkime, shoqata dhe familje shqiptare me synim forcimin e lidhjeve midis tyre dhe me atdheun.
2. Shteti, duke respektuar legjislacionin e shtetit prites, si dhe marreveshjet dypaleshe dhe shumepaleshe ne te cilat Republika e Shqiperise eshte pale, kujdeset per arsimimin e emigranteve dhe te familjeve te tyre ne gjuhen shqipe, krijon kushte per ruajtjen e gjuhes, kultures dhe trashegimise kombetare, si dhe te lidhjeve shpirtore ne mes komuniteteve te emigranteve.

Neni 12

Shteti shqiptar kujdeset edhe per ata shtetas dhe familjet e tyre, te cilet jetojne e punojne ne shtetet pritese, por qe nuk kane perfituar ende statusin e emigrantit.

Neni 13

Shteti nxit kthimin e vullnetshem te emigranteve ne atdhe dhe riintegrimin e tyre ne jeten ekonomike, sociale te vendit, nepermjet krijimit te lehtesive **LIGJ**ore, financiare dhe fiskale dhe te zbatimit te programeve te zhvillimit te biznesit, te punesimit dhe te formimit profesional. Masat dhe strukturat perkatese percaktohen me **VENDIM** te Keshillit te Ministrave.

Neni 14

Shteti krijon lehtesi dhe kushte favorizuese per dergesat monetare te emigranteve ne bankat shqiptare.

Neni 15

1. Sigurimet shoqerore per emigrantet shqiptare afatgjate dhe afatshkurter rregullohen ne baze

te legjislacionit per sigurimet shoqerore te shtetit shqiptar dhe shtetit prites, marreveshjeve dypaleshe ne kete fushe dhe konventave nderkombetare per sigurimet shoqerore ku Republika e Shqiperise eshte pale.

2. Shteti shqiptar, nepermjet strukturave perkatese, nxit hapjen e agjencive per derdhjen e kontributeve te sigurimit vullnetar te emigranteve ne vendet prites.

KREUIV

STRUKTURAT SHTETERORE DHE PRIVATE TE EMIGRACIONIT

Neni 16

Ministria e Punes dhe Çeshtjeve Sociale eshte autoriteti kompetent kombetar, qe pergatit politikat dhe propozon ndryshime ne legjislacionin e fushes emigratore, duke ia paraqitur per miratim Keshillit te Ministrave.

Neni 17

Ministria e Punes dhe Çeshtjeve Sociale

Ministria e Punes dhe Çeshtjeve Sociale, nepermjet strukturave vartese te saj, ne bashkepunim me ministrite dhe organizatat jofitimpruese, ushtron kompetencat e saj per:

- perkujdesjen ndaj emigranteve shqiptare para largimit nga vendi, gjate qendrimin ne vendin prites dhe gjate rikthimit te tyre ne Republiken e Shqiperise;
- planifikimin, zbatimin dhe vleresimin e politikave te emigrimit;
- realizimin e marreveshjeve me vende te tjera per lehtesimin e emigrimit legal te shtetasve shqiptare, lehtesimin e qendrimin te tyre ne vendet prites dhe garantimin e te drejtave te tyre, sipas legjislacionit te vendeve prites, ne perputhje me konventat nderkombetare per te drejtat e emigranteve;
- studimin dhe propozimin e politikave te vecanta ekonomike e sociale, qe stimulojne emigrantet, per te investuar kursimet e tyre ne Shqiperi, me qellim riintegrimin e tyre;
- pergatitjen e akteve **LIGJ**ore dhe nen**LIGJ**ore ne fushen e emigrimit.

Neni 18

Agjencite private te punesimit

Shteti njeh dhe perkrah veprimtarite e agjencive private te punesimit qe konsistojne ne:

- sherbime qe lidhen me ndermjetesimin midis punekerkesve dhe punedhenesve jashte territorit te Republikes se Shqiperise, pa qene pale e marredhenieve te punesimit, qe mund te lindin nga ky ndermjetesim;
- sherbime per informimin lidhur me trajnimin e punekerkesve, per t'i bere ata te disponueshem per subjekte fizike ose juridike;
- dhenien e informacionit dhe ndermjetesimin per menaxhimin e punesimit te shtetasve shqiptare, brenda dhe jashte vendit.

KREU V

DISPOZITA KALIMTARE DHE TE FUNDIT

Neni 19

Shtetasit shqiptare, qe kane emigruar para dates se hyrjes ne fuqi te ketij **LIGJ**i, regjistrohen ne regjistrin "Per emigrantet" ne Ministrine e Punes dhe Çeshtjeve Sociale.

Neni 20

Ngarkohet Keshilli i Ministrave dhe Ministria e Punes dhe Çeshtjeve Sociale te nxjerrin aktet nen **LIGJ**ore ne zbatim te ketij **LIGJ**i.

Neni 21

LIGJi nr.7939, date 25.5.1995 "Per migracionin", si dhe cdo dispozite tjeter **LIGJ**ore qe bie ne kundertshtim me kete **LIGJ**, shfuqizohen.

Neni 22

Ky **LIGJ** hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3779, date 16.4.2003 te Presidentit te Republikes se Shqiperise, Alfred Moisiu

VENDIM

Nr .96, date 13.2.2003

PER PERCAKTIMIN PER VITIN 2003 TE NUMRIT TE PUNONJESVE TE INSTITUCIONEVE BUXHETORE

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te nenit 10 te **LIGJ**it nr.8983, date 20.12.2002 "Per Buxhetin e Shtetit te vitit 2003", me propozimin e Ministrit te Financave dhe te Ministrit te Shtetit prane Kryeministrit, Keshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Numri i punonjesve buxhetore per vitin 2003 per ministrite dhe institucionet qendrore te jete sipas listes qe i bashkelidhet ketij **VENDIM**i.
2. Per ministrite dhe institucionet qendrore, te cilat do te bejne shkurtime, numri i punonjesve te behet efektiv respektivisht nga datat 15 mars dhe 1 qershor te vitit 2003, sipas listes qe i bashkelidhet ketij **VENDIM**i.
3. Shtesa e numrit te punonjesve per Ministrine e Drejtesise te behet pas fillimit te punes ne burgjet e reja.
4. Ngarkohen te gjitha ministrite dhe institucionet qendrore per zbatimin e ketij **VENDIM**i. Ky **VENDIM** hyn ne fuqi menjehere.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

Nurmi i punonjesve per vitin 2003

1 Janar 15 Mars 1 Qershor

1 Presidenca 60 66 66

2 Kuvendi 320 404 404

3 Keshilli i Ministrave 305 317 317

4 Ministria e Industrise dhe Energjetikes 398 398 398

5 Ministria e Bujqesise dhe e Ushqimit 1350 1350 1300

6 Ministria e Rregullimit te Territorit dhe Turizmit 405 405 405

7 Ministria e Ekonomise 191 191 191

8 Ministria e Transportit dhe

Telekomunikacionit 1360 1300 1260

9 Zyra e Regjistrimit te Pasurive te

Paluajtshme 2421 242 242

10 Ministria e Financave 440 450 450

11 Ministria e Arsimit dhe e Shkences 44500 44400 44300

12 Ministria e Kultures, Rinise dhe Sporteve 1072 1070 1070

13 Ministria e Shendetesise 21600 21500 21400

14 Ministria e Drejtesise 1830 2200 2200

15 Ministria e Puneve te Jashtme 157 177 177

16 Ministria e Rendit Publik 13850 13800 13800

17 Ministria e Mbrojtjes 9300 9000 9000

18 Sherbimi Informativ Shteteror 1500 1400 1400

20 Drejtoria Arkivit te Shtetit 120 120 120

21 Drejtoria e Rezerves se Shtetit 500 400 300

22 Akademia e Shkencave 600 620 620

24 Kontrolli i Larte i Shtetit 150 150 150

25 Ministria e Punes, Ceshtjeve Sociale 1340 1350 1350

26 Ministria e Mjedisit 80 100 100
27 Agjencia Kombetare e Privatizimit 60 55 55
28 Prokuroria e Pergjithshme 750 720 720
29 Pushteti Gjvqesor 1140 1140 1140
30 Gjykata Kushtetuese 30 30 30
31 Agjencia Telegrafike Shqiptare 118 118 118
32 Ministria e Pushtetit Vendor dhe
Decentralizimit 2189 2170 2170
35 Drejtoria e Doganave 1050 1050 1050
37 Drejtoria e Standardeve 25 25 25
39 Drejtoria e Pergjithshme e Pvieve 1150 1100 1050
41 Drejtoria e Tatimeve 1400 1400 1400
50 Instituti i Statistikes 150 155 155
54 Enti Kombetar i Zonave te Lira 7 7 7
55 Shkolla e Magjistratures 15 17 17
57 Qendra Kombetare e Kinematografise 10 10 10
59 Instituti i Rehabilitimit te Perndjekurve
Politike 50 50 50

63 Inspektorati i Keshillit te Larte te
Drejtese 15 15 15
66 Zyra e Avokatit te Popullit 45 45 45
67 Komisioni i Sherbimit Civil 25 28 28
73 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve 45 45 45
74 Avokati i Shtetit 22 22 22
Totali 109966 109612 109172

VENDIM

Nr. 61, date 23.1.2003

PER CAKTIMIN E NUMRIT TE PERFAQESUESVE TE ORGANIZATAVE TE PUNEMARRESVE DHE TE PUNEDHENESVE NE KESHILLIN KOMBETAR TE PUNES

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te nenit 200 te **LIGJ**it nr. 7961, date 12.7.1995 "Per Kodin e Punes te Republikes se Shqiperise", ndryshuar me propozimin e Ministrit te Punes dhe te Çeshtjeve Sociale, Keshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Perfaqesuesit e organizatave te punemarresve dhe te punedhenesve ne Keshillin Kombetar te Punes te jene si me poshte vijon:

I. Perfaqesues nga organizatat e punemarresve:

- a) Konfederata e Sindikatave te Shqiperise (KSSH) 5 anetare, 5 kandidatë;
- b) Bashkimi i Sindikatave te Pavarura te Shqiperise (BSPSH) 4 anetare, 4 kandidatë;
- c) Unioni i Sindikatave te Punonjesve te Shqiperise (USPSH) 1 anetar, 1 kandidat.

II. Perfaqesues nga organizatat e punedhenesve:

- a) Konfederata e Punedhenesve te Shqiperise (KOP) 4 anetare, 4 kandidatë;
- b) Bashkimi i Organizatave te Biznesit Shqiptar (BOBSH) 3 anetare, 3 kandidatë;
- c) Shoqata e Ndertuesve te Shqiperise (SHNSH) 1 anetar, 1 kandidat;
- ç) Bashkimi i Industrialisteve dhe Investitoreve te Shqiperise (BI&ISH) 1 anetar, 1 kandidat;
- d) Keshilli i Agrohiznesit shqiptar 1 anetar, 1 kandidat;

2. Emertimi i anetareve dhe i kandidatëve te Keshillit Kombetar te Punes behet nga Ministri i Punes dhe i Çeshtjeve Sociale, me propozimin e organizatave te punemarresve dhe te punedhenesve.

3. **VENDIM** nr. 768, date 8.12.1998 i Keshillit te Ministrave "Per caktimin e perfaqesuesve te organizatave te punemarresve dhe te punedhenesve ne Keshillin Kombetar te Punes", i ndryshuar me **VENDIM**in nr. 307, date 1.7.1999 te Keshillit te Ministrave, shfuqizohet. Ky **VENDIM** hyn ne fuqi pas botimit ne F1etoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

NUMRI I PUNONJESVE TE SEKSIONEVE TE ADMINISTRIMIT DHE MBROJTJES SE TOKES

NIP Emertimi i Qarkut Numri i punonjesve Nendarja Numri i punonjesve administrative

1 BERAT 8 Berat 4

Kuçove 2

Skrapar 2

2 FIER 12 Fier 5

Lushnje 4

Mallakaster 3

3 GJIROKASTER 8 Gjirokaster 4

Permet 2

Tepelene 2

4 DIBER 7 Peshkopi 3

Bulqize 2

Mat 2

5 KUKES 7 Kukes 3

Has 2

Tropoje 2

6 LEZHE 7 Lezhe 3

Kurbin 2

Mirdite 2

7 SHKODER 8 Shkoder 4

M.Madhe 2

Puke 2

8 VLORE 10 Vlore 5

Delvine 2

Sarande 3

9 DURRES 7 Durres 4

Kruje 3

10 TIRANE 7 Tirane 4

Kavaje 3

11 KORÇE 11 Korçe 4

Devoll 2

Kolonje 2

Pogradec 3

12 ELBASAN 10 Elbasan 4

Peqin 2

Gramsh 2

Librazhd 2

Totali 102 102

V E N D I M

Nr. 17, date 10.1.2003

PER DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NE STATUTIN E SHERBIMIT KOMBETAR TE PUNESIMIT, MIRATUAR ME **VENDIMIN** NR. 42, DATE 17.1.1998 TE KESHILLIT TE MINISTRAVE "PER MIRATIMIN E STATUTIT TE SHERBIMIT KOMBETAR TE PUNESIMIT", I NDRYSHUAR

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te nenit 18, pikat 1 e 4 te **LIGJIT** nr.7995, date 20.9.1995 "Per nxitjen e punesimit", me propozimin e Ministrit te Punes dhe Çeshtjeve Sociale, Keshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve ne statutin e Sherbimit Kombetar te Punesimit, sipas tekstit qe i bashkelidhet ketij **VENDIMI**.
2. Ngarkohet Ministria e Punes dhe e Çeshtjeve Sociale per zbatimin e ketij **VENDIMI**. Ky **VENDIM** hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

SHITESAT DHE NDRYSHIMET NE STATUTIN E SHERBIMIT KOMBETAR TE PUNESIMIT

1. Ne statut fjalet "ç zyrove dhe agjencive lokale te punesimit.", te zevendesohen me "ç zyrove rajonale dhe vendore te punesimit, agjencive vendore..".
2. Ne nenin 12 emertimi "...Ministrise se Ekonomise Publike dhe Privatizimit " te zevendesohen me .., ...Ministrise se Industrise dhe te Energjetikes. .." .
3. Ne nenin 16 behen ndryshimet, si me poshte vijon:
 - a) Ne piken. IV fjalet " ...te nivelit lokal. .." te zevendesohen me "ç ne nivel qarku dhe vendor..." .
 - b) Ne paragrafin e fundit fjalet "...ne nivel qendror dhe lokal.", zevendesohen me "...ne nivel qendror, qarku dhe vendor. " .
4. Ne paragrafin e dyte te nenit 18, fjalet " ...me **UDHEZIM** te Ministrit te Punes dhe te Çeshtjeve Sociale.", zevendesohen me "...nga keshilli administrativ tripalesh.".
5. Pas nenit 18 shtohet neni 18/1 me kete permbajtje:

"Neni 18/1

Detyrat dhe pergjegjesite e zyrove rajonale dhe vendore te punesimit

Zyra rajonale ne nivel qarku ka keto detyra dhe pergjegjesi:

- Menaxhon zbatimin e politikave te punesimit ne zyrat vendore te qarkut.
- Propozon forma te reja funksionimi per persosjen e sherbimeve te punesimit ne nivel qarku
- Jep mbeshtetje profesionale ne kualifikimin e stafit rajonal dhe vendor te sherbimeve te punesimit
- Organizon punen dhe monitoron zbatimin e detyrave ne zyrat vendore.
- Miraton projekte per nxitjen e punesimit, nga te cilat perfitojne ndermarrjet e vogla.
- Ndjek ecurine e zbatimit te projekteve te miratuara ne nivel qarku.
- Mban rregullisht te dhena per subjektet private, qe zhvillojne veprimtarine ne qark.
- Bashkerendon oferten me kerkesen per formim profesional, ne nivel qarku.
- Bashkerendon punen e zyrove te punesimit ne qark me qendrat publike te formimit profesional, per plotesimin e nevojave per formim qe kane pune kerkuesit e papune, ne perputhje me

kerkesat e tregut te punes.

-Harton ne menyre te hollesishme projektbuxhetin e zyres rajonale dhe e dergon per miratim ne SHKP .

-Ndjek dhe kontrollon realizimin e buxhetit te zyres rajonale.

-Harton dhe mbyll bilancet.

-Siguron te dhena statistikore per programet e sherbimet dhe politikat e punesimit, ne nivel qarku.

-Zbaton programin ekzistues statistikor dhe perpunon statistikat e qarkut.

-Propozon permiresime te treguesve statistikore.

-Ben parashikimin afatshkurter te tregut te punes, ne nivel qarku.

-Jep te dhena per organet e qeverisjes vendore (qark, komune, bashki) dhe institucionet e tjera te qarkut, organizon takime dhe bashkepunon meto, merr pjese ne studime te perbashketa qe i sherbejne zhvillimit ne nivel qarku.

-Njofton Ministrine e Punes dhe te Çeshtjeve Sociale per studimet ne nivel qarku ne fushen e punesimit, te tregut te punes, ne sherbimet e punesimit, formimin profesional, nxitjen e punesimit, punet publike etj .

-Regjistron dhe vendos ne vendet e punes puneckerkuesit qe paraqiten dhe kerkojne sherbime dhe ndihmen e zyres se punesimit.

-Ofron sherbime te orientimit profesional, keshillime per pune dhe sherbime te tjera per shtetasit qe paraqiten dhe i kerkojne keto sherbime.

-Zbaton programe te mbeshtetjes me te ardhura.

-Zbaton programe shteterore te tregut te punes, si formim profesional, nxitje te punesimit, pune publike dhe programe te tjera, te ngarkuara me akte, **LIGJore** e nen**LIGJore**,

-Bashkepunon me institucione dhe organizma te tjera, qe zbatojne programe te ndryshme punesimi apo mbrojtjeje sociale.

-Krijon lidhje ndermjet Ministrise se Punes dhe te Çeshtjeve Sociale me qarkun, per harmonizimin e politikave shteterore te punesimit, ne nivel qarku.

Zyra vendore ne bashki dhe komune ka keto detyra dhe pergjegjesi:

-Zbaton politikat e punesimit ne zyrat vendore.

-Mban rregullisht te dhenat per subjektet private, qe zhvillojne veprimtarine ne nivel vendor.

-Bashkerendon oferten me kerkesen per formim profesional, ne nivel vendor .

-Harton, ne menyre te hollesishme, projektbuxhetin e zyres vendore dhe ia dergon ate zyres rajonale

-Ndjek dhe kontrollon realizimin e buxhetit te zyres vendore.

-Harton dhe mbyll bilancet.

-Siguron te dhena statistikore per programet, sherbimet dhe politikat e punesimit, ne nivel vendor

-Zbaton programin ekzistues statistikor dhe perpunon statistikat ne nivel vendor.

-Ben parashikimin afatshkurter te tregut te punes, ne nivel vendor, dhe ia dergon ate zyres rajonale dhe organeve te pushtetit vendor .

-Regjistron dhe vendos ne vendet e punes puneckerkuesit qe paraqiten dhe kerkojne sherbime dhe ndihmen e zyres se punesimit.

-Ofron sherbime te orientimit profesional, keshillime per pune dhe sherbime te tjera per shtetasit, qe paraqiten dhe i kerkojne keto sherbime.

-Zbaton programe te mbeshtetjes me te ardhura.

-Zbaton programe shteterore te tregut te punes, si formim profesional, nxitje te punesimit, pune publike dhe programe te tjera, te ngarkuara me akte, **LIGJore** e nen**LIGJore**.

-Bashkepunon me bashkite, komunat, institucionet dhe organizma te tjera, per zbatimin e programeve te ndryshme te punesimit apo te mbrojtjes sociale."

VENDIM

Nr. 67, date 10.1.2003

PER MIRATIMIN E STRATEGJISE SE PUNESIMIT DHE TE FORMIMIT PROFESIONAL

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te nenit 4 te **LIGJ**it nr. 7995, date 20.9.1995 "Per nxitjen e punesimit", me ndryshimet perkatese, me propozimin e Ministrit te Punes dhe te Çeshtjeve Sociale, Keshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e strategjise se punesimit dhe te formimit profesional, sipas tekstit, qe i bashkelidhet ketij **VENDIM**i.

Ky **VENDIM** hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr. 511, date 24.10.2002

PER KOHEZGJATJEN E PUNES DHE TE PUSHIMIT NE INSTITUCIONET SHTETERORE

Ne mbështetje te nenit 100 te Kushtetutës, te neneve 19 shkronja "c", 20 shkronjat "e" dhe "g" e 29 te **LIGJit** nr. 8549, date 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", dhe te neneve 76-108 te **LIGJit** nr.7961, date 12.7.1995 "Kodi i Punën i Republikës se Shqipërisë", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

KREU I

Kohëzgjatja e punës

1. Kohëzgjatja javore e punës është 40 ore ne jave për nëpunësit civile dhe punonjësit e tjerë, ne institucionet e administratës publike te nivelit qendror, si dhe ne institucionet e tjera shtetërore.
2. Orari ditor i punës fillon çdo dite nga ora 8.00 deri ne orën 13.00 dhe nga ora 14.30 deri ne orën 18.00.

Ditën e premte nga ora 8.00 deri 14.00

3. Për efekt te llogaritjes se pagës orare muaji llogaritet, mesatarisht, me 174 ore pune.
4. Ne raste te veçanta dhe për arsye objektive, orari ditor i punës mund te ndryshohet me urdhër te Kryeministrit, por jo për një periudhe me te gjate se 3 muaj .
5. Me kërkesë te eprorit te drejtpërdrejtë dhe me miratimin e drejtuesit te institucionit përkatës, nëpunësit civil apo punonjësit mund t'i kërkohej te kryeje ore shtese. Çdo ore shtese, tej orarit ditor, ne dite te zakonshme, paguhet mbi pagën orare edhe me 25 për qind shtese te kësaj page, ndërsa orët shtese gjate ditëve te pushimit apo ditëve te festave, si dhe çdo ore shtese e kryer nga ora 22.00 -6.00 paguhet mbi pagën orare edhe me 50 për qind shtese te kësaj page. Nëpunësi civil apo punonjësi ka te drejte te kërkojë qe te mos kompensohet me shtese mbi pagën normale, por me pushim, i cili kompensohet, përkatësisht, me pushim te barabarte me orët shtese plus 25 për qind te tyre, kur këto ore janë kryer ne dite te zakonshme pune apo me orët shtese plus 50 për qind te tyre kur orët janë kryer ne dite pushimi, dite feste apo nga ora 22.00-6.00. Drejtuesi i institucionit detyrohet t'ia japë kërkuetit këtë pushim, brenda 2 muajve nga kryerja e orëve shtese.

KREU II

Pushimet

1. Ditët e shtune dhe e diel janë dite pushimi javor .
2. Kohëzgjatja e pushimit vjetor te paguar është 4 jave kalendarike. Koha e kryerjes se lejes se pushimit vjetor përcaktohet nga drejtuesi i institucionit, sipas kërkesës se nëpunësit civil apo te punonjësit, duke mos cenuar vijueshmërinë e punës. Nëpunësi civil apo punonjësi ka te drejte te kërkojë kryerjen e pushimit vjetor edhe ne periudha te ndryshme e te ndara, por këto periudha nuk mund te jene me te shkurtra se 6 dite ne vijim. Ne qofte se pushimi vjetor nuk kryhet brenda vitit kalendarik përkatës, ai mund te kryhet deri ne tremujorin e pare te vitit kalendarik pasardhës.
3. Nëse nëpunësi civil apo punonjësi nuk e kryen pushimin vjetor, brenda periudhës se përcaktuar me lart, ai ka te drejte te kompensohet me pagën përkatëse.
4. Kohëzgjatja e pushimit vjetor te paguar, kur nëpunësi civil apo punonjësi nuk ka kryer një vit kalendarik pune te plote, përcaktohet ne përpjesëtim te drejte me kohëzgjatjen e marrëdhënieve

juridike te punës.

5. Pushimi vjetor i paguar, qe i është dhënë nëpunësit civil apo punonjësit ne një vend tjetër pune, llogaritet ne kohen e pushimit vjetor te paguar, kur ai caktohet ne një vend tjetër pune.

6. Kur marrëdhëniet juridike ne shërbimin civil apo te punës kane përfunduar dhe nëpunësi civil apo punonjësi nuk ka kryer pushimin vjetor te paguar, ai përfiton një shpërblim ne masën e pagës përkatëse.

7. Paga e dhënë për pushimin vjetor te paguar është ajo qe ka përfituesi ne çastin e marrjes se saj dhe i jepet atij ne fillim te pushimit vjetor .

8. Kur nëpunësi civil apo punonjësi, për arsye shëndetësore, behet i paafte për pune gjate periudhës se kryerjes se pushimit vjetor te paguar dhe këtë e vërteton me raport mjekësor, njofton eprorin e drejtpërdrejtë dhe drejtorinë e personelit dhe pushimi vjetor i zgjatet për atë periudhe kohe.

9. Nëpunësi civil apo punonjësi ka te drejtën e pushimit te paguar edhe për rastet si me poshtë vijon:

a. Martesën e nëpunësit civil apo te punonjësit 5 dite;

b. Martesën e fëmijës se tij 3 dite;

c. Lindjen e fëmijës për baballarët 3 dite;

ç. Vdekjen e prindërve, te gjyshërve, te bashkëshortit, 5 dite;

te fëmijës, te vëllezërve, te motrave

d. Ndërrimin e banesës 2 dite;

dh. Sëmundje te renda te fëmijëve, prindërve apo 5 dite;

bashkëshortit, te vërtetuara me raport mjekësor

e. përgatitjen dhe mbrojtjen e titujve pasuniversitar, 10 dite.

për punën qe kryejnë

10. Nëpunësi civil ka te drejte, qe, ne raste te veçanta, te kërkojë leje pa te drejte page, për arsye shëndetësore, personale, për fëmijët, bashkëshortin apo prindërit. Kohëzgjatja e kësaj leje përcaktohet nga drejtuesi i institucionit, me propozimin e eprorit te drejtpërdrejtë.

Kohëzgjatja maksimale e te gjitha lejeve te papaguara, brenda një viti kalendarik, nuk mund te jete me e gjate se 30 dite.

KREU III

Dispozita transitore dhe te fundit

1. Ky **VENDIM** nuk zbatohet për ato institucione shtetërorë, për te cilat përcaktohet ndryshe ne akte te tjera, **LIGJore** apo nën**LIGJore**.

2. Pushimi vjetor i paguar, pushimet e tjera dhe koha e kryerjes se tyre shënohen ne dosjen e personelit te nëpunësit civil apo te punonjësit.

3. **VENDIMI** nr.761, date 19.11.1998, i Këshillit te Ministrave, "Për kohen e punës dhe te pushimit ne shërbimin civil" , shfuqizohet.

Ky **VENDIM** hyn ne fuqi me 1.11.2002.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

L I G J

Nr.8862, datë 7.3.2002

PËR DISA NDRYSHIME NË **LIGJIN** NR.7995, DATË 20.9.1995 "PËR NXITJEN E PUNËSIMIT",
NDRYSHUAR ME **LIGJIN** NR.8444, DATË 21.1.1999

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në **LIGJ**in nr.7995, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit", ndryshuar me **LIGJ**in nr.8444, datë 21.1.1999, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Pika 5 e nenit 4 ndryshohet si më poshtë:

"5. Politikat shtetërore të punësimit vendosen nga Këshilli i Ministrave. Ministria nxit dhe realizon zbatimin e politikave për punësimin, arsimimin dhe formimin profesional nëpërmjet Shërbimit Kombëtar të Punësimit."

Neni 2

Neni 17 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 17

1. Shërbimi Kombëtar i Punësimit është një shërbim publik, autonom, me statusin e një administrate shtetërore, qendrore, që përgjigjet para ministrit.

2. Organi më i lartë **VENDIM**marrës i Shërbimit Kombëtar të Punësimit është Këshilli Administrativ Trepalësh. Organizimi dhe funksionimi i tij përcaktohen në Statutin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

3. Autoriteti më i lartë ekzekutiv i Shërbimit Kombëtar të Punësimit është Drejtori i Përgjithshëm, i cili emërohet nga Kryeministri, me propozimin e ministrit përkatës."

Neni 3

Shkronja "b" e pikës 2 dhe pika 3 e nenit 18 shfuqizohen.

Neni 4

Ky **LIGJ** hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYETARE

Makbule Çeço

L I G J

Nr. 8857, datë 07.02.2002

PË DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË **LIGJIN** NR. 7986, DATË 13.09.1995 "PËR INSPEKTIMIN SHTETËROR TË PUNËS", NDRYSHUAR ME **LIGJIN** NR. 8394, DATË 02.09.1998

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në **LIGJ**in nr. 7986, datë 13.09.1995 "Për Inspektoratin Shtetëror të Punës", ndryshuar me **LIGJ**in nr. 8394, datë 02.09.1998, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 27 ndryshon si më poshtë:

"Neni 27

Procedura dhe sanksione

1. Për shkeljet e dispozitave të legjislacionit të punës vendos gjobë ndaj kundërvajtësve deri në vlerën e pesëdhjetëfishit të pagës minimale.
2. Kundërshtimi dhe pengimi i inspektorëve në ushtrimin e detyrës përbën kundërvajtje dhe dënohet me gjobë nga 5 000 deri në 50 000 lekë.
3. Kur shkelja përbën vepër penale, zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit Penal.
4. Kundër **VENDIM**it të inspektorit të punës mund të bëhet ankim, pranë Inspektorit të Përgjithshëm, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit. Inspektori i Përgjithshëm shprehet dhe nxjerr **VENDIM**in për ankimin brenda 30 ditëve nga data e regjistrimit të ankesës. Kundër **VENDIM**it të Inspektorit të Përgjithshëm mund të bëhen ankim në gjykatën e shkallës së parë ku ka ndodhur kundërvajtja, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.
5. **VENDIM**et e formës së prerë, të marra nga Inspektori i Punës, janë tituj ekzekutivë dhe kur nuk zbatohen vullnetarisht nga kundërvajtësit, ekzekutohen nga zyrat e përmbarimit".

Neni 2

Pas nenit 27 shtohet neni 27/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 27/1

1. Kur gjobat e vëna nga Inspektori i Punës nuk ekzekutohen vullnetarisht, zyra e përmbarimit vë në sekuëstrim një pjesë të pasurisë së kundërvajtësit, sa vlera e gjobës për 6 muaj.
2. Kur pas këtij afati nuk ekzekutohet **VENDIMI**, bëhet konfiskimi i pasurisë në vlerën e gjobës."

Neni 3

Nenet 25, 26 dhe 26/1 të **LIGJ**it nr. 7986, datë 13.09.1995 "Për Inspektoratin Shtetëror të Punës", ndryshuar me **LIGJ**in nr. 8394, datë 02.09.1998, shfuqizohen.

Neni 4

Ky **LIGJ** hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3256, datë 11.02.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani

VENDIM

Nr .262, date 25.5.2000

PER DHENIEN E LEJES PER PUNE SHTETASVE TE HUAJ

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te nenit 83 te **LIGJ**it nr .8492, date 27.5.1999, "Per te huajt", me propozimin e zevendeskrjeminstirit dhe ministrit te Punes dhe Çeshtjeve Sociale, Keshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministria e Punes dhe Çeshtjeve Sociale eshte institucioni i cili kujdeset per perpunimin e politikave te punesimit te shtetasve te huaj koordinon veprimtarine e strukturave te punesimit te shtetasve te huaj, dhe pajis shtetasit e huaj me leje per ne Republiken e Shqiperise. , Ministria e Punes dhe Çeshtjeve Sociale dhe strukutrat e saj bashkepunojne me institucionet e tjera per percaktimin e drejtimeve te zhvillimit te tregut te punes se te huajve ne Republiken e Shqiperise .

2. Zyra e punesimit, sektori i migracionit, ne njesine vendore pajis me:

Leje pune te tipit B, leje pune te tipit D, ne te gjitha rastet kur veprimtaria e lejekerkuesit shtrihet vetem ne nje njesi vendore.

2 Zyra e punesimit, sektori i migracionit, ne njesine vendore pajis me:

Leje pune te tipit B, leje pune te tipit D, ne te gjifua rastet kur veprimtaria e lejekerkuesit shtrihet vetem ne nje njesi vendore

3. Drejtoria e Migracionit ne Ministrine e Punes dhe Çeshtjeve Sociale, pajis me:

a) Leje pune te tipit A, leje pune te tipit B, leje pune te tipit D, kur veprimtaria e lejekerkuesit shtrihet ne me teper se nje njesi vendore;

b) Leje pune te tipit C, leje pune te tipit E, leje pune te tipit F, leje pune te tipit G, leje pune te tipit H, qe nuk kane kufizime gjeografike;

c) Lejet e punes pa kufizime, per personat qe parashikon neni 33 i **LIGJ**it;

ç) Lejet e punes per personat qe zhvillojne aktivitetin e tyre ne njesite vendore ku mungon zyra e punesimit

4. Shtetasi i huaj qe aplikon per leje pune te tipit A, leje pune te tipit B, leje pune te tipit D, leje pune te tipit E, leje pune te tipit F, leje pune te tipit G, paraqet prane organit kompetent dokumentacionin e meposhtem

a) Kerkesen me nje historik te shkurter te punesimit te tij

b) Kopjen e firmosur te kontrates se punes te nenshkruar midis paleve,

c) Kualifikimet, ne pershtatje me kontraten dhe vendin e punes

ç) Kerkesen me shkrim te punedhenesit qe do te beje punesimin dhe dokumentin, per punesimin e dy shqiptareve kundrejt nje shtetasi te huaj

d) Vendmin e gjykates se vendit te origjines, ku eshte regjistruar si person juridik,

dh) Proven e hyrjes se **LIGJ**shme ne territortn e Republikes se Shqiperise

e) Dokumentin qe tregon pjesemarrjen ne skemen e sigurimeve shoqerore ose deshmi per sigurim shoqeror ne vendin e origjines,

e) Raportin mjeko-**LIGJ**or leshuar nga autoritetet kompetente ne vendin e origjines ose ne Republiken e Shqiperise

f) 4 fotografi,

g) Formularin tip qe jepet ne organin qe leshon lejen e punes

Ne rast te ripertesitjes se lejeve te tipeve te mesiperme, nga lejekerkuesit duhet te dokumentohet shlyerja e detyrimeve ne Zyren e Tatimeve, akt-kontrolli i ISHP-se si dhe leje paraardhese e punes

5 Shtetasi i huaj qe aplikon per leje pune te tipeve C dhe H, paraqet prane organit kompetent dokumentacionin e meposhtem:

- a) Kërkesen me një historik të shkurtër të punësimit të tij
 - b) Kopjen e firmosur të kontratës së punës të nënshkruar midis paleve,
 - c) Kualifikimet, në përshatje me kontratën dhe vendin e punës
 - ç) Kërkesen me shkrim të punëdhënesit që do të bëjë punësim dhe dokumentim të zbatimit të **LIGJit**, për punësimin e dy shqiptarëve kundrejt një shtetasi të huaj
 - d) **VENDIMin** e gjykatës si person juridik
 - dh) Proven e hyrjes së **LIGJshme** në territorin e Republikës së Shqipërisë,
 - e) Dokumentin që tregon pjesëmarrjen në skemën e sigurimeve shoqërore ose deshmi për sigurim shoqëror në vendin e origjinës,
 - e) Raportin mjeko-**LIGJor** lëshuar nga autoritetet kompetente në vendin e origjinës ose në Republikën e Shqipërisë
 - f) 4 fotografi
 - g) Formularin lip, që jepet në organin që leshon lejen e punës
 - gj) Dokumentimin e shlyerjes së detyrimeve të punëdhënesit që bën punësimin, konfirmen nga ISHP-ja, nga zyra e tatim-taksave si dhe lejen paraardhese të punës,
Te gjitha dokumentet e kerkuara nga vendi i origjines, sipas paragrafeve 4 dhe 5, duhet te jene te noterizuara.
6. Shtetasi i huaj, aplikant për leje pune, i refuzohet kërkesa në rast se ai nuk arrin të plotësojë qoftë edhe një nga kriteret e përshkruara nga nenin 4 deri në nenin 11 të **LIGJit**. Gjithashtu leja e punës mund të refuzohet kur konstatohen shkelje të **LIGJeve** në fuqi nga ana e punëdhënesit, punëmarresit apo personave të vetëpunësuar .
7. Leja e punës anulohet kur ndryshojnë kushtet thelbësore të miratimit të saj dhe në rastet kur kontrata e punës bëhet e pavlefshme, sipas dispozitave të Kodit të Punës.
8. Shtetasi i huaj, leja e punës e të cilit është anuluar, ka të drejtë të ankohet brenda dy javësh, një instance më lart, për **VENDIMin** e anulimit.
Në rast të një përgjigjeje negative, i huaji ka të drejtë të ankohet tek titullari një jave pas marrjes së përgjigjes për ankesën.
Përgjigja në shkallën e dytë është përfundimtare dhe jepet brenda një jave nga data e berjes së ankimit.
9. Drejtoria e Migracionit grumbullon informacionin për të gjitha aplikimet e shqyrtuara nga zyra e punësimit të njesive vendore, ndërton bazën e të dhënave dhe bën përpunimin statistikor . Drejtoria e Migracionit bën raportin vjetor për vlerësimin e situatës së punësimit të të huajve, me sugjerimet përkatëse për politikën shtetërore në këtë fushë.
10. Tarifat për lejet e punës janë nga 2 000 leke deri në 10 000 leke. Masa e tyre për çdo tip leje pune përcaktohet me **UDHEZIM** të veçantë të ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale.
11. Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale përcakton me **UDHEZIME** të veçanta:
- a) Menyren e koordinimit dhe veprimtarinë e institucioneve në linjë vertikale.
 - b) Formularin tip që plotësohet nga lejekerkuesit sipas kategorive .
 - c) Modelin e lejes së punës, sipas kategorive të shprehura në **LIGJ**.
 - ç) Afatet kohore të lejes së punës.
12. Ngarkohet Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale të nxjerrë **UDHEZIMet** e nevojshme në mbështetje dhe në zbatim të këtij **VENDIMI**.
- 13, **VENDIMI** nr. 680, datë 30.10.1995, i Keshillit të Ministrave, "Për dhenien e lejes për punë shtetasve të huaj " shfuqizohet.
- Ky **VENDIM** hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM

Nr .263, date 25.5.2000

PER MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NE STATUTIN E SHERBIMIT KOMBETAR TE PUNESIMIT, E MIRATUAR ME **VENDIMIN** NR. 42, DATE 17.1.1998, TE KESHILLIT TE MINISTRAVE, "PER MIRATIMIN E STATUTIT TE SHERBIMIT KOMBETAR TE PUNESIMIT"

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te nenit 18, te **LIGJIT** nr. 7995, date 20.9.1995, "Per nxitjen e punesimit", me propozimin e ministrit te Punes dhe Çeshtjeve Sociale, Keshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve ne statutin e Sherbimit Kombetar te Punesimit, i cili i bashkelidhet ketij **VENDIMI**.
2. Ngarkohet Ministria e Punes dhe Çshtjeve Sociale per zbatimin e ketij **VENDIMI**. Ky **VENDIM** hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

NE STATUTIN E SHERBIMIT KOMBETAR TE PUNESIMIT BEHEN NDRYSHIMET E MEPOSHTME:

1. Ministria e Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Gruas behet Ministria e Punes dhe Çeshtjeve Sociale.
2. Ne fund te nenit 1 shtohet nje fjali me kete permbajtje:
"Keshilli i Ministrave miraton simbolin e SHKP".
3. Neni 7 ndryshohet si vijon:
"Buxheti i investimeve vjetore te SHKP behet vetem me aprovim te Ministrit te Punes dhe Çeshtjeve Sociale dhe ne asnje rast nuk kalon 10 per qind te buxhetit vjetor te shpenzimeve te SHKP .
4. Neni 24 behet paragrafi 2 i nenit 8.
5. Ne fund te nenit 10 shtohet togfjaleshi "nga Ministri i Punes dhe Çeshtjeve Sociale" .
6. Ne nenin 11 hiqet fjala e fundit.
7. Ne nenin 13 fjala "nje vit" zevendesohet me fjalen "2 vite". Fjala "emertim" behet "emerim" . Mbas fjales "kalendarik" shtohet fjalite: "Miratimi i emerimit te anetareve behet nga Ministri i Punes dhe Çeshtjeve Sociale. perfaqesite e institucioneve shteterore duhet te jene ne nivel zevendesminister ose drejtor drejtorie" .Ne fund shtohet fjalia "Keshilli ushtron veprimtarine sipas rregullores se funksionimit te tij":
8. Ne nenin 13 fjala "gjashte" behet "kater", pas fjales "sociale" shtohet togfjaleshi "ne raste te vecanta " dhe togfjaleshi "tre te katertat" zevendesohen me fjalen "gjysma".
9. Ne piken 5 te nenit 14 shtohet ne fund "me te rendesishme te SHKP sipas rregullores perkatese. Pika 6 ndryshohet si vijon "miraton strukturat e pergjithshme te SHKP dhe rregulloret e SHKP" .
Shtohet pika 7 me kete permbajtje: "krijon Komisionin e Kontrollit per kontrollin e veprimtarise se tij .
10. Ne nenin 15 pas fjalise se pare pjesa tjeter e nenit ndryshohet si vijon:
"Ai emerohet nga Kryeministri me propozimin e Ministrit te punes dhe Çeshtjeve Sociale dhe

pergjigjet para ketij te fundit per veprimtarine e tij. Drejtori i pergjithshem shkarkohet kur:

a) Jep doreheqjen;

b) Gjate ushtrimit te detyres denohet nga gjykata me **VENDIM** te formes se prere;

c) Kur eshte ne pamundesi fizike a mendore per te kryer funksionet e ngarkuara;

d) Konkludohet paaftesia, me dy vleresime negative te njepasnjeshme te punes.

11. Ne nenin 16 pika 4 ndryshohet si vijon:

"Me miratim te Ministrit te Punes dhe Çeshtjeve Sociale emerohet drejtoret e drejtorive ne SHKP, ata te nivelit lokal si dhe drejtoret e institucioneve te tjera ne vartesi te SHKP" :

Ne kete nen shtohen kater pikat e meposhtme:

.emerohet personel te niveleve te tjera te SHKP

.propozon ne Keshill strukturat e pergjithshme te SHKP

.propozon ne Keshill buxhetin vjetor, bilancin vjetor dhe detajimin e buxhetit

.propozon dhe sipas rastit miraton programet kualifikuese per stafin ne nivel qendror dhe lokal

12. Ne nenin 18 shtohet paragrafi i dyte me kete permbajtje:

"Keshilli lokal trepalesh perbehet nga perfaqesues te zyres se punesimit, organizatave te punedhenesve dhe te punemarresve. Te drejtat, detyrat dhe perberja e i keshillit lokal trepalesh percaktohen me **UDHEZIM** te Ministrit te Punes dhe Çeshtjeve Sociale" .

13. Ne nenin 21 ne fjaline e pare hiqet togfjaleshi "informacion per: "

Shtohet pika e fundit me kete permbajtje: "(IV) veprimtarine e saj, realizimin e buxhetit, realizimin e programeve te punes, informacionin statistikor per nivelin qendror dhe lokal" .

14. Titulli "Dispozita te pergjithshme dhe kalimtare" hiqet.

15. Neni 22 ndryshohet si vijon: "SHKP paraqet ne Ministrine e Punes dhe Çeshtjeve Sociale propozimet per projektbuxhetin, ndryshimet ne legjislacion, çdo iniciative per projekte, studime dhe bashkepunime te reja si dhe per papunesine dhe tregun e punes".

16. Ne nenin 23 shtohet paragrafi i pare me kete permbajtje:

"SHKP bashkepunon me Institutin e Sigurimeve Shoqerore, Sherbimin Social Shteteror dhe Inspektoriatin Shteteror te Punes per bashkerendimin e koordinimin e aktiviteteve. "

Paragrafi i pare behet i dyte i ketij neni.

17. Neni 24 behet: "Sherbimi Kombetar i Punesimit kontrollon institucionet publike dhe private per aktivitetin e tyre dhe i propozon Ministrise se Punes dhe Çeshtjeve Sociale autorizimin e tyre" .

VENDIM

Nr. 307, date 1.7.1999

PER NJE NDRYSHIM NE **VENDIMIN** E KESHILLIT TE MINISTRAVE NR. 768, DATE 8.12.1998 "PER CAKTIMIN E PERFAQESUESVE TE ORGANIZATAVE TE PUNEMARRESVE DHE PUNEDHENESVE NE KESHILLIN KOMBETAR TE PUNES"

Ne mbështetje te nenit 100 te Kushtetutës dhe te nenit 200 te **LIGJIT** nr .7961, date 12.7.1998 "Për Kodin e Punës ne Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë se Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Ne **VENDIMIN** e Këshillit te Ministrave nr .768, date 8.12.1998, ne piken 1, ne titullin "Përfaqësues te organizatave te punëmarrësve " bëhen këto ndryshime :

"PERFAQESUES TE ORGANIZATAVE TE PUNEMARRESVE

1. Bashkimi i Sindikatave te Pavarura te Shqipërisë (BSPSH) 4 anëtarë 4 candidate
2. Konfederata e Sindikatave te Shqipërisë (KSSH) 4 anëtarë 4 candidate
3. Unioni i Sindikatave te Punonjësve te Shqipërisë (USPSH) 1 anëtar, 1 kandidat
4. Sindikata e Pavarur i Minatorëve te Shqipërisë (SPMSH) 1 anëtar, 1 kandidat"

Ky **VENDIM** hyn ne fuqi menjëherë.

KR YEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.69, date 11.2.1999

PER PROGRAMIN E NXITJES SE PUNESIMIT TE PUNEKERKUESVE TE PAPUNE

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes se Republikes te Shqiperise dhe te **LIGJit** nr.7995, date 20.9.1995 "Per nxitjen e punesimit", me propozimin e Ministrise se Punes dhe Çeshtjeve Sociale, Keshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Punedhenesit, qe marrin ne punesim te perkohshem ose ne punesim prove persona punekerkues te papune nga lista e zyres se punesimit, mund te perfitojne financim mujor te pages dhe te shpenzimeve per sigurimet e detyrueshme te ketyre personave. Kohezgjatja e punesimit eshte jo me pak se tre muaj dhe jo me shume se gjashte muaj. Paga kompensohet deri ne masen e pages minimale, ne shkalle vendi, kurse sigurimet e detyrueshme deri ne masen 100 per qind.
2. Punedhenesit, qe punesojne, me kontrate te rregullt, per kohezgjatje te pakten njevjeçare, presona punekerkues te papune nga lista e zyres se punesimit, mund te perfitojne nje subvencion te menjehershem, te barabarte me shumen e pages minimale dhe shpenzimet per sigurimet e detyrueshme, per nje periudhe deri ne 5 muaj.
Ne rastin kur personat e punesuar ne kete forme jane trajtuar me pare sipas pikes 1 te ketij **VENDIMI**, kompensimi behet per nje periudhe deri ne 3 muaj.
3. Ne rastin kur personat e punesuar nuk kane formimin e duhur profesional per proceset e punes, per te cilat punesohen, punedhenesi mund te perfitoje nje rritje, deri ne 20 per qind te kompensimit, sipas pikes 1 te ketij **VENDIMI** dhe deri ne 10 per qind te subvencionit, sipas paragrafit te pare te pikes 2 te ketij **VENDIMI**. Kur kerkohen masa te veçanta dhe shpenzime shtese, qe punedhenesi detyrohet t'i kryeje per pergatitjen profesionale, ai ka te drejte te kerkoje ndihme dhe subvencion per keto shpenzime nga zyra kompetente e punesimit. Subvencioni ne asnje rast, nuk duhet ta kaloje masen 75 per qind te kostos se pergjithshme.
4. Kur personat e punesuar jane perfitues te programit te pageses se papunesise, punedhenesi perfiton shtesa ne mase proporcionale me numrin e muajve te pageses se papunesise qe shkurtohen.
Per rastet e parashikuara ne piken 1 te ketij **VENDIMI**, kompensimi mujor per page rritet ne masen 3 per qind per çdo muaj pagese papunesie qe shkurtohet. Per rastet e parashikuara ne paragrafin e pare te pikes 2 te ketij **VENDIMI** perfitohet shtese e subvencionit ne masen 25 per qind te shumes se mbetur, per t'u paguar si pagese papunesie.
5. Ne rastin kur personat e trajtuar jane pjesetare nga familje ne ndihme ekonomike, punedhenesi perfiton shtesa ne mase proporcionale me ndihmen ekonomike, qe familja ka perfitur ne vitin e fundit kalendarik.
Per rastet e parashikuara ne piken 1 te ketij **VENDIMI**, kompensimi mujor per page rritet ne masen 2 per qind per çdo muaj ndihme ekonomike te plote dhe 1 per qind per çdo muaj ndihme ekonomike te pjesshme. Per rastet e parashikuara ne paragrafin e pare te pikes 2 te ketij **VENDIMI**, perfitohet shtese subvencioni ne masen 10 per qind te shumes se paguar per ndihme ekonomike.
6. Fondet e pageses se papunesise, te kursyera nga zbatimi i ketij programi transferohen ne masen 100 per qind ne buxhetin e tij.
7. Ky program perfiton transferime nga buxheti i ndihmes ekonomike ne mase proporcionale me kursimet e fondeve, qe i sjell ketij buxheti.
Per çdo anetar te familjes qe perfiton ndihme ekonomike, i cili punesohet sipas pikes 1 te ketij

VENDIMI, sasia e fondeve qe transferohen eshte ne masen 30 per qind te ndihmes ekonomike te plote per nje familje me 4 persona, ne nje periudhe te barabarte me kohen e punesimit. Ne rastin e paragrafit te pare te pikes 2 te ketij **VENDIMI**, per çdo person qe punesohet, transferohet nje fond i barabarte me 30 per qind te shpenzimeve, qe programi i ndihmes ekonomike ka bere per familjen e personit gjate vitit te fundit kalendarik.

8. Zbatimi i programit behet nga Sherbimi Kombetar i Punesimit.

Ministria e Punes dhe çeshtjeve Sociale percakton kriteret te detajuara per rastet, si dhe masen e perfitimit nga ky program dhe mbikeqyr zbatimin e tij.

9. Kostoja e ketij programi mbulohet nga fondet e buxhetit te shtetit per nxitjen e punesimit.

Ky **VENDIM** hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.70, date 11.2.1999

PER EVIDENTIMIN E PUNEKERKUESVE TE PAPUNE

Ne mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të **LIGJ**it nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës së Republikës të Shqipërisë" dhe **LIGJ**it nr.7995, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit", me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Personat, që për shkak të papunesisë ose të varferisë, kërkojnë të përfitojnë nga programet shtetërore të mbështetjes në të ardhura, duhet që në çdo rast, të vertetojnë nga zyra kompetente e punësimit për gjendjen e tyre si të papunë.
 2. Zyra kompetente e punësimit verteton të qenit i punësuar, i papunë ose punëkërkuar i papunë për vetë personin ose organizmin shtetëror, të interesuar për këtë.
 3. Sherbimi Kombëtar i Punësimit nxjerr dhe pajis me librezë personale punësimi të tere punëmarresit, kliente të zyrave të punësimit dhe që e pranojnë një gjë të tillë. Në librezën e punësimit shënohen nga punëdhënësi dhe nga zyra kompetente e punësimit marrëdhëniet e punës së mbajtesit të librezës që nga çasti i leshimit të saj. Zyra kompetente e punësimit shënon në librezë profesionet, specializimet, kurset e kualifikimit dhe të dhëna të tjera, që kanë të bëjnë me formimin dhe aftësitë profesionale. Librezë qëndron e depozituar të punëdhënësi gjatë tere periudhës që vazhdojnë marrëdhëniet e punës. Inspektorati Shtetëror i Punës vlerëson si punësim të pa**LIGJ**shëm çdo rast punësimi, për të cilin nuk është depozituar nga punëdhënësi librezë e rregullt e punësimit. Librezat e punësimit kanë numer serie dhe elemente sigurie. Një personi i jepet vetëm një librezë punësimi. Publikatat për humbjen e origjinalit, dypunësim ose për arsye të tjera të pranueshme shënohen në regjistrë dhe janë të ndryshme, në formë nga origjinali.
 4. Zyra kompetente e punësimit vlerëson dhe regjistron si të papunë çdo person i cili paraqitet pranë saj, deklaron se nuk është në marrëdhënie pune, nuk është i vetëpunësuar dhe që depoziton pranë saj librezën e punësimit.
 5. Zyra kompetente e punësimit vlerëson dhe regjistron si punëkërkuar të papunë çdo person të papunë, i cili kërkon pune dhe është i gatshëm të paraqitet sa herë që i kërkohet një gjë e tillë. Një pretendues mund të vlerësohet si punëkërkuar i papunë të paktën një muaj kalendarik pas ditës së paraqitjes së tij të parë në zyrën kompetente të punësimit për këtë qëllim.
 6. Sherbimi Kombëtar i Punësimit nxjerr dhe pajis me kartë personale papunesie të tere personat që pranojnë një gjë të tillë. Në kartën e papunesisë bëhet vertetimi nga zyra kompetente e punësimit e të qenit punëkërkuar i papunë i mbajtesit të kartës. Pajisja me kartë papunesie bëhet kundrejt depozitimit në zyrën kompetente të punësimit të librezës së punësimit dhe anasjelltas. Kartë e papunesisë përmban numer serie dhe ka elemente sigurie. Një personi i jepet vetëm një kartë papunesie. Publikatat për humbjen e origjinalit ose për arsye të tjera të pranueshme shënohen në regjistrë dhe janë të ndryshme në formë nga origjinali.
 7. Personat, të cilët kundërshtojnë vendet pune apo pjesëmarrje në programe të tjera shtetërore, të ofruara nga zyra perkatese e punësimit, hiqen nga lista e punëkërkuarëve të papunë.
 8. Ngarkohet Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale të nxjerrë **UDHEZIM**et në zbatim të këtij **VENDIM**i.
 9. Ngarkohen Sherbimi Kombëtar i Punësimit dhe Inspektorati shtetëror i Punës për zbatimin e këtij **VENDIM**i.
- Ky **VENDIM** hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.71, DATE 11.2.1999

PER MENYREN E LICENCIMIT DHE TE FUNKSIONIMIT TE AGJENCIVE PRIVATE TE PUNESIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të nenit 19 të **LIGJ**it nr.7691, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës së Republikës të Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Lejimin e veprimtarisë së Agjencive Private të Punësimit (në vazhdim APP).
2. APP-ja funksionon si person fizik ose juridik, privat, që ofron shërbimet e tregut të punës.
3. APP-ja siguron:
 - shërbime, që bëjnë vlerësimin e kërkesave dhe të aplikimeve për punësim, brenda dhe jashtë shtetit;
 - shërbime, që lidhen me kërkimin e punës
 - shërbime për punësimin e punëtorëve, për t'u bërë të disponueshëm për një palë të tretë, person fizik ose juridik, i cili cakton detyra dhe kontrollon zbatimin e tyre.
4. Në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale ngrihet komisioni i licencimit, i përbërë nga:
 - Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale (kryetar)
 - Inspektori i Përgjithshëm i ISHP-së (anëtar)
 - Drejtori i Përgjithshëm i SHKP-së (anëtar)
 - Drejtori i Drejtorisë së Emigraiconit (anëtar)
 - specialist, jurist (anëtar)
5. Komisioni i licencimit, pasi bën vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur prej subjekteve të interesuara, vendos licencimin ose jo të tyre.
6. Dokumentet e nevojshme, që duhet të paraqiten për licencim, janë:
 - Kërkesë me shkrim për licencim.
 - Pasaportë (fotokopje e noterizuar), 4 copë fotografi dhe, për personat juridikë, akti regjistrimit në gjykatë.
 - Dëshmi penaliteti.
 - Përshkrimi i veprimtarisë së personit juridik.
 - Përshkrimi i degëve të ekonomisë ose veprimtarive ekonomike, ku synon të zhvillohet veprimtaria e APP-së.
7. Për marrjen e licencës paguhet një tarifë prej 150 000 (njëqindpesëdhjetë mijë) lekë.
8. Komisioni i licencimit mund të mos pranojë licencimin e APP-së për kategori të caktuara punëtorësh ose degë të ndryshme të veprimtarisë ekonomike, me **VENDIM** të argumentuar, në bazë të rrethanave specifike që mund të krijohen ose në mbrojtje të interesave të punëtorëve.
9. Kundër **VENDIM**it të mospranimit mund të bëhet ankim në gjykatë.
10. APP-ja duhet të sigurojë trajtim të barabartë për të gjithë punëtorët, pa dallime raciale, seksi, besimi fetar, pikëpamjeje politike.
11. APP-ja nuk mund të ofrojë shërbimet e veta për të miturit.
12. Punëtorët e rekrutuar nga APP-ja gëzojnë të drejta për negociim kolektiv, lirinë e asocimit, pagën minimale, kohën dhe kushtet e punës, përfitimet e sigurimeve

shoqërore, mbrojtjen e sigurisë dhe të shëndetit në punë.

13. APP-ja duhet të njoftojë punëtorët për kushtet e punës përpara fillimit të punës.

14. Përpunimi i të dhënave të punëtorëve nga APP-ja bëhet duke respektuar konfidencialitetin dhe përdorimin e të dhënave, sipas natyrës së punës.

15. APP-ja, për punësimet jashtë shtetit të shtetasve shqiptarë, zbaton të gjitha marrëveshjet dypalëshe të Qeverisë Shqiptare me vendet përkatëse.

16. APP-ja, një herë në vit, njofton Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale për strukturën dhe veprimtarinë e saj.

17. APP-ja duhet të shkëmbejë, rregullisht, informacione me Agjencitë Publike të Punësimit.

18. Komisioni i licencimit kur vëren:

- shkelje të parimit të barazisë;

- mospërbushje të detyrimeve për sigurimet shoqërore, kontratat e punës, negocimet kolektive, sigurimin dhe mbrojtjen në punë, kompensimin në raste aksidenti ose sëmundjeje;

- publike të përsëritura mashtruese,

me kërkesë të Inspektoratit Shtetëror të Punës, organizatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve, si dhe të subjekteve të tjera të interesuara, mund të ndalojë veprimtarinë e APP-së.

19. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale për të nxjerrë **UDHËZIM**in përkatës për përcaktimin e tarifave të shërbimeve të ofruara nga APP-ja.

20. **VENDIMI** i Këshillit të Ministrave nr.606, datë 30.10.1995 "Për dhënien e lejes për ndërmjetësimin për punësim dhe kualifikim, nëpërmjet punësimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të shtetasve shqiptarë" shfuqizohet.

21. Ngarkohet Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale të nxjerrë **UDHËZIM**in në zbatim të këtij **VENDIMI**.

Ky **VENDIM** hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E M I N I S T R I
PANDELI MAJKO

V E N D I M

Nr.73, date 11.2.1999

PER PROGRAMIN E NXITJES SE PUNESIMIT NEPERMJET FORMIMIT NE PUNE

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes se Republikes te Shqiperise dhe te **LIGJit** nr.7995, date 20.9.1995 "Per nxitjen e punesimit", me propozimin e Ministrise se Punes dhe ç eshtjeve Sociale, Keshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Punedhenesit, qe angazhojne per qellim formimin nepermjet punes te personave punekerkes te papune, mund te perfitojne financime nga zyra kompetente e punesimit, me kusht qe ne perfundim te periudhes se formimit te punesojne, me kontrate te rregullt, me kohezgjatje te pakten nje ç are, ne pjese te te trajnuarve. Pjesemarresit ne formim duhet te jene persona profesionalisht te pakualifikuar per proceset e punes, per te cilat do te formohen. Kohezgjatja e programit mund te jete deri ne 9 muaj. Financimi perfshin kompensimin e kostove per sigurime te detyrueshme deri ne masen 100 per qind. Kompensimi i pages behet deri ne masen e pages minimale ne shkalle vendi. Numri i personave qe punesohen te jete te pakten 40 per qind e numrit te pergjithshem te pjesemarresve ne formim.
2. Per ç do te punesuar mbi numrin e fiksuar ne marreveshje, punedhenesi merr nje shperblim te barabarte me shumen e pages minimale ne shkalle vendi dhe shpenzimet per sigurimet e detyrueshme per nje periudhe deri 3-mujore.
3. Personat punekerkes te papune, qe kundershtojne oferten e zyres kompetente te punesimit, per pjesemarrjen ne formim, si me siper, hiqen nga lista e punekerkesve te papune.
4. Fondet e programit te pageses se papunesise, te kursyer nga zbatimi i ketij programi, transferohen, ne masen 100 per qind, ne buxhetin e ketij programi.
5. Per ç do person te trajtuar nga ky program, qe eshte pjesetar i nje familjeje ne ndihme ekonomike, buxheti i ketij programi perfiton transferime nga buxheti i ndihmes ekonomike ne masen 40 per qind te ndihmes se plote per nje familje me 4 persona, per ç do muaj trajtim.
6. Ngarkohet Sherbimi Kombetar i Punesimit per zbatimin e ketij programi.
Ngarkohet Ministria e Punes dhe ç eshtjeve Sociale te percaktoje kriteret e detajuara dhe te mbikeqyre zbatimin e ketij programi dhe te ketij **VENDIMI**.
7. Kostoja e ketij programi mbulohet nga fonde te buxhetit te shtetit per nxitjen e punesimit.
Ky **VENDIM** hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.74, date 11.2.1999

PER PROGRAMIN E NXITJES SE PUNESIMIT, NEPERMJET MBESHTETJES SE FORMIMIT INSTITUCIONAL

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes se Republikes te Shqiperise dhe te **LIGJit** nr.7995, date 20.9.1995 "Per nxitjen e punesimit", me propozimin e Ministrise se Punes dhe çeshtjeve Sociale, Keshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Subjektet, qe ofrojne kurse formimi institucional, ne perfundim te te cilave garantohet punesimi i te pakten te 20 per qind te pjesemarresve, kane te drejte te kerkojne nga zyra kompetente e punesimit sigurimin e numrit te duhur te kursanteve per shfrytezimin e kapacitetit te plote te kursit. Tarifat per kursantet e siguruar ne kete menyre paguhen nga zyra kompetente e punesimit.

Per çdo te punesuar mbi numrin e caktuar, subjekti perfiton nje shperblim shtese deri ne tre paga minimale ne shkalle vendi. Kushti i punesimit quhet i plotesuar, kur ai realizohet me kontrate te rregullt per nje periudhe, te pakten, njevjeçare dhe sipas profesionit per te cilin u trajnuar.

2. Subjektet, qe ofrojne kurse formimi institucional per puneckerkues te papune nga lista e zyres kompetente te punesimit, kane te drejte te kerkojne nga kjo zyre mbulimin e nje pjese te kosos se trajnimit per çdo pjesemarrës ne kurs.

Ne keto raste, subjektet duhet te argumentojne, nepermjet studimit dhe te analizes se tregut te punes, dobine social-ekonomike qe sjell zhvillimi i kursit. Financimi behet kur, te pakten, 60 per qind e kursanteve jane puneckerkues te papune dhe, ne asnje rast, nuk mbulon me shume se 60 per qind te kosos se pergjithshme te kursit.

3. Vleresimi i ofertave dhe i studimeve, sipas pikes 1 dhe 2 te ketij **VENDIMI**, behet ne perputhje me kriteret e shpallura me pare. Perparesi u jepet kurseve te formimit per profesionet e percaktuara si paresore ne politikat shteterore te punesimit dhe te formimit profesional dhe qe realizojne punesimin maksimal te mundshem.

4. Kursantet, puneckerkues te papune, perfitojne pagese pjesemarrjeje ne kurs. Per perfituesit e programeve shteterore te mbeshtetjes me te ardhura pagesa shkon deri ne nivelin e pages minimale ne shkalle vendi. Per kategorite e tjera te puneckerkuesve pagesa shkon deri ne masen 75 per qind te pages minimale.

5. Personat, qe kundershtojne te marrin pjese ne keto kurse, hiqen nga lista e puneckerkuesve te papune.

6. Fondet e pageses se papunesise, te kursyera nga zbatimi i ketij programi, transferohen ne masen 100 per qind ne buxhetin e shtetit.

7. Per çdo anetar nga familje qe trajtohet me ndihme ekonomike, buxheti i ketij programi perfiton transferime nga buxheti i ndihmes ekonomike ne masen 50 per qind te ndihmes ekonomike te plote per nje familje me 4 persona, per nje periudhe te barabarte me periudhen e pjesemarrjes ne kurs.

8. Zbatimi i programit behet nga Sherbimi Kombetar i Punesimit.

Ngarkohet Ministria e Punes dhe çeshtjeve Sociale te percaktoje kriteret e detajuara per rastet, si dhe masen e perfitimit nga ky program, dhe mbikeqyr zbatimin e ketij **VENDIMI**.

9. Kostoja e ketij programi mbulohet nga fondet e buxhetit te shtetit per nxitjen e punesimit. Ky **VENDIM** hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

L I G J

Nr.8444, DATE 21.1.1999

PER DISA SHTESA E NDRYSHIME NE **LIGJIN** NR.7995,
DATE 20.9.1995 "PER NXITJEN E PUNESIMIT"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I

I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

Në **LIGJ**in nr.7995, datë 20.9.1995 bëhen këto ndryshime:

NENI 1

Në nenin 2 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
"20. Me termin "grupe të veçanta" nënkuptohen punëkërkuessit:
nëna me shumë
fëmijë, persona me moshë mbi 50 vjeç, të rinj nën 18 vjeç, të
papunë afatgjatë dhe
persona nga familje nën nivelin e varfërisë."

NENI 2

Neni 8 ndryshohet si vijon:

"Mbajtja e vendeve ekzistuese dhe krijimi i vendeve të reja
të punës:

1. Shteti mbështet punëdhënësit që krijojnë dhe mbajnë vende
të reja pune dhe
punësojnë në to kandidatë të ofruar nga zyrat e punësimit.

Mbështetja shtetërore
realizohet nëpërmjet:

a) subvencionimit, në përqindje të caktuar, të kostove për
sigurimet e detyrueshme
dhe të pagës;

b) subvencionimit apo kreditimit për pajisjen e vendit të
punës. Punësimi për
personat me arsim universitar dhe nga grupe të veçanta nxitet me
përparësi.

2. Zyrat e punësimit ndjekin situatat e falimentimeve dhe
të pushimeve masive nga
puna. Çdo punëdhënës ka të drejtë të kërkojë mbështetje në rast
vështirësish, të

krijaura nga forca madhore, të cilat e shpien atë në falimentim
ose pushime masive nga puna.

3. Masat, afatet dhe kriteret, sipas të cilave punëdhënësit

përfitojnë mbështetje për rastet e mësipërme, vendosen nga Këshilli i Ministrave."

NENI 3

Neni 11 ndryshohet si vijon:

"Formimi profesional

1. Formimi profesional u shërben si punëkërkesve edhe punëdhënësve dhe realizohet nëpërmjet kurseve të mësimi teoriko- praktik dhe pjesëmarrjes në procese të posaçme pune.
2. Shteti mbështet krijimin e kapaciteteve për formimin profesional, në sasi dhe cilësi, nëpërmjet:
 - a) zhvillimit të sistemit të qendrave shtetërore të formimit profesional;
 - b) nxitjes, mbështetjes, bashkëpunimit me subjektet joshetërore të interesuara dhe punëdhënësit.
3. Çdo punëdhënës mund të kërkojë nga zyra kompetente e punësimit që të financohet, të subvencionohet apo të kreditohet, për të siguruar formimin profesional të punëmarrësit apo të kandidatëve për punësim. Punëdhënësi ka, gjithashtu, të drejtë të kërkojë mbështetje për të krijuar në mjediset e ndërmarrjes së tij kurse formimi nëpërmjet punës, për qëllime të veta ose fitimi.
4. Zyrat e punësimit mbështesin kurset e formimit profesional nëpërmjet punës në ndërmarrjet që kanë mundësi potenciale për të rritur numrin e të punësuarve ose që ofrojnë formimin për profesione të kërkuara në tregun e punës.
5. Qendrat shtetërore të formimit profesional administrohen nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe ofrojnë:
 - a. kurse pa pagesë për punëkërkes të papunë që trajtohen nga zyrat e punësimit;
 - b. kurse me pagesë për persona që e kërkojnë një gjë të tillë;ç
 - c. mjedise dhe mjete logjistike kundrejt qirasë për subjekte që ushtrojnë formimin profesional.
6. Kriteret, sipas të cilave Shërbimi Kombëtar i Punësimit zbaton programet shtetërore në zbatim të dispozitave të mësipërme, vendosen nga Këshilli i Ministrave."

NENI 4

Në nenin 12 bëhen këto ndryshime:

- Titulli i nenit 12 "Fondi për formim" ndryshohet dhe zëvendësohet me fjalët

"Pagesa e pjesëmarrjes në kurs".

Në pikën 1 fjalët "një fond përgatitjeje" ndryshohen dhe zëvendësohen me fjalët

"pagesë për pjesëmarrje në kurs".

NENI 5

Në nenin 20 pika 3 në paragrafin B fjala "mbështetje" zëvendësohet me fjalën "subvencion".

NENI 6

Ky **LIGJ** hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2303, datë 1.2.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani

L I G J

Nr.8394, DATE 2.9.1998

PER DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NE **LIGJIN** NR.7986, DATE 13.9.1995 "PER INSPEKTORATIN SHTETEROR TE PUNES"

Në mbështetje të nenit 16 të **LIGJ**it nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

Në **LIGJ**in nr.7986, datë 13.9.1995 "Për Inspektoratin Shtetëror të Punës" bëhen këto shtesa e ndryshime:

NENI 1

Pikat 2 dhe 3 të nenit 2 ndryshohen si më poshtë:

- Me termin "ministër" kuptohet ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale.
- Me termin "ministri" kuptohet Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale.

NENI 2

Neni 6 ndryshohet si vijon:

"Inspektorati Shtetëror i Punës hyn në marrëdhënie dhe zhvillon një bashkëpunim efektiv me:

- a) ministrinë dhe inspektoratet e varura prej tyre;
- b) Insitutin e Shëndetit Publik, përsa i takon higjienës industriale;
- c) shërbime të tjera dhe institucione që kryejnë veprimtari të ngjashme;
- ç) organet e policisë;
- d) gjithë punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Mënyrat dhe format e bashkëpunimit me institucionet dhe organizatat e lartpërmendura rregullohen me **VENDIM** të Këshillit të Ministrave ose me marrëveshje dypalëshe.

NENI 3

Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:

- a) Në shkronjën "b" të pikës 1 pas fjalës "anketimi", shtohen fjalët "apo fotografimi".
- b) Në fund të pikës 1, pas paragrafit të katërt, shtohet paragrafi i pestë si vijon:
"v) të kërkojë identitetin e punëmarrësit."

NENI 4

Në nenin 17, në rreshtin e dytë dhe të tretë hiqen fjalët "të nxjerrë nga inspektori i Përgjithshëm".

NENI 5

Në nenin 25, pika 2 dhe 3 shfuqizohen.

NENI 6

Në nenin 26 bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet si vijon:

"Kundërshtimi dhe pengimi i inspektorëve në ushtrimin e detyrës dënohet me gjobë nga 1 000 deri në 50 000 lekë. Kur shkeljet përbëjnë vepër penale, zbatohen dispozitat e Kodit Penal."

b) Pika 2 shfuqizohet.

NENI 7

Pas nenit 26 shtohet neni 26/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 26/1

Pranë Inspektoratit Shtetëror të Punës, me urdhër të ministrit, krijohet Komisioni i Apelimit të Gjobave dhe të **VENDIM**eve, i përbërë nga tre anëtarë."

NENI 8

Neni 27 ndryshohet si vijon:

"Kundër **VENDIM**eve të inspektorëve për gjoba deri në 5 000 lekë, bëhet ankim pranë inspektorit të Përgjithshëm, brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të tyre.

Kundër **VENDIM**it të inspektorit të Përgjithshëm për ankimet për gjobat mbi 5 000 lekë, bëhet ankim në Komisionin e Apelimit të Gjobave dhe të **VENDIM**eve, brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të tij.

Kundër **VENDIM**it të inspektorit të Përgjithshëm dhe Komisionit të Apelimit të

Gjobave dhe të **VENDIM**eve bëhet ankim në gjykatë brenda 10 ditëve nga dita e dhënies së **VENDIM**it."

NENI 9

Ky **LIGJ** hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.2213, datë 15.9.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani

V E N D I M

Nr.357, datë 25.3.1996

PER RREGULLIMIN E KOHES SE PUNES DHE TE PUSHIMIT NE INSTITUCIONET E SPEKTAKLIT

Në zbatim të **LIGJ**it nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe të Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Për personelin artistik të teatrove të përhershëm puna nuk duhet të fillojë para orës 9.00 dhe as të vazhdojë pas orës 2400.

Punonjësit duhet të kenë një pushim ditor të paktën 10 orë pa ndërprerje.

Pushimi ditor mund të reduktohet në raste të rralla në 9 orë, me kusht që si mesatare e llogaritur për një javë të mos jetë më pak se 10 orë.

Punëdhënësi mund të urdhërojë kryerjen e orëve shtesë. Numri i këtyre orëve shtesë nuk mund të kapërcejë 220 orë në vit për çdo punonjës. Punëdhënësi duhet t'i kompensojë këto orë me një shtesë page 25 për qind ose me pushime të së njëjtës kohëzgjatje

a) brenda 10 javëve që nga kryerja e orëve shtesë;

b) me pëlqimin e punonjësit të zgjatë pushimet vjetore.

Puna e ditës së kryer në kufijtë e parashikuar më sipër duhet të ndërpritet nga pushimet të një kohëzgjatjeje 6 orë gjithsej.

Një pushim të paktën 4 orë pa ndërprerje duhet të shoqërojë gjithmonë një shfaqje. Megjithatë lejohet të shkelet ky rregull në raste të rralla, ose gjatë turneve apo kur disa shfaqje paraqiten në të njëjtën ditë.

Punëdhënësi ka të drejtë të urdhërojë punën natën ose të dielave. Konsiderohet natë intervali i kohës ndërmjet orës 2400 dhe 900.

Puna e të dielave duhet të kufizohet në dhënien e shfaqjeve.

Në raste të rralla mund të mos zbatohet ky rregull. Kjo punë duhet kompensuar me një pushim të paktën 24 orësh pa ndërprerje.

Në rast nevoje urgjente ditët e pushimit mund të shpërndahen gjatë gjithë sezonit teatral.

2. Për personelin teknik e komercial të teatrove të përhershëm puna e ditës nuk mund të fillojë para orës 700 dhe as të vazhdojë pas orës 2400. Ajo duhet të përfshihet, me gjithë pushimet, në një interval kohor prej 15 orësh.

Punëmarrësit duhet të kenë një pushim nate të paktën 9 orë pa ndërprerje. Ky pushim nate mund të reduktohet në 8 orë, me kusht që si mesatare e llogaritur në një javë të jetë 9 orë.

Punëdhënësi mund të urdhërojë kryerjen e orëve shtesë. Numri i këtyre orëve nuk duhet të kapërcejë 220 orë në vit për çdo

punëmarrës. Punëdhënësi duhet të kompensojë këto orë me një shtesë page 25 për qind ose me pushime të së njëjtës kohëzgjatjeje:

- a) brenda 10 javëve që nga kryerja e orëve shtesë;
- b) me pëlqimin e punonjësit të zgjatë pushimet vjetore.

Punëdhënësi ka të drejtë të urdhërojë punën natën ose të dielave. Konsiderohet natë intervali i kohës ndërmjet orës 2400 dhe 700. Punëmarrësi duhet të ketë të paktën 6 të diela pushim në vit.

3. Në ndërmarrjet kinematografike puna e ditës nuk mund të fillojë para orës 800 dhe as të vazhdojë pas orës 2400. Ajo duhet të përfshihet, me gjithë pushimet, në një interval kohe prej 14 orësh.

Në raste të rralla punëmarrësit mund të mbahen në punë deri në orën 130, nëse një gjë e tillë është e nevojshme për të përgatitur dërgimin e një filmi apo prezantimin e tij në një rreth privat. Në këtë rast jepet një shtesë page prej 25 për qind.

Ai mund të urdhërojë punën të dielën.

Punëmarrësit duhet të kenë çdo javë një pushim javor 24-orësh pa ndërprerje pas pushimit të natës. Ky pushim javor duhet të qëllojë të dielën të paktën 12 herë në vit.

4. Në cirqet kohëzgjatja javore maksimale e punës është 54 orë për periudhën nga 13 marsi gjer në 30 nëntor dhe 42 orë për pjesën tjetër të vitit.

Puna e ditës nuk mund të fillojë para orës 500 dhe as të vazhdojë pas orës 2330.

Gjatë periudhës 15 mars-30 nëntor punëdhënësi mund të urdhërojë kryerjen e orëve shtesë, në rast se një gjë e tillë bëhet e domosdoshme për të përballuar një rritje të pazakontë të vëllimit të punës, veçanërisht në rastet e zhvendosjeve të vazhdueshme.

Orët shtesë nuk mund të kapërcejnë 6 orë në javë, me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme. Ato duhet të kompensohen me një pushim të së njëjtës kohëzgjatje brenda 8 javëve.

Punëdhënësi ka të drejtë të urdhërojë kryerjen e punës të dielave ose natën (konsiderohet natë koha ndërmjet orës 2300 dhe 500), kur një gjë e tillë është e domosdoshme për të kryer transporte, montime e ç'montime.

Punëmarrësit nuk mund të mbahen në punë nate, veçse me pëlqimin e tyre. Në këtë rast jepet një shtesë page prej 50 për qind.

Punëmarrësit duhet të kenë çdo javë, pas një pushimi nate, një pushim javor, i cili, për periudhën nga 15 marsi deri më 30 nëntor, do të jetë 12 orë pa ndërprerje, kurse për pjesën tjetër të vitit të paktën 36 orë pa ndërprerje. Ky pushim duhet të qëllojë të dielën, të paktën 12 herë në vit.

5. Në institucionet dhe ndërmarrjet e tjera të spektaklit kohëzgjatja javore maksimale e punës është 54 orë për periudhën nga 1 marsi gjer më 30 nëntor dhe 42 orë për pjesën tjetër të vitit.

Puna e ditës nuk mund të fillojë para orës 500 për periudhën

nga 1 marsi gjer më 30 nëntor dhe as para orës 600 për pjesën tjetër të vitit. Ajo nuk mund të zgjatet pas orës 24.00.

Punëdhënësi ka të drejtë të urdhërojë punën natën (konsiderohet natë, për periudhën nga 1 marsi gjer më 30 nëntor, koha ndërmjet orës 00 dhe 500 dhe për pjesën tjetër të vitit koha ndërmjet orës 00 e 600), kur një gjë e tillë është e nevojshme për të kryer transporte, montime e çmontime ose në raste festash dhe të dielave. Punëmarrësit duhet të japin pëlqimin e tyre për të pranuar natën. Në këtë rast jepet një shtesë page prej 50 për qind. Punëmarrësit duhet të kenë çdo javë pas pushimit të natës një pushim javor, i cili do të jetë, për periudhën 1 mars-30 nëntor 12 orë pa ndërprerje dhe për pjesën tjetër 36 orë pa ndërprerje. Ky pushim javor duhet të qëllojë të dielën, të paktën 12 herë në vit.

6. Në gjithë sektorët e mësipërm puna duhet të ndërpritet nga pushime minimumi:

15 minuta, nëse dita e punës zgjat më shumë se 5 orë e 30 minuta;

30 minuta, nëse dita e punës zgjat më shumë se 7 orë dhe 60 minuta nëse dita e punës zgjat më shumë se 9 orë.

Pushimet llogariten si kohë pune, në rastin kur punëmarrësi nuk është i autorizuar të largohet nga vendi i punës gjatë këtyre pushimeve.

Ky **VENDIM** hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE

Aleksandër Meksi

V E N D I M

Nr.358, datë 25.3.1996

PER RREGULLIMIN E KOHES SE PUNES DHE TE PUSHIMIT PER SHTYPIN E SHKRUAR DHE TE FOLUR

Në zbatim të **LIGJIT** nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Në redaksinë e gazetave periodike, në agjencitë fotografike ose të lajmeve punëdhënësi ka të drejtë të urdhërojë të punuarit natën a të dielën.

Nëse puna e së dielës ka një kohështrirje nga mëngjesi deri pasdreke ose zgjat mbi 5 orë, punëdhënësi duhet ta kompensojë javën pasardhëse apo atë paraardhëse, me një pushim prej të paktën 24 orësh pa ndërprerje, i cili duhet të korrespondojë me një ditë pune.

Redaktorët sportivë duhet të kenë të paktën një të diel pushim çdo 4 javë. Për punëmarrësit e tjerë jepen 2 të diela pushim çdo 4 javë.

2. Puna në radio dhe në televizion mund të fillojë në orën 530 dhe të vazhdojë deri në orën 2400, kur shfrytëzimi i pajisjeve e kërkon një gjë të tillë.

Puna e ditës, me gjithë pushimet, duhet të përfshihet në një interval prej 14 orësh.

Punëmarrësit duhet të kenë një pushim nate prej të paktën 10 orësh pa ndërprerje. Ky pushim mund të reduktohet, në raste të rralla, në 8 orë për disa punëmarrës ose disa kategori punëmarrësish:

a) kur shfrytëzimi i pajisjeve kërkon një gjë të tillë me kusht që ky reduktim të mos përsëritet më tepër se 2 herë radhazi dhe që kohëzgjatja mesatare e pushimit të natës të llogaritur për një javë të jetë të paktën 10 orë.

b) me qëllim që pushimi javor të bëhet 36 orë pa ndërprerje kjo mund të bëhet vetëm një herë në javë.

Punëdhënësi mund të kërkojë bërjen e orëve shtesë deri në 220 orë në vit për çdo punëmarrës. Në këtë rast paguhet një shtesë page prej 25 për qind. Kjo shtesë nuk jepet, kur orët shtesë janë kompensuar brenda vitit me një pushim të së njëjtës kohëzgjatje.

Punëdhënësi ka të drejtë të urdhërojë të punuarit natën a të dielave përkohësisht, por jo në mënyrë periodike. Për punën e kryer natën jepet një shtesë page prej 50 për qind dhe për punën e kryer të dielave jepet një shtesë page prej 25 për qind. Punëmarrësi duhet të ketë të paktën një të diel pushim çdo 3 javë.

3. Në gjithë sektorët e mësipërm puna duhet të ndërpritet

nga pushime minimumi:

15 minuta, nëse dita e punës zgjat më shumë se 5 orë e 30 minuta.

30 minuta, nëse dita e punës zgjat më shumë se 7 orë dhe 60 minuta, nëse dita e punës zgjat më shumë se 9 orë.

Pushimet llogariten si kohë pune, në rastin kur punëmarrësi nuk është i autorizuar të largohet nga vendi i punës gjatë këtyre pushimeve.

Ky **VENDIM** hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE

Aleksandër Mexsi

V E N D I M

Nr.359, datë 25.3.1996

PER RREGULLIMIN E KOHES SE PUNES DHE PUSHIMIT TE ROJAVE DHE PUNONJESVE TE TJERE TE CILET PERMBUSHIN FUNKSIONE TE NGJASHME ME TA

Në zbatim të **LIGJ**it nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Brendshme dhe të Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Personeli rojë përfshin rojat e natës, portierët dhe punonjës të tjerë që përmbushin funksione të ngjashme me ta dhe kur koha e punës së tyre konsiston, në një masë të madhe, në qenien thjesht të pranishëm.

Kohëzgjatja maksimale javore e punës është 60 orë si mesatare në 2 javë. Kjo kohëzgjatje nuk mund t'i kapërcejë 66 orët.

Pushimi ditor duhet të zgjasë të paktën 12 orë si mesatare për 2 javë, por të paktën 9 orë në një interval 24-orësh.

Pushimet nuk duhet të ndahen. Pushimi ditor mund të reduktohet, në raste të rralla, me pëlqimin e punëmarrësit:

- a) kur shfrytëzimi e kërkon urgjentisht një gjë të tillë;
- b) një herë në javë, me qëllim që pushimi javor të bëhet të paktën 36 orë pa ndërprerje.

Punëdhënësi ka të drejtë të urdhërojë kryerjen e orëve shtesë.

Maksimumi i orëve shtesë duhet të jetë 2 orë në ditë dhe 90 orë në vit për çdo punëmarrës.

Punëdhënësi ka të drejtë të urdhërojë, në raste të jashtëzakonshme joperiodike, të punuarit natën. Në këtë rast jepet një shtesë page prej 25 për qind.

Rojat e natës, që punojnë të dielave e për pasojë kapërcejnë kohëzgjatjen maksimale javore të punës, duhet të kenë, në javën paraardhëse apo atë pasardhëse, një pushim kompensues të së njëjtës kohëzgjatje.

Pushimi javor duhet të përfshijë të paktën 20 të diela.

Ky **VENDIM** hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE

Aleksandër Meksi

V E N D I M

Nr.360, datë 25.3.1996

PER RREGULLIMIN E KOHES SE PUNES DHE TE PUSHIMIT NE NDERMARRJET E TRANSPORTIT AUTOMOBILISTIK, HEKURUDHOR, DENTAR DHE AJROR DHE NDERMARRJET QE MIREMBAJNE DHE RIPAROJNE MJETET E TRANSPORTIT

Në zbatim të **LIGJ**it nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës
i Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së
Industrisë, Transportit e Tregtisë dhe të Ministrisë së Punës,
Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve
Politikë, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Dispozitat e mëposhtme zbatohen vetëm ndaj personelit të
shfrytëzimit të ndërmarrjeve të transportit dhe atyre që
mirëmbajnë e riparojnë mjetet e transportit. Shërbimi i
shfrytëzimit përmbledh shërbime të ndërmarrjes që kanë për
detyrë:

a) të transportojë udhëtarë dhe të shesin bileta, të
pranojnë, magazinojnë dhe dërgojnë mallra e pako postare;
b) të ndërtojnë, mbikëqyrin e mirëmbajnë instalimet,
pajisjet dhe automjetet që i përkasin shërbimeve të përmendura
në pikën "a";

c) të kryejnë shërbime dytësore në mjetet e transportit, si
p.sh. në vagona-restorant, shërbimi në aviona etj.

Në një kohështrirje prej 28 ditësh kohëzgjatja ditore e
punës është 7 orë.

Në shërbimet ku koha e punës përmban më shumë se 2 orë
thjesht prezencë, kohëzgjatja ditore e punës mund të zgjatet 40
minuta.

Në asnjë rast kohëzgjatja e punës nuk mund të tejkalojë 10
orë për një turn shërbimi dhe as 9 orë si mesatare për 7 ditë
punë me orë të plota.

Në ndërmarrjet që kanë një periudhë trafiku të rëndësishëm,
kohëzgjatja ditore e punës mund të kapërcehet me një orë gjatë
6 muajve në vit, me kusht që të respektohet si mesatare 7-orëshi.
Kur kohëzgjatja e punës e fiksuar në tabelat e shërbimit
kapërcehet për arsye shërbimi, çdo shtesë konsiderohet si kohë
shtesë dhe kompensohet me një pushim të së njëjtës kohëzgjatjeje.
Kur ky kompensim nuk është i mundur, jepet një shtesë page
prej 25 për qind. Mund të paguhen maksimumi 100 orë shtesë në
vit.

Turni i shërbimit përbëhet nga koha e punës dhe pushimet.

Ai nuk mund të kapërcejë 12 orë, por në raste të rralla mund të
zgjatet deri në 13 orë.

Nga mesi i punës punëmarrësve duhet t'u jepet një pushim për
të ngrënë. Si rregull ky pushim duhet të jetë të paktën 1 orë.

Për çdo turn shërbimi punëmarrësve duhet t'u jepen të paktën
3 pushime nga 30 minuta secili.

Pushimi ditor është intervali ndërmjet dy turneve të shërbimit. Ky pushim ditor duhet të jetë të paktën 12 orë si mesatare në një kohështrirje prej 28 ditësh.

Të punuarit ndërmjet orës 2400 dhe orës 0400 konsiderohet punë nate.

Përveç punëmarrësve që punojnë vetëm natën, si dhe rasteve të rralla, kur duhen ndërmarrë punime konstruksioni natën, një punëmarrës nuk mund të detyrohet të punojë natën më shumë se 7 herë radhazi dhe as gjatë 15 ditëve në një periudhë 28-ditore. Punëmarrësi ka të drejtën e 62 ditëve pushim të paguar në vit. Këto ditë duhet të shpërndahen në mënyrë sa më harmonike gjatë gjithë vitit.

Ditët e pushimeve duhet të zgjaten të paktën 24 orë pa ndërprerje. Punëmarrësi ka të drejtë, çdo vit, të marrë 4 javë kalendarike pushime vjetore të paguara.

2. Me kohë pune të shoferëve profesionistë të automjeteve kuptohet koha, gjatë së cilës punëmarrësi qëndron në dispozicion të punëdhënësit, duke përfshirë kohën kur është thjesht i pranishëm, si dhe pushimet më të shkurtra se 15 minuta. Kur ekuipazhi përbëhet nga disa shoferë, në kohën e punës përfshihet edhe koha, gjatë së cilës punëmarrësi nuk drejton automjetin. Kjo pikë zbatohet vetëm ndaj shoferëve të këtyre automjeteve.

a) automjete për transportin e mallrave me një peshë totale të regjistruar në patentë prej më shumë se 3,5 tonësh;

b) automjete për transportin e personave që janë regjistruar me më shumë se 8 vende ulur, pa llogaritur vendin e shoferit.

Kur një shofer drejton një automjet, të regjistruar në Shqipëri, jashtë vendit, kjo pikë zbatohet për aq sa marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë nuk përmbajnë rregulla më të forta.

Kjo pikë nuk zbatohet ndaj shoferëve të automjeteve, të cilët:

a) qarkullojnë me një shpejtësi maksimale 30 km/orë;

b) i përkasin shërbimeve të policisë, zjarrfikësve, ushtrisë, shërbimeve komunale, të telekomit, postare, të radios dhe të televizionit;

c) transportojnë persona në linja të një gjatësie më pak se 50 km;

ç) përdoren në misione urgjente ose shpëtimi;

d) i përkasin shërbimeve të urgjencës mjekësore;

dh) transportojnë materiale për cirqe a panairt;

e) janë specializuar në dhënien e ndihmës teknike ose bërjen e provave teknike;

ë) përdoren për transporte jotregtare me qëllime krejtësisht private;

f) përdoren për mbledhjen dhe transportin e qumështit me bidona nga persona juridikë e fizikë.

Kohëzgjatja maksimale ditore e drejtimit të automjetit nuk duhet të kapërcejë 9 orë.

Dy herë në javë ajo mund të bëhet 10 orë.

Kohëzgjatja maksimale e drejtimit të automjetit për 2 javë nuk mund të kapërcejë 90 orët.

Shoferi i një automjeti të caktuar për transportin e mallrave duhet të respektojë një pushim javor, pas maksimumi 6 periudhash drejtim automjeti. Shoferi i një automjeti të caktuar për transportin e pasagjerëve duhet të respektojë këtë pushim javor pas maksimumi 12 periudha drejtimi.

Kohëzgjatja maksimale javore e punës është 46 orë. Kur automjeti drejtohet nga ekuipazh (dy a më shumë shoferë), të cilët zëvendësojnë gjatë udhëtimit njeri-tjetrin në drejtimin e automjetit të paktën 3 ditë gjatë javës, kohëzgjatja maksimale javore mund të arrijë në 53 orë.

Kohëzgjatja maksimale javore mund të kapërcehet me 5 orë shtesë.

5 orë të tjera shtesë në javë mund të lejohen gjatë periudhave, kur ndërmarrja duhet të përballojë përkohësisht një veprimtari intensive të një karakteri të jashtëzakonshëm.

Megjithatë totali i orëve shtesë nuk duhet të kapërcejë asnjëherë 208 orët në vit.

Orët shtesë duhet të kompensohen me një shtesë page prej 25 për qind, ose me një pushim të së njëjtës kohëzgjatje. Ky kompensim duhet të jepet brenda 3 muajve.

Pas 4 orë e 30 minuta drejtimi në timon, shoferi duhet të respektojë një pushim prej të paktën 45 minutash. Ky pushim mund të zëvendësohet nga pushime prej 15 minutash secili të shpërndara në kohën e drejtimit të automjetit.

Pas 5 orë e 30 minuta drejtimi në timon, punëmarrësi është i detyruar ta ndërpresë punën për të paktën 1 orë rresht.

Për çdo periudhë 24-orësh shoferi duhet të respektojë një pushim ditor prej 11 orësh pa ndërprerje. Ai mund ta reduktojë 3 herë në javë këtë pushim në 9 orë, me kusht që një pushim kompensues të jepet para fundit të javës pasardhëse. Për çdo periudhë 30-ditore, gjatë së cilës të paktën dy shoferë ndodhen në drejtimin e një automjeti, duke u ndërruar në drejtimin e tij, një pushim ditor prej 8 orësh pa ndërprerje duhet të respektohet nga secili prej tyre.

Çdo javë shoferi duhet të bëjë si total 45 orë pa ndërprerje pushim javor, duke llogaritur këtu edhe pushimin ditor. Kjo periudhë pushimi javor mund të reduktohet në 36 orë, nëse merret në vendbanimin e shoferit apo në vendqëndrimin e automjetit ose në 24 orë, nëse merret në një vend tjetër.

Në këto raste jepet një pushim kompensues jo më vonë se java e tretë pasardhëse. Me kusht që të mos kompromentojë sigurinë rrugore dhe me qëllim arritjen e një pike ndalimi të përshtatshme, shoferi ka të drejtë të mos respektojë rregullat e vendosura në këtë pikë lidhur me kohën e punës, të drejtimit në timon dhe të pushimit, për aq sa është e nevojshme për të marrë përsipër sigurinë e pasagjerëve, të automjetit dhe të mallrave.

3. Në ndërmarrjet e riparimit të automjeteve, të makinave dhe pajisjeve bujqësore punëdhënësi ka të drejtë të kërkojë vazhdimin e punës në verë deri në orën 2200, kur një gjë e tillë është e domosdoshme për të riparuar automjete, makina e pajisje bujqësore. Pushimi i natës duhet të zgjatë të paktën 9 orë.

4. Pushimi ditor për personelin në tokë të aeroporteve është

të paktën 10 orë pa ndërprerje. Për disa punëmarrës ose disa kategori punëmarrësish pushimi ditor mund të reduktohet në raste të rralla në 8 orë pa ndërprerje:

- a) kur bëhet fjalë për të parandaluar anomali në shfrytëzimin e aeroportit ose për t'i ndrequr këto anomali;
- b) një herë në javë, në mënyrë që punëmarrësit të kenë një pushim javor prej të paktën 36 orësh pa ndërprerje.

Punëdhënësi mund të kërkojë bërjen e orëve shtesë në raste urgjente, kur vërehet një shtim i pazakontë i vëllimit të punës, ose për të parandaluar a ndrequr anomali në shfrytëzim.

Orët shtesë nuk mund të kapërcejnë, përveç rasteve të rralla, 12 orë në javë. Ato duhet të kompensohen maksimumi pas 6 muajsh me një pushim të së njëjtës kohëzgjatjeje. Për orët shtesë të pakompensuara me pushim, jepet një shtesë page prej 25 për qind.

Ai ka të drejtë të urdhërojë të punuarit të dielave ose gjatë 6 netëve rresht, kur një gjë e tillë është e nevojshme për të parandaluar ose ndrequr anomali që kanë ndodhur në shfrytëzimin e aeroportit. Në këto raste jepet një shtesë page prej 25 për qind.

Punëmarrësi duhet të ketë çdo vit të paktën 20 ditë pushim javor, që korrespondojnë me një të diel dhe që përfshijnë intervalin kohor nga ora 00 deri në 2400.

Puna duhet të ndërpritet nga pushimi minimumi:

- 15 minuta, nëse dita e punës zgjat më shumë se 5 orë e 30 minuta;
- 30 minuta, nëse dita e punës zgjat më shumë se 7 orë dhe
- 60 minuta nëse dita e punës zgjat më shumë se 9 orë.

Pushimet llogariten si kohë pune, në rastin kur punëmarrësi nuk është i autorizuar të largohet nga vendi i punës gjatë këtyre pushimeve.

Ky **VENDIM** hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE

Aleksandër Meksi

V E N D I M

Nr.429, datë 25.3.1996

PER KOHEN E PUNES DHE TE PUSHIMIT NE SISTEMIN E SHENDETESISË

Në mbështetje të **LIGJIT** nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në sistemin e shëndetësisë kohëzgjatja maksimale javore e punës është 48 orë.
2. Pushimi ditor zgjat 12 orë pa ndërprerje dhe përfshin intervalin ndërmjet orës 2200 dhe 600. Personeli i zënë në punë para orës 600 ose pas orës 2200 do të ketë një pushim ditor të paktën 12 orë pa ndërprerje. Në rastin e mjekut të rojës dhe të urgjencës mjekësore do të zbatohen rregullat e përcaktuara në **UDHËZIME** të veçanta të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit.
3. Orari i punës në sistemin e shëndetësisë është nga ora 0000 deri në orën 2400. Turnet e punës janë turni i parë nga ora 600 deri në orën 1400, turni i dytë 1400 deri në orën 2200 dhe turni i tretë 2200 deri në 600.
4. Çdo orë pune e kryer në turnin e dytë paguhet me një shtesë prej 20 për qind dhe në turnin e tretë me një shtesë prej 50 për qind.
5. Pushimi javor është një ditë e javës, sipas marrëveshjes me punëdhënësin. Ky pushim duhet të jetë ditën e diel të paktën 1 herë në 4 javë.
6. Puna e kryer ditën e diel dhe në ditët e festave zyrtare kompensohet me një pushim të barabartë me 25 për qind shtesë.
7. Orët shtesë të punës të kryera me kërkesën e punëdhënësit kompensohen me një shtesë prej 25 për qind.
8. Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit nxjerr **UDHËZIMET** e nevojshme për zbatimin e këtij **VENDIMI**.

Ky **VENDIM** hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE

Aleksandër Meksi

V E N D I M

Nr.430, datë 25.3.1996

PER RREGULLIMIN E KOHES SE PUNES E TE PUSHIMIT NE NDERMARRJET QE SIGUROJNE FURNIZIMIN ME BUKE DHE TE MIRA MATERIALE QE DEMTOHEN SHPEJT

Në zbatim të **LIGJit** nr.7961, datë 12.7.1993 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë e Ushqimit dhe të Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Në furrat e bukës, punishtet e pastave dhe bonboneritë kohëzgjatja javore maksimale e punës është 50 orë.
Nëse puna e së dielës ka një kohështrirje nga mëngjesi deri në pasdrekë apo zgjat mbi 3 orë, punëdhënësi duhet ta kompensojë në javën pasardhëse me një pushim jo më pak se 24 orë, i cili duhet të korrespondojë me një ditë pune.
2. Në shitoret e mishit kohëzgjatja javore maksimale e punës është 50 orë.
Në dimër punëdhënësi ka të drejtë të urdhërojë fillimin e punës në orën 500.
3. Në punishtet e përpunimit të qumështit dhe të nënprodukteve të tij puna nuk mund të fillojë para orës 300 ose të zgjatë pas orës 2400
Punëdhënësi mund të urdhërojë punëmarrësit të punojnë të dielën, nëse një gjë e tillë është e nevojshme për të parandaluar dëmtimin e mallit.
Ai ka të drejtë veçanërisht të urdhërojë punën të dielën për:
 - a) të sjellë qumështin dhe nënproduktet e tij pranë popullsisë;
 - b) të transportuar qumështin nga qendra e prodhimit dhe stacionet hekurudhore në depot e lokalet e shitjes;
 - c) të marrë në dorëzim qumështin për ta filtruar e freskuar;
 - d) të përpunuar qumështin deri në orën 1300 maksimumi;
 - e) të shitur produktet e bulmetit.Puna të dielën duhet të reduktohet në atë më të domosdoshmen.
4. Në tregtinë e fruta-perimeve kohëzgjatja javore maksimale e punës mund të zgjatet maksimumi 6 orë, me kusht që të mos kapërcehet si mesatare vjetore.
Punëdhënësi ka të drejtë të urdhërojë fillimin e punës në orën 400 dhe mbarimin e saj në orën 2200 maksimumi.
Në rast nevojë, dhe vetëm gjatë periudhës prill-tetor, punëdhënësi ka të drejtë të urdhërojë kryerjen e punës natën.
Ai ka të drejtë gjithashtu të urdhërojë të punuarit përkohësisht të dielave, kur një gjë e tillë bëhet e domosdoshme për të mënjanuar dëmtimin e mallit.
5. Në gjithë sektorët e mësipërm puna duhet të ndërpritet

nga pushime minimumi:

a) 15 minuta, nëse dita e punës zgjat më shumë se 5 orë e 30 minuta;

b) 30 minuta, nëse dita e punës zgjat më shumë se 7 orë dhe

c) 60 minuta, nëse dita e punës zgjat më shumë se 9 orë.

Pushimet llogariten si kohë pune, në rastin kur punëmarrësi nuk është i autorizuar të largohet nga vendi i punës gjatë këtyre pushimeve.

Ky **VENDIM** hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE

Aleksandër Mexsi

V E N D I M

Nr.431, datë 25.3.1996

PER RREGULLIMIN E KOHES SE PUNES E TE PUSHIMIT NE NDERMARRJET E KONSERVAVE, KOPSHTARISE, PYJEVE DHE KULLOTAVE

Në zbatim të **LIGJit** nr.7961, datë 12.7.1995 pKodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe të Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Në ndërmarrjet e prodhimit të konservave puna e ditës, për periudhën nga 15 maj deri në fund të tetorit nuk mund të fillojë para orës 500 dhe as të zgjatë pas orës 2200. Për pjesën tjetër të vitit puna nuk mund të fillojë para orës 600 dhe as të zgjatë pas orës 2000.

Numri i orëve shtesë nuk mund të kapërcejë 2 orë në ditë dhe as 220 orë në vit për çdo punëmarrës. Këto limite mund të kapërcehen, kur një gjë e tillë është e domosdoshme për të mënjanuar dëmtimin e mallit.

Punëdhënësi ka të drejtë të urdhërojë të punuarit natën për ata punëmarrës që janë dakord dhe vetëm kur kjo gjë është e domosdoshme për të mënjanuar dëmtimin e mallit. Në këtë rast jepet një shtesë page prej 50 përqind. Kohëzgjatja e punës së natës nuk duhet të kapërcejë 8 orë në ditë për çdo punëtor dhe ajo duhet të përfshihet në një interval kohor prej 12 orësh.

2. Në kantinat dhe punishtet e prodhimit të verës e të rakisë kohëzgjatja maksimale javore e punës është 72 orë gjatë 8 javëve të periudhës së vjeljeve dhe 50 orë pjesën tjetër të vitit.

Numri i orëve shtesë nuk mund t'p'i kapërcejë 2 orët dhe për çdo punëmarrës, me përjashtim të rasteve të rralla, ose gjatë periudhës 8-javore të vjeljeve, gjithmonë duke respektuar kufirin prej 120 orësh në vit. Përtej këtij kufiri duhet kërkuar një leje e posaçme nga Inspektorati i Punës. Punëmarrësit duhet të kenë një pushim ditor prej 10-orësh pa ndërprerje.

Gjatë periudhës së vjeljeve prej 8-javësh punëdhënësi ka të drejtë të urdhërojë të punuarit natën dhe të dielave. Punëmarrësi duhet të ketë të paktën një të dielë pushim në 4 javë.

3. Në ndërmarrjet e kopshtarisë kohëzgjatja maksimale javore e punës është 51 orë. Ajo mund të zgjatet maksimumi 4 orë gjatë 16 javëve në vit, me kusht që mesatarja vjetore të mbetet 51 orë. Punëdhënësi ka të drejtë të urdhërojë punën të dielave; kur një gjë e tillë është e domosdoshme për të parandaluar dëmtimin e pemëve. Në këtë rast jepet një shtesë page prej 50 përqind. Puna të dielën mund të urdhërohet edhe për të siguruar një shërbim ruajtjeje. Ky shërbim duhet të kufizohet në atë që është më e domosdoshme. Një punëmarrës nuk mund të caktohet në këtë shërbim më shumë se një herë në një periudhë prej 4 javësh, me përjashtim të rasteve shumë të rralla. Punëmarrësi duhet të ketë

të paktën një të diel pushim në 3 javë.

4. Në ndërmarrjet e pyjeve dhe të kullotave punëdhënësi ka të drejtë të urdhërojë të punuarit natën. Në këtë rast jepet një shtesë page prej 25 për qind.

5. Në gjithë sektorët e mësipërm puna duhet të ndërpritet nga pushime minimumi:

15 minuta, nëse dita e punës zgjat më shumë se 5 orë e 30 minuta.

30 minuta, nëse dita e punës zgjat më shumë se 7 orë, dhe 60 minuta, nëse dita e punës zgjat më shumë se 9 orë.

Pushimet llogariten si kohë pune, në rastin kur punëmarrësi nuk është i autorizuar të largohet nga vendi i punës gjatë këtyre pushimeve.

Ky **VENDIM** hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE
Aleksandër Mexsi

L I G J

Nr.7995, datë 20.9.1995

PER NXITJEN E PUNESIMIT

Në mbështetje të nenit 16 të **LIGJ**it nr.7491, datë 29.4.1991
"Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të
Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i **LIGJ**it në lidhje me punësimin, formimin e kualifikimin profesional, shërbimin kombëtar të punësimit dhe fondin e punësimit është ndjekja e politikave aktive të përgjithshme për të mbështetur punësimin e plotë, produktiv dhe të zgjedhur lirisht.
2. Shteti krijon dhe zhvillon zyrat e punësimit, që veprojnë nën kontrollin e një autoriteti qendror, për të përmbushur të drejtën e gjithë shtetasve rezidentë në Shqipëri, për punësim fitimprurës, për të marrë këshillimin dhe kualifikim profesional për çdo punësim të tillë dhe për të marrë mbështetje në të ardhura.

Neni 2

Përcaktime

1. Në qoftë se në këtë **LIGJ** nuk parashikohet ndryshe, përcaktimet e bëra në Kodin e Punës do të përdoren edhe në këtë **LIGJ**.
2. Me termin "Ministër" kuptohet ministri i Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Ish-të Përndjekurve Politikë.
3. Me termin "Ministri" kuptohet Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Ish-të Përndjekurve Politikë.
4. Me termin "Person" kuptohet një person fizik, siç përcaktohet në Kodin Civil.
5. Me termin "Ndërmarrje" kuptohet një person juridik, siç përcaktohet në Kodin Civil.
6. Me termin "Punëdhënës" përfshihen ndërmarrjet dhe personat që u sigurojnë personave të tjerë një punësim të paguar me një

kontratë punësimi.

7. Me termin "Punë e përshtatshme" kuptohet punësimi i paguar i një personi, në përputhje me kushtet shëndetësore, moshën, kualifikimin dhe aftësitë e tij/saj.

8. Me termin "Person i vetëpunësuar" kuptohet personi që kryen një veprimtari të autorizuar, në mënyrën e parashikuar nga **LIGJET** e Republikës së Shqipërisë, për llogari të tij/saj, në shkëmbim të një pagese ose forme tjetër shpërblimi.

9. Me termin "Person i papunë" kuptohet personi që është shtetas i Republikës së Shqipërisë, ka mbaruar shkollën e detyrueshme dhe kërkon punë.

10. Me termin "Kërkues pune" kuptohet një person i papunë që është regjistruar në një zyrë pune dhe është në pritje që të punojë, si dhe çdo person i cili është në marrëdhënie pune dhe vjen në zyrën e punës për të kërkuar punë të re.

11. Me termin "Ndërmjetësim për punësim" kuptohen veprimtaritë që synojnë të përcaktojnë një punë të përshtatshme për atë shtetas që kërkon punë dhe që sigurojnë informacionin e formimit e domosdoshëm.

12. Me termin "Politikat e tregut aktiv të punës" përfshihen format e ndërhyrjes qeveritare në tregun e punës të caktuara për të rritur eficiencën e tij dhe për të zvogëluar papunësinë.

13. Me termin "Formim profesional" përfshihen formimi dhe riaftësimi për punë i personave të papunësuar, të cilët organizohen ose kontrollohen nga shërbimet e punësimit.

14. Me termin "Riaftësim profesional" kuptohet ajo pjesë e procesit të riaftësimit, ku përfshihet përgatitja profesionale dhe caktimi i seleksionuar, të caktuara për të mundësuar një person me aftësi të kufizuara që të sigurojë dhe të mbajë një punë të përshtatshme.

15. Me termin "Person me aftësi të kufizuar" kuptohet invalidi, mundësitë e të cilit për të siguruar e mbajtur një punë të përshtatshme janë shumë të vogla, si pasojë e dëmtimit fizik dhe/ose mendor.

16. Me termin "Kursant" (ai që kualifikohet) kuptohet personi që merr pjesë në një program të kualifikimit profesional, të autorizuar nga ministria.

17. Me termin "Politika shtetërore të punësimit" kuptohen programet dhe projektet qeveritare, të cilat synojnë nxitjen e punësimit të personave.

18. Termi "Zyra kompetente e punësimit" kupton:

a) një person që kërkon punë, zyrën e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, kompetente për zonën e vendbanimit të përhershëm të kandidatit për punë;

b) një punëdhënës, zyrën e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, kompetente për zonën ku ndodhet qendra e punëdhënësit.

19. Me termin "Zyra e punësimit" kuptohet zyra rajonale ose ajo lokale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

Neni 3

1. Çdo person që kërkon punë ose punë të re, mund të drejtohet për punë dhe për përgatitje për punë në zyrën kompetente të

punësimi ose, me lejen e saj, edhe në ndonjë zyrë tjetër punësimi. Me anën e zyrës kompetente të punësimi, ai mund të regjistrohet për të marrë ndihmën që i takon.

2. Personat e huaj dhe pa shtetësi gëzojnë të njëjtat të drejta si shtetasit shqiptarë sipas marrëveshjeve ndërkombëtare dypalëshe dhe shumëpalëshe, që u japin mundësi autoriteteve kompetente t'u japin të drejtën e banimit dhe të lëshojnë për ta lejen për punë.

3. Ministria përcakton kushtet, në të cilat i njëjti trajtim u sigurohet të huajve që vijnë nga ato vende që nuk kanë bërë një marrëveshje të tillë me Republikën e Shqipërisë.

4. Personat e huaj dhe pa shtetësi që martohen me shtetas shqiptarë, gëzojnë të njëjtat të drejta si shtetasit shqiptarë, me kusht që ata të jenë rezidentë në Republikën e Shqipërisë.

KREU II

POLITIKAT SHETETERORE TE PUNESIMIT

Neni 4

1. Politikat shtetërore të punësimi përfshijnë si masat aktive për nxitjen e punësimi, ashtu edhe sigurimin e mbështetjes me të ardhura.

2. Duke vlerësuar siç duhet zhvillimin ekonomik, punësimin dhe objektivat e tjerë të politikave shtetërore, politikat aktive shtetërore të punësimi synojnë të mbështetin punësimin e plotë, produktiv dhe të zgjedhur lirisht, nëpërmjet sigurimit që:

a) të ketë punë për të gjithë ata që kërkojnë punë;

b) një punë e tillë të jetë sa më produktive që të jetë e mundur;

c) të ketë liri në zgjedhjen e punës dhe mundësitë më të plota të mundshme për çdo person të punësuar që të kualifikohet dhe të përdorë aftësitë e dhuntitë e tij në një punë ku ai është përshtatur siç duhet.

3. Në sasinë e të ardhurave përfshihen sigurimi i të ardhurave për papunësinë, si dhe mbështetja me të ardhura e kursantëve dhe e të papunësuarve prej një kohe të gjatë.

4. Për arritjen e këtyre synimeve, politikat shtetërore të punësimi duhet të zbatohen nëpërmjet zhvillimit:

a) të programeve dhe projekteve aktive të tregut të punës;

b) të formimit profesional;

c) të riaftësimi profesional dhe formave të tjera të mbështetjes për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, dhe

e) të një sistemi të mbështetjes me të ardhura për të papunët.

5. Politikat shtetërore të punësimi vendosen nga Këshilli i Ministrave dhe zbatohen nga ministria. Kjo e fundit është përgjegjëse për përhapjen e politikave shtetërore të punësimi dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të akteve **LIGJORE** e nën**LIGJORE** në këtë fushë. Ministria kren zbatimin e politikave shtetërore të punësimi nëpërmjet bordit të punësimi.

Neni 5

Detyrat e ministrisë

1. Në fushën e politikës shtetërore të punësimit ministria:
 - a) do të vëzhgojë sistematikisht tregun e punës, do të parashikojë zhvillimet e punësimit dhe do të propozojë programe e projekte për rritjen e shkallës së punësimit;
 - b) do të hartojë politika për zhvillimin e programeve që mbështesin kontributin për punësim, veçanërisht, në lidhje me ndryshimet e nevojshme strukturore;
 - c) do të hartojë politika që mbështesin projekte që synojnë krijimin e vendeve të reja të punës, rritjen e shkallës së vetëpunësimit dhe biznesit të vogël;
 - ç) do të hartojë dhe mbështesë programe për formim e riaftësim profesional;
 - d) do të zhvillojë politika për ruajtjen e vendeve ekzistuese të punës;
 - dh) do të kontrollojë dhe do të ndërhyjë në punësimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë dhe mbështetë punësimin e shtetasve shqiptarë jashtë shtetit;
 - e) do të zbatojë marrëveshjet ndërkombëtare për punësimin.
2. Ministria bashkëpunon me Ministrinë e Arsimit për përhapjen e formimit profesional dhe programet e kualifikimit.
3. Për detyrimet e ministrisë dhe ministrive të tjera në lidhje me zbatimin e politikave shtetërore të punësimit vendos Këshilli i Ministrave

KREU III

PROGRAMET DHE PROJEKTET AKTIVE TE TREGUT TE PUNES

Neni 6

1. Politikat aktive të tregut të punës përfshijnë:
 - a) ndërmjetësimin për punësim;
 - b) programet e krijimit të vendeve të punës;
 - c) këshillimin profesional dhe
 - ç) programet e formimit dhe të riaftësimin.

Neni 7

Ndërmjetësimi

1. Ndërmjetësimi për punësim përfshin programe pune që harmonizohen:
 - a) brenda një komune, bashkie;
 - b) brenda një rajoni (prefekturë);
 - c) brenda një shteti dhe
 - ç) jashtë shtetit, sipas marrëveshjes me shtete të tjera.
2. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet ndërmjetësimin për punësim të grupeve delikate, ku përfshihen:
 - a) të miturit në përfundim të shkollës së detyrueshme;
 - b) ata që lënë shkollën dhe kërkojnë punë për herë të parë;

- c) nëna me fëmijë nën moshën 15 vjeç;
- ç) ata që kërkojnë punë me moshë mbi 50 vjeç;
- d) ata që kërkojnë punë dhe janë regjistruar për këtë qëllim prej më shumë se një viti;
- dh) personat me aftësi të kufizuara.

3. Ndërmjetësimi sigurohet nga ana e Shërbimit Kombëtar të Punësimit ose përgjegjës të tjerë të autorizuar publikë, që caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 8

Krijimi i vendeve të punës

1. Punëdhënësit që krijojnë dhe ruajnë punët e sapokrijuara për një afat jo më të shkurtër se një vit, marrin një subvencion 1 vjeçar i rimbursueshëm në fund të vitit të punës, i cili vendoset nga Këshilli i Ministrave, që shkon deri në 70 për qind të ndihmës për papunësinë, me kusht që puna të zgjatë një vit.
2. Programet për krijimin e vendeve të punës përfshijnë:
 - a) programe afatgjata për krijimin e vendeve të mirëqena e të përhershme të punës;
 - b) programe afatmesme për të siguruar punë për ata që mbarojnë shkollën;
 - c) programe afatshkurtra për punë publike (botore);
 - ç) programe të nxitjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.
3. Një punëdhënës që hap një vend të ri pune për një të diplomuar që kërkon punë për herë të parë, do të marrë një subvencion 1 vjeçar të rimbursueshëm për të paguar pagën, i cili është i barabartë me 50 për qind të pagës së paguar dhe që shkon deri në 70 për qind të ndihmës për papunësinë, me kusht që puna të zgjatë një vit.

Neni 9

Punët publike

1. Organet e pushtetit lokal që projektojnë dhe organizojnë programet e punëve publike, marrin një subvencion për pagat që u paguhen personave që kërkojnë punë, të cilët ata i punësojnë në punët publike, që shkon deri në 70 për qind të pagesës për papunësinë, subvencion i pagueshëm gjatë kohës që kryhen punët publike që zgjatën deri në 6 muaj.
2. Këshilli i Ministrave përcakton kushtet, sipas të cilave Fondi Kombëtar i Punësimit siguron kredi për punë publike të organizuara nga bashkitë dhe komunat, si dhe përqindjet e interesit dhe garancitë e kthimit të këtyre kredive.

Neni 10

Këshillimi profesional

1. Me këshillimin dhe formimin profesional synohet t'i sigurohen të papunit njohuri dhe aftësi profesionale për punë.
2. Këshillimi profesional për ata që kërkojnë punë ose punë të re përfshin sigurimin e një këshillimi profesional për shtetasit, me qëllim që t'i aftësojë ata në zgjedhjen e profesionit dhe/ ose punës më të përshtatshme për interesat, arsimin, mundësitë fizike e mendore të tyre, duke përfshirë këshillat për formimin dhe riaftësimin e mëtejshëm.
3. Këshillimi profesional për personat që kërkojnë punë, sigurohet nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit.
4. Shërbimi Kombëtar i Punësimit siguron gjithashtu këshillimin profesional për personat që kërkojnë punë, sipas nevojave të tyre të veçanta.
5. Ministria nxjerr aktet nën**LIGJ**ore për zbatimin e këtij neni.

Neni 11

Programet e formimit dhe riaftësimit profesional

1. Formimi profesional përfshin:

- a) kurse për kërkim pune (klube profesioni) për persona që sapo janë kthyer në të papunë;
- b) formim profesional për të papunë prej një kohe të gjatë;
- c) formim profesional të veçantë për profesione të veçanta dhe
- ç) riaftësim të personave të përgatitur më parë për punë të veçanta.

2. Kurset për kërkim pune (klubet e profesionit) për personat që sapo janë bërë të papunë, zgjatin një javë dhe ato sigurojnë informacion për të përmirësuar kërkimin dhe sigurimin e punësimit ose vetëpunësimit.

3. Me formimin profesional për të papunët prej mëse një viti synohet t'u ofrohet atyre ruajtje dhe/ose zhvillim i njohurive dhe aftësive për të përmirësuar shanset e tyre në tregun e punës.

4. Me kurset e formimit të veçantë për profesione të zgjedhura, si pjesë e programeve të krijimit të punëve të reja, synohet të përgatiten persona të zgjedhur të papunësuar, për t'i pajisur ata me njohuritë dhe aftësinë e nevojshme për kërkesat nga ana e instituconeve dhe sipërmarrësve.

5. Formimi dhe riaftësimi i veçantë sigurohen gjithashtu për personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me paaftësitë e tyre.

6. Me kurset e riaftësimit për persona të formuar e arsimuar synohet formimi dhe riaftësimi i personave të veçantë të papunësuar, për t'i pajisur ata me njohuritë e nevojshme për punët ekzistuese sipas kërkesave nga punëdhënësit, si pjesë e programeve të ristrukturimit.

7. Formimi profesional sigurohet nga:

- a) Shërbimi Kombëtar i Punësimit;
- b) punëdhënësit;
- c) zyrat private të punësimit, nëse janë autorizuar nga ministria;
- ç) organizatat joqeveritare në marrëveshje ose me autorizim nga

ministra.

8. Këshilli i Ministrave përcakton kushtet, sipas të cilave Fondi Kombëtar i Punësimit do të sigurojë kredi për punëdhënësit, që të organizojnë përgatitjen, si dhe përqindjet e interesit dhe garancitë e kthimit të këtyre kredive.

9. Formimi dhe riaftësimi sigurohet nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit ose përgjegjës të tjerë të autorizuar që caktohen nga Këshilli i Ministrave.

10. Ministria kontrollon procedurat që do të ndiqen nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit për zbatimin e këtij neni.

Neni 12

Fondi për formim

1. Personat e papunësuar, të cilët janë regjistruar për punë pranë zyrës kompetente të punësimit dhe kanë pranuar të marrin pjesë në formimin profesional të siguar nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit, marrin një fond përgatitjeje që përcaktohet nga ministria, me kusht që ata të mos kenë të drejtë për ndihmën ekonomike ose pagesën e papunësisë.

2. Pagesa për formimin profesional përcaktohet me **VENDIM** të Këshillit të Ministrave.

3. Fondi i formimit paguhet nga zyra kompetente e punësimit, mbi bazën e dërgimit të një deklaratë nga qendra e formimit profesional që pjesëmarrja në programin e formimit profesional është e rregullt dhe e kënaqshme.

Neni 13

Ministria

1. Për këshillimin dhe formimin profesional ministria:

a) do të ndërmarrë studime strategjike dhe projekte që synojnë të zhvillojnë sistemin e këshillimit dhe formimit profesional;

b) do të krijojë, autorizojë, zhvillojë dhe mbikëqyrë qendrat private e publike të formimit, qendrat e biznesit të vogël dhe klubet e punës;

c) do të vendosë kritere për administrimin dhe gjetjen e kuadrit për këshillimin profesional dhe qendrat e formimit;

ç) do të sigurojë rregullat për financimin e këshillimit dhe të formimit profesional;

d) kontrollon plotësimin e formimit profesional dhe të qendrave të formimit, veçanërisht në lidhje me cilësinë dhe efektivitetin e kostos të kësaj veprimtarie.

2. Ministria financon studimet dhe projektet në lidhje me formimin profesional, të cilat zbatohen nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe autorizohen nga ministria.

KREU IV

PUNESIMI I PERSONAVE ME AFTESI TE KUFIZUAR

Neni 14

Riaftësimi profesional

1. Shërbimet e riaftësimin profesional janë të mundshme për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, me kusht që ata të mund të përgatiten për to dhe të kenë perspektivë të arsyeshme për sigurimin dhe mbajtjen e punëve të përshtatshme.
2. Parimet, mënyrat e veprimit dhe metodat e përgatitjes profesional të zbatuara përgjithësisht në kualifikimin e personave jo me aftësi të kufizuara, zbatohen në rastin e personave me aftësi të kufizuara deri në masën që lejojnë kushtet e tyre mjek-sore dhe arsimore.
3. Shteti merr të gjitha masat e nevojshme, të mundshme e praktike, për të krijuar e zhvilluar brenda kuadrit të zyrave të punësimit shërbimet e specializuara të formimit profesional për personat me aftësi të kufizuara që kërkojnë ndihmë në zgjedhjen dhe ndërrimin e punës.
4. Ministria kontrollon zbatimin e këtij neni.

Neni 15

Detyrimet e punëdhënësit për të punësuar personat me aftësi të kufizuara

1. Çdo punëdhënës që punëson më tepër se 24 punonjës, është i detyruar të punësojë një person me aftësi të kufizuara për çdo 25 punonjës të personelit të tij.
2. Një punëdhënës mund të punësojë një person me handikap të rëndë në vend të pesë personave me handikap të lehtë. Ministria përcakton se kush do të quhet person me handikap të rëndë.
3. Inspektorati Shtetëror i Punës kontrollon zbatimin e këtij neni.

Neni 16

Stimujt për inkurajimin e punësimit të personave me aftësi të kufizuara

1. Punëdhënësi mund të kërkojë subvencion nga zyra kompetente e punësimit për të pajisur siç duhet vendin e punës të personit me aftësi të kufizuara dhe për t'i siguruar atij/asaj një përgatitje thelbësore për punën. Rregulla të hollësishme caktohen nga ministria.
2. Paga që një punëdhënës i paguan një personi me aftësi të kufizuara që ai punëson, përjashtohet nga taksat deri në një masë që caktohet nga Këshilli i Ministrave.
3. Një punëdhënës që nuk punëson numrin e rekomanduar të personave me aftësi të kufizuara, siç përcaktohet në nenin 15, është i detyruar të paguajë në një llogari të veçantë në Fondin Kombëtar të Punësimit shumë e barabartë me minimumin e pagës, për çdo muaj dhe çdo person me aftësi të kufizuara që ai duhej ta kishte

punësuar, por që nuk ka vepruar kështu. Këto të ardhura përdoren për të krijuar vende pune për personat me aftësi të kufizuara.

4. Këshilli i Ministrave cakton rregullat për zbatimin e paragrafit të mësipërm të këtij neni.

KREU V

SHERBIMI KOMBËTAR I PUNESIMIT

Neni 17

1. Shërbimi Kombëtar i Punësimit është një shërbim publik autonom me statusin e një administrate shtetërore qendrore, që përgjigjet para ministrit.

2. Shërbimi Kombëtar i Punësimit kryesohet nga drejtori i përgjithshëm i emëruar nga Këshilli i Ministrave.

Neni 18

Statuti

1. Shërbimi Kombëtar i Punësimit vepron sipas një statusi të propozuar nga ministri në përputhje me dispozitat e këtij **LIGJi** dhe të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

2. Statuti përcakton:

- a) organizimin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit;
- b) formimin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit nga një bord drejtorësh të emëruar nga ministri dhe të kryesuar nga drejtori i përgjithshëm;
- c) rekrutimin dhe kushtet për punësimin e personelit;
- ç) financimin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit;
- d) të drejtat dhe detyrat e zyrave të punës kundrejt bordit të punëdhënësve.

3. Ministri përcakton kushtet e kualifikimit që duhen plotësuar nga kandidatët për postin e drejtorit të përgjithshëm dhe të drejtorit në një konkurrim të përgjithshëm. Organizatat e punëdhënësve dhe sindikatat mund të paraqesin qysh më parë propozimet e tyre për konkurrimin e përgjithshëm.

4. Zyrat e punësimit janë pjesë integrale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, e përfaqësojnë atë dhe kanë kompetencën që u është besuar atyre nga statuti.

5. Shërbimi Kombëtar i Punësimit është plotësisht përgjegjës për **VENDIMet** e veprimet e zyrave dhe personelit të tij të punësimit.

Neni 19

Trupat konsultativë

(Punëdhënësi, punëmarrësi, shteti)

1. Zyrat e punësimit kërkojnë këshilla nga trupat konsultativë për:

- a) qëndrueshmërinë e programeve dhe projekteve;
- b) vëzhgimin e kushteve për punësim dhe mundësitë për shtimin e politikave aktive të punësimit.

2. Çdo zyrë punësimi cakton një këshill konsultativ trepalësh për të inspektuar projektet:

- a) e punëdhënësve që synojnë krijimin dhe ruajtjen e punëve sociale të qëllimta (projekte afatgjata për më tepër se një vit);
- b) e punëdhënësve për të krijuar punë kualifikuese për të sapodiplomuarit e shkollave të mesme e të larta (projekte afatmesëm nga 6 muaj deri në një vit);
- c) e organeve të pushtetit lokal për zhvillimin e komunitetit ku përfshihen punë të dobishme të përgjithshme (projekte afatshkurtra për jo më shumë se 6 muaj).

Neni 20

Fondi Kombëtar i Punësimit

1. Shërbimi Kombëtar i Punësimit financohet nga Fondi Kombëtar i Punësimit, i subvencionuar nga buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera, siç mund të jenë donacionet dhe kuotizacionet për shërbimet, të siguruara sipas një kontrate me punëdhënësit, pushtetin lokal dhe institucione të tjera.

2. Të ardhurat e Fondit Kombëtar të Punësimit do të jenë:

- a) subvencione nga buxheti i shtetit, siç është miratuar nga Kuvendi Popullor;
- b) transferime nga fondi i sigurimeve shoqërore;

c) donacione;

ç) të ardhura nga veprimtari të mirëfillta;

d) fitime nga dhënia me qira.

3. Shpenzimet e Fondit Kombëtar të Punësimit përfshijnë:

- a) pagesën e përkrahjes me të ardhura për ata që kërkojnë punë dhe për kursantët;
- b) mbështetje dhe kredi për punëdhënësit që krijojnë vende të reja pune në përputhje me dispozitat e këtij **LIGJ**;

c) kredi për këshillat e rretheve për të mbështetur punët publike (botore);

ç) koston e zbatimit të studimeve dhe projekteve, që kanë lidhje me formimin dhe aftësimin profesional, ku përfshihen:

(i) investimet për ndërtimin, pajisjen dhe mirëmbajtjen e shërbimeve të domosdoshme, të autorizuara nga ministria;

(ii) kostoja e librave dhe e materialeve të tjera të domosdoshme për përgatitjen, në një raport për capita, që përcaktohet nga ministria;

d) pagat e personelit;

dh) shpenzimet administrative të formimit në një raport me kostot e përgjithshme, që përcaktohet nga ministria.

4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton statutin e Fondit Kombëtar të Punësimit. Statuti do të rregullojë organizimin dhe administrimin e Fondit Kombëtar të Punësimit nga ana e Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

KREU VI DETYRIMET E PUNEDHENESVE

Neni 21

Detyrimi për të raportuar

1. Çdo punëdhënës ka detyrimin të raportojë në zyrën kompetente të punësimit për çdo vend të lirë pune në ndërmarrjen e tij, brenda 7 ditëve nga data që hapet ky vend i lirë. Në raportin e tij punëdhënësi do të specifikojë moshën, arsimin, përgatitjen profesionale dhe aftësitë që kërkohen për punën.
2. Në rastet e falimentimit të pritshëm, punëdhënësi raporton në zyrën kompetente të punësimit sapo ai të jetë bërë i vetëdijshëm për falimentimin e mundshëm të tij, jo më vonë se data e pritshme e mbylljes së veprimtarisë.
3. Në rast të një pezullimi nga puna, punëdhënësi mund të propozojë në njoftimin e tij programe alternative prodhimi, të cilat do të kërkonin riaftësimin e punonjësve, mbështetjen e zyrës kompetente të punësimit dhe pagesën e një fondi formimi për punonjësit që riformohen.
4. Çdo punëdhënës raporton vendet e lira të punës veçan për personat me aftësi të kufizuara. Në raportin e tij, punëdhënësi specifikon se çfarë kushtesh moshe, arsimit, aftësimi profesional dhe aftësish kërkohen për punën.
5. Shërbimi Kombëtar i Punësimit së bashku me Inspektoratin Shtetëror të Punës, kontrollojnë zbatimin e këtij neni.

Neni 22

Detyrimi për të nxitur punësimin

1. Çdo punëdhënës është i detyruar të regjistrojë pranë zyrës së punës përkatëse, ku ai ushtron veprimtarinë e tij ekonomike, çdo punëmarrës që ai merr në punë për të plotësuar vendet e lira të punës që ai disponon.
2. Çdo punëdhënës ka të drejtë të plotësojë vendin e lirë të punës që ai disponon me kandidaturat që i ofron zyra e punës ose me kandidatë të tjerë të përshtatshëm, që ai mund t'i zgjedhë vullnetarisht.

KREU VII

INFORMACIONI PER TREGUN E PUNES

Neni 23

Detyrimi i punëdhënësve

1. Çdo punëdhënës raporton çdo tre muaj në zyrën kompetente të punësimit për:
 - a) numrin e personave të punësuar dhe listat e tyre emërore;
 - b) veprimtaritë e tij më të rëndësishme.
2. Zyra kompetente e punësimit e ruan këtë informacion në fshehtësi dhe e përdor atë vetëm në një formë të përmbledhur, pa zbuluar të dhënat vetjake dhe fshehtësinë e biznesit të punëdhënësit. Çdo zbulim i këtij informacioni në mënyrë të paautorizuar është i ndaluar.

Neni 24

Zyrat e punësimit

1. Çdo zyrë punësimi raporton rregullisht çdo tre muaj te drejtori i përgjithshëm për:
 - a) numrin e personave të punësuar dhe listat e tyre emërore;
 - b) numrin e ndërmarrjeve dhe institucioneve në kompetencë të tyre dhe veprimtaritë e tyre më të rëndësishme;
 - c) numrin e vendeve të lira të punës dhe shpërndarjen e tyre në përputhje me profesionin, nivelin arsimor dhe kualifikimin e kërkuar;
 - ç) numrin e pezullimeve dhe falimentimeve të pritshme, si dhe numrin e personave të punësuar të përfshirë;
 - d) numrin e personave të kualifikuar dhe strukturën e tyre sipas profesionit, arsimit, moshës dhe seksit;
 - dh) numrin e personave të parashikuar për t'u kualifikuar në tremujorin e ardhshëm dhe plane të tjera për politikatat aktive të punësimit.

Neni 25

Ministria dhe institucionet

1. Ministria ka të drejtën ekskluzive për t'i siguruar Zyrës Qendrore të Statistikës të gjitha statistikat e punës, përveç atyre që rrjedhin nga regjistrimi i popullsisë dhe vëzhgimet statistikore të autorizuara nga Zyra Qendrore e Statistikës, dhe të japë parashikimin e zhvillimeve të tregut të punës në Shqipëri.
2. Ministria bën përcaktimin e informacionit të mbledhur në koordinim me Zyrën Qendrore të Statistikës.
3. Të gjitha institucionet dhe struktrat e varura prej tyre janë të detyruara të japin informacionin e nevojshëm të kërkuar nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit, si dhe kanë të drejtë të kërkojnë informacion nga kjo strukturë.

KREU VIII

DENIMET DHE PROCEDURAT

Neni 26

Procedurat

Këshilli i Ministrave cakton rregullat që janë të nevojshme për zbatimin e këtij **LIGJi**.

Neni 27

Dënimet

Një punëdhënës që shkel dispozitat e këtij **LIGJi**, dënohet për kundërvajtje administrative nga Inspektorati Shtetëror i Punës me një gjobë deri në 1 milion lekë për rast.

Kundër **VENDIM**it të dënimit administrativ mund të bëhet ankim, konform **LIGJ**it "Për Inspektoratin Shtetëror të Punës".

KREU IX

DISPOZITA TE PERKOHSHME DHE PERFUNDIMTARE

Neni 28

Dispozita të përkohshme

1. Zyrat e punësimit që janë krijuar dhe veprojnë përpara hyrjes në fuqi të këtij **LIGJi**, do të shndërrohen në zyra punësimi të Shërbimit Kombëtar të Punësimit që nga data kur ky shërbim është krijuar.
2. Punonjësit e zyrave të punësimit që kanë vepruar përpara hyrjes në fuqi të këtij **LIGJi**, do të bëhen punonjës të Shërbimit Kombëtar të Punësimit që nga data kur ky shërbim është krijuar.
3. **VENDIM**et dhe aktet e tjera që lidhen me punësimin, të marra para datës që ky **LIGJ** hyn në fuqi, do t'i përmbahen legjislacionit, i cili ka qënë në fuqi në kohën kur është marrë ky **VENDIM**.

Neni 29

Zbatimi

1. Nëse nuk është parashikuar ndryshe, Këshilli i Ministrave cakton rregulla të hollësishme për zbatimin e këtij **LIGJi**, me kusht që ai të mos ndryshojë të drejtat dhe detyrimet që u jepen shtetasve dhe ndërmarrjeve nga ky **LIGJ**.
2. Këshilli i Ministrave përcakton gjithashtu, përveç rregullave të mësipërme, rastet kur ministri do të zbatojë **LIGJ**in me anë të rregullave që rrjedhin prej tij.

Neni 30

Dispozita përfundimtare

1. Që nga data kur ky **LIGJ** hyn në fuqi, të gjitha aktet **LIGJ**ore dhe nën**LIGJ**ore që bien në kundërshtim me të, shfuqizohen.

Neni 31

1. Ky **LIGJ** hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1248, datë 11.10.1995, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha

L I G J

Nr.7986, datë 13.9.1995

PER INSPEKTORATIN SHTETEROR TE PUNES

Në mbështetje të nenit 16 të **LIGJ**it nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

1. Qëllimi i **LIGJ**it "Për Inspektoratin Shtetëror të Punës" (që më poshtë do të quhet "**LIGJ**") është të sigurojë zbatimin e legjislacionit të punës nga punëdhënësi dhe personat e punësuar prej tyre.
2. Shteti do të krijojë, zhvillojë e fuqizojë Inspektoratin Shtetëror të Punës (që më poshtë do të quhet "Inspektorati"), për të siguruar në emër të tij zbatimin e legjislacionit të punës dhe të kryejë inspektimin në punë, siç parashikohet në këtë **LIGJ**.

Neni 2

Përkufizime

1. Përkufizimet e Kodit të Punës do t'p aplikohen dispozitave të këtij **LIGJ**i, me përjashtim të rasteve kur në të parashikohet ndryshe.
2. Me termin "Ministër" do të kuptojmë ministrin e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë.
3. Me termin "Ministri" do të kuptojmë Ministrinë e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë.
4. Me termin "Inspektorat" do të kuptojmë organet dhe inspektorët e Inspektoratit Shtetëror të Punës.
5. Me termin "Inspektimi në punë" do të kuptojmë veprimtarinë dhe inspektimin e kryer nga inspektorati.
6. Me termin "Person" do të kuptojmë çdo person fizik, siç përcaktohet në Kodin Civil.
7. Me termin "Ndërmarrje" do të kuptojmë çdo person juridik siç përcaktohet në Kodin Civil.
8. Termi "Legjislacioni i punës" do të përfshijë:
 - a) Kodin e Punës;
 - b) **LIGJ**in e punësimit;

c) **LIGJ**et që për zbatim i ngarkohen shprehimisht inspektoratit;

ç) aktet nën**LIGJ**ore që dalin në zbatim të pikave a deri në c.

9. Me termin "Marrëveshje kolektive" do të kuptojmë marrëveshjen e lidhur ndërmjet punëmarrësve dhe punëdhënësve, që rregullon marrëdhëniet juridike të punës, të drejtat dhe detyrat e secilës palë, të cilat rrjedhin prej tyre.

10. Me termin "Anëtar familjeje" do të kuptojmë një anëtar familjeje të punëdhënësit a të një personi të vetëpunësuar, i cili punon me të ose për të, pa pasur një kontratë punësimi dhe pa pagesë.

11. Me termin "Person i vetëpunësuar" do të kuptojmë një person, i cili kryen një veprimtari me leje, siç parashikohet nga **LIGJ**et e Republikës së Shqipërisë, për llogari të tij dhe kundrejt një fitimi.

12. Termi "Formim profesional" përfshin formimin dhe riformimin e:

) të papunëve për punësim, të organizuar dhe të kontrolluar nga shërbimet e punësimit;

b) personave të punësuar nga punëdhënësi ose nga ndonjë person juridik a fizik i angazhuar nga punëdhënësi.

13. Me termin "I formuar" do të kuptojmë një person që merr pjesë në një program të formimit profesional apo punës praktike si pjesë e studimeve të tij, të organizuar nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit ose nga një punëdhënësi a person tjetër juridik ose fizik, i angazhuar nga punëdhënësi kundrejt një pagese dhe i autorizuar nga ministria.

14. Me termin "Zyrë punësimi" do të kuptojmë për:

a) një person që kërkon punësim, Zyrën e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, e cila ka nën juridiksionin e saj vendbanimin e përhershëm të tij;

b) një punëdhënësi, Zyrën e Shërbimit Kombëtar të Punësimit që ka nën juridiksionin e saj vendndodhjen e qendrës së punëdhënësit.

15. Termi "Substanca të rrezikshme" përfshin substancat që për nga vetitë e tyre fizike, kimike a biologjike paraqesin rrezik për personat e punësuar. Substanca të tilla përfshijnë lëndët plasëse, radioaktive, djegëse, helmuese, gërryese, infektuese, kancerogjene dhe lëndë të tjera dëmtuese, siç përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

16. Termi "Objekte të rrezikshme" do të përfshijë ndërtesat, pajisjet dhe makineritë ose objekte të tjera që paraqesin rrezik për jetën dhe shëndetin. Në objektet e rrezikshme përfshihen ashensorët, vinçat dhe mjete të tjera të veçanta transporti sipas përcaktimit nga Këshilli i Ministrave.

17. Termi "Shëndet" në lidhje me punën nuk synon vetëm mungesën e sëmundjes ose paaftësisë, por ai përfshin dhe elementet psikike e fizike që prekin shëndetin dhe janë të lidhura drejtpërdrejt me higjienën dhe sigurimin në punë.

18. Termi "Mirëqenie" nënkupton sigurimin nga ana e punëdhënësit dhe me shpenzimet e tij të ujit të pijshëm, banjove, dusheve, ndihmës së parë dhe kushteve të tjera sanitare; sigurimi i këtyre kushteve varet nga natyra e punës dhe numri i punëmarrësve që punojnë në ndërmarrje.

Neni 3

Të drejtat e inspektimit në punë

1. Ministri është përgjegjës për inspektimin në punë dhe për zbatimin e legjislacionit të punës. Ai ka të drejtë:

- a) të krijojë inspektoratin dhe ta kontrollojë atë;
- b) të nxjerrë rregullore për procedurat që duhet të ndjekë inspektorati;
- c) të përcaktojë formën e procesverbaleve të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale;
- ç) të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar parandalimin e aksidenteve dhe sigurimin në punë, duke përfshirë këtu edhe informimin publik.

2. Inspektorati ka të drejtë:

- a) Të inspektojë rregullisht
 - i) rregullshmërinë e marrëdhënieve të punësimit
 - ii) regjistrimin e punonjësve në sigurimet shoqërore e shëndetësore
 - iii) kushtet e punësimit, siç parashikohen në legjislacionin e punës dhe marrëveshjet kolektive
 - iv) sigurimin në punë
 - v) punësimin e fëmijëve dhe grave, të formuarve dhe anëtarëve të familjes.
- b) Të urdhërojë punëdhënësit të riparojnë a zëvendësojnë ndonjë pajisje ose të ndërpresin çdo veprimtari që paraqet rrezik të dukshëm për shëndetin e punëmarrësve, apo të kërkojë riparimin e defekteve që vërehen në konceptimin e funksionimit të pajisjeve a të metodave të punës, për të cilat ata mund të kenë shkaqe të arsyeshme të besojnë se ato përbëjnë një kërcënim për shëndetin ose sigurinë e personave të punësuar.
- c) Të hetojë aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale të personave të punësuar, të formuarve dhe anëtarëve të familjeve.
- ç) Të këshillojë punëdhënësit dhe punëmarrësit për të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni i punë dhe të organizojë informimin publik për legjislacionin e punës.
- d) Të bëjë kërkime të nevojshme për fuqizimin e inspektimit në punë ose të kontraktojë për to.
- dh) Të marrë të gjitha masat e nevojshme për forcimin e parandalimit e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale.

3. Të drejtat e inspektoratit zbatohen kundrejt gjithë punëdhënësve, punëmarrësve, personave të vetëpunësuar dhe anëtarëve të familjeve të tyre, që punojnë në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht nga shtetësia e tyre.

KREU II

POLITIKAT SHTETERORE TE INSPEKTIMIT NE PUNE

Neni 4

1. Shteti vendos një sistem të inspektimit në punë për të gjitha vendet e punës, i cili kërkon zbatimin e dispozitave të legjislacionit të punës, marrëveshjeve kolektive dhe të mbrojtjes gjatë procesit të punës të personave të punësuar dhe që sigurohet nga inspektorët e punës.
2. Këshilli i Ministrave zhvillon politikat dhe merr masa që synojnë të sigurojnë zbatimin e dispozitave të legjislacionit të punës në të gjitha vendet e punës.
3. Ministri siguron:
 - a) zbatimin e dispozitave të legjislacionit të punës në të gjitha vendet e punës;
 - b) nxitjen e masave të sigurimit në vendet e punës ku përdoren substanca dhe objekte të rrezikshme;
 - c) fuqizimin e parandalimit të aksidenteve në punë.

Neni 5

1. Inspektori i përgjithshëm publikon një listë të vendeve të punës, të cilat duhet t'i nënshtrohen rregullisht inspektimit për arsye të substancave dhe pajisjeve të dëmshme që ato përdorin në procesin e prodhimit
2. Veprimtaritë ushtarake ose pjesë të tyre që varen nga Ministria e Mbrojtjes, përjashtohen nga zbatimi i **LIGJ**it vetëm përse i përket forcave të armatosura.

Neni 6

- Këshilli i Ministrave nxjerr rregulla për të nxitur bashkëpunimin efektiv të inspektoratit me:
- a) ministritë dhe inspektoratet e varura prej tyre;
 - b) institutin e Shëndetit Publik përse i përket higjienës industriale;
 - c) shërbime të tjera qeveritare dhe institucione shtetërore ose private që kryejnë veprimtari të ngjashme;
 - ç) policitë;
 - d) gjithë punëdhënësit, punëmarrësit dhe organizatat e tyre.

KREU III

INSPEKTORATI SHTETEROR I PUNES

Neni 7

Ministri krijon Inspektoratin Shtetëror të Punës, si organ publik që do të mbikëqyret dhe kontrollohet nga ministria.

Neni 8

Inspektori i përgjithshëm

1. Inspektorati drejtohet nga inspektori i përgjithshëm.

2. Inspektori i përgjithshëm emërohet nga ministri dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave.

3. Inspektori i përgjithshëm ka statusin e Drejtorit të përgjithshëm dhe raporton te ministri.

Neni 9

Statuti

1. Organizimi dhe drejtimi i inspektoratit rregullohet me statut, i cili propozohet nga ministri dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave.

2. Statuti përcakton:

a) Numrin e inspektorëve, në përpjesëtim të drejtë me:

i) numrin, natyrën, madhësinë dhe gjendjen e vendeve të punës që i nënshtrohen inspektimit;

ii) numrin dhe kategoritë e punonjësve të punësuar në këto vende pune dhe

iii) numrin dhe kompleksitetin e dispozitave **LIGJORE** që duhen zbatuar.

b) Organizimin dhe drejtimin e Inspektoratit.

c) Kushtet për marrjen në punë dhe procedurat për emërimin e inspektorëve dhe personelit ndihmës, duke u bazuar në aftësitë profesionale për përmbushjen e detyrave.

ç) Statusin e inspektorëve si nëpunës shtetëror dhe kushtet e shërbimit, në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria e tyre në vendet e punës dhe pavarësia nga ndërhyrjet e padrejta.

d) Barazinë e trajtimit të burrave dhe grave.

dh) Një formim të përshtatshëm për kryerjen e detyrave, duke përfshirë këtu edhe kualifikimin e vazhdueshëm dhe bashkëkohor të stafit.

e) Masat disiplinore për inspektorët.

Neni 10

Detyrat e Inspektoratit

1) Detyrat e inspektoratit përfshijnë:

a) Sigurimin e zbatimit të legjislacionit të punës sidomos përsa i përket zbatimit të kontratës së punës, kushteve të punës dhe mbrojtjen e personave të punësuar gjatë kohës së punës, si për shembull dispozitat lidhur me orët e punës, pagat, sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien, punësimin e të miturve dhe çështjeve të tjera që lidhen me to në atë masë që zbatimi i këtyre dispozitave sigurohet nga inspektorët e punës;

b) inspektimin e vendeve të punës aq herë dhe në atë masë sa është e nevojshme për të siguruar zbatimin efektiv të dispozitave të legjislacionit të punës;

c) sigurimin e informacionit teknik dhe këshillim të punëdhënësve e punëmarrësve në lidhje me mjetet më efektive për zbatimin e legjislacionit të punës;

ç) të njoftojë organet kompetente për të metat ose parregullsitë që nuk mbulohen në mënyrë të veçantë nga dispozitat

e legjislacionit të punës, si për shembull nëse personat e punësuar janë të siguruar sipas **LIGJit** të sigurimit shëndetësor dhe **LIGJit** të sigurimeve shoqërore;

d) dhe çdo lloj detyre tjetër që mund t'ji besohet inspektoratit me **LIGJ** ose **VENDIME** të Këshillit të Ministrave.

2. Detyrat e tjera që mund t'ji besohen inspektoratit nuk duhet të jenë të tilla që të pengojnë a komprometojnë zbatimin efektiv të detyrave parësore të inspektorëve apo të dëmtojnë në çfarëdo lloj mënyre autoritetin dhe paanësinë, të cilat janë të nevojshme për inspektorët në lidhjet e tyre me punëdhënësit dhe punëmarrësit.

3. Detyrat e inspektoratit nuk duhet të përfshijnë ato që lidhen me mënyrën e të vepruarit si pajtues apo arbitër gjatë procesit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në punë, me përjashtim të rastit kur të dy palët e kërkojnë vetë këtë.

Neni 11

Kompetencat

1. Inspektorët të pajisur me fletënjoheje kanë këto kompetenca:

a) të hyjnë lirshëm dhe pa bërë njoftim paraprak në çdo orë të ditës ose të natës në çdo vend pune që i nënshtrohet inspektimit;

b) të kryejë çdo lloj kontrolli, testi apo anketimi, të cilin ata mund ta konsiderojnë si të nevojshëm për t'ju bindur që legjislacioni i punës është zbatuar në mënyrë rigoroze dhe në veçanti:

i) të pyesin, vetëm apo në prani të të tjerëve, punëdhënësin ose personelin e ndërmarrjes për çdo problem që lidhet me zbatimin e legjislacionit të punës,

ii) të kërkojnë hartimin e të gjitha librave, regjistrave a dokumenteve të tjera, mbajtja e të cilave është parashikuar në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë apo rregulloret që lidhen me kushtet e punës, në mënyrë që të shihet nëse ato përputhen me legjislacionin e punës, si dhe të kopjojnë dokumente të tilla apo të nxjerrin pjesë prej tyre,

iii) të kërkojë afishimin e lajmërimeve, vendosja e të cilave parashikohet nga dispozitat e legjislacionit të punës,

iv) të merren apo të nxirren për qëllime analizash mostra të lëndëve dhe substancave që përdoren mjaft, me qëllim që punëdhënësi ose përfaqësuesi i tij të jenë në dijeni që lëndët ose substancat u nxorrën apo u morën për këtë qëllim.

2. Në rastin e një vizite inspektimi, inspektorët duhet të njoftojnë punëdhënësin ose përfaqësuesin e tij për praninë e tyre, me përjashtim të rasteve kur gjykohet që një njoftim i tillë bëhet pengesë në kryerjen e detyrave të tyre.

3. Me qëllim që inspektorët të jenë të aftë të marrin të tilla masa, atyre duhet t'u njihet e drejta, e cila mund të apelohej te ministri:

a) të urdhërojë

i) modifikimin e instalimeve apo të ndërmarrjes brenda një afati të caktuar kohor, për të siguruar pajtueshmërinë e tyre me dispozitat **LIGJore** që lidhen me shëndetin dhe sigurimin e

punëtorëve, ose

- ii) masa me një forcë zbatuese të menjëhershme në rast rreziku të dukshëm për shëndetin apo sigurinë e punëtorëve;
- b) tpu kërkojnë organeve kompetente të zbatojnë masat që parashikohen në **LIGJ** ose në akte të tjera nën**LIGJ**ore.

Neni 12

Rregullat e sjelljes

1. Inspektorët:

- a) ndalohen të kenë interesa të drejtpërdrejta a të tërthorta në ndërmarrjet ku ushtrohet kontrolli i tyre;
 - b) dënohen me sanksione të caktuara ose masa disiplinore në rast se nxjerrin, edhe pas mbarimit të shërbimit, ndonjë sekret prodhimi a tregtimi ose procesesh pune, për të cilat mund të kenë marrë dijeni gjatë ushtrimit të detyrave të tyre;
 - c) duhet të ruajnë sekretin e burimit të çdo lloj ankese që sjell në vëmendje të tyre ndonjë të metë a shkelje të dispozitave **LIGJ**ore dhe të mos i zbulojnë punëdhënësit a përfaqësuesit e tij se vizita e inspektimit u bë si rrjedhim i marrjes së kësaj ankese.
2. Inspektori i përgjithshëm nxjerr për gjithë personelin e inspektoratit rregulla të përgjithshme sjelljeje.

KREU IV

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E PUNEDHENESVE

Neni 13

Të drejtat e punëdhënësve

- 1 Punëdhënësi ka të drejtë të marrë nga inspektorati gjithë informacionin e kërkuar në lidhje me legjislacionin e punës dhe sidomos me kushtet e punës dhe sigurinë në punë.
2. Punëdhënësi ka të drejtë të kërkojë me shkrim mendimin e inspektoratit mbi çdo çështje a problem të veçantë që lidhet me zbatimin e legjislacionit të punës dhe sidomos me kushtet e punës dhe sigurinë në punë.

Neni 14

Detyrimet e punëdhënësve

1. Punëdhënësi duhet të zbatojë të gjitha dispozitat e legjislacionit të punës në të gjitha pjesët e ndërmarrjes, siguron të gjitha kushtet për sigurinë në punë dhe formon në mënyrë të rregullt punonjësit e tij në drejtim të dispozitave të legjislacionit të punës që lidhen me sigurinë dhe shëndetin.
2. Punëdhënësi duhet të sigurojë gjithë informacionin e nevojshëm që lidhet me zbatimin e legjislacionit të punës, kur e kërkon inspektorati dhe inspektorët që vizitojnë me fletënjohtjen

përkatëse.

3. Punëdhënësi njofton inspektoratin për aksidentet në punë dhe rastet e sëmundjeve profesionale.

KREU V

DETYRIME TE PERGJITHSHME

Neni 15

Detyrimi për informim

Çdo person që kërkon të ngrejë një ndërmarrje, të marrë përsipër një ndërmarrje ose të fillojë kryerjen e një kategorie të veçantë veprimtarie të përcaktuar nga inspektori i përgjithshëm, duhet të njoftojë paraprakisht inspektoratin.

Neni 16

Detyrimi për konsultim

1. Planet dhe projektet për ngritjen e një ndërmarrjeje të re, uzinë a objekti ose procesi prodhimi paraqiten pranë inspektoratit për të marrë mendim nëse planet apo projektet e sipërpërmendura e bëjnë të vështirë ose të pamundur zbatimin e legjislacionit të punës, ose mund të përbëjnë kërcënim për shëndetin a sigurinë e personave të punësuar.

2. Zbatimi i planeve për ngritjen e ndërmarrjeve të reja, uzinave dhe proceseve të prodhimit, të cilat gjykohen nga inspektorati si të rrezikshme a kërcenuese për shëndetin, kushtëzohen nga kryerja e ndryshimeve të urdhëruara nga inspektorati, të cilat kanë si qëllim ruajtjen e shëndetit dhe sigurinë e punëtorëve.

3. Një person mund të importojë në Republikën e Shqipërisë vetëm mallra dhe shërbime që janë në përputhje me standardet e pranuar nga Republika e Shqipërisë. Inspektorati ka të drejtë të gjobitë a ndalojë shitjen e mallrave dhe shërbimeve të importuara në Republikën e Shqipërisë, në të gjitha rastet kur mallrat dhe shërbimet nuk përputhen me legjislacionin e punës dhe rregulloren e sigurimit në punë. Çdo importues që dyshon në pajtueshmërinë me legjislacionin e punës të mallrave dhe shërbimeve të importuara, duhet të konsultohet me shkrim me inspektoratin.

Neni 17

Detyrimi për të kërkuar një autorizim

Asnjë ndërmarrje a person nuk ka të drejtë të shesë ose të furnizojë dikë me substanca dhe objekte të rrezikshme, tË përfshira në listën e substancave dhe pajisjeve të tillam të nxjerrë nga inspektori i përgjithshëm, pa autorizimin e inspektoratit.

KREU VI

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E PERSONAVE TE PUNESUAR

Neni 18

1. Të drejtat dhe detyrimet e personave të punësuar, të përcaktuara në legjislacionin e punës, zbatohen ndaj gjithë personave të punësuar në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga shtetësia e punëdhënësit.
2. Të formuarit dhe pjesëtarët e familjes gëzojnë të njëjtat të drejta dhe përbushin të njëjtat detyrime, sikurse edhe personat e punësuar.

Neni 19

E drejta për të paraqitur një ankesë

Personi i punësuar ka të drejtë të paraqesë një ankesë pranë inspektoratit, nëse punëdhënësi shkel një dispozitë të legjislacionit të punës.

Neni 20

Detyrimi për t'u formuar mbi masat e sigurimit

Personat e punësuar kanë për detyrë t'i nënshtrohen formimit mbi masat e sigurimit, të përdorin të gjitha pajisjet e sigurimit në mënyrën e duhur dhe të respektojnë të gjitha rregullat e sigurimit në punën që ata bëjnë.

Neni 21

Bashkëpunimi i personave të punësuar

Personat e punësuar bashkëpunojnë me punëdhënësin e tyre, me qëllim përmirësimin e kushteve që ndikojnë në shëndetin dhe sigurimin në punë. Personat e punësuar marrin pjesë në formim mbi sigurimin në punë, kur e kërkon punëdhënësi.

KREU VII

INFORMIMI

Neni 22

Informimi publik

1. Inspektorati këshillon dhe instrukton punëdhënësin dhe personat e punësuar prej tyre për legjislacionin e punës dhe çështjet që lidhen me sigurimin në punë nëpërmjet:
 - a) Leksionesh, bisedash në radio, afishesh, pamfletesh dhe

filmash që shpjegojnë dispozitat e legjislacionit të punës dhe sugjerojnë metodat për zbatimin e tyre dhe masat parandaluese për aksidentet në punë e sëmudjet profesionale;

b) ekspozitash për shëndetin dhe sigurimin;

c) **UDHËZIM**esh për higjienën dhe sigurimin në punë në shkollat teknike.

2. Inspektorati publikon rregullisht rregulloret për sigurimin në punë në një mënyrë përgjithësisht të kuptueshme nga punëdhënësit dhe personat e punësuar prej tyre.

Neni 23

Detyrimi për të raportuar

1. Punëdhënësit që janë të regjistruar për t'pau nënshtuar një inspektimi të rregullt, duhet t'i raportojnë çdo vit inspektoratit për të gjitha vendet e punës që i nënshtohen këtij inspektimi, numrin e personave të punësuar në to, duke përfshirë:

a) numrin e vendeve të punës që i nënshtohen inspektimit;

b) numrin mesatar të personave të punësuar në këto vende gjatë vitit;

c) veçoritë e klasifikimit të personave të punësuar sipas ndarjeve: burra dhe gra sipas grup-moshave.

2. Inspektorët dhe zyrat lokale të inspektoratit, sipas rastit, paraqesin pranë inspektorit të përgjithshëm raporte periodike për rezultatet e veprimtarive të tyre inspektuese.

3. Këto raporte hartohen në mënyrë të tillë dhe trajtojnë çështje të tilla siç parashikohen herë pas here nga organi qendror. Ato duhet të paraqiten sa herë kërkohen nga ky organ, por në çdo rast jo më pak se një herë në vit.

Neni 24

Raporti vjetor

1. Inspektori i përgjithshëm publikon një raport të përgjithshëm vjetor për punën e shërbimeve të inspektimit që ai drejton.

2. Një raport i tillë vjetor i paraqitet ministrit brenda një periudhe prej tre muajsh, Kuvendit Popullor brenda gjashtë muajsh dhe publikohet brenda 12 muajsh pas mbarimit të vitit të cilit ai i përket.

KREU VIII

PROCEDURA DHE SANKSIONE

Neni 25

Procedura

1. Personat që shkelin ose nuk respektojnë dispozitat **LIGJ**ore,

zbatimi i të cilave sigurohet nga inspektorët, i nënshtrohen procedurave **LIGJ**ore të menjëhershme pa paralajmërim.

2. Në rast të shkeljeve nga punëdhënësi të orëve të punës dhe të masave mbi kushtet e punës, ai paralajmërohet që të marrë masa për ndreqjen ose parandalimin e tyre.

3. I lihet gjykimit të inspektorëve nëse duhet paralajmëruar dhe këshilluar apo të marrin masat e tjera të parashikuara në këtë **LIGJ**.

Neni 26

Sanksione

1. Sanksionet për shkeljen e dispozitave të legjislacionit të punës, zbatimi i të cilave sigurohet nga inspektorët dhe për pengimin e inspektorëve në kryerjen e detyrave të tyre, përfshijnë:

a) gjobë deri në 50 herë të pagës minimale;

b) nëse kjo shkelje përbën vepër penale zbatohen dispozitat e Kodit Penal.

2. Ekzekutimi i **VENDIM**eve të dënimit me gjobë bëhet sipas **LIGJ**it nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative".

Neni 27

Apelimet

Kundër **VENDIM**eve të inspektoratit bëhet ankim te Inspektori i Përgjithshëm brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të **VENDIM**it, i cili brenda 15 ditëve duhet të shprehet me një **VENDIM**. Kundër **VENDIM**it të Inspektorit të Përgjithshëm bëhet ankim në gjykatë brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të **VENDIM**it.

KREU IX

DISPOZITAT E PERKOHSHME DHE PERFUNDIMTARE

Neni 28

Këshilli i Ministrave nxjerr rregulla për zbatimin e dispozitave të **LIGJ**it "Për Inspektoratin Shtetëror të Punës".

Neni 29

VENDIMi i Këshillit të Ministrave nr.600, datë 20.12.1993 "Për krijimin e inspektoratit të punës" dhe çdo dispozitë që bie në kundërshtim me këtë **LIGJ**, shfuqizohet.

Neni 30

Ky **LIGJ** hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1229, datë 26.9.1995 të Presidentit të
Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha

VENDIM

Nr.470, datë 12.9.1994

PER RREGULLIMIN E KOHES SE PUNES DHE PUSHIMIT NE INSTITUCIONET BUXHETORE TE SISTEMIT TE MINISTRISE SE KULTURES, RINISE DHE SPORTEVE

Në zbatim të **LIGJ**it nr.7742, datë 21.6.1993 "Për rregullimin e kohës së punës dhe të pushimit", me propozimin e Ministrisë së Kulturës, të Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në institucionet buxhetore të sistemit të Ministrisë së Kulturës, të Rinisë dhe Sporteve koha javore e punës është jo më pak se 40 orë, e ndarë si rregull në pesë ditë me 8 orë në ditë.

2. Në institucione të veçanta që zhvillojnë veprimtari artistike skenike, artistike dhe punonjësit e profesioneve të tjera që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me skenën, në institucionet që zhvillojnë veprimtari sportive, si dhe në institucionet e prodhimit të filmit në periudhën e xhirimit e të montim-dublimit, punohet 6 ditë në javë, por jo më pak se 40 orë në javë.

Detyra, funksionet dhe ditët kur do të bëhet pushimi në institucionet që do të punojnë 6 ditë në javë, përcaktohen nga drejtuesi i institucionit përkatës.

3. Për punën e kryer në ditën e gjashtë punonjësit i jepet pushim brenda vitit kalendarik sipas përcaktimit që do të bëhet në rregulloren e brendshme të institucionit.

4. Drejtoritë e institucioneve kulturore, artistike të rinisë dhe sporteve kanë në kompetencë rregullimin e kohës ditore të punës, si dhe përcaktojnë sipas specifikave fillimin dhe mbarimin e kohës së punës, mbikohën e punës, pushimin gjatë kohës së punës dhe ditën kur do të bëhet pushimi javor.

5. Për punën e kryer para ose pas kohës së punës në ditët e zakonshme dhe në ato të pushimit të festave zyrtare, punonjësve në sektorin e mirëmbajtjes e të shërbimit, daktilografisteve, pastrueseve, rojave, portierëve, shoferëve e magazinierëve u jepet pushim ose u paguhet deri në 240 orë në vit.

6. Për punën e kryer në mbikohë, me **VENDIM** të drejtuesit të institucionit, punëmarrësit i jepet pushim ose paguhet si vijon:

a) Për mbikohën para dhe pas kohës së punës paguhet shtesë prej 25 për qind e pagës.

b) Për mbikohën në ditët e diela dhe të festave zyrtare paguhet shtesë prej 50 për qind e pagës.

7. Punëmarrësve që përcaktohen në pikën 5 të këtij

VENDIMi për të cilët koha javore e punës rregullohet sipas pikës 1, kur me **VENDIM** të drejtuesit të institucionit punojnë

ditën e shtunë, u jepet pushim ose u paguhet puna e kryer si në ditët e zakonshme.

8. Punëmarrësve të institucioneve buxhetore të sistemit të kulturës, rinisë dhe sporteve që nuk përmenden në pikën 5, u quhet mbikohë vetëm koha e punës mbi kohën normale për plotësimin e detyrave të ngarkuara nga drejtuesi i institucionit, jashtë detyrës së tyre funksionale.

Pagesa në këto raste bëhet me **VENDIM** të drejtuesit të institucionit në masën që përcaktohet në pikën 6 të këtij **VENDIMI**.

9. Pushimi vjetor i pagueshëm për punëmarrësit e institucionit buxhetor të sistemit të kulturës, rinisë dhe sporteve është jo më pak se 12 ditë dhe jo më shumë se 21 ditë.

Diferencimi për efekt të moshës, vjetërsisë së përgjithshme në punë dhe llojit të punës bëhet duke shtuar ditë pushimi mbi pushimin vjetor minimal, që është 12 ditë sipas ndarjeve të mëposhtme:

a) Moshë në vjeç Ditët që shtohen

deri në 30 vjeç 0 ditë

mbi 30 deri në 40 vjeç 1 ditë

mbi 40 deri në 50 vjeç 2 ditë

mbi 50 vjeç 3 ditë

b) Vjetërsia në punë (në vite) Ditët që shtohen

mbi 5 deri në 15 vjet 1 ditë

mbi 15 deri në 25 vjet 2 ditë

mbi 25 vjet 3 ditë

c) Lloji i punës Ditët që shtohen

Grupi III 1 ditë

grupi II 2 ditë

grupi I 3 ditë

Në grupin e tretë hyjnë të gjithë punonjësit që në tabelën e pagave klasifikohen nga klasa 17 deri në 21.

Në grupin e dytë dhe të parë nuk ka asnjë kategori punëmarrësish të institucioneve të këtij sistemi.

Pushimi vjetor për punëmarrësit që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç, është 16 ditë pune.

10. Punëmarrësit në institucionet e artit, kulturës, sportit dhe punëmarrësit e sektorit kërkimor-shkencor kanë të drejtë të marrin:

a) Pushim plotësues 8 ditë sipas zërave të paraqitur në lidhjen që i bashkëngjitet këtij **VENDIMI**.

b) Pushim të veçantë të pagueshëm për periudhën gjatë së cilës ata ushtrojnë veprimtari të veçantë krijuese.

- Kriteret për dhënien e këtij pushimi përcaktohen me

UDHËZIMet e Ministrisë së Kulturës, të Rinisë dhe Sporteve.

- Kohëzgjatja e këtij pushimi është jo më shumë se 4 ditë në muaj. Kjo përcaktohet me **VENDIM** të drejtuesit të institucionit.

- Masa e pagesës është si në ditët e zakonshme.

- Ky pushim nuk llogaritet në pushimin vjetor dhe në atë plotësues.

11. Punëmarrësit kanë të drejtë për pushim të jashtëzakonshëm të papagueshëm deri në 3 muaj në vit, kur ky nuk i sjell dëm punës, në këto raste:

- a) Martesë dhe vdekje në pjesëtarët e familjes.
- b) Përkujdesje për anëtarët e familjes.
- c) Fatkeqësi në familje.

Pushim i jashtëzakonshëm jepet vetëm me urdhrin e drejtuesit të institucionit.

12. Efektet ekonomike do të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Kulturës, të Rinisë dhe Sporteve.

13. Pika "E" e "Listës së kategorive të punonjësve që përfitojnë pushim plotësues", të **VENDIM**it të Këshillit të Ministrave nr.46, datë 11.4.1968 "Për pushimin plotësues", si dhe çdo dispozitë që bie në kundërshtim me këtë **VENDIM**, shfuqizohen.

Ky **VENDIM** hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE

Aleksandër Meksi

NE SEKTORIN E ARTIT, KULTURES DHE SPORTIT

1. Në Teatrin e Operas dhe të Ansamblit Popullor.

- a) Regjisorët, solistët, artistët lirikë, koreografët e baletit, dirigjentët, baletmaestrot dhe skenografët.
- b) Orkestrantët, udhëheqësit artistikë, pianistët, koristët, ndihmësdirektantët, ndihmësregjisorët dhe koncertmaestri, valltarët dhe këngëtarët popullorë.

2. Në teatrin e dramës në qendër dhe në rrethe, në teatrin e kukullave dhe në institucionet e prodhimit të filmit:

- a) Udhëheqësit artistikë, regjisorët, aktorët dhe skenografët.
- b) Regjisorët, skenaristët, piktorët dhe operatorët e kinostudios.

3. Në cirk, estradat në qendër e rrethe dhe në shtëpitë e kulturës:

- a) Akrobatët, dirigjentët, orkestrantët dhe udhëheqësit artistikë.
- b) Regjisorët, aktorët, solistët, orkestrantët dhe skenografët.

4. Në Institutin e Monumenteve të Kulturës, në Galerinë e Arteve dhe në Qendrën e Realizimit të Veprave të Artit:

- a) Skulptorët dhe piktorët e kulturës monumentale.
- b) Piktorët restauratorë.

5. Në Institutin e Federatës së Sporteve:

- a) Në federatat dhe klubet sportive shumësportëshe dhe të futbollit në qendër e në rrethe.
- b) Sekretarët e federatave dhe të klubeve sportive.

c) Inspektorët e federatave dhe të klubeve sportive, si dhe trajnerët efektivë.

VENDIM

Nr. 400, date 22.8.1994

PER NJE SHITES NE **VENDIMIN** E KESHILLIT TE MINISTRAVE NR. 314, DATE 30.6.1993
"PER RREGULLIMIN E KOHES SE PUNES DHE TE PUSHIMIT NE MINISTRI,
INSTITUCIONE TE TJERA QENDRORE DHE ORGANET E PUSHTETIT LOKAL"

Ne zbatim te **LIGJIT** nr. 7724, date 22.6.1993 "Per rregullimin e kohes se punes dhe pushimit",
Keshilli i Ministrave,

VENDOSI

Ne **VENDIMIN** e Keshillit te Ministrave nr. 314, date 30.06.1993 "Per rregullimin e kohes se
punes dhe te pushimit ne Ministri, institucionet e tjera qendrore dhe organet e pushtetit lokal",
pas pikes 3 shtohet pika 3/1 me kete permbajtje:

"Per punemarresit qe punojne ne nderresat e dyta dhe te treta caktohet shtese page ne masen
20 per qind dhe 50 perqind e pages per kohen e punes se nderreses se pare"

Ky **VENDIM** hyn ne fuqi menjehere.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE

Aleksander Meksi

V E N D I M

Nr.297, datë 30.6.1994

PER RREGULLIMIN E KOHES SE PUNES DHE PUSHIMIT NE INSTITUCIONET SHENDETESORE

Në zbatim të **LIGJ**it nr.7724, datë 22.6.1993 "Për rregullimin e kohës së punës dhe të pushimit", me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Koha javore e punës është 40 orë. Rregullimi i kohës së punës në institucionet shëndetësore bëhet me **UDHËZIM** të Ministrisë së Shëndetësisë, duke u bazuar në specifikat e institucioneve shëndetësore.
2. Niveli i pagës mujore të çdo punëmarrësi nuk ndryshon. Për efekt të llogaritjes së pagës mujore, muaji merret mesatarisht 21 ditë efektive pune.
3. Punëmarrësve për punën e tyre në ndërresën e dytë, u paguhet një shtesë në pagë 20 për qind të pagës në ndërresën e parë, kurse për punën e tyre në ndërresën e tretë u paguhet një shtesë në pagë 50 për qind të pagës në ndërresën e parë.
4. Për vitin 1994, duke filluar nga data 1 korrik 1994, punëmarrësit do t'i paguhet vetëm shtesa për ndërresën e tretë në masën 20 për qind të pagës në ndërresën e parë.
5. Punëmarrësi që punon ditët e diela ose të festave zyrtare, për orët e punuara kompensohet me ditë pushimi gjatë javës.
6. Pushimi vjetor i pagueshëm për punëmarrësit në sektorin e shëndetësisë është 12 deri në 21 ditë pune.
Diferenca për efekt të moshës, vjetërsisë së përgjithshme në punë, llojit të punës dhe llojit të punës sipas funksioneve bëhet duke shtuar ditë pushimi mbi pushimin nominal që është 12 ditë sipas ndarjeve të mëposhtme:
 - a) Mosha (në vite) Ditë që shtohen
Deri në 30 0 ditë
Mbi 30-40 1 ditë
Mbi 40-50 2 ditë
Mbi 50 3 ditë
 - b) Vjetërsia në punë (në vite) Ditë që shtohen
Deri në 5 0 ditë
Mbi 5-15 1 ditë
Mbi 15-25 2 ditë
Mbi 25 3 ditë
 - c) LLoji i punës (në grupe) Ditë që shtohen
Grupi IV 0 ditë
" III 1 ditë
" II 2 ditë

- Në grupin IV përfshihen personeli i mesëm shëndetësor, nëpunësit e thjeshtë dhe punëtorët.
 - Në grupin III përfshihen specialistët me arsim të lartë, shefat e reparteve, kryetarët e degëve dhe punëmarrësit e tjerë që kanë të njëjtën shkallë me ta në pagë.
 - Në grupin II përfshihen zëvendësdrejtorët, drejtorët dhe punëmarrësit që kanë të njëjtën shkallë me ta në pagë.
7. Në varësi nga lloji i punës (ndarë në grupe sipas funksioneve në organikë) punëmarrësit marrin pushim plotësues si më poshtë:

Lloji i punës (në grupe) Ditë pushimi plotësues

Grupi IV 0 ditë

Grupi III 2 ditë

Grupi II 5 ditë

- Pushimi vjetor për punëmarrësit që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç, është 18 ditë.

8. Punëmarrësit i jepet pushim i jashtëzakonshëm i papagueshëm deri në 3 muaj në vit, kur ky nuk sjell dëm për punën, në këto raste:

- a) Vdekje dhe martesë në pjesëtarët e familjes.
- b) Përkujdesje për anëtarët e familjes.
- c) Fatkeqësi në familje.

Pushimi i jashtëzakonshëm jepet me urdhër të titullarit të institucionit.

9. Në shëndetësi lejohet puna e grave në ndërresën e tretë.

10. Efekti financiar për vitin 1994 prej 9 milionë lekësh përballohet nga buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

11. Për zbatimin e këtij **VENDIMI** ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit për të nxjerrë **UDHËZIMET** përkatëse.

Ky **VENDIM** hyn në fuqi menjëherë, me përjashtim të pikës 3 që hyn në fuqi më 1.1.1995.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

V E N D I M

Nr.314, datë 30.6.1993

PER RREGULLIMIN E KOHES SE PUNES DHE TE PUSHIMIT NE MINISTRITE, DHE INSTITUCIONET E TJERA QENDRORE DHE ORGANET E PUSHTETIT LOKAL

Në zbatim të **LIGJ**it nr.7724, datë 22.6.1993 "Për rregullimin e kohës së punës dhe të pushimit",
Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Në ministritë e në institucionet e tjera qendrore dhe në organet e pushtetit lokal koha e punës është 8 orë në ditë. Puna fillon në orën 7.00 dhe mbaron në orën 15.00.
2. Koha javore e punës është 40 orë, të ndara në 5 ditë pune, nga dita e hënë deri ditën e premte. Niveli i pagës mujore të çdo punëmarrësi nuk ndryshon. Për efekt të llogaritjes së pagës mujore muaji merret mesatarisht me 21 ditë efektive pune.
3. Për punën e kryer para dhe pas kohës së punës në ditët e zakonshme, si dhe në ditët e pushimit dhe të festave zyrtare, punëmarrësve në sektorin e shërbimit e të mirëmbajtjes, daktilografistëve, shumëfishuesve, portierëve, rojave, shoferëve, centralistëve e magazinierëve u jepet pushim ose u paguhen deri 240 orë në vit.
Pagesa për punën e kryer në mbikohë bëhet me urdhër të titullarit si vijon:
 - a) Për mbikohën para dhe pas kohës së punës paguhet shtesë prej 25 për qind të pagës.
 - b) Për mbikohën në ditët e diela dhe të festave zyrtare paguhet shtesë prej 50 për qind të pagës.
4. Punëmarrësve që përcaktohen në pikën 3 të këtij **VENDIMI**, kur me urdhër të titullarit punojnë ditën e shtunë, u jepet pushim ose u paguhet puna e kryer si në ditët e zakonshme.
5. Punëmarrësve të ministrive e institucioneve të tjera qendrore dhe të organeve të pushtetit lokal që nuk përcaktohen në pikën 3 të këtij **VENDIMI**, u quhet mbikohë vetëm koha e punës mbi kohën normale, për plotësimin e detyrave të ngarkuara nga titullari.
Pagesa në këto raste bëhet me urdhër të titullarit në masën që përcaktohet në pikën 3 të këtij **VENDIMI**.
6. Pushimi vjetor i pagueshëm për punëmarrësit e ministrive e të institucioneve të tjera qendrore dhe të organeve të pushtetit lokal është 12 deri 21 ditë pune.
Diferencimi për efekt të moshës, vjetërsisë së përgjithshme në punë dhe llojit të punës bëhet duke shtuar ditë pushimi mbi

pushimin minimal, që është 12 ditë, sipas ndarjeve të mëposhtme:

a) Moshë Ditët që shtohen
(në vjeç)

deri në 30 0 ditë
mbi 30 deri 40 1 ditë
mbi 40 deri 50 2 ditë
mbi 50 3 ditë

b) Vjetërsia në punë Ditët që shtohen
(në vite)

deri në 5 0 ditë
mbi 5-15 1 ditë
mbi 15-25 2 ditë
mbi 25 3 ditë

c) Lloji i punës Ditët që shtohen
(në grupe)

Grupi IV 0 ditë
Grupi III 1 ditë
Grupi II 2 ditë
Grupi I 3 ditë

Në grupin IV përfshihen punëmarrësit që përmenden në pikën 3 të këtij **VENDIMI**.

Në grupin III përfshihen specialistët, shefat e sektorëve ose seksioneve, kryetarët e degëve dhe punëmarrësit e tjerë të një shkalle me ta në pagë.

Në grupin II përfshihen zëvendësministrat, drejtorët e drejtorive, kryetarët e këshillave të rretheve e bashkive dhe funksionarë të tjerë të një shkalle me ta në pagë.

Në grupin I përfshihen Kryeministri, zëvendëskryeministrat, ministrat dhe funksionarë të tjerë të lartë të një shkalle me ta në pagë.

Pushimi vjetor për punëmarrësit që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç, është 18 ditë pune.

7. Në varësi nga lloji i punës (ndarë në grupe sipas funksioneve në organikë) punëmarrësit marrin pushim plotësues të pagueshëm si vijon:

Lloji i punës Ditët e pushimit plotësues
(në grupe)

Grupi IV 0 ditë
Grupi III 2 ditë
Grupi II 5 ditë
Grupi I 8 ditë

Ndarja në grupe është sipas pikës 6 të këtij **VENDIMI**.

8. Punëmarrësit kanë të drejtë për pushim të jashtëzakonshëm të papagueshëm deri në 3 muaj në vit, kur ky nuk i sjell dëm punës, në këto raste:

- a) vdekje dhe martesë në pjestarë të familjes;
- b) përkujdesje për anëtarë të familjes;
- c) fatkeqësi në familje.

Pushimi i jashtëzakonshëm i papagueshëm jepet vetëm me urdhër të titullarit.

9. Efektet financiare për vitin 1993 të përballohen nga çdo ministri, institucion tjetër qendror dhe organ i pushtetit lokal brenda fondeve të miratuara.

Ky **VENDIM** hyn në fuqi më 1 korrik 1993.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE
ALEKSANDER MEKSI

L I G J

PER MARREDHEINIET E PUNES

Ne mbështetje të nenit 16 të **LIGJ**it nr.7491 datë 29.4.1991
" Për dispozitat kryesore kushtetuese ", me propozimin e
Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I :

I. Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Legjislacioni i punës bazohet në dispozitat kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Ai merr parasysh, njëherë e respektuar parimet dhe normat përgjithësisht të pranueshme të së drejtës kombëtare.

Neni 2

Punëdhëniesit (personat juridike e fizike, shqiptarë a të huaj) dhe të punësuarit (punëtorët e nepunësit) kanë për detyrë të respektojnë në mënyrë të përpiktë legjislacionin e punës.

Neni 3

Marredheniet juridike të punës janë marrëdhënie me shpërblim, prej të cilave burojnë të drejta dhe detyrime që parashikohen në kontratën e punës.

II. Lindja e marrëdhënies juridike të punës

Neni 4

Marredheniet e punës lindin mbi bazën e marrëveshjes që lidhen ndërmjet të punësuarit dhe punëdhëniesit, me anën e së cilit i punësuarit detyrohet të punojë në një vend pune sipas profesionit, specialitetit ose sipas kushteve të tjera të përcaktuara në marrëveshje, duke iu nënshtruar rendit të brendshëm të punës, kurse punëdhënësi detyrohet që kundërshtuar kësaj pune të japë atij një pagë të caktuar dhe të sigurojë kushte normale pune.

Neni 5

Pranohet në punë personi që ka mbushur 16 vjeç.
Kontrata e punës lidhet me shkrim, përndryshe quhet e pavlefshme. Ajo regjistrohet në regjistrat përkatës të

punedhenesit.

Neni 6

Kushtete domosdoshme te kontrates se punes jane :

- a) LLoji i punes (profesioni, specialiteti) per te cilin i punesuari eshte marre ne pune.
- b) vendi i punes (rrethi, qyteti, fshati, personi juridik e fizik, shqiptar a i huaj) ku do te punoje i punesuari.
- c) Data e hyrjes ne pune.
- ç) Kushtet e punes e te mbrojtjes individuale e kolektive.

Kontrata e punes mund te permbaje edhe kushte te tera qe paraqesin rendesi per dyja palet.

Neni 7

Kontrata e punes eshte individuale ose e lidhur me nje grup personash. Me lidhjen e nje kontrate pune me nje grup personash, ndermjet paleve linden po ato te drejta e detyrimeve qe linden nga kontrata e punes individuale.

Neni 8

I punesuari mund te kryeje edhe me shume se nje lloj pune te nje a me shume punedhenes, brenda ose jashte kohes normale te punes.

Kontrata e punes mund te lidhet edhe per pune qe kryhen ne shtepi.

Neni 9

Kontrata e punes lidhet :

- a) Per nje kohe te pacaktuar.
- b) Per nje kohe te caktuar, e cila nuk mund te jete me teper se nje vit. Kur i punesuari mbahet ne pune tej ketij afati, kontrata quhet e lidhur per nje kohe te pacaktuar.
- c) Per kohen qe nevojitet per kryerjen e nje pune te caktuar.

Neni 10

I punesuari para se te pranohet ne pune, mund te merret ne prove. Koha e proves zgjat gjer ne tre muaj dhe eshte e pagueshme sipas kontrates. Koha e proves njihet si vjetersi ne pune.

Neni 11

Personi qe merret ne pune per here te pare, pajiset me librezen e punes nga punedhenesi. Libreza e punes te jete unike per te gjitha te punesuarit, sipas modelit te percaktuar nga organi kompetent.

Neni 12

Eshte e pavlefshme kontrate e punes qe permbajn kushte ne

kundershtim me **LIGJin**, kontraten kolektive ose qe keqeson gjendjen e te punesuarit, zbut pergjegjesine e paleve per moskryerjen e detyrimeve ose tejkalon masen e caktuar te drejtave te tyre.

Neni 13

Te drejtat dhe detyrimet ndermjet te punesuarit dhe punedhenesit rregullohen ne baze te dispozitave te legjislacionit te punes, edhe kur kontrata e punes eshte e pavlefshme, por i punesuari ka qene ne mirebesim.

Neni 14

Marredheniet e punes lindin edhe nga zgjedhja ose emerimi ne nje detyre te caktuar, sipas dispozitave te vecanta.

Neni 15

Kontrata kolektive e punes lidhet ndermjet sindikatave dhe punedhenesve.

Kontrata kolektive e punes lidhet per 1 vit.

Neni 16

Me kontraten kolektive te punes palet marrin persiper detyrime dhe fitojne te drjta qe kane te bejne me marredheniet juridike te punes e te sigurimeve shoqerore.

Kontrata kolektive e punes nuk mund te parashikoje per palet tedrejta e detyrime qe jane ne kundershtim me **LIGJ**et. Kontratat jane te pavlefshme per pjeset e tyre qe bien ne kundershtim me **LIGJin**.

Neni 17

Projekti i kontrates kolektive hartohet nga organet drejtuese te sindikatave (keshilli drejtues) dhe i jepet per diskutim anetareve te sindikates. Pasi merren mendimet e tyre hartohet teksti perfundimtar i saj, i cili nenshkruhet nga perfaqesuesit e paleve kontraktuese.

Kontrata kolektive lidhet brenda muajit dhjetor te vitit paraardher per vitin pasardhes.

Kur palet kontraktuese nuk bien dakort per kushtet themelore te kontrates kolektive te punes, mbi ankimin e seciles pale ose vetem te njeres pale, ceshtja zgjidhet nga gjykata e rrethit ku e ka qendren e veprimtarise punedhenesi. Ne keto raste ankimi ne gjykate behet brenda 5 diteve nga dita kur palet nuk jane marre vesh per kushtet e kontrates. Palet percaktojne me shkrin kushtet, per te cilat nuk jane marre vesh.

VENDIMI i gjykates eshte i formes se prere.

Neni 18

Gjate kohes se zbatimit te kontrates kolektive, palet kontraktuese, ne marrevshje ndermjet tyre, mund ti bejne asaj ndryshimet dhe plotesimet e nevojshme.

Neni 19

Palet kontraktuese ne kontraten kolektive te punes jane te detyruar te zbatojne me perpikmeri kushtet e kontrates. Kontrata kolektive nuk mund te zgjidhet ne menyre tenjeaneshme.

Kur gjate zbatimit te kontrates kolektive lindin mosmarrevshje, kur keto duhet te zgjidhen me bisedime ndermjet paleve, dhe kur palet nuk bien dakort ndermjet tyre, ceshtja zgjidhet ne rruge gjyqesore.

Neni 20

Ne rast moszbatimi te pjesshem ose te plote te kontrates kolektive nga punedhenesi, keshilli sindikal nderhyn per zgjidhjen e ceshtjes me mirekuptim dhe propozon marrjen e masave konkrete, si te masave disiplinore ndaj personave, per fajin e te cileve eshte penguar realizimi i kesaj kontrate. Kur punedhenesi nuk eshte dakort me propozimet e keshillit sindikal, ky i fundit ka te drejte te protesotoje kunder veprimeve te punedhenesit me mjetet qe i lejon **LIGJi**, ose brenda pese diteve mund te kerkoje zgjidhjen e mosmarrevshjes ne rruge gjyqesore

Ne rast moszbatimi te pjesshem ose te plote te kontrates kolektive nga keshilli sindikal, punedhenesi ka te drejte ti drejtohet gjykates e te kerkoje zbatimin e kontrates dhe marrjen e masave disiplinore kunder personave, per fajin e te cileve eshte penguar realizimi i kontrates kolektive.

Neni 21

Per mospermbushjen e plote ose te pjesshem te detyrimit palet kontraktuese detyrohen ti paguajne njera tjetres si kusht disiplinor nje shume te hollash ne masen e caktuar ne kontraten kolektive te lidhur ndermjet tyre.

Neni 22

Rrregullat per kushtet themelore te kontrates kolektive te punes, percaktohen nga Keshilli i Ministrave.

Neni 23

Punonjesi qe punen jashte kohes normale te punes, ne ditet e pushimit a ne ditet e festave zyrtare, paguhet me dyfishin e pages qe merr ne ditet e zakonshme te punes.

IV. Transferimi (ndryshimi i marredhenieve juridike te punes)

Neni 24

Punendhenesi nuk ka te drejte te transferoje te punesuarin

pa pelqimin e tij nen nje pune te nje profesioni ose specialiteti te ndryshem nga ai, per te cilin eshte marre ne pune dhe as ka te drejte ta transferoje ne nje vend tjeter, edhe ne te njejtin profesion ose specialitet, te percaktuara ne kontraten e punes.

Neni 25

I punesuari, kur nderpriten punimet ose per nevoja prodhimi mund te transferohet nga punedhenesi perkohesisht ne nje pune tjeter, por jo me shume se nje muaj.

Neni 26

Punedhenesi eshte i detyruar ta transferoje te punesuarin ne nje pune me te pershtatshme, po ne ate qender pune, ne qoftese ai per shkak semundjeje (ose gruaja per shkak shtatezanie) behet i paafte per punen e meparshme, per aq kohe sa caktohet ne raportin mjekesor.

Punedhenesi, kur nuk ka vende te pershtatshme qe tu pergjigjen gjendjes shendetesore te te punesuarit, detyrohet ta sistemoje kete ne nje pune te pershtatshme te nje punedhenes tjeter ne te njejtin vend. Kur nuk eshte e mundur te gjendet nje pune e pershtatshme, te punesuarit i jepet paga deri ne riaftesim ose deri ne gjetjen e nje pune tjeter te pershtatshme.

Neni 27

Urdheri i transferimit duhet ti njoftohet te punesuarit me shkrim.

Ne urdherin e transferimit percaktohet lloji, vendi i punes dhe paga perkatese.

V.Largimi nga puna(zgjidhja e marredhenies juridike te punes)

Neni 28

Marredhenia e punes zgjidhet:

- a) Me marreveshje te paleve
- b) Me mbarimin e kohes se caktuar
- c) Me mbarimin e kohes se caktuar
- ç) me Kerkesen e te punesuarit ose te punedhenesit.
- d) Ne raste te tjera te parashikuara me dispozita **LIGJore**.

Neni 29

Kur marredhenia e punes zgjidhet me kerkesen e te punesuarit, duhet te respektohet afati i paralajmerimit i parashikuar ne kontrate.

Kur ky afat nuk eshte percaktuar, i punesuari duhet ta njoftoje punedhenesin 15 dite me pare per largimin e tij.

Neni 30

Punedhenesi ka te drejte te largoje nga pune te punesuarin,
kur :

- a) I ka lindur e drejta e pensionit te plote te pleqerise.
 - b) Eshte i paaftte nga pikpamja profesionale per te kryer punen ose detyren e caktuar.
 - c) Shperndahet personi juridik, behet shkurtimi ne personelin e organikes a ne numrin e punetoreve, ose nderpriten punimet.
 - ç) Eshte marre ne pune ne kundershtim me dispozitat **LIGJore**.
 - d) Nuk permbush sistematikisht detyrat e punes pa shkaqe te arsyeshme.
 - dh) Mungon ne pune pa shkaqe te arsyeshme.
 - e) Sipas **VENDIM**it te organit perkates duhet te zere vendin e nje puntor ose nenpunes tjetër qe e kishte kete vend me pare, por qe eshte larguar padrejtesisht.
 - e) I punesuari kryen nje veper penale qe ka lidhje me punen e tij dhe kjo provohet me **VENDIM** te formes se prere te gjykates,ose denohet e vuan nje denim me heqje lirie me teper se dy muaj.
 - f) I punesuari me **VENDIM** te formes se prere te gjykates denohet me ndalimin e ushtrimit te nje veprimtarie a mjeshterie te caktuar.
 - g) Me **VENDIM** te arsyetuar te hetuesit, te miratuar nga prokurotori, merret si i pandehur ne gjendje te lire per nje veper penale qe ka lidhje me detyren.
 - gj) I Punesuari thirret per te kryer sherbimin e detyrueshem ushtarak.
- Ne rastet e parashikuara nga shkronjat "ç", "e" dhe "gj" te ketij neni, i punesuari njoftohet 15 dite me pare.

Neni 31

Kur i punesuari ndodhet me leje vjetore, plotesuese ose shendetesore, punedhenesi nuk mund te largoje ate nga puna, pervec rasteve kur denohet per nje veper penale me heqje te lirise.

Neni 32

Kur zgjidhet marredhenia e punes, ne librezen e punes te te punesuarit shenohen shkaqet e largimit nga puna, si dhe dispozita perkatese, ne baze te te cilave zgjidhen marredhenia e punes.

VI.Zgjidhja e mosmarreveshjes ne pune

Neni 33

Per mosmarreveshjet qe lindin ndermjet tij dhe punedheniesit, kur nuk ka qene e mundur te zgjidhen drejtpersedrejti ndermjet tyre, i punesuari ka te drejte te ankohet ne gjykaten e rrethit brenda 10 diteve nga data e njoftimit te **VENDIM**it te punedhenesit.

Gjykata e rrethit mund te marre ne shqyrtim ankesen e paraqitur nga i punesuari edhe pas kalimit te afatit 10 ditor, kur ka rrethana qe cmohen te per**LIGJ**ura prej saj.

Neni 34

Masat disiplinore te parashikuara nga shkronja "a", "b" dhe "c" te nenit 83 te Kodit te Punes, jepen nga punedhenesi dhe jane te formes se prere.

Neni 35

Kreu I, II,III,IV,XI e XII i Kodit te Punes dhe cdo dispozite tjeter qe eshte ne kundersiztim me kete **LIGJ**, shfuqizohen.

Neni 36

Ky **LIGJ** hyn ne fuqi menjehere.
Tirane,me 3.12.1991
Nr. i **LIGJ**it 7526

Shpallur me dekretin nr.84 date 9.12.1991 te Presidentit te Republikes se Shqiperise Ramiz Alia.

L I G J

PER PUNESIMIN E SHTETASVE SHQIPTARE JASHTE TERRITORIT RE REPUBLIKES SE SHQIPERISE

Duke u bazuar ne te drejten e njeriut per ushtrimin e lire te punes e te profesionit, ne mbeshtetje te nenit 16 te **LIGJit** nr.7491 date 29.4.1991 " Per dispozitat kryesore kushtetuese ", me propozimin e Keshillit te Ministrave,

KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I

Neni 1

Shtetasi shqiptar i afts per pune, me kerkesen e tij prane organit kompetent shteteror, ka te drejte te punesohet edhe jashte territori te Republikes se Shqiperise.

Neni 2

Te drejten e punesimit jashte territorit te Republikes se Shqiperise nuk mund te ushtrojne :

- a) personat qe nuk kane mbushur moshen 18 vjec
- b) personat qe kane per te kryer sherbimin ushtarake,
- c) personat e denuar penalisht si dhe ata kunder te cileve ka filluar ndjekja penale deri ne perfundimin e saj ,
- ç) personat, ndaj te cileve institucioni,ndermarrja, organizata ose individi ngrene pretendime per detyrime materiale deri ne shqyrtimin perfundimtar te tyre dhe ne shlyerjen e plote te detyrimit,
- d) personat qe kane detyrime familjare te pazgjdhura te parashikuara ne Kodin e Familjes me perjashtim te rastit kur japin garanci **LIGJore** per permbushjen e detyrimeve,
- dh) te gjithë pjestaret e forcave te armatosura ,
- e) personat t cileve me **VENDIM** te gjykates u eshte hequr zotesia per te vepruar.

Neni 3

Punesimi jashte shtetit behet ne baze te legjislacionit te punes te Republikes se Shqiperise dhe te vendit kur behet punesimi.

Neni 4

Punesimi jashte shtetit mund te behet ne grupe ose ne menyre individuale, mbi bazen e kontrates qe lidhet me punedhenesin e huaj. Kontratat mund te jene kolektive ose individuale.

Neni 5

Afati i punesimit eshte nga nje muaj deri ne pese vjet. Ky afat mund te agjatet mbi bazen e nenshkrimt te nje kontrate te re.

Neni 6

Per punesimin e shtetasve shqiptare jashte shtetit lidhen marreveshje qeveritare me vende perkatese.

Komiteti i Punes dhe i Perkrahes Sociale drejton, organizon e kontrollon punesimin e shtetasve shqiptare jashte territorit te Republikese se Shqiperise.

Ne varesi te ketij Komiteti,ngrihet e funksionon Zyra e Emigracionit me deget e saj ne shtete te huaja, te cilat mbrojne interesat e shtetasve shqiptare te punesuar ne to.

Neni 7

Komiteti i Punes dhe i Perkrahes Sociale lidh marreveshje punesimi me organet perkatese ose personat juridike a fizike te shteteve te tjera. Lejohet kontrata individuale e punesimit.

Zyra e Emigracionit me deget e saj ne shtetet e huaja si dhe personat juridike a fizike vendas, lidh kontrata punesimi dhe ndjekin plotesimin e tyre, duke vene ne dijeni Komitetin e Punes dhe te Perkrahes Sociale.

Neni 8

Kushtet e punes e te jeteses, pagat, ndihmat, paaftesia e perkohshme dhe e perhershme ne pune, pensionet, si dhe llojet e tjera te sigurimeve shoqerore te detyrueshme, transportimi i punonjsve dhe ceshtje te tjera te kesaj natyre, rregullohen ne baze te marrveshjeve te kontrates.

Neni 9

Zyra e Emigracionit u siguron personave qe do te punesohen jashte shtetit nje informacion te plote per legjislacionin dhe rregullat e punes e te jeteses te vendit perkates.

Neni 10

Koha e punes jashte shtetit i njihet e vlefshme punonjesit per efekt pensioni, kur ai kthehet ne atdhe me zgjidhjen e kontrates dhe kur paguan kuoten mujore te sigurimeve shoqerore te caktuara me dispozita te Keshillit te Ministrave.

Neni 11

Shtetasit qe punesohen jashte shtetit paguajne nje takse mbi te ardhuratt mujore.

Neni 12.

Rregjistrimi dhe zgjedhja e punonjesve qe do te punesohen jashte shtetit behet mbi bazen e kerkesave (testeve) te punedhenesit te huaj, te ballafaquara me aftesite fizike, pervojen profesionale dhe certifikaten e kualifikimit teknik te tyre nga seksionet e punes e te perkrahjes sociale te komiteteve ekzekutive te rretheve e te rajoneve ku behet dhe rregjistrimi ne bashkepunim me Zyren e Emigracionit te Komitetit te Punes e te Perkrahes Sociale.

Kur personat juridike dhe fizike vendas lidhin kontrata punesimi me punedhenesit e huaj, bejna vete zgjidhjen e punonjesve qe do te punesohen jashte shtetit.

Neni 13

Shpenzimet per pergatitjen e percjelljen e dokumentacionit te nevojshem perballohen nga vete personi qe kerkon te punesohet jashte shtetit, ne baze te nje tarife te percaktuar nga Komiteti i Punes dhe i Perkrahes Sociale, ne bashkepunim me Ministrine e Financave.

Neni 14

Komiteti i Punes dhe i Perkrahes Sociale, ne bashkepunim me Ministrine e Arsimit dhe ministrite e institucionet e tjera qendrore, ka te drejta te ngreje kurse kualifikimi me shkeputje nga puna per punenjesit qe do te punesohen jashte shtetit. Shpenzimet per aftesim profesional e nderrim profesional per shtetasit qe nuk jane ne marredhenie pune, perballohen nga shteti, kurse per ata qe jane ne marredhenie pune, nga vete personat.

Neni 15

Keshilli i Ministrave nxjerr rregulla te hollesishme ne zbatim te ketij **LIGJi**.

Neni 16

Ky **LIGJ** hyn ne fuqi menjehere.

Tirane, me 8.10.1991
Nr.i **LIGJit** 7517

Shpallur me dekretin nr.60 date 12.10.1991 te Presidentit te Republikes se Shqiperise Ramiz Alia.

V E N D I M

Nr. 140, datë 03.04.1991

PËR DETYRAT E TË DREJTAT E KOMITETIT TË PUNËS DHE TË EMIGRIMIT EKONOMIK

Në zbatim të dekretit të Presidiumit të Kuvendit Popullor nr. 7477, datë 12.03.1991 "Për lejimin e punësimit jashtë shtetit dhe krijimin e Komitetit të Punës dhe të Emigrimit Ekonomik", Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Komiteti i Punës dhe të Emigrimit Ekonomik ka këto detyra e të drejta kryesore:
 - a) Studion e llogarit burimet e punës të qytetit e të fshatit, sipas rretheve e në shkallë kombëtare, si dhe nevojën e hapjes së vendeve të reja të punës, dhe në bashkëpunim me komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve i pasqyron këto në bilancin e kraheve të punës.
 - b) Evidencon dhe ndjek gjëndjen e forcave të afta të pazëna me punë sipas gjinisë, moshës, profesionit, nivelit arsimor, përbërjes e të ardhurave familjare etj., dhe në bashkëpunim me rrethet, ministritë e institucionet e tjera qendrore studion rrugët e mundësitë për sistemimin e tyre në punë.
 - c) Studion mundësitë për punësimin në vende të tjera të shtetasve shqiptar me banim të përhershëm në RPS të Shqipërisë, lidh marrëveshjet dhe kontratat përkatëse me organet, organizatat ose firmat e huaja, organizon, ndjek dhe përgjigjet për zbatimin e detyrave që dalin në këtë fushë.
 - ç) Studion dhe propozon në organet përkatëse masa me karakter social që lidhen me trajtimin e përkohshëm ekonomik të forcave të pazëna me punë, si dhe organizon e ndjek zbatimin e detyrave në këtë fushë.
 - d) Studion dhe ndjek problemet organizative që lidhen me intensitetin në punë, regjimin e kohëzgjatjen e punës së punonjësve për degë e sektorë të ekonomisë shtetërore e private dhe, mbi bazën e rezultateve e konkluzioneve që dalin, bën propozimet e nevojshme në organet përkatëse.
 - dh) Studion dhe ndjek çështjet që kanë të bëjnë me kualifikimin e rikualifikimin nëpërmjet punës e formave të tjera të punëtorëve që dalin të tepërt në ndërmarrje nga përmirësimet në strukturën e prodhimit, nga rinovimet në teknikë e teknologji, nga ndërprerja e veprimtarisë së prodhimit, ndërtimit etj.
 - e) Ndjek dhe ndërhyr për zbatimin e detyrave për përmirësimin e kushteve të punës së punonjësve.
 - ë) Udhëheq punën metodike, ndjek, ndihmon e kontrollon zbatimin drejt të dispozitave **LIGJore** në fushën e punës e të emigracionit ekonomik.
 - f) Pezullon batimin e akteve nën**LIGJore** të nxjerra nga ministritë, institucioneve të tjera qendrore dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve e rajoneve, kur ato bien në kundërshtim me aktet **LIGJore** për problemet e punës e të emigrimit, deri në shqyrtimin e tyre nga organet kompetente.
 - g) Jep mendim dhe bën vërejtje për projektet e ministrive e të institucioneve të tjera qendrore që lidhen me problemet, të cilat i përkasin fushës së veprimtarisë së komitetit, para se ato të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave; kërkon prej tyre të dhëna të ndryshme për treuesit e punës.
 - gj) Veprimtaria që kryen Komisioni i Planit të Shtetit për këto çështje, i kalon këtij komiteti.
2. Ndaj shtetasve shqiptarë që punësohen në mënyrë të organizuar në vende të tjera, mbi të ardhurat mujore që sigurohen nga puna në valutë të huaj, zbatohet një tatim, masa e të cilit cktohet nga Komiteti i Punës dhe të Emigrimit Ekonomik, në bazë të kriterëve të miratuara së bashku me Ministrinë e Financave.
3. Komiteti i Punës dhe të Emigrimit Ekonomik përfaqson RPSSH në Organizatën

Ndërkombëtare të Punës (ONP), mban lidhje të drejtpërdrejt me organizatat ndërkombëtare të punës e të emigrimit të vendeve të tjera dhe vendos basjkëpunimin me ato në fushën e informacionit, të shkëmbimit të literaturës, të përvojës dhe të kualifikimit për problemet e punës e të emigrimit ekonomik.

4. Komiteti i Punës dhe i Emigrimit është organ kolegjal e **VENDIM**or dhe përbëhet nga kryetari, nënkryetari dhe 11-13 anëtarë nga kuadro e specialistë me përvojë në këtë fushë. Përbërja e tij miratohet nga Kryesia e Këshillit të Ministrave.

Komiteti i Punës dhe të Emigrimit Ekonomik merr **VENDIM** me shumicë votash. Kur kryetari ka mendime të kundërta me shumicën e anëtarëve të komitetit, çështja i paraqitet Kryesisë së Këshillit të Ministrave

Komiteti i Punës dhe të Emigrimit Ekonomik ka aparatit e tij, i cili vepron sipas rregullores së brendshme të miratuar nga kryetari.

5. Në planin e vitit 1991 të shtohen 115 mijë lekë fond page për Komitetin e Punës dhe të Emigrimit Ekonomik me numër punonjësish në organikë 15 vetë, kurse struktura organizative caktohet nga kryetari i këtij komiteti. Komisionit i Planit të Shtetit , në planin e vitit 1991, për veprimtarinë që i kalon këtij komiteti, i pakësohen 115 mijë lekë fond page.

Komisionit i Planit të Shtetit dhe Ministria e Financave të caktojnë mjetet e nevojshme financiare, materiale e valutore për kryerjen e veprimtarisë së tij.

6. Pagat mujore të punonjësve të Komitetit të Punës dhe të Emigrimit Ekonomik të jetë për kryetarin 1.200 lekë, nënkryetarin 1.000 deri 1.100 lekë dhe përgjegjës të sektorit 930 deri 1.000 lekë, kurse për punonjës të tjerë zbatohen pagat për emërtimet përkatëse, të miratuara me **VENDIM**in e Këshillit të Ministrave nr. 88, datë 24.06.1967, lidhja I-1 nr. 2 "Pagat e punonjësve të ministrave dhe të institucioneve të tjera qendrore".

Ky **VENDIM** hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
FATOS NANO

DEKRET

PËR LEJIMIN E PUNËSIMIT JASHTË SHTETIT DHE KRIJIMIN E KOMITETIT TË PUNËS DHE TË EMIGRIMIT EKONOMIK

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës;
Me propozimin e Këshillit të Ministrave;

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Shtetasve shqiptarë me banim të përhershëm në Republikën Popullore socialiste të Shqipërisë u njihet e drejta për të punuar jashtë kufijve të shtetit.

Neni 2

Krijohet Komiteti i Punës dhe i Emigrimit Ekonomik si organ kolegjal e **VENDIM**or në varësi të Këshillit të Ministrave.

Neni 3

Përbërja, detyrat dhe të drejtat e Komitetit të Punës dhe të Emigrimit Ekonomik përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 4

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, më 12.03.1991

Nr. i dekretit: 7477

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI KRYETARI
SIHAT TOZAJ RAMIZ ALIA